


# KËRKIME PEDAGOGJIKE

*Përmbledhje punimesh*

Prishtinë, 2012





**KËRKIME  
PEDAGOGJIKE**

---

*Përmbledhje punimesh*

**Prishtinë, 2012**

**Botues:**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Kryeredaktor:**

Nezir Çoçaj

**Redaksia:**

Bekim Morina

Gani Gajraku

Haxhere Zylfiu

Lirije Bytyqi

Zehrije Plakolli

**Lektor:**

Bekim Morina

**Redaktor teknik:**

Skender Mekolli

## **PËRMBAJTJA**

Arbneshja Mexhuani: Rëndësia e TIK-ut dhe aktivitetëve edukative jashtëshkollore në të nxënëit e pavarur .....	7
M. Sc. Bashkim Ali Azemi: Të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar .....	25
M. Sc. Bekim Morina: Gjuha standarde shqipe në shkollat e Kosovës.....	41
Binak Gërguri & Sylejman Sylejmani: Modelet kurrikulare për profilet profesionale në Qendrat e Kompetencës, nga këndvështrimi i strukturës së planit mësimor .....	59
Mr. Sc. Hajrije Devetaku-Gojani: Zhvillimet në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar .....	77
M. Sc. Ismet Potera: Rëndësia e të dhënave statistike për vendimmarrje në arsim.....	97
M. Sc. Luljeta Bajrami-Shala: Pasqyrim i shkurtër i reformës së sistemit arsimor në Kosovë, 2000-2010 .....	111
M. Sc. Lirije Bytyqi-Beqiri: Planifikimi dhe organizimi i piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve mësimore në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë .....	135
Sahare Reçica: Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë .....	159
M. Sc. Safete Statovci-Shala: Organet e shkollës dhe funksionimi i tyre .....	183
MA. Osman Buleshkaj & M. Sc. Selim Mehmeti: Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave në Kosovë – instrumente për vetëvlerësim të performancës dhe vetëzhvillim profesional .....	203
Zehrije Plakolli: Planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës.....	213

## *Parathënie*

“Kërkime Pedagogjike - përmbledhje punimesh” paraqet vazhdimësinë e përpjekjeve të IPK-së për të ofruar ndihmë profesionale për çështje të teorisë dhe të praktikës arsimore. Edhe në këtë numër janë trajtuar tema të rëndësishme, të cilat do të nxisin edhe shqyrtime të këtyre çështjeve. Mësuesit, por edhe studentët, të cilët janë orientuar në mësimdhënie, kanë nevojë për literaturë profesionale, në të cilën trajtohen tema nga praktika shkollore. Temat e trajtuara në këtë numër paraqesin ose pikëpamjen e autorit për problemin e trajtuar, ose janë nisje për diskutim dhe trajtim më të thelluar të asaj fushe.

Të gjitha temat e trajtuara nga autorët (hulumtues të IPK-së) paraqesin çështje të preokupimit të tyre si hulumtues në fushat përkatëse. Shumë prej tyre paraqesin përpjekjen e autorëve për të integruar aspektet teorike të çështjeve të trajtuara dhe ndërlidhjen e tyre me aspektet apo gjendjen në praktikën arsimore të ne.

Synimi ynë, si institut, është që nëpërmjet trajtesave të këtilla, hulumtimeve dhe analizave, t’u ofrojmë praktikuesve (punonjësve) të arsimit, politikëbërësve dhe komunitetit arsimor në përgjithësi, pasqyrimin e gjendjes dhe rekomandime për përmirësimin e praktikave arsimore.

Në këtë numër lexuesit mund të gjejnë trajtesa dhe analiza për çështjet që e preokupojnë shkollën/arsimin në Kosovë, si: Rëndësia e teknologjisë për nxënie të pavarur dhe të vetorganizuar, gjuha standarde shqipe në shkolla, zhvillimet e reja në Planet dhe Programet, rëndësia e përdorimit të të dhënave për përmirësimin e arsimit, reforma në arsim, rëndësia e aktiviteteve jashtëkurrikulare, mbështetja e fëmijëve me nevoja të veçanta, standardet e përgatitjes profesionale për drejtorë të shkollave, planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës etj. Secili

punim i qaset aspektit arsimor nga këndvështrimi autorial, bazuar në praktika dhe teori aktuale, dhe paraqet përpjekjet e autorit për të ofruar qasje të dobishme për mësimdhënësit, studentët dhe të interesuarit e tjerë për çështje të caktuara të arsimit.

Çmoj përkushtimin e të gjithë hulumtuesve, të cilët kanë paraqitur problemet me të cilat përballet arsimi parauniversitar dhe rekomandimet, me synim përmirësimin e gjendjes.

Revista është e hapur për të gjithë dashamirët e arsimit dhe mirëpresim bashkëpunimin me të gjithë ata që e ndiejnë të nevojshme të shtrojnë ose të vënë në diskutim çështjet e arsimit në Kosovë, veçanërisht me mësimdhënësit.

Mbetet që lexuesit të gjykojnë për aspektet e trajtuara në punimet që po i ofrojmë.

Komentet dhe sugjerimet profesionale janë të mirëseardhura, si dhe çdo kontribut qëllimor për avancimin e formatit profesional të botimeve të IPK-së.

Dhjetor, 2012

Nezir Çoçaj, kryeredaktor i botimit





Arbnesha Mexhuani

## RËNDËSIA E TIK-ut DHE AKTIVITETEVE EDUKATIVE JASHTËSHKOLLORE NË TË NXËNIT E PAVARUR

### **Hyrje**

Dihet se për një kohë të gjatë, i vetmi burim dijesh për nxënësit ka qenë shpjegimi i mësuesit dhe libri, si dhe varësia nga mësuesi, ndërsa sot përparimet në shkencë, në teknikë e në teknologji, si dhe informimi i shpejtë, ndikojnë pozitivisht për të bërë ndryshime të thella në organizimin e procesit mësimor. Sot ato kanë bërë të mundur që të modernizohen teknikat e kërkimit e të përhapjes së informacionit që merren nga burime të ndryshme. Përmes këtyre metodave dhe teknikave bashkëkohore, edhe Korniza e Kurrikulumit për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, parasheh që mësimdhënia dhe mësimnxënia të mbështet edhe në integrimin e çështjeve ndërrkurikulare si: teknologjia informative e komunikimit (kompjuteri, interneti, video, televizori, etj) dhe aktiviteteve edukative jashtëshkollore (ekskursioneve, vizitave në muze, ekspozitave të ndryshme, manifestimeve kulturore, etj). Përveç kësaj, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka nxjerrur Udhëzimin Administrativ, që përmes tij rregullohet mënyra e organizimit dhe e realizimit të vizitave, shetitjeve, ekskursioneve dhe manifestimeve kulturore në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë<sup>1</sup>. Duke u bazuar në këtë dhe duke pasur parasysh se të gjitha këto janë pjesë e procesit mësimor dhe mund të integrohen në çdo lëndë mësimore, që shkollat shumë pak i japin hapësirë, atëherë përpjekja ime ka qenë, që të

---

<sup>1</sup> Shih Udhëzimin Administrativ për piknikët, vizitat, shetitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, të nxjerrur në vitin 2008  
[http://www.masht.gov.net/advCms/documents/35\\_UA\\_Eskurzioni\\_lektura.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/35_UA_Eskurzioni_lektura.pdf)

analizojë rëndësinë e të nxënimit të pavarur, si dhe rolin e mësimdhënësve për fuqizimin e të nxënimit përmes metodave dhe aktiviteteve të ndryshme, që organizohen në shkollë dhe jashtë saj. Punimi Rëndësia e TIK-ut dhe aktiviteteve edukative jashtëshkollore në të nxënimit e pavarur synon t'u vijë në ndihmë, mësuesve, nxënësve dhe të gjithë aktorëve të arsimit parauniversitar, që të njihen me rëndësinë dhe vlerat e TIK-ut dhe aktiviteteve edukative jashtëshkollore që organizohen në institucione shkencore dhe kulturore.

Përdorimi i TIK-it në shkollë dhe aktivitetet edukative jashtëshkollore, kanë vlerë të madhe edukative, për arsye se ofrojnë alternativa të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, gjë që kjo shkollat i shpie që të kenë një mësimdhënie bashkëkohore. Përmes tyre, të nxënësit, zbulohet potenciali i tyre për të nxënë si dhe aftësitë e tyre kërkuese. Nxënësit përmes këtyre metodave dhe aktiviteteve jashtëshkollore mund të zhvillojnë mësim të gjithanshëm.

Studimi është i ndarë në kapituj dhe secili prej tyre synon të zërthejë një aspekt të edukimit përmes trajtimit të koncepteve dhe veprimtarive praktike që mund të zhvillohen në shkollë dhe jashtë saj. Kapitulli i parë trajton rëndësinë e të nxënimit të pavarur të nxënësve dhe kjo mund të arrihet duke vendosur një bashkëpunim mësues-nxënës, brenda në shkollë dhe jashtë mësim. Punimi përshkohet nga ideja që mësimdhënësit duhet të largohen nga tradicionalizmi pedagogjik duke përdorur metoda, teknika dhe strategji të përshtatshme që lehtësojnë dhe nxisin të nxënësit pavarësinë e tyre në nxënie.

Në kapitullin e dytë përshkruhet rëndësia e teknologjisë informative që fuqizon të nxënimit e pavarur të nxënësve. Teknologjitë mësimore janë të shumëllojshme, mirëpo ato që janë përshkruar në analizë janë kompjuteri, interneti, video, televizori dhe kasetofoni të cilat ushtrojnë ndikim të ndjeshëm në procesin mësimor. Përdorimi i këtyre mjeteve shpie në forcimin e të nxënimit kritik e krijues gjatë periudhës shkollore dhe gjatë gjithë jetës. Në kapitullin e tretë është përshkruar rëndësia e institucioneve jashtë shkolle dhe aktivitetet me karakter mësimor.

Aktivitetet jashtëshkollore të cilat janë cekur në analizë janë: Ekskursionet, vizitat në muze, organizimi i ekspozitave të ndryshme, bibliotekat, manifestimet kulturore, etj. Organizimi në mënyrë edukative i të gjitha këtyre aktiviteteve jashtëshkollore, ndihmon në rritjen e aftësive të nxënësve për të bërë punë kërkimore krijuese, për të fituar shprehje praktike, për të zgjeruar horizontin e tyre dhe për t'i aftësuar nxënësit që teorinë ta lidhin me praktikën.

### **Rëndësia e të nxënësve të pavarur**

Të nxënësve të pavarur është një formë mësimi që ka parasysh faktin se fëmijët dallohen nga njëri tjetri nga karakteristikat e veta personale dhe natyra e inteligjencës. Puna e pavarur e nxënësve nuk ngulmon në kryerjen e detyrave të njëjta për të gjithë nxënësit, por në zgjedhjen e detyrave që u përgjigjen më së miri<sup>2</sup>. Për të vetëdijësuar nxënësit për rolin dhe rëndësinë e të nxënësve të pavarur në shkollë dhe në institucione të tjera shkencore, artistike, mësuesit qysh në klasën e parë fillore duhet të ndikojnë te nxënësit për të formuar mendimin për të nxënësve të pavarur. Kjo arrihet duke vendosur një bashkëpunim shkencor mësues-nxënës brenda procesit mësimor, domethënë duke përcaktuar se çfarë duhet të bëjë mësuesi dhe çfarë duhet e mund të bëjë nxënësi në veprimtaritë mësimore që organizohet brenda dhe jashtë mësimi. Nxënësit përmes angazhimit të mësimdhënësve duhet të fitojnë hap pas hapi aftësi për të kërkuar, gjetur e përpunuar dijet. Kjo është një punë që vazhdon gjatë tërë viteve të shkollimit dhe i shpie ata me kalimin e kohës drejt studimit të tyre të pavarur.

Të nxënësve të pavarur është më produktiv në çiftëse mësuesi e luan rolin e mbikëqyrësit, këshilluesit dhe vlerësuesit, se sa duke ofruar ndihmë. Cilido që të jetë niveli i punës së pavarur apo raportet ndërmjet punës së mësuesit dhe punës së pavarur të nxënësve, drejtimi i tyre nga

---

<sup>2</sup> Musai Bardhyl, Psikologji edukimi, zhvillimi, të nxënësve, mësimdhënësia, f. 269, Shtëpia botuese Pegi, Tiranë 1999

mësuesi është i domosdoshëm (Gaçe, 1988)<sup>3</sup>. Roli i të nxënit të pavarur nuk qëndron vetëm për nxënësit sa janë në shkollë, por kjo i hap rrugë shndërrimit të tij në një studim individual. Mënyrat e të nxënit që fuqizojnë të nxënit e pavarur të nxënësve janë të shumta, mirëpo, disa prej tyre që janë cekur në punim si p.sh. të nxënit përmes teknologjisë informative të komunikimit (kompjuteri, interneti, video, kasetofoni, televizorit) si dhe aktiviteteve edukative jashtëshkollore (ekskursionet, vizitat në muze, ekspozitat e ndryshme, bibliotekat, manifestimet kulturore etj.)

### **Rëndësia e TIK-ut për të nxënit e pavarur**

Me aplikimin e kompjuterëve për mësim, ndryshon edhe sistemi i deritashëm i mësimdhënies, dhe nga mësimdhënia tradicionale, kalohet në mësimdhënie bashkëkohore.

Mësimi përmes teknologjisë mësimore ndihmon krijimin e një ambienti më efektiv të mësimi, për arsye se mediumet e ndryshme e lehtësojnë dhënien e informatave në mënyra të ndryshme (audio, vizuale, tekstuale), duke iu përshtatur nxënësve me modele të ndryshme të mësimi si dhe duke iu mundësuar atyre të kenë qasje në materiale të ndryshme mësimore në mënyrë të pavarur. Përmes teknologjisë informative nxënësit motivohen më shumë për mësim si dhe kushtëzohet përqendrimi i vëmendjes duke zhvilluar të menduarit e tyre kritik gjatë hulumtimit të tyre të pavarur. Përveç kësaj, nxënësit përmes TIK-ut mund të zgjedhin mënyrën e të mësuarit duke përvetësuar njohuri dhe shkathtësi në mënyrë të pavarur, përmes një procesi aktiv të të nxënit, ndërsa mësimdhënësit do të jenë lehtësues dhe koordinator të procesit mësimor. Nxënësit do të kenë rolin kryesor në procesin mësimor. Teknologjia informative e komunikimit që përdoret për mësimdhënie dhe nxënie përfshin çdo burim që përdoret për të

---

<sup>3</sup> Pedagogët e Mëdhenj .Nga J.S. Brubacher,G.Calo,R.Dottrens,W.Flitner,V.Garcia Hoz, V. Mallinson, P. Mesnard, L. Meylan, J. Moreau, J. B. Piobetta, R. Plancke, R. Savioz, nën drejtimin e Jean Chateau ,f. 165 Shtëpia botuese Toena ,Tiranë 2000

lehtësuar apo ndihmuar procesin e mësimnxënies, ndërsa nga mësimdhënësit kërkohet një këshillim i suksesshëm. TIK-it gjatë procesit të të nxënies ka krijuar, që kultura e të nxënies të ndryshojë, praktikat mësimore të kthehen më shpejt në fusha kërkimesh e zbatimesh. Në çoftëse këto metoda zbatohen me sukses në shkollë, atëherë të nxënies do të krijohet aftësia për të nxënies e pavarur, aktiv, kritik e krijues gjatë tërë periudhës shkollore dhe më pas.

## **Kompjuteri**

Në kushtet bashkëkohore të aplikimit të elektronikës në mësim, sot me të madhe përdoren kompjuterët. Kompjuteri mund të vihet në shërbim të edukatorit dhe të përdoret për drejtimin e klasës apo shkollës. Kjo mënyrë e të nxënies, favorizon të mësuarit e pavarur nga ana e nxëniesve, për punën e tyre kërkimore në shkollë dhe jashtë saj. Përmes kompjuterit mund të realizohet mësimi individual dhe roli i mësuesit duhet të forcohet, ai mund të kthehet në një bashkënxënës të vërtetë. Nxëniesit hulumtojnë burime të ndryshme nga kompjuteri, dhe kjo bën që në mësim të zhvillohet debat i mësuesve dhe nxëniesve për tema të caktuara mësimore. Përdorimi i kompjuterit bën të mundur që nxëniesi në çdo lëndë të lirohet nga disa veprime mekanike që i kryen kompjuteri brenda një kohe tepër të shkurtër. Kjo ndihmon që nxëniesit kohën e fituar ta shfrytëzojnë për punë kërkimore në mënyrë të pavarur.

## **Interneti**

Interneti ndihmon që brenda një kohe të shkurtër të merret informacioni dhe ofron mënyra të llojlojshme për nxëniesit dhe arsimtarët në procesin e mësimin, duke u mundësuar atyre të hulumtojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha lëndët mësimore. Përveç tekstit që kanë në duar mësimdhënësit, interneti iu mundëson edhe gjetjen e të dhënave të ndryshme me burime plotësuese të informacioneve. Interneti lehtëson për mësimdhënësit dhe nxëniesit bashkëpunimin duke e zvogëluar nevojën që bashkëpunëtorët të jenë në vendin e njëjtë. Roli i

mësimdhënësve në përdorimin e internetit për mësim është i rëndësishëm. Ka mënyra të ndryshme që mësimdhënësit mund t'i stimulojnë nxënësit për përdorimin e drejtë të internetit. Ata duhet të kërkojnë nga nxënësit që komunikimin në mënyrë të bërë përmes e-mail. Kjo është vetëm një mënyrë mësimore që nxënësit, sidomos ata të klasave të ulëta, i mëson për përdorimin e e-mail-it. Përveç kësaj, nxënësit duhet të edukohen për përdorimin në mënyrë pedagogjike të internetit, gjë që do të ndikojë në mësimin e tyre gjatë gjithë jetës.

### **Televizori i qarkut të mbyllur**

Sot me organizimin televiziv të punës mësimore, aplikohet televizori i qarkut të mbyllur. Në këtë formë të shfrytëzimit të televizorit në mësim, imitimet televizive janë të kufizuara vetëm në lokalitetet shkollore. „Një nga këto forma quhet televizion me karakter interno dhe janë të kufizuara në objektet e caktuara. Emisionet televizive të qarkut të mbyllur për nevojat e punës mësimore, për herë të parë filluan të përdoren më 1956, në SHBA, në shtetin Merilend, ku me sistemin kabllovik u lidhën 43 shkolla”<sup>4</sup>.

Televizori i qarkut të mbyllur luan një rol shumë me rëndësi në shkolla gjatë procesit mësimor. Përmbajtja televizive duhet bërë sipas detyrave dhe qëllimeve që janë në program të shkollës. Përcjellja programore nga televizori i qarkut të mbyllur bëhet me lidhje direkte në monitor të veçantë, me anën e kabllove. Monitorët vihen në shkolla në pozicione të përshtatshme që mësimdhënësit, nxënësit dhe udhëheqësit e shkollës, mund të njoftohen edhe me informacione të ndryshme që lidhen me organizimin e shkollës si: informacione, lajmërimi nga më të ndryshmet, që kanë të bëjnë me procesin mësimor.

Marrja e informacioneve të nxënësve përmes televizorit bëhet përmes shumë shqisave dhe është mjet themelor i konkretizimit të mësimin. Këto informacione nxënësit i marrin njëherazi grupi i nxënësve ose edhe individualisht gjë që mundëson të nxënësit e pavarur të nxënësve.

---

<sup>4</sup> Didaktika, Njazi Zylfiu, f. 246, Prishtinë, 2001

## **Kasetofoni**

Kasetofoni shërben sidomos për të mësuar gjuhë të huaja, për të bërë incizime e intervista, për të regjistruar seanca diskutimesh apo debatesh mësimore. Kasetofoni mund të shfrytëzohet individualisht, poashtu edhe në grup. Ky mjet ndihmon edhe për rritjen e efektivitetit të procesit të të nxënës, sidomos gjatë zhvillimit të debateve mësimore në kohën e përsëritjeve si dhe mund të përdoret edhe për të realizuar vetëkontroll.

## **Video**

Përmes videos mund të organizohen modele të ndryshme të mësimdhënies dhe nxënies. Kjo mënyrë ka përparësi sepse përmes videos, montimet mund të bëhen sipas kërkesave mësimore. Nxënësit duke shfrytëzuar njëherësh zërin dhe figurën, zhvillojnë imagjinatën, mendimin, kritik, krijues e aktiv në mënyrë të pavarur. Nxënësit duke i regjistruar materialet e regjistruara kanë mundësinë t'i shikojnë sa herë të ketë nevojë. Duke përdorur këtë, ata mund të bëjnë përforsimin e njohurive të kaluara dhe vetëvlerësimin e tyre. Shumë gjëra që regjistrohen nga emisionet televizive mund të shfrytëzohen gjatë debateve krijuese për të konkretizuar problemet për të cilat diskutohet. Për studimin e vlerave të ndonjë pjese teatrale apo të një festivali të këngëve, video luan rol të rëndësishëm, sepse mund të rishikohen sekuencat e regjistruara, për të mbështetur ose kundërshtuar vlerat që shfaqin diskutantët.

## **Integrimi i TIK-ut në detyrat e shtëpisë**

Përmes integrimit të TIK-ut në detyrat e shtëpisë, bëhet aktivizimi i drejtpërdrejtë dhe i pavarur i nxënësve për përforsimin e lëndës mësimore pa mbikëqyrje nga ana e mësimdhënësit. Detyrat e shtëpisë ndikojnë në zgjerimin e njohurive dhe realizohen në mënyrë të pavarur nga puna e planifikuar me plan-program.

Roli i përdorimit të teknologjisë informative për detyrat e shtëpisë të nxënësve është shumë i rëndësishëm për arsye se mundëson që nxënësit, përveç zgjidhjes së detyrave përmes librave, ata mund të përdorin edhe internetin duke hulumtuar dhe duke zgjeruar njohuritë e tyre për një çështje apo lëndë mësimore. Përmes kësaj, ata mund të mësohen se si të përdorin burime nga interneti. Roli i mësimdhënësve në këtë rast është orientues. Ata mund të kërkojnë nga nxënësit hulumtime në internet për tema të caktuara mësimore në mënyrë që t'i stimulojnë që internetin ta përdorin për nevoja pedagogjike. Nga mësimdhënësit, në procesin mësimor, kërkohet të përdorin strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe nxënies. Ata kanë nevojë të përtërijnë metodat e tyre tradicionale. Mësimdhënësia bashkëkohore kërkon që të ketë llojllojshmëri të mënyrave për mësimnxënie.

Në çoftëse mësimdhënësit i stimulojnë nxënësit që ta përdorin kompjuterin në mënyrë edukative edhe në shtëpi, duke u bazuar se sot, gati të gjithë fëmijët janë të pajisur me kompjuter, atëherë edhe prindërit, do të jenë të vetëdijshëm se për çka e përdorin fëmijët e tyre atë. Përveç kompjuterit, edhe televizori mund të luaj rol të rëndësishëm në detyrat e shtëpisë. Në programet televizive ka emisione të ndryshme shkollore; për mësimin e gjuhëve të huaja, drama, kuize, sport, histori, shkencë, etj. Duke u bazuar në këtë, mësimdhënësit mund t'i orientojnë nxënësit se çka të shikojnë që mund t'i kombinojnë edhe me temat mësimore që i kanë në planprograme dhe këto emisionet televizive mund të shfrytëzohen gjatë debateve krijuese në shkollë për të konkretizuar problemet për të cilat diskutohet. Në programe të ndryshme televizive ka emisione me shkrimtarë, artist, drama, pjesë teatrale të ndryshme, filma, etj, që mësimdhënësit të gjitha këto mund t'i integrojnë në procesin mësimor në formë të debateve dhe diskutimeve të ndryshme me nxënësit, gjë që nxënësit i shpie në zhvillimin e mendimit kritik e krijues dhe zhvillon aftësitë e tyre komunikuese. Për të integruar TIK-un për nevoja pedagogjike në



shtëpi, gjithnjë kërkohet orientim dhe vlerësim nga mësimdhënësit, si dhe mbikëqyrje nga prindërit.

### **Roli i institucioneve shkencore për veprim edukativ**

„Detyra e edukimit u besohet institucioneve dhe personave të caktuar. Institucionet shkollore janë dy llojesh: ato për të cilët edukimi nuk përbën strukturën dhe qëllimin kryesor dhe ato që janë krijuar në radhë të parë për veprimin edukativ. Midis të parëve përmendim koleksionet shkencore, artistike, teknike, teatrot, etj, ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë institucionet shkollore që nga kopshtet e fëmijëve e gjer në universitet<sup>5</sup>.

Puna mësimore e nxënësve në shkollë dhe vizitat e nxënësve në institucione shkencore dhe artistike janë dy linja që me kalimin e kohës shkrihen në një dhe e krijojnë mundësinë për nxënësit që të bëjnë punë të mirëfilltë shkencore, domethënë për të kërkuar e gjetur vlera të reja e të panjohura. Të gjitha këto institucione mund të kenë një vlerë edukative. Nxënësit në pamje të parë duket se ndjekin dy shkolla, mësimin në shkollë dhe punën kërkimore në institucione të tjera shkencore dhe kulturore. „Të nxënët përmes aktiviteteve mësimore është një shkollë e një tipi të veçantë ku secili futet vetë“. Ndjekja e dy shkollave përnjëherë fuqizon procesin e formimit të nxënësve. „Nga mësimi në shkollën e parë nxënësit do të ndahen një ditë, ndërsa nga puna kërkimore në institucione të ndryshme shkencore nuk do të shpëtohen kurrë. Kjo luan rol të madh për arsye se nxënësit i kthen në nxënës permanent që është shkalla më e lartë e procesit të kërkimit e të përvetësimit aktiv, kritik e krijues të dijeve”<sup>6</sup>.

---

<sup>5</sup> Pedagogët e Mëdhënj .Nga J. S. Brubacher, G. Calo, R. Dottrens, W. Flitner, V. Garcia Hoz, V. Mallinson, P. Mesnard, L. Meylan, J. Moreau, J. B. Piobetta, R. Plancke, R. Savioz, nën drejtimin e Jean Chateau f. 270 Shtëpia botuese Toena ,Tiranë 2000

<sup>6</sup> Jean Chateau, Pedagogët e mëdhënj, f 271, Shtëpia botuese TOENA, Tiranë , 2000

## **Aktivitetet jashtëshkollore edukative që fuqizojnë të nxënit e pavarur**

Aktivitetet shkollore për nxënësit kanë një rëndësi të madhe edukuese dhe formuese. Këto aktivitete edukojnë tek nxënësit iniciativën, vetëveprimin si dhe zhvillojnë aftësitë krijuese, hulumtuese, për të nxënit në mënyrë të pavarur. Organizimi në mënyrë sistematike dhe me karakter edukativ i aktiviteteve të ndryshme shkollore, ndihmon në rritjen e aftësive të nxënësve për të bërë punë kërkimore, krijuese, për të fituar shprehje praktike, për të zgjeruar horizontin e tyre dhe për t'i aftësuar që teorinë ta lidhin me praktikën. Përmes këtyre, nxënësi mund të përfitojë një mësim të gjithanshëm, ndërsa roli i mësuesit është të krijojë për nxënësit, edhe në aktivitete mësimore hapësira didaktike sa më të gjëra për të zhvilluar mendimin e tyre të pavarur aktiv, kritik e krijues. Aktivitetet shkollore janë të shumta, por disa prej tyre janë: Bibliotekat, muzetë, ekspozitat, ekskursionet, manifestimet kulturore etj.

### **Bibliotekat**

Bibliotekat janë institucione edukativo-arsimore. Bibliotekat janë djepi kryesor i dijes. Shkolla duhet të njohë rolin dhe rëndësinë e bibliotekave dhe vijueshmëria e nxënësve në bibliotekë ka një rëndësi të madhe, sepse nxënësit përmes studimit të tyre në biblioteka, ata mund të kthehen në një forcë aktive, që thithin informacione nga burime të ndryshme dhe aftësohen që ta përpunojnë atë. Shkolla si institucion i krijuar për shoqërinë, mund të ndikojë në kultivimin e ndjenjës tek nxënësit për kulturën dhe rëndësinë e librit dhe bibliotekës si institucion edukativo arsimor. Leximi i librave, siç thoshte teoricieni amerikan i letërsisë Northrop Fraj, e edukon imagjinatën, ai na e zbulon përfytyrimin tonë për të mundshmen. Gjithashtu, sipas Çarlz Tempëll "diskutimi ynë për veprat duhet të nxjerrë paralelet ndërmjet asaj që

përshkruhet në libra dhe nuancave të jetës së nxënësve”<sup>7</sup>. Biblioteka në rend të parë vlen për përdoruesit dhe vetë ata i japin kuptim asaj, përndryshe nuk do të duhej të ekzistonte fare. E drejta e një personi për ta shfrytëzuar një bibliotekë nuk duhet të mohohet ose të kufizohet për shkak të origjinës, moshës, historisë, apo pikë-pamjeve të tij. Bibliotekat, të cilat kanë në dispozicion hapësira ekspozuese apo dhoma takimesh, shoqërisë që i shërbejnë, duhet t’i ofrojnë këto hapësira në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh moshën, përkatësinë e individëve apo të grupeve të cilat kërkojnë ta shfrytëzojnë atë hapësirë<sup>8</sup>.

Në kuadër të veprimtarive dhe perspektivës zhvillimore, Biblioteka mund t’i ofrojë shkollave (nxënësve ) këto aktivitete:

- Të ofrojë librin nxënësve, duke filluar nga të gjitha grup moshat;
- Të shërbejë si qendër informative (jo vetëm për librin);
- Të mbahen seminare dhe kurse te ndryshme kulturore dhe shkencore;
- Të bëjë këshillime të ndryshme në lëmin e bibliotekarisë;
- Të hap ekspozita (të librit, të piktorëve të vegjël, ekspozita në çdo fund vit);
- Të themelojë grupe dhe të zhvillojnë aktivitete për grup moshë të ndryshme;
- Të mbajë takime me shkrimtarë;
- Të promovojë libra;
- Të mbajë orë letrare;
- Të inkurajojë nxënësit që merren me shkrime, duke ndihmuar në botimin e librave të tyre.

## **Muzetë**

"Shkolla është mjedisi kryesor për formimin e qytetarit. „Pierr Burdië thoshte me të drejtë se njeriu i rritur nuk do të hyjë kurrë në një muze,

---

<sup>7</sup> [http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Libri\\_per\\_Seminarin\\_4.pdf](http://www.masht-gov.net/advCms/documents/Libri_per_Seminarin_4.pdf).

<sup>8</sup> [http://www.biblioteka-ks.org/Biblioteka\\_Botime/Viti1Nr32004.pdf](http://www.biblioteka-ks.org/Biblioteka_Botime/Viti1Nr32004.pdf)

nëse nuk e ka bërë këtë së paku një herë kur ishte ende i mitur. Prandaj, hapi i parë është forcimi i lidhjes me shkollën për të krijuar projekte didaktike të afërme me programet që zhvillohen në klasë. Nuk kemi të bëjmë më vetëm me nxënësin që dëgjon mësuesin, por me nxënësin që merr pjesë gjallërisht në vizitë, për të shijuar me të gjitha shqisat e mundshme, kryeveprat e artit"<sup>9</sup>.

Vizitat e nxënësve në muze të ndryshëm duhet të jenë me synim didaktik. Secili nxënës që viziton muzetë e ndryshëm orientohet në interesat e tij intelektuale. Nxënësit bien në kontakt të drejtpërdrejt me objektet që vizitojnë, me njerëzit që i administrojnë, me komentatorë shkencorë, me literaturë unike me dokumente arkivale që nuk mund të merren në rrugë të tjera. Kudo që mund të shkohet dhe të vizitohet, mund të gjendet informacion që shërben për zgjerimin e fondit vetjak të dijeve. Nxënësit kanë mundësi të njihen përveç me pasuri të qytetit ku jetojnë, ata përmes ekskursioneve të ndryshme shkollore mund të njihen edhe me pasuritë e muzeve të vendeve të tjera në rajon dhe me gjerë. Në muze nxënësit mund të njoftohen me gjëra të vjetra që nga antikiteti e deri në kohërat tona. Rëndësia e vizitave në muze qëndron në atë se nxënësit i zhvillojnë shkathtësitë e iniciativës, ata mund të hartojnë plan të hulumtimit dhe të kërkojnë burime të ndryshme që të arrijnë në informacionet e nevojshme për vete. Mësuesit përmes rolit të tyre orientues që kanë, mund të zbulojnë aftësitë e tyre krijuese dhe kërkuese që ndikojnë në të nxënit e tyre të pavarur.

## **Ekspozitat**

Organizimi i ekspozitave në shkollë dhe vijueshmëria e nxënësve në ekspozita jashtë shkolle; ka rëndësi të madhe sepse kjo ndikon që nxënësit ta njohin artin në mënyrë aktive dhe krijuese. Secili nxënës në një ekspozitë mund të orientohet nga përshtypja e tyre e gjërave që hasin në ekspozitë. Ekspozitat e fotove, pikturave, kostumeve kombëtare etj, kanë vlerë edukative dhe mund të shërbejnë për

---

<sup>9</sup> <http://sq.radiovaticana.va/articolo.asp?c=466728>

formimin e personalitetit moral të nxënësve. Nxënësit mund të njoftohen për së afërmi me trashëgiminë kulturore të tyre dhe të popujve të tjerë që kanë trashëguar nga e kaluara ,që e bëjnë shumë të veçantë kulturën dhe identitetin kombëtar të trevave të ndryshme. Nxënësit gjatë ekspozitave të ndryshme nuk mjaftojnë vetëm të vëzhgojnë dhe të përshkruajnë gjërat, por është e domosdoshme që të përqendrohen me vëmendje edhe në drejtimin e kapjes së tendencave të reja të zhvillimit të tyre. Teoria e edukimit duhet të njohë strukturën e pasurive kulturore, që përmes tyre mund të zhvillohet një mësimdhënie e gjithanshme. Duhet pasur parasysh që qëllimi final i të mësuarit nuk është vetëm transmetimi i njohurive, por zhvillimi i ndijimit të vlerave<sup>10</sup>.

### **Ekskursionet**

Ekskursionet janë pjesë përbërëse e punës mësimore përmes të cilave mund të bëhet lidhja e shkollës me jetën që nxënësve i krijon mundësi të zgjerojnë njohuritë e tyre në mënyrë të gjithanshme. Puna jashtë shkolle përmes ekskursioneve luan një rol të rëndësishëm në edukimin dhe formimin e nxënësve. Ekskursionet shkollore meqenëse realizohen jashtë shkollës, atëherë këto forma mundësojnë njohjen e objekteve, veprimeve dhe dukurive të ndryshme që ngjallin interesim te nxënësit. Meqenëse shkollat janë pjesë e shoqërisë dhe zhvillojnë veprimtarinë e vet në një mjedis të caktuar, atëherë puna e mësimdhënësit duhet të zgjerohet edhe në aktivitete jashtë shkolle. Mësimdhënësit duhet të jenë hallkë lidhëse ndërmjet shoqërisë dhe shkollave<sup>11</sup>.

---

<sup>10</sup>Pedagogët e Mëdhenj. Nga J. S. Brubacher, G. Calo, R. Dottrens, W. Flitner, V. Garcia Hoz, V. Mallinson, P. Mesnard, L. Meylan, J. Moreau, J. B. Piobetta, R. Plancke, R. Savioz, nën drejtimin e Jean Chateau, f.269. Shtëpia botuese Toena Tiranë 2000

<sup>11</sup> Grup autorësh, Pedagogjia, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, 1988, f. 584, Originali: Pedagogjia, Pedagosko-knjizhevni zbor, Zagreb,1978, përkthyer nga, Isa Bajcinca, 1988

Ekskursionet janë të pazëvendësueshëm sepse njohuritë e përfituara gjatë ekskursioneve janë mjaft të konkretizuara, rrënjosen më lehtë dhe mbahen mënd më gjatë. Vrojtimi përmes ekskursionit ndihmon sidomos nxënësit e ciklit të ulët për zhvillimin e gjithanshëm të shqisave, e shtyn nxënësin të krahasojë, analizojë, të zbulojë shkakun dhe pasojat si dhe të kryejë veprime mendore dhe praktike për problemet arsimore. Temat mësimore, që mësimdhënësit i kanë në plan program mund t'i realizojnë në mënyrë mjaft të suksesshme me anë të ekskursioneve. Çdo gjë që ka të bëjë me mësimin mund të lidhet me jetën jashtë shkolle, meqenëse shkollat janë pjesë e shoqërisë dhe janë krijuar për shoqërinë. Ekskursionet kërkohen të planifikohen me kohë, të përgatiten dhe të organizohen mirë për të arritur objektivat e planifikuara. Ekskursionit ka metodikën e vet dhe përmban këto elemente: qëllimin, vendin dhe kohën kur do të zhvillohet, përgatitjen e bazës materiale për të vrojtuar dhe grumbulluar material faktik, programimin e punës dhe të kohës, planifikimin e punës për të gjithë klasën ose të grupeve të veçantë.

Për planifikimin e ekskursioneve duhet pasur parasysh këto faza:

**Parapërgatitja:** Ekskursionit kryhet me qëllim që nxënësit të njohin objektet, dukuritë, proceset dhe ngjarjet në mjedisin natyror të tyre.

U tregohet nxënësve objekti ose dukuria që do të vrojtohet dhe arsytet përse do të vëzhgojnë. Pas kësaj i bëhet i qartë nxënësve, qëllimi i vëzhgimit, koha e vrojtimit dhe përfundimi i vrojtimit. U kërkohet nxënësve që gjatë vrojtimit të shënojnë pyetjet që u lindin atyre për t'i diskutuar ato pas vrojtimit.

**Zhvillimi i ekskursionit:** Në këtë fazë mësuesi paraqet qëllimin e ekskursionit para nxënësve, cakton detyrat, mbahen shënime, plotësohen formularë dhe regjistrohen vrojtimitet.

**Mbledhja e të dhënave:** Të dhënat e marra nga vrojtimi mbahen shënim. **Përpunimi i të dhënave.** Nxënësit bëjnë përpunimin e të dhënave duke përdorur grafikë, tabela.

Raportimi i përfundimeve: Nxënësit raportojnë përfundimet e vrojtimit në mjedise të ndryshme.

Publikimi dhe vlerësimi i përfundimeve: Në këtë fazë bëhet paraqitja e përfundimeve të ekskursionit, përgatitja e një raporti vlerësues nga mësuesi.

## **Manifestimet kulturore**

Manifestimet kulturore zënë një vend të rëndësishëm në fushën e edukimit. Aktivitetet e organizuara, kulturore janë në funksion të forcimit të etikës së shkollës dhe vlerave edukative të nxënësve. Kur bëhet fjalë për aktivitete në shkollë, është shumë me rëndësi që vetë shkollat të iniciojnë dhe të realizojnë aktivitete të përbashkëta jashtë mësimore (shfaqje/ festime, koncerte, orë letrare, promovime etj.) dhe aktivitete jashtëshkollore (gara në mes shkollash, vizitë të ngjarjeve kulturore etj.) të cilët përfshijnë një numër më të madh nxënësish. Aktivitetet kulturore, duhet të jenë të planifikuara me kujdes e profesionalizëm, të miratuara nga të gjithë autorët dhe aktorët, përfitues të planit vjetor të shkollës, dhe të jenë sa më afër moshës së nxënësve, që plotësojnë dëshirat e tyre, mbresëlënëse, nxitëse, inkurajuese dhe motivuese, në funksion të formimit të vlerave patriotike, etike, e qytetare të nxënësve. Roli i mësuesit në të gjitha këto aktivitete jashtë shkolle është shumë i rëndësishëm. Mësuesit duhet të përkufizojnë qëllimin e manifestimeve, të bisedojnë me nxënësit se çka kanë mësuar dhe si mund të zbatojnë në praktikë. Nxënësit kanë mundësi që përmes manifestimeve të ndryshme kulturore siç janë koncertet e ndryshme për fëmijë, promovimet e librave nga shkrimtarë të ndryshëm, vijueshmëria e tyre në karvanë të shkrimtarëve, panairë të librave, kino dhe teatro, etj., të fuqizojnë të nxënësit e tyre të pavarur. Vijueshmëria e nxënësve në kino dhe teatro ndikon po ashtu në të nxënësit e tyre të pavarur dhe ngjallë shpirtin e tyre kritik e krijues, domethënë favorizon shndërrimin e tyre në një nxënie individuale të gjithanshme. Mësuesit mund t'i orientojnë nxënësit të shkruajnë skenarë, dhe nxënësit sipas skenarëve

të tyre mund të luajnë role, që më në fund kjo mund edhe të incizohet, dhe nxënësit mund të vlerësojnë vetveten. Rëndësia e të gjitha këtyre aktiviteteve qëndron në atë se te nxënësit rritet motivacioni për mësim, krijohet gjindshmëria për situata të paparashikueshme, nxitet të menduarit kritik dhe zhvillimi emocional dhe social i nxënësve.

## **Përfundime**

Tekstet shkollore nuk duhet të jenë burimi i vetëm i mësimdhënësve dhe i nxënësve dhe që qasja e tyre të kufizohet vetëm në tekstet shkollore. Ata duhet të kenë qasje në një spektër më të gjerë të burimeve mësimore, duke u nisur nga përdorimi i TIK-it në shkollë dhe realizimi i aktiviteteve shkollore me karakter edukativ. Korniza e Kurrikulit për arsimin fillor dhe të mesëm, më shumë duhet t'i kushtojë rëndësi këtyre aktiviteteve shkollore, duke u bazuar në atë që e parasheh një mësimdhënie dhe nxënie të integruar në procesin mësimor. Mësimdhënësit mund të praktikojnë strategji të ndryshme të mësimdhënies, meqenëse janë të njoftuar për dallimet në stilet e të nxënësve ndërmjet nxënësve. Nga mësimdhënësi kërkohet, që nxënësit e tyre t'i stimulojnë që TIK-un ta përdorin si teknologji mësimore, duke i mbikëqyrur dhe orientuar, që këto mjete t'i integrojnë në procesin mësimor. Nga shkollat kërkohet që të jenë më të hapura me shoqërinë, sepse shkolla është mjedisi kryesor për formimin e qytetarit, prandaj roli i shkollave është edhe forcimi i lidhjeve me institucione jashtë shkollore, për të krijuar projekte didaktike që janë të përafërta me programet shkollore. Shkollat duhet t'i kushtojnë rëndësi të madhe po ashtu edhe aktiviteteve mësimore (vizitave në muze, ekskursioneve bibliotekave dhe manifestimeve të ndryshme kulturore). Këto aktivitete, nuk duhet realizuar pa ndonjë qëllim të caktuar edukativ. Qëllimi i realizimit të tyre duhet të jetë edukativ, që nxënësit duke qenë pjesëmarrës në të gjitha këto aktivitete, ata do të njihen më mirë me kulturat e vendeve të ndryshme artet, që të gjitha këto janë të përfshira në planprograme mësimore, mirëpo kërkohet nga mësimdhënësit që të



bëjnë integrimin e tyre në procesin mësimor. Nxënësit përmes tyre mund të nxënë në mënyrë të pavarur njohuri të gjithanshme. Ndërsa, mësimdhënësit, vlerësimin e nxënësve kanë mundësi të bëjnë nga perspektiva shumë dimensionale, p.sh, kreativiteti, shkathtësitë për zgjedhjen e problemit, shkathtësitë e larta intelektuale, etj. Nga shkollat kërkohet të bashkëpunojnë sa më shumë edhe me institucione tjera private, publike dhe me organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Komuniteti së bashku me shkollat duhet bashkëpunuar për të vendosur qendrat e burimeve mësimore, ku nxënësit mund të udhëzohen nga mësimdhënësit, në identifikimin e burimeve të përshtatshme, që kanë të bëjnë me temat e tyre mësimore dhe më gjerë. Nxënësit kanë nevojë për t'i zgjeruar njohuritë e tyre të cilat në shkollë i marrin vetëm përmes tekstit shkollor. Shkollat ende nuk kanë arritur të vetëdijësojnë nxënësit për rëndësinë e TIK-ut dhe aktiviteteve shkollore për edukim, që përmes tyre mund të realizohet edhe mësimi në distancë, i cili u mundëson nxënësve që të hulumtojnë në mënyrë të pavarur, gjë që u nevojitet për arsimimin e tyre gjatë gjithë jetës.

#### Literatura:

1. Dunn, R., & Dunn, K. (1993). Teaching secondary students through their individual learning styles: Practical approaches for grades 7-12 Boston: Ally and Bacon.
2. Gardner, Howard. Mendja e pashkolluar, Tiranë, 2003,
3. Musai Bardhyl. Psikologji edukimi, zhvillimi, të nxënës, mësimdhënia, Shtëpia botuese Pegi, Tiranë 1999.
4. Mialaret Gaston. Pedagogjia e Përgjithshme, 1995
5. Njazi Zylfiu, Didaktika, Botues, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2011
6. Pedagogët e Mëdhenj. Nga J. S. Brubacher, G. Calo, R. Dottrens, W. Flitner, V. Garcia Hoz, V. Mallinson, P. Mesnard,

- L. Meylan, J. Moreau, J. B. Piobetta, R. Plancke, R. Savioz, nën drejtimin e Jean Chateau, Shtëpia botuese Toena, Tiranë 2000
7. Pedagogjia, Pedagosko-knjizhevni zbor, Zagreb, 1978, përkthyer nga, Isa Bajçinca, 1988
  8. Vuji Mark. Drejt vetëmësimit dhe vetëformimit intelektual permanent, Shtëpia botuese, Kuvend Tiranë 2003
  9. Burime nga interneti:
  10. [http://www.biblioteka-ks.org/Biblioteka\\_Botime/Viti1Nr32004.pdf](http://www.biblioteka-ks.org/Biblioteka_Botime/Viti1Nr32004.pdf)
  11. [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Libri\\_per\\_Seminarin\\_4.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Libri_per_Seminarin_4.pdf).
  12. [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/35\\_UA\\_Eskurzioni\\_lektura.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/35_UA_Eskurzioni_lektura.pdf)
  13. <http://sq.radiovaticana.va/articolo.asp?c=466728>

M. Sc. Bashkim Ali Azemi

## TË MËSUARIT E VETORGANIZUAR DHE VETËDREJTUAR

### **Hyrje**

Të mësuarit gjatë gjithë jetës është i nevojshëm për të rriturit, në mënyrë që vazhdimisht të përpiqen të përmirësojnë njohuritë e tyre, aftësitë dhe kompetencat, dhe gjithashtu për të zhvilluar personalitetin e tyre në shumë aspekte.

Ndërrimi i paradigmës prej arsimimit të të rriturve në të mësuarit e të rriturve si proces i vetorganizuar dhe i vetëplanifikuar po bëhet një eksperiencë e përhapur në lëmenjtë e ndryshëm në arsim, në mjedis, në punë dhe në veprimtari kulturore për të gjithë të rriturit. Të mësuarit gjatë gjithë jetës shihet si domosdoshmëri, për shkak të kapërcimit gjithmonë e më shpejt të dijeve. Nuk mjafton thjesht ajo që ka mësuar i rrituri, por lind domosdoshmëria që të vijohet të mësuarit jo vetëm për të tanishmen, por edhe për të ardhmen.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës po kthehet në një faktor vendimtar për individin, për ekonominë dhe për shoqërinë tonë, në përpjekje për t'iu përgjigjur kërkesave të reja, por edhe të papërcaktueshmërisë së kërkesave të së ardhmes.

Aftësitë e nevojshme në fushat e punës e të profesionit mund të ndryshojë shumë me kalimin e kohës, kështu që i rrituri duhet të vazhdojë të mësuarit, që të jetë i përgatitur për ndryshimet e mundshme. Një nga përfitimet e të mësuarit gjatë gjithë jetës është se i rrituri mund të përmirësojë aftësitë e tij në një punë të tanishme apo të ndihmojë të fitojë aftësi të reja.

Të mësuarit e organizuar dhe vetëdrejtuar është shumë i rëndësishëm për ata që planifikojnë për karrierën ose kanë nevojë për aftësi ndërfunksionale në një punë të tanishme. Të mësuarit e vetëdrejtuar për të

zhvilluar aftësitë ndërfunksionale, të cilat e ndihmojnë të rriturin në procesin vetjak të arsimimit, është tipik për epokën tonë.

Rëndësia dhe efektet e tij vihen gjithmonë e më fort në qendër të vëmendjes publike, në mënyrë që të rritet vetëpërgjegjshmëria dhe pjesëmarrja në arsimim, jo vetëm për grupe specifike të të rriturve, por për të gjithë të rriturit.

Në frymën e kërkesës për një të mësuar gjatë gjithë jetës njeriu i rritur duhet të mësojë për zhvillimin e tij profesional. Disa të rritur arsimohen, ngase punëdhënësit e tyre kërkojnë punonjës për të mësuar aftësi të reja për të ruajtur punën e tyre të tanishme apo të ngrihen në poste që kërkojnë nivele të avancuara të aftësive për punë. Edhe pse të mësuarit gjatë gjithë jetës është i rëndësishëm për një punë, nuk është patjetër vetëm për përfitim. Disa të rritur mund të zgjedhin të arsimohen për të zhvilluar një interes të ri ose për të përmirësuar aftësitë në një hobi të tanishëm. Për shembull, mund të marrë kurse për të zhvilluar aftësitë në një sport, gjuhë të huaj, artizanale, apo instrumente muzikore. Koncepti i të mësuarit të vetëdrejtuar në këtë analizë do të trajtohet me specifikat që janë të ndërlidhura veçanërisht për të rriturit.

### **Koncepti i të mësuarit të vetorganizuar**

Koncepti për të mësuarit e vetorganizuar dhe në mënyrë të pavarur ka ekzistuar gjithmonë, pasi liria e dhe mundësia e të rriturit për të mësuar ka ekzistuar edhe në shoqëritë parasokratike, megjithatë rëndësia e të mësuarit të vetëdrejtuar në kohën tonë është rritur për shkak të lidhjes me arsimin gjatë gjithë jetës apo në kuadër të paradigmës së mësimit gjatë gjithë jetës. Ky i vetëmësuar natyror, i kushtëzuar nga nevojat dhe ballafaqimet e të rriturit me sfidat e jetës, është një pikënisje e mirë për të mësuarit gjatë gjithë jetës. *Të mësuarit e vetëdrejtuar nënkupton përpunimin konstruktiv të informacioneve, përshtypjeve dhe përvojave nga vetë i rrituri, sipas nevojave të tij.*

Për të mësuarit e vetëdrejtuar është e rëndësishme të dihet se është i qëllimshëm, që në radhë të parë varet nga dëshirat dhe mundësitë tona për të mësuar, çka është e rëndësishme të mësojmë se si të menaxhojmë procesin e të mësuarit, si të mësojmë nga eksperiencia jonë dhe si të marrim aksione, iniciativa për të mësuarit personal.

Të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar varion nga të mësuarit sipas profesionit, për punësim, për ngritje profesionale, e deri te përmbushja e kërkesave individuale të vetë të rriturit. Pra, pothuajse çdo lloj i të mësuarit që vetorganizohet dhe vetëdrejtohet nga i rrituri për qëllim pasurimi personal apo profesional, si një mjet për përmirësimin e aftësive të tyre, interesave dhe shanseve të tyre për avancim në karrierë.

Të mësuarit e vetorganizuar dhe të vetëdrejtuar nuk i referohet vetëm të rriturve që tashmë e zotërojnë një diplomë universitare, por si një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, i cili do të duhej të përfshinte të gjithë të rriturit, si nevojë e kohës dhe i shtyrë nga faktorë personalë, socialë dhe kognitivë. Andaj, çdo i rritur është përgjegjës për fitimin e njohurive dhe aftësive të reja, por gjithnjë duke vendosur vetë kur do të mësojë dhe si do të mësojë.

Të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar mund të përfshijnë kurse në klasë, punëtori gjatë fundjavës dhe seminare. Përmbajtja dhe metodat e të mësuarit varen nga i rrituri, në varësi të kërkesave personale ose profesionale. Kështu, të rriturit, të cilët janë të interesuar për marrjen e njohurive dhe aftësive për qëllime punësimi, zakonisht përzgjedhin kurse ose trajnime që janë të njohura nga punëdhënësit ose organizatat që kërkojnë punonjës.

## **Vetorientimi si kërkesë për të mësuar të vetëdrejtuar**

Vetorientimi si kërkesë për të mësuar të vetëdrejtuar është i rëndësishëm në radhë të parë për të zhvilluar aftësitë për planifikim, orientim dhe kontroll të të mësuarit.

Është e ditur se i rrituri është vetëdrejtues, planifikues dhe vendimmarrës se si dhe kur të marrë pjesë në arsim gjatë gjithë jetës. Këto planifikime parapërcaktohen varësisht nga perceptimi i të rriturve, ku hyjnë:

1. Nevoja për të njohur;
2. Të mësuarit vetëkonceptues;
3. Roli i eksperiencave (përvojave) të atij që mëson;
4. Gatishmëria për të mësuar;
5. Orientimi për të mësuar;
6. Motivimi, që përcaktohet nga vija shtytëse, nxitje e brendshme apo e jashtme.

Prandaj, këta të rritur kanë një plan sistematik për drejtimin e përgatitjes personale ose profesionale të tyre, përmes arsimit gjatë gjithë jetës, pra në këtë aspekt merret parasysh çdoherë përmasa personale dhe kohore.

Në planin personal i rrituri përqendrohet në ndërlikohen e brendshme të zhvillimit mendor, fizik dhe shpirtëror të tij, ndërsa përmasa kohore kërkon që e kaluara, e tashmja dhe ardhmja e të rriturit të lidhen apo kushtëzohen nga shqetësimet dhe përparësitë e së sotshmes, e po ashtu edhe nga perceptimi dhe sfidat që pritet t'i ketë i rrituri në të ardhmen.

I rrituri bën përzgjedhjen e të mësuarit për arritjen e atyre qëllimeve, pra merr parasysh jo vetëm dëshirën, por edhe efektin e tyre në përditshmëri. Të mësuarit e vetëdrejtuar bëhet me qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive vepruese për jetën. Sipas Cyril O Houle, pjesëmarrja në arsimin e të rriturve varet nga orientimi dhe fokusi i orientimit:

1. Të mësuarit e të rriturit është i orientuar dhe i qëllimshëm;
2. Të mësuarit e të rriturit është i orientuar në aktivitete;
3. Të mësuarit e të rriturit është i orientuar në njohuri<sup>12</sup>.

---

<sup>12</sup> Knowles, Malcolm S. Elwood F. Holton III, and Richard A. Sanson. 2005. *The Adult Learner*.f. 40

Zakonisht, i rrituri të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar e ndërlihdh me nevojat e tij për njohuri të përditësuar, që është e dobishme për të kryer punën e tij dhe karrierën, megjithatë të mësuarit e të rriturit të vetëdrejtuar dhe vetorganizuar mund të gjenden në një shumëllojshmëri të gjerë të fushave, duke përfshirë arsimin shëndetësor, arsimin ekologjik etj.

Është e ditur se të rriturit vetë e caktojnë se kush do të kontrollojë të mësuarit e tyre, megjithatë, varësisht nga qëllimi i të mësuarit përcaktohet edhe **kontrolli i të mësuarit**, p.sh:

Në të mësuarit e paqëllimshëm	=	s'ka kontroll të të mësuarit
Në të mësuarit e vetëplanifikuar	=	i rrituri vetë e kontrollon të mësuarit
Në të mësuarit përmes medimeve elektronike	=	ndahet kontrolli në mes të vijuesit dhe autoritetit të jashtëm
Në të mësuarit që orientohet nga autoritetet	=	autoritetet e kontrollojnë në formë të organizuar ose individuale të mësuarit <sup>13</sup>

### **Roli i preferencave (parapëlqimeve) në të mësuarit e vetëdrejtuar**

Të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar varet nga parapëlqimet për të mësuar, individualisht ose në grup.

Preferencat e të rriturit për të mësuar në grup:

- Pëlqen orientimin grupor dhe të mësuarit bashkëpunues;
- Preferon strukturë të qartë dhe organizim të materialit;
- Kujdeset (ndjek, merr) për kompetencat sociale dhe të mjedisit;
- I përgjigjet mirë punës në grup;
- Preferon udhëzimet nga jashtë.

Preferencat e të rriturit për të mësuar individualisht:

- I pëlqen të zgjidhë vetë problemet;

<sup>13</sup> Po aty, f. 55.

- Preferon situatat në të cilat ka figura dhe i momerizon ose i organizon informacionet;
- Pëlqen ndryshimin e njohurive në situata neveriste (të ngjashme si në novela);
- Preferon pavarësimin në të mësuar;
- Të mësuarit që i përgjigjet inkurajimit dhe të mësuarit zbulues<sup>14</sup>.

Ka shumë lloje të ndryshme të të mësuarit të vetorganizuar dhe vetëdrejtuar në dispozicion për të rriturin, andaj i rrituri duhet të qartësojë përshtatshmërinë e të mësuarit që i përgjigjet stileve të tyre për të mësuar.

### **Rëndësia e stilit të të mësuarit e vetëdrejtuar dhe vetorganizuar**

Mendojmë se për të mësuarit e vetorganizuar dhe të vetëdrejtuar është e rëndësishme që të rriturit të njohin stilet e të mësuarit të tyre dhe parapëlqimet individuale të tyre në mënyrën e të mësuarit para se të fillojnë të mësuarit.

Stilet e të mësuarit mund të përkufizohen thjesht si **mënyra karakteristike individuale, se si të rriturit në mënyrën më efektive dhe më frytdhënëse perceptojnë, përpunojnë, ruajnë dhe rikujtojnë përmbajtjen apo atë çfarë mësojnë.**

Çdo i rritur mendohet të ketë stilin e tij të të mësuarit, andaj të rriturit ndryshojnë nga njëri-tjetri, por kanë edhe karakteristika të përbashkëta, si:

1. Të gjithë të rriturit mund të mësojnë;
2. Mjediset, mjetet, burimet dhe udhëzimet e të mësuarit zgjidhen nga vetë i rrituri;
3. Njerëz të ndryshëm kanë aftësi të ndryshme për të nxënë.

---

<sup>14</sup> Knowles, Malcolm S. Elwood F. Holton III, and Richard A. Sanson. 2005. *The Adult Learner*.f. 211.



Pra, stili i të mësuarit është karakteristikë individuale, për shkak të cilësive të trashëguara, arsimimit paraprak, përvojave të veçanta të jetës etj.

Kështu, disa të rritur që i përkasin stilit divergjent e perceptojnë informacionin konkretisht dhe e përpunojnë në mënyrë reflektive. Ata janë të aftë të japin pikëpamje të ndryshme në situata konkrete për të njëjtin problem, nga këndvështrime të ndryshme të një situatë, si dhe janë të zotë në përgjithësimin e ideve, pra i përkasin **stilit divergjent**.


Ndërsa, disa të rritur e perceptojnë informacionin në mënyrë abstrakte më shumë në ide dhe koncepte abstrakte sesa në vlerat praktike të një teorie dhe e përpunojnë atë vazhdimisht, andaj i përkasin **stilit përvetësues**.

Të rriturit që e perceptojnë informacionin në mënyrë abstrakte me rend dhe janë shumë të kujdesshëm në detaje, por megjithatë e përpunojnë atë në mënyrë reflektive, i përkasin **stilit konvertues**.

Përderisa të rriturit që e perceptojnë informacionin konkretisht pëlqejnë ndryshimet dhe janë fleksibël, kur e bëjnë (zbatojnë) atë në mënyrë aktive, i përkasin **stilit të përshtatësit**.

### **Të mësuarit e vetëdrejtuar që mbështet në përvojë dhe nga përvoja**

Të mësuarit e vetëdrejtuar fiton rëndësi praktike kur lind nga përvoja në të mësuar dhe mbështetet në përvojën e të mësuarit. Në literaturën andragogjike flitet për “ciklin i të mësuarit të vetëdrejtuar nga përvoja”, që e krijoi Kolbi, e cila përfshin katër faza të të mësuarit, ku i rrituri që mëson “prek” përvojën, reflektimin, të menduarin dhe të vepruarit në një proces që përsëritet dhe që i rrituri është përgjegjës për çfarë po mësohet.



Modeli i të mësuarit sipas Kolbit

Koncepti i David Kolb, adaptuar dhe dizajnuar sipas Alan Chapman 2005-06 bazuar në modelin e të mësuarit sipas Kolbit, 1984.

Në fillim i rrituri duhet të provojë diçka drejtpërdrejt - përvoja konkrete. Më pas, reflektimi mbi përvojën e nxit të bëjë përgjithësim dhe, së fundi, i rrituri zbaton atë përvojë si bazë për të mësuarit në të ardhmen.

### **Rëndësia e të mësuarit të individualizuar për të mësuarit e vetëdrejtuar dhe vetorganizuar**

Të mësuarit e përshtatur individualisht ndryshon nga të mësuarit e varur, sepse janë të rriturit që zgjedhin vetë, përcaktohen se në çfarë lloji të kursit të regjistrohen dhe vetëdrejtohen varësisht nga sfidat e paraqitura nga puna e tyre dhe përditshmëria e tyre në përgjithësi.

Të mësuarit është një proces individualist, sepse njeriu nuk nxë çka i mësojnë, por çfarë e sheh si të rëndësishme për të mësuar. Pra, në vend të orareve të ngurta, me një ofertë që u drejtohet të gjithë pjesëmarrësve, i rrituri përmes arsimit të individualizuar bën përshtatjen e kohës, përzgjedh ofertën e të mësuarit, varësisht nga synimi i tij.

Secili duhet të mësojë se si të mësojë nga jeta dhe për jetën, në mënyrë që t'i përballojë pengesat dhe ballafaqimet me problemet. Të mësuarit e të rriturit bazohet në radhë të parë nga këndvështrimi individual, për mundësinë e zbatimit në situata të ndryshme jetësore. Pra jo si një qellim në vete të mësuarit për të mësuarit, por si rëndësi dhe funksion shërbyes për jetën e tij.

I rrituri nuk merr pjesë në një kurs vetëm për kënaqësi dhe që nuk do t'i hyjë në punë tani apo në të ardhmen. Do të thotë se nga aspekti pragmatik i rrituri merr pjesë në një kurs ose kualifikim në dobi për jetën e tij, që është:

- E rëndësishme për të rriturin;
- Reale (që mund të zbatohet në përditshmëri nga i rrituri);
- I përgjigjet nevojave të të rriturit;
- Ofron mundësi për punësim;
- Lehtëson pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme;
- I referohet jo vetëm të tanishmes, por edhe të ardhmes së të rriturit.

Të rriturit marrin pjesë në arsim gjatë gjithë jetës nëse arsimimi i tyre do të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve të jetës së përditshme, të cilat rrjedhin nga përgjegjësia e tyre, siç janë puna, obligimet familjare etj.

### **Të mësuarit e vetëdrejtuar përmes internetit dhe mjeteve të tjera telekomunikuese**

Zhvillimi i formave të reja të të mësuarit për të rritur rrjedh si pasojë e informatizimit, globalizimit dhe individualizimit. Mediet e reja mund ta

mbështetin të mësuarit e vetëdrejtuar, por nuk mund t'i zëvendësojnë rrugët "klasike të mësimit", megjithatë mund t'i plotësojnë ato, andaj duhet përkrahur aktivitetet e të mësuarit të vetëdrejtuar që u përgjigjen mundësive të të rriturit, pra të gjitha modalitetet e arsimit gjatë gjithë jetës.

Të mësuarit përmes internetit dhe mjeteve telekomunikative e kanë bërë më të lehtë pjesëmarrjen e të rriturit në arsimim, pa pasur nevojë të lërë punën<sup>15</sup>. Pjesa më e madhe e të rriturve të punësuar sot kanë në dispozicion mundësinë e të mësuarit 'online', nga shtëpia apo nga zyra ku punojnë.

Në epokën në të cilën jetojmë të mësuarit e vetëdrejtuar përmes internetit po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, për faktin se të mësuarit e vetëdrejtuar ndihmon të rriturin të arsimohet nga largësia, e jo vetëm nga arsimimi tradicional.

Të mësuarit e vetëdrejtuar mund të realizohet me ndihmën e mediave, pra çdo përdorim i veçuar dhe i pavarur nga koha dhe vendi i mjeteve në ndihmë të të mësuarit.

### **Pengesat për të mësuarit e vetorganizuar dhe vetëdrejtuar**

Në përgjithësi mund të themi se mundësitë për të mësuar të vetorganizuar dhe të vetëdrejtuar janë të kufizuara dhe të ndërvarura nga dy faktorë:

1. Nga zotërimi i dobët i aftësive bazike dhe
2. Problematika e financimit të kurseve për pjesëmarrës.

Të rriturit që nuk kanë fituar aftësi të mjaftueshme në arsimin fillestar, sidomos për aftësitë bazike, dhe që më vonë nuk u është ofruar shansi i dytë, janë pothuajse analfabetë funksionalë dhe mundësia e tyre për të mësuar të vetorganizuar është shumë e vogël dhe si pengesë e dytë del financimi. Nga pamundësia e financimit rrjedhimisht varen edhe mundësitë për të mësuarit e vetorganizuar.

---

<sup>15</sup> Report, Early Intervention for Lifelong Learning, Noëgian Ministry of Education and Research, 2006-2007. fq.37

Ndërsa, për të mësuarit e vetëdrejtuar janë me rëndësi gatishmëria dhe aftësitë themelore që duhet t'i zotërojë një i rritur, të cilat luajnë rol qendror në të mësuarit e vetëdrejtuar:

1. Kushti paraprak për të mësuarit e vetëdrejtuar të të rriturit është a janë në gjendje t'i përkushtohen arsimimit vetjak, ngase i rrituri që mëson ka një besim në vete dhe aftësitë e tij.
2. Aftësia në përzgjedhjen e ofertës mësimore, sa oferta i përgjigjet kërkesave aktuale të të rriturve dhe a përputhet ajo me nevojat faktike të tyre.
3. Sa i rrituri është në gjendje të zotërojë gjuhët e huaja, në mënyrë që të këtë informacionin e duhur dhe të mund të mbështetet në teknologjinë telekomunikative për të mësuarit e tij.

### **Si mund të ndihmohet të mësuarit e vetëdrejtuar?**

Të mësuarit e të rriturve nuk është një veprim i manipuluar nga jashtë, por një veprim aktiv – konstruktiv, i vetë atij që mëson, megjithatë edhe të mësuarit e vetëdrejtuar kërkon nxitje, përkrahje dhe shoqërim, në mënyrë që të rriturit të reflektojnë, drejtojnë, kontrollojnë dhe zhvillojnë qëndrimin personal ndaj të mësuarit.

Të mësuarit e të rriturve bëhet ndodh në mënyra të ndryshme. Disa gjëra mësohen e përshtaten vetë, disa të tjera kanë nevojë për ndihmë, përmes këshillimit, instruktimit etj., ndërsa disa zhvillohen nëpërmjet pjesëmarrjes në kurse, me seminare, udhëtime, studime etj.

Realizimi i të mësuarit aktiv- konstruktiv nuk do të thotë se i rrituri tërë kohën, derisa mëson, duhet të jetë vetëm. Ai mund të këshillohet, të marrë përvoja, të nxitet dhe mbështetet sa herë atij i nevojitet ajo. Sepse, shpeshherë, jo të gjithë të rriturit kanë mundësi dhe aftësi që arsimimin e tyre ta bëjnë në formën e duhur.

Te arsimit i të rriturve nuk përdoret koncepti “jap mësim”, por ndërmjetësoj, nxis, këshilloj, orientoj, moderoj, instruktoj etj<sup>16</sup>.

---

<sup>16</sup> Dokumente themelore ndërkombëtare për arsimin dhe të mësuarit. IIZ & DVV, Prishtinë. 1997.

Kjo ndihmë bëhet përmes përkrahjes nga profesionistë të kualifikuar, zakonisht andragogë.

Ndihma e tyre mund të bëhet përmes:

- **Këshillimit për të mësuar të vetëdrejtuar**

Këshillimi përdoret si pikënisje në procesin e mësimit të vetëdrejtuar, varësisht nga problemet konkrete dhe situatat në të cilat gjenden të rriturit. Roli i këshilluesit është që gjatë procesit të punës me të rritur në përvetësimin e dijeve ai të japë informacione, të nxisë dhe të mbështesë përgjegjësinë dhe mëvetësinë e individit për të vetëmësuar.

- **Moderimit për të mësuar të vetëdrejtuar**

Gjatë procesit të moderimit, në qendër të vëmendjes vihet problematika personale e të rriturve pjesëmarrës, për dallim nga këshillimi ku personi që mëson udhëhiqet metodikisht nga drejtuesi, qartësohet për situatën e tij dhe vihet në gjendje të mendojë alternativa veprimi, si dhe të zgjedhë se cilat janë ato domosdoshmëri të të mësuarit që lypsen.

- **Instruktimit për të mësuar të vetëdrejtuar**

Në qendër të mësimdhënies instruktuese është përqimi i dijeve dhe përvetësimi i diturive të reja, pra mësohen dituri të reja për një temë.

- **Trajnimit për të mësuar të vetëdrejtuar**

Gjatë trajnimit në plan të parë apo në qendër duhet të jetë veprimi praktik, pra të rriturit bëjnë ushtrime praktike dhe më pas diskutohen me trajnerin. Pra, trajnimi bëhet jo vetëm për të ushtruar mënyra të sjelljes, por edhe të reflektohet mbi to.

Nevoja e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të rriturin nuk mund të plotësohet vetëm nga përqimi i dijeve profesionale nga mësimdhënësi, por më tepër nga gatishmëria e atij që mëson. Megjithatë, përkrahja

përmes shërbimeve informuese, orientuese dhe atyre të këshillimit nuk duhet të mungojë.

## **Përfundim**

Përmes të mësuarit të vetorganizuar dhe vetëdrejtuar të rriturit ia mundësojnë vetes së tyre që të marrin më shumë pjesë në shoqëri. Prandaj, ky i mësuar ua mundëson këtë për të mbështetur dhe për të përmirësuar aftësinë konkurruese, ngase të rriturit duhet të jenë në gjendje të përballen me sfidat dhe të gjejnë rrugën e tyre në një shoqëri të bazuar në dije. Në këtë kontekst, sa më e zhvilluar të bëhet shoqëria kosovare, aq më e madhe do të jetë nevoja e arsimimit dhe pjesëmarrjes në arsim gjatë gjithë jetës.

Andragogjisë, si shkencë e arsimimit të të rriturve, i del detyrë të vëre në dispozicion koncepte didaktike e metodike që u përshtaten të rriturve për të mësuarit e vetorganizuar dhe të vetëdrejtuar, andaj zhvillimi i mëtejshëm në këtë aspekt është i lidhur ngushtë me sigurimin profesional të personelit andragogjik. Arsimi gjatë gjithë jetës në shoqërinë tonë nuk duhet të jepet si detyrë, obligim, vetëm për nxënësit në kurrikulë, por si një mundësi që u ofrohet të gjithë të rriturve.

Iniciativa për të mësuarit e vetëdrejtuar bëhet në radhë të parë nga nevoja e të rriturit për plotësimin e nevojave të tij, megjithatë të mësuarit e vetëdrejtuar nxitet duke e ndërlidhur pjesëmarrjen e të rriturve me mundësinë e tyre për punësim, përkrahjen me projekte që për qëllim kanë ofrimin dhe nxitjen e të rriturve për pjesëmarrje në arsimim gjatë gjithë jetës dhe në të njëjtën kohë të mënjanohej të gjitha format e përjashtimit dhe kufizimit, duke u ofruar mundësi inkuadrimi dhe mbështetje, qoftë me ofrimin e kurseve afër vendbanimeve, me një pagesë simbolike.

Duke e ditur se të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe veçanërisht arsimimi i të rriturve luajnë sot një rol kyç në përmirësimin e ecures individuale, shoqërore dhe ekonomike, është e rëndësishme që MASHT-i dhe OJQ-

të të ofrojnë informim, këshillim dhe mbështetje për ofertat konkrete – kurse të veçanta, programe për arsimimin, broshura etj., duke marre parasysh kërkesat e të rriturve për punësim.

Si do të mund të ndërthureshin rekomandimet me sistemin arsimor dhe politikat arsimore për të rriturit, për ndërveprimin midis institucioneve publike dhe private, duke mos harruar këtu edhe rolin e medieve të shkruara dhe elektronike, për të zhvilluar një kulturë për mësim gjatë gjithë jetës, ku qytetarët mësojnë në mënyrë të pavarur dhe të vetëpërgjegjshme. Kur atë e shohin si një kërkesë e bashkëkohësisë, në të cilën jetojnë dhe kur te ta zhvillohet aftësia e të zgjedhurit të formave të ndryshme të arsimimit. Të gjithë të rriturit duhet të marrin përgjegjësitë e tyre për të mësuar gjatë gjithë jetës, megjithatë përkrahja e shoqërisë nuk duhet të mungojë asnjëherë.

## **Literatura**

1. Bejta, Pajtim, “Të nxënit në shoqërinë e sotme”, Tiranë, 2003.
2. Biehler, F. Robert, Jack Snowman, “Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie”, ISP, “Nënë Tereza”, Tiranë, 2004
3. Gardner, Howard. (2003), “Mendja e pashkolluar”, Tiranë.
4. Grillo, Dr. Kozma, Fjalor Edukimi (Psikologji–Sociologji–Pedagogji), ISP, Tiranë, 2002.
5. Malcolm S. Knowles, Elwood F. Holton III, Richard A. Swanson, The Adult Learner, 2005, Gulf Publishing Company, Houston, Texas.
6. Puna me të rriturit, udhëzues për përgatitjen e trajnerëve, KEC, Prishtinë, 2001.

## **Dokumente, revista dhe raporte hulumtimi**

1. Dokumente themelore ndërkombëtare për arsimin dhe të mësuarit. IIZ & DVV, Prishtinë, 1997.



2. Hyrje në harmonizimin e strukturave arsimore në Evropë, projekti 'Tuning', Prishtinë, 2007.
3. Report, Accomplishing Europe through education and training, education training youth, European commission, Brussels, Luxemburg, 1997.
4. Report, Early Intervention for Lifelong Learning, Nowegian Ministry of Education and Research, 2006-2007.
5. Griggs, S. A. (1991). Learning Styles Counseling. *ERIC Digest*. Ann Arbor: ERIC Clearinghouse on Counseling and Personnel Services, University of Michigan,  
<http://www.ascd.org/services/eric/erichmgs>.
6. Instituti i Studimeve Pedagogjike (2005), manual trajnimi për përgatitjen e trajnuesve, Tiranë, ILAR.
7. The Kolb Learning Style Inventory -Version 3.1. (2005). Technical Specifications: Conceptual foundation-Exsperiential learning teori and individual learning stiles.  
<http://www.hayresourcesdirect.haygroup.com>



M. Sc. Bekim Morina

## GJUHA STANDARDE SHQIPE NË SHKOLLAT E KOSOVËS

### **Hyrje**

Në shkollat e Kosovës lënda Gjuhë shqipe dhe letërsi zhvillohet në ciklin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, përmes të cilës mësohet gramatika e saj, drejtshkrimi dhe normat e tjera gjuhësore. Gjuha, si mjet komunikimi, nuk nënkupton vetëm anën komunikuese, prandaj synimi kryesor i mësimin të gjuhës shqipe në shkolla është të zotëruarit e normave të saj, me qëllim të plotësimit të nevojave në shoqëri. Ndër objektivat e saj janë mësimi, ruajtja dhe përhapja e standardit të shqipes, me anë të planeve dhe programeve, teksteve shkollore dhe mësimdhënësve adekuatë, nëpërmjet metodave dhe teknikave të ndryshme.

Duke e ditur se pa kulturë gjuhësore nuk mund të ketë njerëz të kulturuar dhe niveli kulturor i një populli dëshmohej me nivelin e përdorimit të gjuhës, zotërimin e normave të saj, si kudo në shoqëritë e zhvilluara, edhe në shkollat tona mësohet gjuha standarde dhe kultura gjuhësore.

Meqenëse gjuha standarde shqipe është përballur me vështirësi të shumta që nga formimi i saj, qëllimi i analizës ishte të kuptojmë se sa përdoret gjuha standarde në shkolla, cili është niveli i zotërimit të saj nga mësimdhënësit dhe nxënësit, dhe cilat janë pengesat dhe vështirësitë që hasin sot shkollat në përdorimin e shqipes standarde, pas reformave të shumta vitet e fundit në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Kemi trajtuar rolin e kurrikulave dhe teksteve shkollore në përdorimin e gjuhës standarde në shkolla, nivelin e përgatitjeve të mësimdhënësve

dhe kujdesin e tyre ndaj gjuhës, ndikimin e medieeve, familjes dhe rrethit, si dhe ndikimin e opinioneve për rishikimin e gjuhën standarde në shkolla.

Për trajtimin e kësaj teme jemi bazuar në hulumtimin e bërë vitin e kaluar në disa shkolla të Kosovës me temë “Norma e shqipes së shkruar në hartimet e nxënësve të klasave të nënta në Kosovë”, kemi shfletuar punime të ndryshme shkencore, profesionale, që kanë të bëjnë me shqipen standarde dhe kemi analizuar kurrikulën, planet dhe programet, tekstet shkollore etj.

### **Formimi i gjuhës standarde**

Procesi i formimit të gjuhës standarde ka pasur një rrugë të gjatë, qysh nga shekujt XVI-XVIII, megjithëse përpunimi i saj hyri në një periudhë të re në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare. Thuhet se në Komisinë Letrare të Shkodrës gjuha shqipe për herë të parë në historinë e saj u standardizua dhe standardizimi i aprovuar në Komisinë Letrare të Shkodrës zë vend të rëndësishëm në historinë e shqipes letrare, si një fazë e rëndësishme e standardizimit përfundimtar të gjuhës shqipe. Përpjekjet për njësimin përfundimtar të gjuhës shqipe kanë vazhduar pas Luftës së Dytë Botërore nga Instituti i Shkencave i Shqipërisë, ngase në përdhën kohore midis dy luftërave botërore në Kosovë nuk u zhvillua kurrfarë aktiviteti në planin e drejtshkrimit të gjuhës letrare, përveçse Instituti i Shkencave krijoi komisione të posaçme për hartimin e projekteve të drejtshkrimit.

“Derisa në pjesën e parë të shekullit XX kemi dy ndërmarrje kolektive me peshë në fushën e planifikimit gjuhësor (Kongresi i Manastirit dhe Komisia Letrare), në pjesën e dytë të këtij shekulli kjo punë u intensifikua: u hartuan Ortografitë 1948-1951, 1956, 1967 e 1973 në Tiranë, ndërsa më 1952, 1957 dhe 1964 në Prishtinë, më 1953, 1954-5 në Tiranë, më 1957, 1961-63 e sidomos më 1968 në Prishtinë, për të

përfunduar pastaj më 1972 në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë më 1972”<sup>17</sup>.

Megjithëse të gjitha këto ortografi ndihmuan në formimin e gjuhës standarde, sipas profesor Ismajlit, “ngjarja më e rëndësishme mbetet organizimi i Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968) nga Instituti Albanologjik dhe Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Filozofisë në Prishtinë, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit nga të gjitha trojet etnike shqiptare të ish-Jugosllavisë, që, në të vërtetë, udhëhiqej nga ideja ‘një komb-një gjuhë letrare’. Tubimi i 22 e 23 prillit të vitit 1968 bëri një hap drejt mënjanimin të disa divergjencave që në të shkruar kanë ekzistuar në praktikën e deritashme dhe njeh, njëzëri, si gjuhë të veten gjuhën letrare të vendit amë. Tubimi shpreh bindjen se njësimi i shqipes letrare është rezultat i natyrshëm i proceseve progresive të shoqërisë shqiptare, veçanërisht nga Rilindja e këndej”.<sup>18</sup> Megjithatë, vetëm më 1972, në Kongresin e Drejtshkrimit, u vendos që shqipja të ketë një normë drejtshkrimore të vetme, e cila u pranua edhe në Kosovë dhe në çdo vend ku jetojnë shqiptarët.

Pas Kongresit të Drejtshkrimit është manifestuar entuziazëm dhe vullnet i madh për të përdorur shqipen standarde, u botuan një varg veprash të rëndësishme, të cilat rezultuan me kodifikimin e normave të gjuhës standarde, si: “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), “Fjalori i gjuhës së sotme letrare” (1980), “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), “Fjalori Drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1976), “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I” - Morfologjia (1995), II - Sintaksa (1997) etj. Përveç veprave të cekura më lart, rëndësi të veçantë për përhapjen të gjuhës standarde patën sidomos dy revistat e specializuara të gjuhësisë: “Gjuha jonë” (Tiranë) dhe “Gjuha shqipe” (Prishtinë), të cilat vazhdojnë të luajnë një rol mjaft me rëndësi në pasurimin e gjuhës standarde, pastaj seminarët, simpoziumet e ndryshme etj.

<sup>17</sup> Ismajli Rexhep, *Drejtshkrimet e shqipes*, Prishtinë, 2005, f. 14

<sup>18</sup> Po aty, f. 521.

Në shkollat e Kosovës dhe në institucione të tjera edukativo-arsimore filloi të përdorej shqipja standarde dhe në sistemin arsimor procesi nisi të shënonte suksese, me gjithë vështirësitë që kishte. Mirëpo, në vitet e nëntëdhjeta filloi mbyllja e shkollave nga regjimi serb, gjuha shqipe rrezikohej nga gjuha serbe dhe mësimi në gjuhën shqipe u detyrua të funksiononte në rrethana të jashtëzakonshme, sepse shkollat, përmes mësimdhënësve, teksteve shkollore, ishin të pazëvendësueshme në ruajtjen dhe përhapjen e standardit.

Por, cili është vendi i shqipes sot në shkollat tona, në çfarë niveli është zbatimi i gjuhës standarde dhe cili është ndikimi i Kurrikulës, plan-programeve, teksteve shkollore, medieve, familjes dhe rrethit për ruajtjen, përhapjen dhe pasurimin e gjuhës?

### **Roli i Kurrikulës dhe i teksteve shkollore në përdorimin e gjuhës standarde**

“Kongresi i Drejtshkrimit u bënte thirrje arsimtarëve, shkrimtarëve, studentëve, nxënësve, publicistëve e të gjithë njerëzve punues që të bënin përpjekje maksimale për zbatimin adekuat të normës së gjuhës së shkruar dhe të folur të shqipes standarde”<sup>19</sup>. Kjo thirrje bëri jehonë të madhe dhe solli rezultate në shumë drejtime, veçanërisht në trajtën e shkruar të gjuhës filloi botimi i teksteve shkollore në gjuhën standarde dhe zbatimi i saj u vu në planin parësor nga gjuhëtarët, shkencëtarët, mësimdhënësit etj.

Sistemi arsimor në Kosovë pas luftës së fundit ka pasur ndryshime të rëndësishme, të cilat lidhen me fushën e planeve dhe programeve mësimore, tekstet shkollore, përgatitjen e mësimdhënësve etj., megjithatë akoma vërehet mungesë e planifikimeve të mirëfillta gjuhësore dhe përkujdesje jo e duhur institucionale për gjuhën shqipe. Standardi gjuhësor tashmë po rrezikohet nga gjuha angleze dhe gjuhët e tjera, ngase në leksikonin e saj janë futur mjaft fjalë të huaja të

---

<sup>19</sup> IA, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, Prishtinë, 1974, f. 143.

panevojshme, të cilat po ia zënë frymën shqipes, e po ashtu edhe në shkolla dhe në tekste shkollore standardi nuk po gjen zbatim të duhur.

Megjithëse asnjëherë nuk kemi pasur kushte më të mira për ta mësuar dhe përmirësuar gjuhën standarde, më shumë njerëz që merren me studime gjuhësore, më shumë mësues dhe më shumë libra e revista të shkruara, niveli i të nxënës të gjuhës standarde në shkolla nuk është i kënaqshëm, bëhen shkelje të normave gjuhësore, shpërfillje të rregullave dhe sidomos përdorimi i tepruar i fjalëve të huaja është bërë praktikë e rëndomtë në shkolla.

“Shkolla jonë dhe gjithë sistemi i arsimit, pavarësisht se në program, si një nga detyrat themelore, sidomos në programin e gjuhës shqipe e të letërsisë, shtrohet pikërisht zotërimi i tipareve kryesore e i pasurisë së madhe të shqipes standarde dhe krijimi i shkathtësisë për ta përdorur atë, madje edhe për të regjistruar regjistra e stile të veçanta të saj, - ajo as me statusin dhe mënyrën e përgatitjes së mësuesve (duke u nisur nga përzgjedhja e tyre), as me tekstet dhe as me mjetet e veprimtaritë e tjera brenda në shkollë dhe në institucionet me ndikim në formimin e përgjithshëm dhe në fushë të kulturës së gjuhës, - nuk ka arritur të përmbushte këtë kërkesë fisnike për secilin individ të arsimuar”<sup>20</sup>. Problemet vazhdojnë të përcillen nga viti në vit dhe nuk vërehen përpjekje serioze institucionale, as nga shkollat, as nga Drejtoritë Komunale dhe as nga MASHT-i, për ta ndryshuar këtë gjendje.

Në Kornizën e Kurrikulës së arsimit parauniversitar nuk i është dhënë hapësirë e mjaftueshme (20-30 për qind) fushës **Gjuhët dhe komunikimi** (gjuha amtare, gjuhët e huaja), edhe pse, në fakt, thuhet se kurrikula mbështetet në nevojat dhe prirjet individuale të nxënësve, pranon një qasje që bazohet në kompetenca, të cilat zhvillohen përmes të nxënës që bazohet në punën praktike<sup>21</sup>. Bazuar në kurrikula, edhe

---

<sup>20</sup> Bajçinca Isa, “Shqipja standarde në medie, administrate dhe institucione”, Kulturë e Gjuhës 1, Prishtinë, 2003, f. 12

<sup>21</sup> Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, Prishtinë, 2011.

testi i Arritshmërisë, i cili organizohet nga MASHT-i që disa vjet, i hartuar në bazë të planeve dhe programeve, përmban vetëm 20 pyetje nga Gjuha shqipe dhe letërsia, nga gjithsej 100 pyetje (20 për qind të pyetjeve), dhe vetëm 6 pyetje kanë të bëjnë me gjuhën (6 %), ndërsa 14 me letërsinë (14 %) dhe rezultatet e nxënësve çdoherë dalin rreth 50 %. Ndërsa, sa u përket Planeve dhe Programeve mësimore, megjithëse janë përmirësuar dukshëm, duke u mbështetur në parime të reja gjuhësore, mbetet ende për t'u bërë, në mënyrë që të rritet kultura gjuhësore në shkolla. Nuk i është dhënë mjaft rëndësi zbatimit të njohurive gjuhësore, ka munguar qasja e duhur për përvetësimin e gjuhës standarde dhe normave të saj. Edhe pse përmbajtjet e planeve dhe programeve aktuale janë në funksion të rezultateve mësimore, përvetësimi i gjuhës standarde në shkolla nuk është i kënaqshëm, mungojnë rezultatet në praktikë dhe vërehen shkelje të shumta të normave gjuhësore, ngase gramatikës së gjuhës nuk i kushtohet rëndësi sa duhet. “78,4 për qind e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se nuk i është dhënë hapësirë e duhur gjuhës shqipe në plan-programe”<sup>22</sup>.

Edhe pse tashmë ekziston Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, deri më tani kanë munguar standardet për hartimin e teksteve shkollore, prandaj shumë tekste janë hartuar pa ndonjë kriter, me një nivel të ulët gjuhësor, me sintaksë dhe leksik të huaj dhe me gabime të shumta logjike. Shumica e teksteve shkollore përmbajnë vetëm njohuri teorike, shpesh të marra nga tekstet universitare, të ngarkuara me terma të pakuptueshëm për moshën e nxënësve. Kjo ka ndikim negativ në përvetësimin e gjuhës, si te nxënësit po ashtu edhe te mësimdhënësit, duke e ditur se tekstet shkollore janë mjetet më të përhapura në shkollat tona, sidomos në zonat rurale teksti shkollor shpesh është burimi i vetëm në funksion të shkathhtësive të komunikimit dhe ndër faktorët që

---

<sup>22</sup> Morina Bekim, “Norma e shqipes së shkruar në hartimet e nxënësve të klasave të nënta në Kosovë”, temë e masterit (e pabotuar), 2011, f. 39.



përvetësimi i gjuhës standarde në shkolla të jetë i ulët janë edhe tekstet shkollore, të cilat nuk janë hartuar tërësisht në harmoni me kërkesat e programeve të reja mësimore, janë të ngarkuara me përmbajtje dhe përmbajnë edhe gabime gjuhësore.<sup>23</sup> Po ashtu, në shumë biblioteka të shkollave mungojnë lekturat bashkëkohore, të cilat duhet të jenë në përputhje me planin dhe programin mësimor dhe moshën e nxënësve, prandaj mësimdhënësit pa përvojë në arsim shpesh nuk dinë se çfarë të udhëzojnë nxënësit të lexojnë dhe i përdorin vetëm lekturat që i posedon biblioteka e shkollës, pa marrë parasysh se sa të vjetra janë dhe sa janë atraktive për nxënësit.

Nëse lekturat kanë vlera edukativo-arsimore nxënësit që lexojnë vazhdimisht, janë në gjendje ta mësojnë më shpejt gjuhën standarde dhe të zotërojnë më mirë normat gjuhësore, mirëpo në shkollat e Kosovës vitet e fundit ka humbur kultura e leximit dhe është i vogël numri i nxënësve të cilët lexojnë rregullisht, prandaj kanë vështirësi të theksuara në zotërimin e gjuhës standarde, në të shkruar dhe në të folur. 67,3 për qind e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim kanë thënë se nxënësit nuk lexojnë vazhdimisht, megjithëse u jepen lektura shkollore për t'i lexuar, por më shumë i kopjojnë referatet nga njëri-tjetri, ndërsa 32,7 për qind kanë thënë se nxënësit lexojnë mjaft<sup>24</sup>.

## **Përgatitjet e mësimdhënësve dhe kujdesi i tyre ndaj gjuhës standarde**

Fakultetet në universitetet publike dhe private në Kosovë kohët e fundit nuk po i kushtojnë mjaft rëndësi përgatitjes së mësimdhënësve dhe po nxjerrin kuadro me nivel jo të kënaqshëm të nxënies së gjuhës standarde. Numër i madh i mësimdhënësve që dalin nga këto fakultete, në mungesë të njohurive, nuk e përdorin gjuhën standarde, nuk e shkruajnë dhe nuk e flasin drejt as gjatë komunikimit me nxënës.

---

<sup>23</sup> .Po aty, f. 40.

<sup>24</sup> Morina Bekim, "Norma e shqipes së shkruar në hartimet e nxënësve të klasave të nënta në Kosovë", temë e masterit (e pabotuar), 2011, f. 42.

Në një shkrim të tij, profesor Agim Vinca shkruan: “Studentët e mi të Degës së Letërsisë në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës (pa folur pastaj për ata të degëve e fakulteteve të tjera dhe universiteteve private, ku gjendja është edhe më e keqe) gjithnjë e më pak flasin në gjuhën standarde dhe gjithnjë e më pak bëjnë përpjekje ta përvetësojnë atë sa e si duhet. Dhe, kur ata që konsiderohen e ardhmja e një shoqërie nuk e respektojnë (ose më saktë, gjithnjë e më pak e respektojnë) gjuhën standarde, kjo flet doemos për një perspektivë të zymtë gjuhësore të asaj shoqërie”<sup>25</sup>.

Edhe pse në shkolla përdorimi i gjuhës standarde është i obligueshëm, njësoj siç është i obligueshëm në libra shkollorë dhe në institucione të tjera edukativo- arsimore, studentët që e përfundojnë fakultetin për mësimdhënie dhe nuk arrijnë ta mësojnë gjuhën standarde në nivel të kënaqshëm, edhe gjatë punës në shkolla nuk tregohen të suksesshëm. Të gjithë mësimdhënësit janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë gjuhësore që kanë në shkollë, por për fat të keq, në shumicën e shkollave në Kosovë kemi vërejtur se, me përjashtim të disa mësimdhënësve të Gjuhës dhe letërsisë shqipe, të tjerët, përfshirë drejtorët dhe punonjësit e administratës, nxënësit, nuk komunikojnë me nxënësit në gjuhën standarde. Kjo mund të shihet në shpalljet, lajmërimet, në mure të shkollës, në dokumente të tjera zyrtare - ditarët e klasave, në procesverbale të mbledhjeve, në të cilët vërehen gabime të rënda logjike dhe gjuhësore, por edhe gjatë bisedave me ta. “76 për qind e mësimdhënësve të gjuhës shqipe, të përfshirë në hulumtim, kanë thënë se përveç mësimdhënësve të gjuhës shqipe dhe letërsisë, të tjerët nuk e përdorin gjuhën standarde gjatë komunikimit, ndërsa vetëm 24 për qind e të intervistuarve kanë deklaruar se mësimdhënësit e përdorin gjuhën standarde në shkollë gjatë punës me nxënës”<sup>26</sup>.

---

<sup>25</sup> Vinca Agim, “Gjuha Standarde shqipe dhe bota akademike”, ‘Gjuha shqipe’, Prishtinë 2010, f.12-13.

<sup>26</sup> Morina Bekim, “Norma e shqipes së shkruar në hartimet e nxënësve të klasave të nënta në Kosovë”, temë e masterit (e pabotuar), 2011, f. 42.

Mungon kujdesi dhe planifikimi didaktik-metodik për përvetësimin dhe zbatimin e standardit, sidomos në shkollën nëntëvjeçare, ku kërkohet përvetësimi i drejtshkrimit dhe i normave të tjera gjuhësore në pajtim me moshën dhe njohuritë e përgjithshme gjuhësore të nxënësve dhe me veçoritë e të folmeve lokale. Mësimdhënësit nuk gjejnë metoda mësimore të përshtatshme gjatë punës në shkollë dhe nuk arrijnë t'i identifikojnë problemet, vështirësitë dhe ngecjet, me të cilat përballen nxënësit për përvetësimin dhe zbatimin e normave gjuhësore. “Disa mësimdhënës, jo vetëm që nuk arrijnë t'i gjejnë të gjitha gabimet e nxënësve gjatë korrigjimit të hartimeve- eseve, por kemi gjetur raste që i kanë shtuar gabimet kur nxënësit i kanë shkruar fjalët drejt, si p.sh: fjalën shqiptar arsimtari e bën **shqipëtar**, qindra e bën **qindëra**, gjersa e bën **gjerësa**- duke menduar se duhet t'i shtohet një ë, pasi nuk e di se te fjalët që përfundojnë me ër, ëz ël etj., bie zanorja ë, pastaj fjalën shembull e bën **shembëll**, gjithsej e bën **gjihësejt**, fjalët të rinj dhe ëndërr i bën me ë fundore- **të rinjë**, **ëndërrë**, e po ashtu foljen në kohën e tashme - unë shpresoj, e bën me i, **unë shpresoi**, fjalën korrigjim e bën me r - **korrigjim** etj.), e po ashtu edhe fjalët e huaja nuk i zëvendësojnë me fjalë shqipe dhe në mjaft raste nuk arrijnë të bëjnë përshtatjen e fjalëve në numër dhe gjini”<sup>27</sup>.

Më tepër mundohen t'ua mësojnë nxënësve rregullat siç janë në libra, por nxënia e standardit nuk duhet të mbarojë me përvetësimin e rregullave, sepse ngulitja e normave të shkruarit është një proces që përbëhet nga disa hallka. Sipas Rami Memushajt, “zotërimi i rregullave përbën hallkën fillestare, hallka të tjera që duhet ta pasojnë janë formimi i shkathtësive dhe i shprehive të shkruarit pa gabime dhe vetëm kur njohuritë për normën gjuhësore të kthehen në shprehi mund të thuhet se kemi arritur të shkruajmë si duhet”<sup>28</sup>. Edhe nëse mësimdhënësit e Gjuhës shqipe dhe letërsisë përpiqen të tregohen të kujdesshëm, ngase janë të obliguar që t'ua mësojnë nxënësve rregullat

<sup>27</sup>. Po aty, f. 38.

<sup>28</sup> Memushaj Rami, ‘Shqipja standarde’, ‘Toena’, Tiranë, 2005.

e drejtshkrimit, duke i mënjanuar dobësitë morfo-sintaksore dhe drejtshkrimore, mjaft ndikim në procesin e nxënies së standardit kanë mësimdhënësit e lëndëve të tjera në shkollë, të cilët nuk bëjnë përpjekje që ta përdorin gjuhën standarde gjatë ligjërimit apo komunikimit me nxënës dhe me stafin e shkollës.

Në këso situatash, nxënësit do të kenë vështirësi ta përdorin drejt gjuhën, sepse gjuha standarde kërkon kujdes të veçantë nga përdoruesit e saj, si personalë, po ashtu edhe institucionalë, në veçanti nga mësimdhënësit, të cilët konsiderohen vendimtarë që kultura gjuhësore të zhvillojë ato veti që janë të domosdoshme për funksionimin e saj. Profesor Sedat Kuçi thekson se “kujdesi personal për gjuhën standarde arrihet së pari me zotërimin e drejtë të normave të gjuhës standarde, si në fushën e drejtshkrimit, të drejtshqiptimit, të gramatikës, të leksikut, të semantikës dhe të niveleve të tjera gjuhësore. Së dyti, vetëdijesimi për zotërimin sa më të drejtë të këtyre normave, e sidomos zbatimi i tyre në ligjërimin me shkrim e me gojë, e rrit kujdesin personal për gjuhën standarde”<sup>29</sup>.

“Shkolla është, si të thuash, laborator i ku norma letrare formohet, përpunohet dhe pastaj përhapet”<sup>30</sup>, prandaj mësuesit dhe nxënësit duhet të bëjnë përpjekje ta përdorin gjuhën standarde dhe ta përhapin përtej shkollave, pa i mohuar varietetet dhe pa harruar se burimet, funksioni dhe zbatimi i gjuhës standarde janë të ndryshëm nga ato të varieteteve që tashmë i njohin dhe se mësimdhënia e mbështetur në gramatikë është normative, e përqendruar në strukturën e gjuhës. Por, pak shkolla në Kosovë janë të pajisura me libra metodiko-didaktikë, fjalorë të ndryshëm, doracakë të gjuhës dhe sidomos me revistat që merren me çështje të gjuhës, “Gjuha shqipe”, “Gjuha jonë”, në mënyrë që mësimdhënësit t’i kenë në dorë dhe të jenë më të informuar për gjuhën standarde dhe zhvillimet e saj. Megjithatë, problemet që dalin lidhur me

---

<sup>29</sup> Kuçi Sedat, “Kujdesi për gjuhën standarde”, Seminari XXV për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006, f. 304.

<sup>30</sup> Kryeziu Bahtjar, “Mësimi i shqipes letrare në shkollë”, Seminari XXV për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006, f. 343.

nxënien dhe përdorimin e gjuhës standarde nuk mund të kapërcehen vetëm përmes mësimdhënies në shkollë, edhe pse mësuesit janë model i përdorimit të gjuhës dhe i shkathtësive gjuhësore, nëse nuk organizohen konferenca, seminare dhe simpoziume në nivel lokal për gjuhën standarde shqipe, nga mësimdhënësit, DKA-të - komisionet për arsim në komuna dhe nëse mediet, familjet dhe rrethi shoqëror nuk i kushtojnë më tepër rëndësi.

### **Ndikimi i medieve, familjeve dhe rrethit në nxënien e gjuhës standarde**

Ndikim në nxënien e gjuhës standarde kanë edhe mediet, qoftë të shkruara apo elektronike, të cilat janë mjaft të rëndësishme për zbatimin dhe përhapjen e saj. Televizionet dhe radiot mund të ndikojnë pozitivisht, me anë të emisioneve edukativo-arsimore dhe atyre që kanë të bëjnë me gjuhën, nëse janë të përgatitura nga gjuhëtarë të zotë, metodistë të gjuhës shqipe, pedagogë të mirë. Vitet e fundit nxënësit dhe mësimdhënësit e kalojnë shumë kohën para televizorit dhe shfrytëzojnë shumë materiale nga kompjuteri përmes internetit, duke e lënë anash librin dhe kjo ka pasur ndikim negativ sa i përket gjuhës, sepse në mediet tona akoma mungon kujdesi i duhur për gjuhën standarde dhe lëshohen gabime të shumta gjuhësore, drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore: përzierje të dialekteve me standardin, fjali të deformatuara, fjali të huaja të panevojshme etj. Po ashtu, disa medie, të shkruara dhe elektronike, nuk i kushtojnë rëndësi përdorimit të gjuhës dhe bëhen mjaft shkelje të normave të gjuhës, ndërsa gazetat dhe revistat shkollore janë në numër të vogël. “61 për qind e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim mendojnë se mediet kanë mjaft ndikim te nxënësit dhe mësimdhënësit sa i përket gjuhës standarde”.

Kurse, sa u përket familjes dhe rrethit shoqëror, në mjaft raste nuk ndikojnë për rritjen e kujdesit ndaj gjuhës standarde dhe përdorimit të saj në shkollë. 84,3 për qind e mësimdhënësve mendojnë se familja dhe

rrethi kanë ndikim të madh, pasi një numër i nxënësve dhe i mësimdhënësve jetojnë në familje të mëdha, me gjyshër dhe anëtarë të tjerë të familjes, me nivel të ulët apo mesatar të shkollimit dhe në rrethe ku kujdesi për gjuhën është minimal, apo fare pak i kushtohet rëndësi gjuhës standarde. Sidomos në zonat rurale, fëmijët, duke u rritur me gjuhën dialektore apo të folmen e rrethit, përvetësojnë trajta lokale, të cilat i bartin edhe në shkollë dhe i përcjellin pastaj gjatë shkollimit”<sup>31</sup>. Pra, ndikimi i familjes dhe i rrethit është mjaft i madh në përdorimin e gjuhës në shkollë, ngase nxënësit dhe mësimdhënësit vijnë nga familje dhe rrethe të ndryshme dhe ndeshen me grupe të ndryshme të të folmeve. Në shkollë ata ndodhen në udhëkryqin e dy të folmeve, të rrethit dhe të mësimdhënësve e të teksteve, prandaj ndikimi i rrethit shpesh mbetet dominues, ngase kultura gjuhësore fillon të zhvillohet nga familja, mandej në shkolla dhe institucione të tjera edukativo-arsimore dhe kulturore. Sipas Mehmet Halimit, “ndikimi gojor i të folmeve lokale, që mishërohet me individin në mënyrë auditive: nga familja, farefisi i ngushtë, vendbanimi më i gjerë, është i pranishëm në masë shumë të dukshme, jo vetëm nga të vegjlit, por edhe të intelektualët, mësuesit, nëpunësit, etj.)”<sup>32</sup>.

### **Ndikimi i opinioneve për rishikimin e standardit të gjuhës**

Për gjendjen e shqipes në shkolla, shkallën e pamjaftueshme të njohjes dhe zbatimit të shqipes standarde ekzistojnë disa faktorë, si: mungesa e kulturës së leximit; shkalla e ulët e përgatitjes së mësuesve; përdorimi i shqipes standarde për një kohë të gjatë nën hijen e serbishtes, ndërsa sot anglishtes dhe gjuhëve të tjera, shkalla e zbatimit të shqipes në libra shkollorë - sidomos të shkencave të natyrës, të ekonomisë, të filozofisë e të tjera, fondi i pamjaftueshëm i orëve, moskujdesi i duhur i mediave

---

<sup>31</sup> Morina Bekim, “Norma e shqipes së shkruar në hartimet e nxënësve të klasave të nënta në Kosovë”, temë e masterit (e pabotuar), 2011, f. 45.

<sup>32</sup> Halimi Mehmet, “Çështje të normës letrare”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1980, f. 123

dhe familjeve, por, sipas disa studiuesve dhe mësimdhënësve të gjuhës, një ndër faktorët del të jetë edhe vetë standardi.

Në vend të përpjekjeve për t'u marrë me këta faktorë dhe kujdesit më të madh për ta mësuar dhe zbatuar standardin, studiues të gjuhës vazhdimisht theksojnë se gjuha standarde ka nevojë të rishikohet, të plotësohet dhe të pasurohet, ngase vështirë zotërohet nga pjesa më të madhe të shoqërisë, duke përfshirë edhe një numër të madh të mësimdhënësve në shkolla. Lidhur me këtë, kohët e fundit janë zhvilluar diskutime të shumta rreth shqipes standarde, të cilat vazhdojnë edhe sot, dyzet vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, duke menduar se diskutimet do të ndihmonin në konsolidimin e gjuhës. Tashmë është formuar Këshilli Gjuhësor Ndërakademik, në mënyrë që të përcaktojë ndryshimet që duhet të bëhen, me qëllim që të thjeshtësohet standardi, dhe janë krijuar edhe komisione, të cilat do të merren me çështje konkrete të normës. Sipas profesor Shkumbin Munishit, “si çdo gjuhë tjetër, edhe shqipja standarde, si gjuhë e normuar, i ka problemet e saj dhe disa prej këtyre problemeve thuhet se kanë lindur qysh nga fillimi i standardizimit të saj, me rastin e përzgjedhjes së bazës dialektore mbi të cilën është ndërtuar norma. Në shqipen standarde problemet shfaqen edhe në rrafshin e normës drejtshkrimore dhe në rrafshin e drejtshqiptimit. Problemi kryesor në të folur buron nga fakti që baza dialektore e standardit është kryesisht varianti i jugut dhe mungesa e formave strukturore të gegërishtes në standard, si mungesa e paskajores dhe e formave të shkurta të pjesores. Problem tjetër është mospërputhja në disa raste e formave të shkruara normative me format shqiptimore dhe problemi fonetik në drejtshkrimin e shqipes standarde, sidomos sa i përket shkrimit të zanores së patheksuar ë”<sup>33</sup>. Këto diskutime kanë ndikuar edhe në përdorimin e gjuhës standarde në shkolla dhe në institucione të tjera edukativo-arsimore, ngase disa mësimdhënës, mungesën e përkushtimit

---

<sup>33</sup> Munishi Shkumbin, “Gjuha e këputun e shqipes”. (Intervistë nga Shkelzen Gashi), Prishtinë, 2000, f. 114

dhe kujdesit për të zotëruar normat gjuhësore e arsyetojnë me nevojën për ndryshim dhe rishikim, duke u bazuar në diskutimet e fundit. Si pasojë e kësaj, në shumicën e institucioneve edukativo-arsimore në Kosovë, sidomos në ato publike, vërehet mungesë e përkushtimit të vazhdueshëm, duke filluar nga çerdhet, shkollat fillore e të mesme, e deri te fakultetet, dhe problemet lidhur me përdorimin e gjuhës standarde dalin gjithandej, të cilat do të jetë vështirë të kapërcehen. Për shkak të nivelit jo të kënaqshëm të të nxënimit në arsimin parauniversitar, gjuha shqipe është futur si lëndë në të gjitha fakultetet në Universitetin Publik të Prishtinës, por shtrohet pyetja a mund të mësohen gjuha standarde dhe kultura e shkrimit me një provim të vetëm, kur dihet se në shumë fakultete lënda ligjërohet nga persona jokompetentë dhe shkeljet nuk bëhen vetëm për mungesë të njohurive, por edhe për shkak të moskujdesit të duhur dhe përpjekjeve të pamjaftueshme për ta zotëruar standardin. Nëse shkollat nuk janë të përgjegjshme dhe mësimdhënësit nuk tregojnë më tepër kujdes për ta zotëruar dhe zbatuar standardin gjatë punës me nxënës, sidomos mësimdhënësit e Gjuhës shqipe, edhe sikur të ndryshohej, të pasurohej me elemente të gegërishtes, gjuha standarde përsëri nuk do të gjente zbatim, as në shkolla dhe as në ndonjë institucion tjetër, dhe shkeljet e normave do të bëheshin prapë, si nga nxënësit, po ashtu edhe nga arsimtarët dhe të tjerët. Problemet kapërcehen me përkushtim më të madh të mësimdhënësve dhe nxënësve për ta zotëruar standardin, me përmirësimin e punës dhe cilësisë në shkolla, sepse vështirësitë nuk janë si pasojë e standardit, por e mungesës së njohurive të duhura dhe moskujdesit institucional.

## **Konkluzione**

Edhe pse gjuha standarde shqipe tashmë ka normë të ngulitur, në shumicën e shkollave të Kosovës nxënësit dhe mësimdhënësit nuk e zotërojnë në shkallë të kënaqshme dhe bëjnë gabime të shumta gjatë



përdorimit të mjeteve të ndryshme gjuhësore: në morfologji, sintaksë, fjalëformim, leksik, pikësim etj.

Përveç faktorëve jashtëgjuhësorë, si statusi që shqipja e gëzon, pastaj qëndrimi jo i njëjtë i shqipfolësve ndaj standardit -mosrespektimi i tij, vendi ku flitet, ndikimi i të folmeve dialektore etj., ekzistojnë edhe faktorë të tjerë, të cilët ndërlidhen drejtpërdrejt me shkollën: planet dhe programet, tekstet shkollore, metodat e mësimdhënies, mungesa e leximit të lektyrave nga nxënësit, komunikimi brenda shkollave, mediet e shkruara dhe elektronike, familja dhe rrethi.

Megjithatë, faktorët kryesorë mbeten fakultetet, ngase ndërlidhen drejtpërdrejt me kompetencat e mësimdhënësve. Fakultetet, të cilat përgatisin kuadro për mësimdhënës, duhet të bëjnë rishikimin e programeve (syllabuseve) të lëndëve mësimore dhe t'i japin më tepër rëndësi standardit të gjuhës, në mënyrë që të përgatisin mësimdhënës me njohuri më të thella gjuhësore, sepse kur normat e gjuhës nuk njihen dhe nuk zotërohen si duhet, atëherë nuk përdoren drejt dhe bëhen vazhdimisht shkelje.

Meqenëse komunikimi nga një numër i madh i mësimdhënësve, përfshirë edhe drejtorët dhe stafin tjetër të shkollave, në kohën më të madhe nuk bëhet në gjuhën standarde, bëhen shkelje të mëdha të normave gjuhësore, në mungesë të njohurive për gjuhën, apo moskujdesit të duhur gjatë punës, planet dhe programet, metodat e punës, do të duhej të ndryshonin dhe të përqendroheshin më shumë në problemet specifike që kanë mësimdhënësit dhe nxënësit me standardin e shqipes dhe jo gjuha shqipe të mësohet si të ishte gjuhë e huaj.

Shkolla e ka për detyrë që t'ua mësojë nxënësve normat e gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur, sepse fëmijët para se të shkojnë në shkollë fare pak ballafaqohen me gjuhën e teksteve, prandaj autorët gjatë hartimit të teksteve shkollore duhet të jenë më të kujdesshëm, t'i kushtojnë më tepër rëndësi gjuhës standarde, të përzgjedhin recensentët dhe redaktorët gjuhësorë, në mënyrë që tekstet shkollore të mos

përmbajnë fjalë të huaja të panevojshme, por të kenë një leksik të pasur dhe sintaksë shqipe.

Përzgjedhja e lektyrave të jetë sa më e qëlluar dhe në pikëpamje të vlerave edukative, pedagogjike, të pëlqyera nga nxënësit, të cilat do t'u ndihmonin në përmirësimin e gjuhës dhe kulturës në përgjithësi.

Mjetet i informimit: televizionet, radiot, gazetatat dhe revistat, të jenë më të kujdesshme ndaj gjuhës, ngase shpesh nxënësit dhe mësimdhënësit i marrin si model për përdorimin e gjuhës.

Është koha e fundit që për gjuhën shqipe të mendohet më seriozisht dhe barrën për këtë e mbajnë në radhë të parë mësimdhënësit, nga të cilët kërkohet të bëjnë më shumë për gjuhën, sepse është vlerë kombëtare dhe nuk duhet të keqpërdoret, sidomos në shkolla. Mirëpo, për të ndryshuar këtë gjendje përgjegjësia nuk mund t'u lihet vetëm shkollave, por mbetet detyrë e të gjitha institucioneve edukativo- arsimore, qendrore e lokale, duke filluar nga MASHT-i, Instituti Albanologjik, Instituti Pedagogjik, Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Edukimit, DKA-të dhe qendrat e tjera të edukimit, që të punojnë më shumë dhe të hartojnë strategji për ruajtjen dhe pasurimin e gjuhës standarde.

Detyrë e nxënësve, mësuesve, gjuhëtarëve, shkrimtarëve, hartuesve të planeve dhe programeve, gazetarëve, prindërve dhe çdo qytetari tjetër është ta duan dhe ta përdorin gjuhën standarde, të mësojnë e të përvetësojnë normat e saj, ta pasurojnë dhe ta ruajnë.

Nuk është zgjidhja e duhur që Universiteti i Prishtinës kulturën e gjuhës ta fusë si lëndë të detyrueshme në të gjitha fakultetet, në mënyrë që të gjithë studentët e UP-së të mësojnë kulturë gjuhe, por përgjegjësinë ta kenë shkollat për përvetësimin e gjuhës, veçanërisht mësimdhënësit e Gjuhës shqipe dhe letërsisë, nga të cilët kërkohet kulturë gjuhësore, mjeshtri pedagogjike, didaktike e metodike, pasion dhe ndërgjegje profesionale.

## **Bibliografia**

1. Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973
2. Dhrimo Ali, “Problemi i normës letrare kombëtare në shqipen e sotme”, S, F 1985
3. Fjalori Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1976
4. Gramatika e Gjuhës Shqipe I, II, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1997
5. Instituti Albanologjik i Prishtinës, “Konsulta Gjuhësore e Prishtinës”, Prishtinë, 2008.
6. Ismajli Rexhep, “Drejtshkrimet e shqipes”, ASHAK, Prishtinë, 2005
7. Ismajli Rexhep, “Gjuhë standarde dhe histori identitetesh”, Tiranë, 2005
8. Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, Prishtinë, 2001
9. Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, Prishtinë, 2011
10. Kryeziu Bahtjar, “Mësimi i gjuhës standarde në shkollë”, Seminari XXV për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006.
11. Kuçi Sedat, “Kujdesi për gjuhën standarde”, Seminari XXV për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2006.
12. Memushaj Rami, “Shqipja standarde”. ‘Toena’, Tiranë, 2005
13. Morina Bekim, “Norma e shqipes së shkruar në hartimet e nxënësve të klasave të nënta në Kosovë”, temë e masterit (e pabotuar), 2011.
14. Munishi Shkumbin, “Gjuha e këputun e shqipes” (Intervistë nga Shkelzen Gashi), Prishtinë, 2000
15. Murati Qemal, “Për shqipen standarde”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2009

16. Ndreca Mikel, Fjalor fjalësh dhe shprehjesh të huaja, “Rilindja”, Prishtinë, 1986
17. Raka Fadil, “Historia e shqipes letrare”, Prishtinë, 2005
18. Raka Fadil, “Shqipja letrare e shekujve XIX-XX, Prishtinë, 2010
19. Rugova Bardh, “Gjuha e gazetave”, ‘Koha’, Prishtinë, 2009
20. Samara Miço, “Historia e gjuhës letrare shqipe”. Tiranë, 2005
21. Sylejmani Fadil, “Praktikumi i gjuhës shqipe”, Prishtinë, 1984
22. Shamku-Skreli, Ledi, “Standard dhe neostandard”, “Çabej”, Tiranë, 2007
23. Shkurtaj Gjovalin, “Si të shkruajmë shqip”, “Toena”, Tiranë 2008
24. Vinca Agim, “Gjuha Standarde shqipe dhe bota akademike”, ‘Gjuha shqipe’, Prishtinë, 2010.

Binak Gërguri & Sylejman Sylejmani

## MODELET KURRIKULARE PËR PROFILET PROFESIONALE NË QENDRAT E KOMPETENCËS, NGA KËNDVËSHTRIMI I STRUKTURËS SË PLANIT MËSIMOR

Qëllimi kryesor i Qendrave të Kompetencës është t'u jepet të rinjve arsim dhe aftësim profesional (AAP), që do të plotësojë kërkesat e nivelit dhe cilësisë me BE. Pas përfundimit të tre vjetëve të arsimit dhe aftësimit dhe të provimit përfundimtar në QK, vijuesit e suksesshëm do të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë të pavarur dhe me mjeshtëri në hapësirat e tyre të punës. Kjo do t'u mundësojë atyre që pa ndonjë arsim dhe aftësim të mëtijshëm të punësohen, si në vendet e BE-së, ashtu edhe në Kosovë.

Këto modele kanë struktura të ndryshme, hartohen sipas metodologjive të ndryshme, dhe zbatohen në profile mësimore, kurse trajnimi, si dhe shkolla profesionale të caktuara.

Kjo analizë u referohet modeleve kurrikulare të Qendrave të Kompetencës në zbatim dhe ato që janë në hartim e sipër në aspektin e strukturës së planit mësimor.

Qendrat e Kompetencës iu ofrojnë nxënësve zhvillimin e kapaciteteve me një sistem mësimor, i cili bazohet në sistemin evropian.

Qendra e Kompetencës në Skenderaj aftëson punëtorë të kualifikuar në Sektorin e Ndërtimtarisë, ndërsa ajo në Malishevë në fushën e Ekonomisë, Kontabilitetit/Administratës dhe Tregtisë.

Viti i parë i çdo programi të arsimit dhe aftësimit profesional ka një perspektivë të gjerë, me qëllim që t'u prezantohen nxënësve profilet e ndryshme profesionale që bashkëveprojnë shpesh në tregun e punës. Ai përfshin pjesën bazike dhe nxënësit mësojnë 50 % teori dhe 50 % praktikë.

Një tjetër arsye për qëllimin e gjerë të vitit të parë është që nxënësit do të kenë një bazë të mirë për zgjedhjen e tyre të mëtejshme të specializimit brenda një profili të veçantë profesional.

Viti i dytë dhe i tretë i çdo programi të arsimit dhe aftësimin profesional fokusohet vetëm në një profil profesional, nga zgjedhja e vetë nxënësve. Nxënësit orientohen në drejtimin përkatës dhe mësimi zhvillohet në 40 % pjesës teorike dhe 60 % pjesën praktike, respektivisht në vitin e tretë 20 % teori dhe 80 % praktikë. Nga numri i përgjithshëm i orëve, bazuar në planin mësimor më shumë orë praktikimi, janë paraparë në ndërmarrje dhe institucione publike, që dallojnë nga institucionet profesionale ekzistuese në vend. Roli kryesor i orëve teorike është që të mbështesë mësimin praktik.

Qendrat e Kompetencës në ndërtim në Ferizaj dhe Prizren synojnë aftësimin në fushat profesionale të mjekësisë, respektivisht Ekonomi, Hotelieri-Turizëm dhe Tregti.

Modeli kurrikular i synuar për t'u zbatuar në Qendrat e Kompetencës në Prizren dhe Ferizaj në shkallë më të lartë u referohet nevojave aktuale dhe perspektives të tregut lokal për kompetenca pune. Bazohet në analizën funksionale të profesionit, gjegjësisht në standardet përkatëse të profesioneve.

Planin mësimor e karakterizo organizimi i përmbajtjeve mësimore profesionale në module mësimore profesionale (module profesionale të përbashkëta dhe të profilit).

## **Hyrje**

Në shumë vende evropiane arsimit profesional momentalisht është në transformim, çfarë është direkt pasojë e politikave recesive, ndryshimeve ekonomike dhe sociale. Ekonomia liberale e tregut sjell me vete kërkesa të rritura, e nganjëherë plotësisht të ndryshme nga aspekti i aftësive, njohurive, shkathtësive, që punëdhënësit i kërkojnë nga punonjësit e kualifikuar të nivelit të shkollimit të mesëm.

Tregu i punës, politikat arsimore, partnerët socialë, arsimit i përgjithshëm/shkollimi obliguar (niveli arsimor hyrës), situata

ekonomike, kërkesat e punëdhënësve (nevojat për punonjës të kualifikuar), shoqëria, kultura dhe tradita e arsimit profesional, lëvizshmëria arsimore vertikale (nivele arsimore më të larta), janë faktorë që ndikojnë në standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve<sup>34</sup>.

Arsimi profesional duhet t'u ofrojë vijuesve spektër të gjerë të shkathtësive bazë, të cilat do të jenë të zbatueshme në shumë punë të ngjashme ose brenda një sektori të profesionit. Për shembull ISCO-ja përmban 15000 profesione të mundshme në tregun e punës, ndërsa KNPJG-ja përmban rreth 35000 profesione në tregun e punës.

Standardet përcaktojnë cilësinë dhe nivelin e arsimit profesional dhe dukshëm kontribuojnë në ruajtjen e cilësisë. Janë masa të cilësisë të përcaktuara dhe të njohura në nivel shteti<sup>35</sup>.

Në Evropë ekzistojnë tri modele themelore, gjegjësisht standarde, të arsimit profesional.

**Modeli i kompetencave dalëse** (Skotland, BM): Modeli kryesisht i orientuar në rezultate, gjegjësisht në cilësinë përfundimtare të kryerjes, që lejon metoda të shumta fleksibile të mësimdhënies. Kualifikimet arrihen nëse kandidati demonstroi performancën adekuate (çfarë mundë të bëjë) dhe njohuri (çfarë di).

**Modeli i arsimit për profesionin:** Është i orientuar në arsimim për profesione specifike, ku qartë janë definuar detyrat punuese specifike, së bashku edhe me kompetencat (shkathtësitë, njohuritë, aftësitë), të cilat punonjësi i ardhshëm duhet t'i përvetësojë me arsimim.

**Modeli modular:** Modulet mund të vështrohen në dy mënyra. Si elemente të kompetencave dalëse ose si elemente të mësimdhënies,

---


<sup>34</sup> Istrazivacki project: Metodologija za kreiranje modularnih kurikulumu srednjih strukovnih škola u skladu s promjenama na tržištu rada, 18. rujna 2011. Zagreb, f.9

<sup>35</sup> Istrazivacki project: Metodologija za kreiranje modularnih kurikulumu srednjih strukovnih škola u skladu s promjenama na tržištu rada, 18. rujna 2011. Zagreb, f.14

mund të jenë ngushtë të specializuara dhe specifike, apo mund të jenë në vëllim të gjerë dhe të përfshijnë disa aktivitete<sup>36</sup>.


**Modeli i modularizuar:** Paraqitet si premtues edhe opsioni i katërt i modelit të arsimit profesional. Është kombinim i modelit të arsimimit për profesionin dhe modelit modular. Një model i tillë i arsimit profesional zbatohet në Holandë dhe sipas veçorive mund të quhet Model i modularizuar<sup>37</sup>.

Modeli i modularizuar i arsimit për profesionin



Modulet janë elemente përbërëse të një tërësie – të profesionit

Modeli modular



Modulet janë tërësi arsimore të pavarura, që mund të kombinohen llojlojshëm

<sup>36</sup> Istrazivacki project: Metodologija za kreiranje modularnih kurikuluma srednjih strukovnih škola u skladu s promjenama na tržištu rada, 18. rujna 2011. Zagreb, f.15

<sup>37</sup> Istrazivacki project: Metodologija za kreiranje modularnih kurikuluma srednjih strukovnih škola u skladu s promjenama na tržištu rada, 18. rujna 2011. Zagreb, f. 15, 18



Modularizimi - dy koncepte të bazuara në konceptimin e ndryshëm të arsimit profesional (marrë dhe adaptuar sipas Laur- Ernst, Kunzmann i Hoene, 2000)<sup>38</sup>.

Qëllimi i analizës është të analizojë modelet kurrikulare nga këndvështrimi i Planit mësimor që zbatohen për profilet profesionale në Qendra të Kompetencës (Skenderaj dhe Malishevë), profilet profesionale në fushën e Teknologjisë ushqimore, si dhe profilet profesionale që synohen të zbatohen në Qendra të Kompetencës në ndërtim (Ferizaj dhe Prizren).

### **Modelet kurrikulare të Arsimit Profesional në Kosovë, të zhvilluara në periudhën 2010-2012**

Në periudhën 2010-2012 janë hartuar modele kurrikulare për profilet profesionale në fushën e teknologjisë ushqimore, fushës profesionale në Qendra të Kompetencës në zbatim (Skenderaj dhe Malishevë), si dhe janë në hartim e sipër modelet kurrikulare për fushat profesionale në Qendra të Kompetencës në ndërtim (Ferizaj dhe Prizren).

#### **A. Modeli kurrikular për Qendrat e Kompetencës në Skenderaj dhe Malishevë**

Për Qendrën e Kompetencës në Skenderaj<sup>39</sup>, e cila aftëson punëtorë të kualifikuar në Sektorin e Ndërtimitarisë janë hartuar kurrikulat për fushat profesionale **Ndërtimtari e ulët** (Profilet: Ndërtues i rrugëve, Montues i gypave dhe ndërtues i kanaleve, Punëtor peizazhi); **Ndërtimtari e lartë** (Profilet: Beton punues, Zdrukthëtar (me punë të kulmit), Murator dhe pllakashtrues, Teneqepunues dhe punues metali, Ndërtues i konstruksioneve të thata, Ngjyrëpunues, Llakpunues), **Energji, klimatizim dhe mjedis** (Profilet: Instalues i ujit, sanitarive

---

<sup>38</sup>Istrazivacki project: Metodologija za kreiranje modularnih kurikuluma srednjih strukovnih škola u skladu s promjenama na tržištu rada, 18. rujna 2011. Zagreb, f, 19

<sup>39</sup> Qendra e Kompetencës në Skenderaj ,Arsimi dhe Aftësimi Profesional, Kurrikuli Instalues i ngrohjes dhe i ventilimit /Niveli i Trajnimit: Vitet I, II, III /Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, Kosovë, prill 2010.

dhe të energjisë, Instalues elektrik, Instalues i ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit), respektivisht në Qendrën e Kompetencës në Malishevë për lëmin e Ekonomisë, Kontabilitetit/Administratës dhe Tregtisë.

## **Struktura e Kornizës së Kurrikulit i ka elementet si në vijim:**

### **1. Hyrje e përgjithshme**

**1.1. Qendrat e Kompetencës:** Qendrat e Kompetencës (QK) janë institucione pilot në Kosovë. Qëllimi kryesor i QK është t'iu jap të rinjve arsim dhe aftësim profesional, që do të plotësojë kërkesat e nivelit dhe cilësisë me BE-në.

**1.2. Struktura e programeve të AAP-së:** Çdo Qendër e Kompetencës ofron aftësimin në profile të ndryshme profesionale brenda një fushe.

Viti i parë i çdo programi të AAP-së ka një perspektivë të gjerë, me qëllim që t'u prezantohen nxënësve profilet e ndryshme profesionale që bashkëveprojnë shpesh në tregun e punës.

Viti i dytë dhe i tretë i çdo programi të AAP-së fokusohet vetëm në një profil profesional, i zgjedhur nga vetë nxënësit.

Kurrikulat për Qendrat e Kompetencës fokusohen në rezultatet e mësimin në aspektin e njohurive, aftësive dhe kompetencave, dhe procesin e aftësimit që nxënësit duhet të kalojnë gjatë shkollimit.

**1.3. Vlerësimi përfundimtar:** Pas përfundimit të programit tre vjeçar të aftësimit, vijuesit do të duhej të kalonin një provë të kombinuar praktike dhe teorike në një ose disa operacione të punës që janë tipike për profilin profesional.

**1.4. Perspektiva e mësimin gjatë gjithë jetës:** Çdo individ duhet të jetë i përgatitur për arsimim të mëtejshëm apo rikualifikim në përgjigje të ndryshimeve në teknologji dhe nevojat e tregut të punës.

**1.5.** Shpërndarja e orëve në lëndë të ndryshme në programin trevjeçar

**Plani mësimor:** Shpërndarja e orëve në Qendrat e Kompetencës janë treguar në tabelën më poshtë

Lëndët	Viti I	Viti II	Viti III
Gjuhë amtare dhe shkenca shoqërore	3	3	
Matematikë	3	2	2
Shkencat natyrore	2		
Gjuhë angleze	3	3	2
TIK	3		
Biznes dhe ndërmarrësi	2	3	3
Gjymnastikë dhe Edukatë fizike	2	2	2
Orët e praktikës, teoria dhe praktika	17	22	28
<b>TOTALI</b>	<b>35</b>	<b>35</b>	<b>37</b>

Numri i përgjithshëm i orëve është më shumë i orientuar në më shumë orë pune në ndërmarrje dhe institucione publike, që dallon nga institucionet profesionale ekzistuese në vend. Roli kryesor i orëve teorike është që të mbështesin mësimin praktik.

## **2. Kurrikuli i tanishëm**

Ky program mbulon lëndët profesionale, të cilat do të mësohen 28 orë në javë.

**2.1. Përshkrimi dhe objektivat:** Nxënësi i suksesshëm do të posedojë njohuri, aftësi dhe kompetenca, që i plotësojnë kërkesat e punëdhënësit në ndërmarrjet private, të autoriteteve publike dhe të publikut në përgjithësi.

**2.2 Përmbajtja:** Qëllimi i mësimit është që të stimulojë dhe të mbështesë ngritjen e kapaciteteve profesionale të nxënësve.

**2.3 Metodatat e mësimit dhe mjetet ndihmëse mësimore:** Mësuesi është në pozitë më të mirë të mundshme për të zgjedhur metodatat optimale mësimore për pjesë të ndryshme të programit.

**2.4. Rezultatet mësimore:** Mësimdhënia dhe aftësimi praktik i realizuar në këtë arsim trevjeçar synon arritjen e rezultateve të përcaktuara mësimore.

### **3. Mësuesi, roli dhe përgjegjësitë**

**3.1. Mësuesi** është një profesionist në fushën e punës në të cilën nxënësit janë duke u trajnuar për të.

**3.2. Mësimdhënia dhe roli i mësuesit:** Roli i mësuesit profesional është organizimi i sesioneve trajnuese në mënyrën më të mirë të mundshme për transferimin e njohurive dhe aftësive të nxënësit.

**3.3. Përgjegjësitë, metodatat mësimore dhe mjetet ndihmëse mësimore**

Programi mësimor përcakton rezultatet e mësimit. Mësuesi është në një pozitë më të mirë për të zgjedhur metodatat optimale mësimore për pjesë të ndryshme të programit mësimor.

**4. Vlerësimi, provimi:** Pas përfundimit të vitit të tretë, që është edhe viti i fundit i arsimit dhe aftësimit, nxënësit duhet të kalojnë edhe testin e kombinuar praktik dhe teorik në një apo më shumë veprime punuese që janë tipike për profilin profesional.

**5. Dokumentimi:** Pas kalimit të provimit praktik-teorik, nxënësi i suksesshëm merr dokumentin final (certifikatën e profesionit).

### **B. Modeli kurrikular në lëmin e Teknologjisë ushqimore**

Janë hartuar kurrikulat për profilet profesionale: Përpunues i mishit, Përpunues i qumështit, Furrtaar kuzhinier, Përpunues i frutave dhe perimeve, Agrobiznesi - niveli I, klasat 10-11/ niveli II, klasa 12<sup>40</sup>.

---

<sup>40</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Programi mësimor Arsimit Profesional, TEKNOLOGJI USHQIMORE Profili: Përpunues i mishit Niveli I, Klasat 10, 11, Niveli II, klasa 12, Kosovë, 2012

## Struktura e Kornizës së Kurrikulit ka elementet si në vijim:

### I. Njoftime të përgjithshme për shkollimin

#### 1. Struktura e shkollimit

Arsimimi në lëmin mësimor “...”profili: **XY** për nivelet I dhe II trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm të lartë në Kosovë.

- **Niveli i parë** i arsimimit profesional, me kohëzgjatje dy vite mësimore (klasat 10,11);
- **Niveli i dytë** i arsimimit profesional, me kohëzgjatje një vit mësimor (klasa 12).

Kurrikuli i lëmit është i strukturuar me lëndë dhe module mësimore, si më poshtë:

- *Grupi i lëndëve teorike të kulturës së përgjithshme*, që synojnë formimin shkencor/humanitar të nxënësve për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri, si dhe vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm.
- *Grupi i moduleve mësimore profesionale, teorike-praktike*, që synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat e nevojshme për t’u integruar me sukses në tregun e punës.

#### 2. Qëllimet e përgjithshme të shkollimit (Janë të theksuara detajisht)

#### Grupi të cilit i drejtohet shkollimi (Është i përkufizuar globalisht)

3. **Shkollimi i mëtejshëm:** Përfundimi me sukses i shkollimit për drejtimin në nivelin I u lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit, të nivelit II. Përfundimi me sukses i shkollimit në nivelin II u lejon nxënësve për të fituar diplomën e maturës, me të drejtë kalimi në shkollimi në lartë universitar.

#### 4. Mundësitë e punësimit

**II. Kompetencat e fituara nga nxënësit në përfundim të shkollimit:** 1. Kompetencat e përgjithshme 2. Kompetencat profesionale (Janë të identifikuar saktësisht)

**III. Plani mësimor për lëmin mësimor“ .....”, Profili: XY - Niveli I-II**

	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët vjetore		
		Niveli I		Niveli II
		Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12
A.	Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	16 (576)	12 (432)	12 (396)
B.	Modulet teorike profesionale (Gjithsej)	9 (324)	9 (324)	7 (231)
C.	Modulet e praktikës profesionale (Gjithsej)	7 (252)	11 (396)	13 (429)
	Gjithsej A+B+C	32 (1152)	32 (1152)	32(1056)

Planin mësimor e karakterizon organizimi i përmbajtjeve mësimore për teorinë profesionale në module teorike profesionale.

#### **IV. Udhëzime për zbatimin e Kornizës së programit mësimor profesional**

Programet e hollësishme të lëndëve të përgjithshme parashtrihen në një dokument të veçantë të MASHT-it.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësve në mbarim të secilit prej të dy niveleve të përgatitjes në fushë do të organizohet në formë provimesh:

#### **V. Udhëzime të përgjithshme didaktike**

**VI. Programet e përgjithshme të lëndëve profesionale dhe të moduleve mësimore (të teorisë dhe praktikës profesionale).**

❖ **Programi i lëndës:**

Lëmi, profili, niveli, klasa. I. Qëllimet e lëndës, II. Fondi i orëve të lëndës, III. Programi i hollësishëm i lëndës, Kapitulli:

- a) Qëllimet e kapitullit;
- b) Temat e kapitullit;
- c) Udhëzime didaktike për kapitullin;
- d) Kushtet për realizimin e kapitullit.

**❖ Përshkruesi i moduleve teorike profesionale dhe profesionale praktike**

Moduli, lëmi, profili, niveli I, klasa e 10-të.

Qëllimi i modulit, kohëzgjatja e modulit, kreditë (orët), niveli i parapëlqyer për pranim, rezultatet e të mësuarit (RM) dhe përmbajtja, procedurat e vlerësimit, më poshtë jepen shkurtime që do të përdoren: RM – Rezultatet e të mësuarit; IV – Instrumentet e vlerësimit; KR – *Kriteret e vlerësimit*:

Udhëzime për zbatimin e modulit- kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit (Janë të detajuara për profilet profesionale përkatëse)

**C. Modeli kurrikular për Qendrat e Kompetencës në Ferizaj dhe Prizren, që janë në proces të hartimit brenda periudhës 2012/2013**

Për QK në Ferizaj janë në hartim kurrikulat për profilet profesionale<sup>41</sup> në lëmin e mjekësisë (Asistent i ortotistit, Ndihma për dëgjim (Akusticien), Nutricionizëm dhe siguri ushqimore, Kujdesi për komunitetin dhe shëndetin, Asistent i prodhimit farmaceutik, Teknik dentar, Asistent i ortopedisë, Optika –riparues i syzeve), respektivisht në QK në Prizren për profilet profesionale (Nëpunës i eksport – importit, Nëpunës i marketingut, Tregtar me shumicë, Menaxher i

---

<sup>41</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Arsimit Profesional, KURRIKULA BËRTHAMË, Programi pilot për kualifikimin e profilit: Kontabilist, Në lëmin Ekonomi, Niveli 3 i Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës Shkalla 5 e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, Niveli I i Arsimit Profesional, klasat 10 dhe 11, hartuar me mbështetjen e Projektit KSV/015 "Mbështetje për Reformën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë", Kosovë, 2012

tregtisë me pakicë-blerje, Shërbime ndaj konsumatorit dhe shitjes, Planifikim udhëtimi dhe informim për turizëm, Planifikim dhe menaxhim ngjarjesh, Menaxhim turizmi, Nëpunës i financave, Administrues zyre dhe menaxhment, Nëpunës i zhvillimit të burimeve njerëzore, Nëpunës i bankës, Nëpunës i industrisë): Niveli I, klasat 10-të dhe 11-të; Niveli II, klasa 12-të.

## **Struktura e Kornizës së Kurrikulit i ka elementet si në vijim:**

### **I. Kurrikula bërthamë për profilin**

#### **1. Njoftime të përgjithshme për profilin**

##### **a) Struktura e shkollimit dhe certifikimi;**

- *Niveli i parë* i arsimimit profesional, me kohëzgjatje 2 vjet mësimorë (klasat 10-të dhe 11-të), i përgatit nxënësit për nivelin fillestar (hyrës) të punësimit.
- *Niveli i dytë* i arsimit profesional, me kohëzgjatje një vit mësimor (klasa 12-të), i përgatit nxënësit për të fituar një kualifikim profesional që u mundëson atyre integrimin në tregun e punës.

##### **A. Lëndët e kulturës së përgjithshme dhe**

##### **B. Module mësimore profesionale të ndara në dy grupe kryesore:**

- Module profesionale të përbashkëta,
- Module profesionale të profilit, që synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat profesionale praktike të nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

##### **b) Kërkesat e pranimit të nxënësve;**

##### **c) Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit;**

##### **d) Qëllimet e përgjithshme të shkollimit;**

##### **e) Kompetencat e përgjithshme të nxënësve;**

##### **f).Kompetencat profesionale të nxënësve (të përbashkëta);**

##### **2. Plani mësimor i lëmit.**



**II. Plani mësimor për lëmin mësimor “ ....”, Profili: XY - Nivelet I-II**

	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët vjetore (kredi)	
		Niveli I	
		Klasa 10	Klasa 11
A	Lëndë të kulturës së përgjithshme	17-18 orë/javë	13 orë/javë
B	Module mësimore profesionale	17-18 orë/javë	22 (76Kr)
B1	<i>Module profesionale të përbashkëta</i>	<i>240 (24Kr)</i>	<i>80 (8Kr)</i>
B2	<i>Module profesionale të profilit</i>	<i>380 (38Kr)</i>	<i>600 (60Kr)</i>
	Shuma e orëve vjetore	1200 (120Kr)	1260 (126Kr)

Planin mësimor e karakterizon organizimi i përmbajtjeve mësimore profesionale në module mësimore profesionale (module profesionale të përbashkëta dhe të profilit).

Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.

III. Udhëzime për zbatimin e kornizës së programit mësimor profesional:

*Vlerësimi përfundimtar* i nxënësve, në mbarim të secilës prej të dy shkallëve të përgatitjes.

IV. Udhëzime të përgjithshme didaktike:

4. Programet e lëndëve të kulturës së përgjithshme.

Përshkruesit e moduleve profesionale:a) Përshkruesit e moduleve profesionale të përbashkëta./PËRSHKRUESI I MODULIT X (Kontabilitet).

Titulli i kualifikimit: YX/Vlera e kredive të modulit, Niveli i modulit në KKK:

Niveli i modulit në strukturën arsimore, rezultatet mësimore të modulit (Kontabilitet).

Një shembull

**RM1:** Nxënësi përshkruan detyrat dhe qëllimet e kontabilitetit në ndërmarrje

**Kriteret e Vlerësimit të nxënësit:** Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përkufizojë nocionin, detyrat, organizimin, zhvillimin, sistemin, format dhe qëllimet e kontabilitetit;
- Të identifikojë pasuritë, detyrimet dhe kapitalin e ndërmarrjes;
- Të klasifikojë dokumentacionin kontabël;
- Të kontrollojë, të regjistrojë dhe të arkivojë dokumentet kontabël.

**Kushtet e nevojshme:**

- Aspektet teorike mund të trajtohen në klasë mësimore;
- Veprimtaritë praktike duhet të realizohen në firma ushtrimore të pajisura me kompjuter, printer, skaner, letër;
- Çdo nxënës duhet të jetë i pajisur me kompjuter dhe softuer përkatës;
- Veprimtaritë praktike duhet të kryhen në grupe të vogla prej 4-5 nxënësish.

**Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:**

- Definimi i detyrave dhe qëllimeve të kontabilitetit;
- Skema e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit;
- Procesi i klasifikimit, ruajtjes dhe kontrollit të dokumentacionit kontabël;
- Llojet e kontove aktive dhe pasive.

**Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:**

- Vlerëson pasuritë, detyrimet dhe kapitalin;
- Plotëson, kontrollon dhe ruan dokumentacionin kontabël;
- Kryen regjistrimet kontabël në librin kryesor dhe konto përkatëse;
- Përdor softuerin dhe pajisjet për zyrë.

**Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:**

- Komunikimi korrekt;
- Bashkëpunimi;
- Pedanteria.

**Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:****Metodat e vlerësimit:**

- Pyetje-përgjigje me shkrim (test) për aspektet teorike;
- Listë-kontrolli për aspektet praktike.

**Evidentimi i Vlerësimit:**

- Test me shkrim që verifikon shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit me karakter teorik;
- Vlerësim i çdo nxënësi me listë kontrolli që përmban kriteret e vlerësimit me karakter praktik, që i referohen produktit të punës dhe procesit të punës;

Kufiri minimal i kalueshmërisë në *testin me shkrim* është kur i plotëson 45 % të pikëve, ndërsa në vlerësimin praktik është kur i plotëson 80 % të kriterëve të vlerësimit në *listën e kontrollit*.

Karakteristikë e përshkruesit të moduleve mësimore (të përbashkëta dhe profesionale) është konteksti i përmbajtjes dhe renditjes së elementeve strukturore lidhur me RM, Çfarë me përshkruesit e moduleve në modelet kurrikulare të hartuar më parë ndryshon është përparësia në kriteret e vlerësimit të nxënësit si kërkesë e parë.

**D. Përfundim**

Kurrikulat me Planin mësimor me bazë lëndët mësimore (tematike) si dhe kurrikulat me Planin mësimor me bazë modulet mësimore janë dy lloje kryesore të kurrikulave arsimore, midis të cilave tradicionalisht përhapjen më të gjerë e kanë pasur të parat. Tani, në praktikën arsimore janë të kombinuara respektivisht dhe gërshetohen në modelet e kurrikulave në AAP.

- Kurrikulat që zbatohen në Qendrat e Kompetencës në Skenderaj dhe në Malishevë kanë një referencë të fuqishme ndaj nevojave

për kualifikime profesionale, si dhe zhvillimeve në tregun e punës.

Pasqyrohet te përmbajtja e këtyre kurrikulave, që është e orientuar nga kompetencat e punës dhe nga veprimtaria praktike, si dhe mbështetet në standarde të profesionit.

Numri i përgjithshëm i orëve është i orientuar në më shumë orë pune në ndërmarrje dhe institucione publike, që e dallon nga institucionet profesionale ekzistuese në vend.

Roli kryesor i orëve teorike është që të mbështesë mësimin praktik. Viti i parë përfshin pjesën bazike, nxënësit mësojnë 50 % teori dhe 50 % praktikë. Viti i dytë dallon nga viti i parë, nxënësit orientohen në drejtimin përkatës dhe mësimi zhvillohet 40 % pjesë teorike dhe 60 % pjesë praktike. Viti i tretë, nxënësit i ofrohen një sistemi evropian të mësimin, 20 % teori dhe 80 % praktikë.

- Kurrikula që zbatohet në lëmin e teknologjisë ushqimore ka një koncept kurrikular relativisht të gjerë, që nuk kufizohet vetëm me trajtimin e përmbajtjeve mësimore (programet lëndore apo modulet), por përfshin dhe elemente të tjera kurrikulare.

*Grupi i lëndëve teorike të kulturës së përgjithshme* synon formimin shkencor/humanitar të nxënësve për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri, si dhe vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm.

*Grupi i moduleve mësimore profesionale, teorike-praktike*, synon përgatitjen e nxënësve me kompetencat e nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

Viti i parë përfshin pjesën bazike, nxënësit mësojnë 50 % teori dhe 50 % praktikë.

Viti i dytë dhe i tretë dallojnë nga viti i parë, nxënësit orientohen në drejtimin përkatës dhe mësimi zhvillohet 40% pjesë teorike dhe 60 % pjesë praktike.

- Modeli kurrikular i synuar për t'u zbatuar në QK në Prizren e Ferizaj në shkallë më të lartë i referohet nevojave aktuale dhe perspektives të tregut lokal për kompetenca pune nëpërmjet bazimit të përmbajtjes së Kurrikulit të “analiza e profesionit-analiza funksionale” dhe të standardet përkatëse të profesioneve.  
*Grupi i lëndëve teorike të kulturës së përgjithshme* synon formimin shkencor/humanitar të nxënësve për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri, si dhe vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm –mundëson arritjen e kompetencave kryesore.  
*Grupi i moduleve mësimore profesionale të përbashkëta dhe të profilit* synon përgatitjen e nxënësve me kompetencat e nevojshme për t'u integruar me sukses në tregun konkurrent të punës.  
Viti i parë përfshin pjesën bazike, nxënësit mësojnë 60% teori dhe 40% praktikë. Viti i dytë dhe i tretë dallojnë nga viti i parë, nxënësit orientohen në drejtimin përkatës dhe mësimi zhvillohet 30 % pjesë teorike dhe 70 % pjesë praktike.

## **Rekomandime**

- Unifikimi i modeleve ekzistuese kurrikulare të Qendrave të Kompetencës në një model metodologjik dhe strukturor, me format standard në nivel qendror, duke respektuar edhe veçoritë e secilit sektor, akoma kërkon shqyrtim dhe ekspertizën e duhur nga këndvështrimi i planit mësimor;
- Duhet synuar për një model kurrikular të bazuar në projekte mësimore. Sipas këtij modeli, gjithë veprimtaritë mësimore strukturohen në formën e një projekti për arritjen e një produkti relativisht kompleks;
- Në të ardhmen duhet bërë një analizë më të thellë dhe gjithëpërfshirëse të modeleve kurrikulare që tani janë në zbatim në ndërlidhje me KB-të e nxjerra nga KKK.

## Referencat

1. Albina Buci - “Të nxënit bazuar në projekte”, AKAFP, Tiranë, 2010.
2. Instituti i Studimeve Pedagogjike – “Reformimi i Kurrikulit të Arsimit dhe Formimit Profesional”, Tiranë, 2000.
3. Istrazivacki project: Metodologija za kreiranje modularnih kurikuluma srednjih strukovnih škola u skladu s promjenama na tržištu rada, 18. rujna 2011, Zagreb.
4. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë –Qendra e Kompetencës në Skenderaj “Kurrikuli :Instalues i ngrohjes dhe ventilimit /niveli i trajnimit, vitet I, II, III”, Prishtinë, Kosovë, prill 2010.
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë –Qendra e Kompetencës në Malishevë “Kurrikuli: Shitje dhe Marketing /niveli i trajnimit, vitet i I,II,III”, Prishtinë, Kosovë, prill 2010.
6. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Programi mësimor Arsimi Profesional, TEKNOLOGJI USHQIMORE, profili Përpunues i mishit, nivelet I dhe II, Prishtinë, Kosovë, 2012.
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Arsimi Profesional, KURRIKULA BËRTHAMË , Programi pilot për kualifikimin e profilit: Kontabilist, në lëmin Ekonomi, niveli 3 i Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës, shkalla e 5-të e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, niveli I i Arsimit Profesional, klasat 10 dhe 11 në hartim me mbështetjen e projektit KSV/015, "Mbështetje për Reformën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë", Kosovë, 2012.
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë – “Program mësimor për vegëltar -nivelet I dhe II”, Prishtinë, 2008.
9. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë – “Program mësimor për vegëltar -nivelet I dhe II”, Prishtinë, 2008.

Mr. Sc. Hajrije Devetaku-Gojani

## ZHVILLIMET NË PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE TË GJUHËS SHQIPE NË ARSIMIN E DETYRUAR

### **Përmbledhje**

Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe të hartuara pas Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës të vitit 2001, për dallim nga Programet e mëhershme, që orientoheshin kryekëput në përmbajtje mësimore, sjellin një qasje të re të mësimdhënies së gjuhës. Kjo qasje e kombinuar fokusohet në rezultate mësimore, por që e ka të përcaktuar edhe përmbajtjen, e cila i orienton mësimdhënësit e gjuhës shqipe në procesin mësimor. Risitë në Programet e reja mësimore vërehen si për nga struktura e tyre ashtu edhe për nga qasja metodologjike.

Në këtë punim janë analizuar Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar në Kosovë 2003-2005, në të cilat përfshihen struktura e tyre, qasja me të cilën janë hartuar ato, përparësitë, dobësitë dhe funksioni i tyre. Analiza ofron informacione të rëndësishme, të cilat do t'i shërbejnë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, Institutit Pedagogjik të Kosovës, hartuesve të kurrikulave dhe Planeve e Programeve të reja, mësimdhënësve, dhe të gjithë partnerëve të tjerë, të cilët do të mund të krijojnë një koncept të qartë për zhvillimet e tyre, për risitë, për përparësitë dhe mangësitë, të cilat do t'u shërbejnë në të ardhmen, qoftë me rastin e rishikimit të Programeve, qoftë në rast të analizave apo diskutimeve që mund të bëhen për to.

Analiza mbështetet në dokumentet e Planeve dhe Programeve mësimore të arsimit të detyruar, në klasat 1-9, në Planet dhe programet e viteve të 90-ta, në dokumentet e Kornizës së Kurrikulit, në dokumentin e vlerësimit të hapave të parë të Planeve dhe Programeve dhe në analizat e Institutit Pedagogjik të Kosovës. Aspektet e trajtuara

në veçanti janë: qasja e mësimdhënies e orientuar në përmbajtje dhe mësimdhënia e orientuar në rezultate, përparësitë dhe dobësitë e këtyre qasjeve, harmonizimi i tyre me kërkesat dhe nevojat e nxënësve, si dhe hapat që duhet ndërmarrë me rastin e rishikimit të Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe në të ardhmen. Po ashtu, kemi krahasuar dhe vlerësuar në këtë analizë edhe aspekte të tjera të rëndësishme, siç janë: shkathtësitë gjuhësore apo shkathtësitë komunikuese dhe dallimi i tyre me përmbajtjen e lëndës, pastaj rezultatet mësimore, qasja lëndore dhe ndër-lëndore, qasja metodologjike dhe aspekte të ndryshme të vlerësimit, për të cilat nuk është diskutuar aq shumë dhe u kanë munguar programeve të vjetra.

Me gjithë ndryshimet e bëra në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe, duke filluar nga struktura, qasja metodologjike, shkathtësitë gjuhësore dhe funksioni i tyre në arritjen e rezultateve të nxënies, konsiderojmë se aspektet të cilat kanë sjellë probleme për zbatimin e suksesshëm të tyre në shkollë dhe në mësimdhënie kanë të bëjnë me mungesën e informacioneve relevante nga mësimdhënësit për Programet e reja, mungesën e trajnimeve të vazhdueshme profesionale dhe metodologjike dhe me mungesën e udhëzuesve të veçantë për mënyrën e zbatimit të tyre në praktikë.

## **I. Hyrje**

Rëndësia e Planeve dhe Programeve të reja mësimore qëndron në faktin se ato sjellin avancime në raport me Planet dhe Programet pararendëse. Filozofia e hartimit të këtyre programeve mbështetet në qasje të kombinuar, e cila përqendrohet në rezultatet mësimore, duke pasur në konsideratë edhe përmbajtjen. Aspekt tjetër i rëndësishëm që i karakterizon këto programe është zhvillimi i shkathtësive gjuhësore/komunikuese: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Me hartimin e programeve të reja mësimore të gjuhës shqipe janë hartuar edhe tekste të ndryshme shkollore, të cilat reflektojnë qasjen e bazuar në shkathtësi, edhe pse jo në nivel të kënaqshëm. Ikja



nga të mësuarit e strukturave gjuhësore në mënyrë tradicionale dhe përvetësimi i strukturave gjuhësore në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit, si dhe në funksion të arritjes së rezultateve mësimore, janë dy çështje me rëndësi që trajtohen në këtë analizë, me qëllim të dhënies së informacioneve relevante për ndryshimet e ndodhura në këtë fushë dhe për ndikimin e tyre në procesin mësimor. Po ashtu, me rëndësi të veçantë është të shihet se mënyra e projektimit të mësimit të gjuhës shqipe në nivele të ndryshme të njohjes, në nivelin e zhvillimit të shkathtësive gjuhësore dhe në nivelin e rezultateve mësimore, ka qenë apo jo funksionale dhe të shihet a ka sjell vërtet ndryshim në procesin mësimor, siç ishte menduar.

### 1.1. Qëllimet e punimit

- Ofrimi i informacioneve relevante për ndryshimet në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe në vitet 2003-2005, funksioni dhe zbatimi i tyre në shkolla, vështirësitë me të cilat ballafaqohen mësimmshënësit në zbatimin e tyre dhe ndikimi i qasjes me të cilën janë hartuar ato në rezultatet mësimore.
- Nxjerrja e rekomandimeve orientuese për adresimin e nevojave për plotësime dhe ndryshime në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe në të ardhmen.

## **II. Analizë e dokumenteve të Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar**

Planet dhe Programet e reja mësimore, të hartuara në periudhën kohore 2003-2005, promovojnë një qasje të re të mësimit të gjuhës shqipe, e cila orienton mësimin e gjuhës në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit, që janë të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit<sup>42</sup>. Gramatika, e cila identifikohet me gjuhën dhe tekstet letrare që identifikoheshin me letërsinë, tashmë është e integruar në këto programe në arsimin e detyruar, si fusha të ndryshme, jo me qëllim të

---

<sup>42</sup> Shkathtësitë gjuhësore në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe pasqyrohen nëpërmjet kategorive dhe nënkategorive.

zhvillimit të tyre si fusha të veçanta, por me qëllim të integritimit dhe funksionimit të të gjithë komponentëve gjuhësorë në një të vetëm, pra në funksion të zhvillimit të shkathtësive komunikuese.

Projektimi i gjuhës shqipe në Planet dhe Programet e viteve 2003-2005 në arsimin e detyruar, në klasat 1-9, është konceptuar në atë mënyrë që gjuha të jetë në funksion të përvetësimit dhe përdorimit të shkathtësive të komunikimit, pa u orientuar në struktura të ngurta gjuhësore, por dhe pa i anashkaluar ato. Është bërë përpjekje që strukturat gjuhësore të integrohen në programin e gjuhës shqipe në funksion të zhvillimit praktik të gjuhës, me idenë që pas përvetësimit të njohurive për to nxënësit të mund t'i zbatojnë ato në situata konkrete.

Ajo që u ka munguar Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe deri në kohën e hartimit të Programeve të reja është pjesa praktike, pa të cilën ideja e përvetësimit të gjuhës shqipe përmes strukturave gjuhësore nuk ka sjellë në masën e duhur përdorimin praktik të gjuhës në situatat në të cilat janë ballafaquar nxënësit: në klasë, shkollë, medie etj. Strukturat gjuhësore janë konsumuar ngurtësisht te nxënësit, të cilët i kanë mësuar mekanikisht në mënyrë të shkëlqyeshme, por që në vazhdimësi janë ballafaquar me probleme të theksuara në rastet e përdorimit praktik të tyre. Ikja nga faktet dhe informacionet e panevojshme, të cilat e ngarkojnë mësimdhënien dhe nxënien dhe aftësimi i përdorimit praktik të fakteve dhe informacioneve të domosdoshme ishte një sfidë jashtëzakonisht e madhe, e cila i karakterizon Planet dhe Programet e reja mësimore të gjuhës shqipe.

Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe të periudhës në fjalë dallojnë nga Planet dhe Programet paraprake, si për nga struktura: qëllimi, objektivat, kategoritë, nënkategoritë, organizimi i përmbajtjes programore, po ashtu edhe për nga qasja metodologjike. Pra, në këtë kuptim, përveç qëllimit, objektiveve dhe përmbajtjeve, ka ndryshuar edhe mënyra e të shtruarit të problemeve të gjuhës dhe mënyra e përvetësimit të njohurive për gjuhën, pjesë e së cilës janë edhe strukturat gjuhësore, fokusi i të cilave paraqitet edhe në gjuhën e

rezultateve të pritura, të cilat jo çdoherë janë përshkruar qartë. Një çështje tjetër që reflektohet në këto programe është edhe qasja ndërlëndore dhe ndërprogramore, përmes së cilës synohet zhvillimi i shkathtësive gjuhësore, duke trajtuar edhe tema nga edukata qytetare, historia e kulturës, por edhe tema të tjera nga shëndetësia, të drejtat e njeriut, çështjet gjinore etj<sup>43</sup>. Tri elemente të tjera të rëndësishme të programeve të gjuhës shqipe, sa i përket qasjes metodologjike që mësimdhënësi duhet t'u kushtojë vëmendje janë: përqendrimi në komunikimin/shkathtësitë e komunikimit, përqendrimi në gjuhën e gramatizuar dhe përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij<sup>44</sup>, të cilat po ashtu u kanë munguar programeve të mëhershme dhe të cilat e ndihmojnë mësimdhënësin e gjuhës për mënyrën e qasjes që ai duhet të përdorë me nxënësin.

Në Planet dhe Programet e viteve të 90 -ta, përveç përmbajtjes programore për gjuhën dhe letërsinë, po ashtu është specifikuar edhe plani operativ, përmes të cilit shkoqitet tërë materia së bashku me numrin e orëve për secilën njësi/temë<sup>45</sup>. Për shembull, janë specifikuar konkretisht tregimet që do t'u mësohen nxënësve, përrallat, vjershat, e kështu me radhë. Për dallim nga këto programe, në Planet dhe Programet e reja mësimore në arsimin e detyruar gjuha dhe letërsia janë konceptuar si një lëndë mësimore e integruar. Programi i ri i gjuhës shqipe promovon idenë e zhvillimit të shkathtësive të komunikimit dhe idenë e realizmit të mësimdhënies mbështetur në rezultatet e pritura. Njësitë mësimore, temat dhe fushat tematike të paraqitura në këto programe janë në shërbim dhe në funksion të arritjes së rezultateve mësimore të përcaktuara në këto programe.

---

<sup>43</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Pani dhe Programi mësimor 7, Prishtinë, 2004, f. 24.

<sup>44</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Pani dhe Programi mësimor 8, Prishtinë, 2005, f. 25.

<sup>45</sup> Ministria e Arsimit e Kosovës: Programi i Gjuhës dhe i letërsisë shqipe për klasën V të shkollës fillore, Prishtinë, 1994.

Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe, të hartuara në vitet e 90-ta, synimet e lëndës i klasifikonin në dy fusha: për gjuhën dhe për letërsinë shqipe. “Programi i gjuhës shqipe fokusohet në katër linja kryesore, që janë: një për gjuhën e folur, një për gramatikën, një për drejtshkrimin dhe një për gjuhën e shkruar në tërë shkollën tetëvjeçare”<sup>46</sup>. Sipas kësaj strukture, shkathtësia e leximit nuk ka qenë synim për t’u zhvilluar përmes lëndës së gjuhës, por kjo shkathtësi që në këto programe emërohet si linja e të lexuarit, mbetet për t’u zhvilluar përmes lëndës së letërsisë<sup>47</sup>. E njëjta strukturë, qasje dhe logjikë e trajtimit të temave është edhe në programet e tjera të gjuhës shqipe të asaj kohe. Po ashtu, synimet dhe kërkesat e lëndës paraqiten ndaras për gjuhën dhe për letërsinë shqipe<sup>48</sup>. Në programet e reja, gjuha dhe letërsia, me theks të veçantë në arsimin e detyruar, nuk shikohen si dy lëndë apo fusha të ndara, por përmes të dyja fushave do të zhvillohen shkathtësitë gjuhësore, që janë: dëgjimi (të kuptuarit), të folurit, leximi dhe shkrimi si dhe gramatika si një fushë e veçantë në funksion të zhvillimit praktik të tyre.

Karakteristikë tjetër e Planeve dhe Programeve të reja mësimore, në raport me Planet dhe Programet e viteve të 90-ta, është fleksibiliteti në shpërndarjen e orëve dhe në zgjedhjen e përmbajtjeve programore në gjuhën shqipe, të cilat janë të hapura dhe mundësojnë autonominë e mësimdhënësve, natyrisht në funksion të arritjes së rezultateve të përcaktuara. Pra, ajo që i karakterizon programet e reja janë pikërisht përcaktimi i rezultateve mësimore në fund të secilës klasë, të cilat i orientojnë mësimdhënësit se çfarë duhet të dinë nxënësit në fund të klasës përkatëse. Planet dhe Programet e reja mësimore promovojnë mësimdhënien e orientuar në rezultate mësimore, përderisa programet e

---

<sup>46</sup> Republika e Kosovës: Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Kulturës, Plani e Programi i Gjuhës Shqipe e i letërsisë për shkollën fillore, klasa I-IV, Prishtinë, 1996, f. 15.

<sup>47</sup> Po aty, f. 35

<sup>48</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Kulturës, Plani dhe Programi i Gjuhës Shqipe dhe i letërsisë për klasën VIII, Prishtinë, 1997, f. 3-12.

viteve të 90-ta mësimdhënien e orientonin në përmbajtje mësimore, e cila është trajtuar në çdo detaj dhe për çdo klasë nga hartuesit e Planeve dhe Programeve.

Në funksion të arritjes së rezultateve mësimore të programeve të reja, përmbajtja programore është një komponent e rëndësishme por jo e vetmja. Përveç përmbajtjes së përcaktuar në këto programe, mësimdhëniesit mund të përcaktohen edhe për përmbajtje të tjera, nëse mendojnë se mund t'i arrijnë më lehtë rezultatet mësimore.

### **III. Qasja metodologjike e Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar**

Qasja metodologjike dhe mënyra e të shtruarit të problemeve gjuhësore është një karakteristikë tjetër e veçantë, e cila i karakterizon programet e reja mësimore dhe po ashtu e orienton mësimdhënien në arritjen e rezultateve mësimore.

Përderisa në të kaluarën mësimdhënia e gjuhës shqipe është përqendruar në përmbajtje mësimore, qëllimi i të cilave ishte i kufizuar në vetë përmbajtjet që përcaktoheshin në programe mësimore dhe pastaj trajtoheshin në tekste shkollore, Planet dhe Programet e gjuhës shqipe të hartuara në vitet 2003-2005 promovojnë qasjen e orientuar në rezultate mësimore, kurse përmbajtja e përcaktuar në këto programe është në funksion të arritjes së rezultateve të përcaktuara për secilën klasë. Ideja e përcaktimit të rezultateve mësimore për secilën klasë dhe zbatimi i përmbajtjeve mësimore në funksion të arritjes së tyre në gjuhën shqipe ishte që mësimi dhe mësimdhënia e lëndës së gjuhës shqipe mos të shikohet vetëm në nivelin e njohjes, por të shikohet si mundësi e mirë për të vënë në funksion praktikimin e gjuhës në të gjitha situatat, me të cilat ballafaqohen nxënësit, duke përfshirë nivelin e njohjes, të kuptuarit, të zbatuarit, analizën dhe sintezën, të klasifikuara sipas Taksonomisë së Blumit. Pra, mësimdhënia e gjuhës të fokusohet dhe orientohet në arritjen e rezultateve, funksioni i të cilave është praktik dhe u ndihmon nxënësve që të dalin jashtë

kornizave, të cilat bëjnë që gjuha të mësohet për të kuptuar rregullat gramatikore apo për të praktikuar ato, duke i “recituar” në mënyrë mekanike. Nëse një nga përmbajtjet e mësimimit të gjuhës shqipe është “Folja” atëherë ne e dimë që folja ka kohë të ndryshme dhe secila nga kohët e foljes mund të trajtohen në kuadër të përmbajtjeve programore. Qasja e orientuar në rezultate mësimore na mundëson që *Folja dhe kohët e saj* të mos e kenë fokusin në mësimdhënien dhe nxënien mekanike, duke u mësuar në formë të rregullave gramatikore, si për shembull të dimë nocionin e foljes, si zgjedhohet, cilat janë kohët e foljes, por mësimi i foljes të ketë funksion praktik, i cili ndihmon nxënësit që elementet e cituara më lart për foljen të praktikohen saktë dhe në funksion të shkathtësive të komunikimit. Kjo qasje e të mësuarit të gjuhës shqipe, e mbështetur në rezultatet e të nxënimit, do ta ketë funksionin e saj nëse përmbajtja e cituar më lart, pra “Folja dhe kohët e saj”, do të jetë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënimit të përcaktuara në Planin dhe Programin mësimor zyrtar si: *Nxënësi praktikon përdorimin e foljes në kohë dhe situata të ndryshme*<sup>49</sup>. Do të thotë se ky rezultat mësimor na shërben për të kuptuar se përse duhet ta mësojmë foljen dhe çka përfitojmë apo çka jemi në gjendje të bëjmë pasi ta mësojmë atë. Po ashtu, nëse përmbajtja mësimore është “*Shenjat e pikësimit*”, rezultati që duhet ta arrijnë nxënësit për këtë temë është: “Përdor saktë shenjat e pikësimit në dialog, në ligjëratën e drejtë, në llojet e fjalive, në fjalitë e përbëra etj”<sup>50</sup>.

Dallimi në mes të përmbajtjes mësimore dhe rezultatit të pritur qëndron në faktin se përmbajtja mësimore tregon se çka duhet të mësojnë nxënësit, çfarë përmbajtje, çfarë materie apo çfarë koncepte duhet të mësojnë nxënësit, kurse rezultati mësimor përcakton se në çfarë shkalle apo në çfarë niveli duhet ta arrijnë përmbajtjen. Pra, rezultati mësimor përcakton minimumin e kërkesave që nxënësit duhet t’i arrijnë për

---

<sup>49</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe Programi mësimor 6, Gjuhë shqipe, Prishtinë, 2003, f. 21.

<sup>50</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe Programi mësimor 5, Gjuhë shqipe, Prishtinë, 2005, f. 28.

përmbajtjen e caktuar për secilën klasë dhe për secilën lëndë mësimore. Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe, për shkaqe praktike dhe për realizim më të lehtë të programit mësimor, përfshijnë edhe nivelin e përmbajtjes edhe nivelin e rezultateve të pritura, ndonëse kjo mënyrë mund të ketë shkaktuar pak konfuzion, sepse rezultatet mësimore jo çdoherë janë shkruar qartë dhe jo çdoherë janë të matshme. Ideja e përcaktimit të rezultateve mësimore dhe shfrytëzimi i përmbajtjes për t'i arritur ato ishte për ta orientuar punën e mësimdhënësit të gjuhës shqipe në funksion të niveleve të ndryshme të arritjeve dhe jo vetëm në nivelin e njohjes, përmes të cilit nxënësit mësojnë dhe prodhojnë vetëm fakte.” *Kjo qasje i ka përparësitë e veta dhe madje mund të preferohet në rastet kur mësimdhënësit nuk janë të aftësuar sa duhet dhe nuk ndihen mirë me qasjen e bazuar në shkathtësitë themelore*”<sup>51</sup> – është njëri nga konkluzionet e dhëna nga ekspertët e Institutit të Londrës për Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe.

Përqendrimi në rezultate të pritura është bazuar në Kornizën e Kurrikulit të Ri të Kosovës<sup>52</sup>, në të cilin shkathtësitë e komunikimit zënë një vend parësor dhe fushat e tjera të përmendura në kurrikul do ta ndihmojnë zhvillimin e tyre. Ato janë hartuar për të tri nivelet e arsimit.

### *3.1. Roli i mësimdhënësit të gjuhës shqipe kur mësimdhënia përqendrohet në përmbajtje*



Kur mësimdhënia mbështetet apo bazohet në përmbajtje mësimore, roli i mësimdhënësit të gjuhës është parësor dhe theksi bie në lëndën mësimore dhe jo në nxënësin. Mësimdhënësi është dhënës i informacioneve të gatshme, kurse nxënësi është marrës i tyre.

---


<sup>51</sup>Jack Peffers, Euan Reid, Dr Fani Stylianidou, Dr. Paddy Walsh, Professor Michael Young: Institute of Education, University of London: Planprogramet kombëtare në Kosovë-Vlerësimi i hapave të parë, korrik, 2005, f. 23.

<sup>52</sup> Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës: Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, Arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë, Prishtinë, 2001, f. 30-37.

*Mësimdhënësi*



*Nxënësi*




Siç shihet në pamjet e mësipërme, rezultatet e mësimdhënies së fokusuar në përmbajtje janë faktet, të cilat të gatshme dhe të përpunuara



i merr nxënësi. Si pasojë e kësaj forme të mësimit të gjuhës shqipe, nxënësi në të njëjtën mënyrë i riprodhon faktet, të cilat i ka marrë nga mësimitdhënësi. Ai mëson fakte dhe të njëjtat ia tregon mekanikisht mësimitdhënësit, sepse qëllimi parësor është mësimi i fakteve dhe motivimi i tij është nota numerike. Pra, ai pajtohet me gjithçka që i ofrohet, është pasiv në procesin mësuesor dhe mëson vetëm për notë. Në këtë kuptim, zhvillimi i shkathtësive gjuhësore mbetet i zbehtë, për të mos thënë nuk zhvillohet fare.

*3.2. Funkzioni i mësimitdhënies së gjuhës shqipe mbështetur në rezultate mësuesore*



Për dallim nga mësimitdhënia e bazuar në përmbajtje, ku përqendrimi ishte te mësimitdhënësi dhe te lënda mësuesore, në mësimitdhënien e mbështetur në rezultate mësuesore përqendrimi është te nxënësi dhe te nxënia e tij. Pra, roli i mësimitdhënies të gjuhës shqipe do të

përqendrohet te nxënësi dhe te nxënia e tij. Gjithçka që do të bëhet në procesin mësimor do të sillet rreth nevojave dhe interesimeve të nxënësve. Në këtë kuadër, Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe dhe qasja me të cilën janë hartuar ato vënë në pah nevojat e nxënësve dhe kjo vërehet në njëfarë mase brenda komponentëve të cilat i përmbajnë programet.


Planet dhe Programet e reja mësimore të gjuhës shqipe janë hartuar në nivele të ndryshme të njohjes. Kryesisht promovohet qasja e bazuar në rezultate, mësimdhënia e përqendruar te nxënësi dhe jo gjithsesi te lënda mësimore, siç ishte më parë. Kjo qasje ngërthen në vete shumë dimensione dhe shumë komponentë, që përveç njohurive për gjuhën nxënësi do të mund të fitojë dhe të zhvillojë edhe shprehë, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, prapa së cilave qëndrojnë nxënësit e suksesshëm, kritikë, kreativë, hulumtues dhe të pavarur. Gjuha dhe mësimdhënia e saj përqendrohen jo vetëm në marrjen e informacioneve të gatshme, por edhe në hulumtimin e informacioneve nga vetë nxënësit, përpunimin e tyre dhe në fund vënien e tyre në funksion praktik të përvetësimit dhe pastaj përdorimit të gjuhës. Fokusi i gjuhës dhe i mësimdhënies së gjuhës shqipe vendos nxënësin në qendër të vëmendjes dhe në qendër të të gjitha proceseve që ndodhen në klasë dhe në shkollë. Vëmendja e mësimdhënësve në këtë kuptim dhe në mbështetje të këtyre programeve do të duhej të ishte jo se çka t'i mësojnë nxënësit, por si t'i mësojnë ata dhe si të arrijnë rezultate.

### *3.3. Roli i mësimdhënësit të gjuhës shqipe kur mësimdhënia përqendrohet në rezultate*


Me ndërrimin e qasjes së mësimdhënies nga ajo e fokusuar në përmbajtje dhe fakte në atë që mbështetet në rezultate mësimore, qasje me të cilën janë hartuar programet e reja të gjuhës, është dashur që të ndërrojë edhe roli i mësimdhënësit të gjuhës shqipe, nga dhënësi i informacioneve në koordinimin dhe orientimin e nxënësve për hulumtimin e tyre. Roli i mësimdhënësit bëhet bashkëpunues,

motivues, stimulues dhe orientues i procesit mësimor drejt arritjeve. Në këtë kornizë ndryshon edhe roli i nxënësit nga ai pasiv dhe i cili mëson për notë në atë aktiv, ndërveprues, komunikues efektiv, mendimtar kritik dhe kreativ dhe i cili synim parësor të tij ka zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive bazike, të cilat atij i shërbejnë në çdo situatë.

***3.3.1. Roli i mësimdhënësit të gjuhës shqipe kur mësimdhënia përqendrohet në rezultate***



***3.3.2. Ndikimi i rolit të mësimdhënësit në ndryshimin e rolit të nxënësit kur mësimdhënia mbështetet në rezultate***



#### **IV. Zbatueshmëria e Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar**

Mungesa e informimit të mirëfilltë të mësimeve të gjuhës shqipe për Planet dhe Programet mësimore është njëri ndër faktorët kryesor që pengon realizimin apo zbatimin e mësimeve të gjuhës shqipe mbështetur në rezultate mësimore dhe në funksion të shkathtësive gjuhësore. Informimi ishte sipërfaqësor, në të cilin nuk u përfshinë të gjithë mësimeve të gjuhës shqipe të arsimit të detyruar, por vetëm disa prej tyre. Kjo çështje duket të jetë sfiduese edhe sot, sepse ende mungon një program trajnimi, përmes të cilit do të bëhej ngritja profesionale e mësimeve të gjuhës shqipe për zbatim të mësimeve mbështetur në rezultate të pritura. Pra, për zbatim të suksesshëm të Planeve dhe Programeve mësimore dhe për arritje të lartë, aftësimi i mësimeve të gjuhës do të duhej të ishte parësor, gjë e cila nuk ka ndodhur deri më tani. Kjo është dëshmuar edhe nga ekipi i ekspertëve nga Londra, të cilët kanë pasur intervista me mësimeve të gjuhës shqipe dhe kanë vëzhguar edhe në orë mësimore mësimeve të gjuhës shqipe, që në raportin e tyre kanë cituar: “Nëse dëshmitë e mbledhura në një orë të vetme mund të shërbejnë si përfaqësuese të orëve të tjera, atëherë gramatika mbetet në kallëpin e vjetër; për shembull, paradigmat e zgjedhimeve foljore caktohen, ilustrohen dhe recitohen pa caktuar asnjë objektiv specifik apo të përgjithshëm të njësive mësimore”.<sup>53</sup> Përveç kësaj, një tjetër konkluzion i këtyre ekspertëve thotë se: “Jo të gjithë mësimeve të gjuhës shqipe kanë pasur rastin të marrin pjesë në kurse aftësuese, të cilat kanë ofruar efekte sipërfaqësore...”<sup>54</sup>. Ekspertët këtu u referohen trajnimeve informative që janë mbajtur me grupe të mësimeve të gjuhës shqipe, qëllimi i të cilave ishte informimi i mësimeve të gjuhës shqipe për risitë e Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe dhe qasjen

---

<sup>53</sup> Jack Peffers, Euan Reid, Dr Fani Stylianidou, Dr Paddy Walsh, Professor Michael Young: Institute of Education, University of London: Plan-programet kombëtare në Kosovë-Vlerësimi i hapave të parë, korrik, 2005, f. 23-24.

<sup>54</sup> Po aty, f. 25.

metodologjike.

Po ashtu, nuk është bërë ndonjë program trajnimi për t'i vlerësuar nxënësit mbështetur në rezultate mësimore<sup>55</sup>. Duke u mbështetur në gjetjet e hulumtimit “Vlerësimi i nxënësve-praktikat dhe treguesit, të realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe për ta fuqizuar këtë çështje edhe më tepër, një nga rekomandimet e dala nga ky hulumtim është “Të hartohet një program funksional dhe koherent për aftësimin e mësimit dhe drejtuesve të shkollave në fushën e vlerësimit dhe në funksion të realizimit të standardeve të përmbajtjes dhe të arritshmërisë”<sup>56</sup>. Si pasojë e mungesës së trajnimeve në këtë fushë, shumica e mësimit dhe drejtuesve të gjuhës shqipe vazhdojnë të punojnë vetëm me tekste shkollore, të cilat i konsiderojnë si një nga burimet kryesore të informacionit dhe që për shumicën e mësimit ato identifikohen me Planet dhe Programet mësimore zyrtare. *Pjesa e mësimit dhe drejtuesve që e praktikojnë mësimit dhe bazuar në Plane dhe Programe janë aftësuar duke qenë vetë pjesë e proceseve nëpër të cilat janë zhvilluar ato dhe jo pjesë e trajnimeve të veçanta.*

Për të parë ndikimin e qasjes me të cilën janë hartuar Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe në rezultatet mësimore, janë analizuar tekstet shkollore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar<sup>57</sup>, të cilat janë hartuar në mbështetje të këtyre programeve. Ajo që vërehet në këto tekste, sidomos në nivelin e parë të shkollimit, në klasat 1-5<sup>58</sup>, shkathtësitë gjuhësore dhe strukturat gramatikore trajtohen mjaft mirë, duke bërë përpjekje për integrimin e tyre dhe po ashtu ofrojnë situata praktike përmes së cilave nxënësit mund t'i praktikojnë ato. Pra, me gjithë problemet për shkak të moszbatimit të mësimit në nivel të

<sup>55</sup> Shih katalogun e programeve trajnuese të akredituara nga MASHT-i, Zyra për trajnimin e mësimit dhe drejtuesve, në të cilin potencohen të gjitha programet e trajnimit.

<sup>56</sup> Grup autorësh: Vlerësimi i nxënësve-praktikat dhe treguesit, Kërkime Pedagogjike, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2010, f. 145.

<sup>57</sup> Kjo është bërë pasi që mësimit dhe drejtuesve të gjuhës shqipe kryesisht mbështetjet vetëm në tekstet shkollore.

<sup>58</sup> Hajrije Devetaku-Gojani: Gjuha Shqipe në tekstet shkollore, Libri Shkollor, Prishtinë, 2009, f. 55-85.

kënaqshëm, bazuar në Plane dhe Programe mësimore, efektet mund të shihen edhe në mësimdhënien e cila vazhdon të mbështetet në tekstet shkollore, pasi që tekstet shkollore reflektojnë kënaqshëm qasjen e bazuar në shkathtësi dhe në rezultate mësimore.

#### **4.1. Çka duhet të ndryshojë në Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe?**

Megjithëse Planet dhe Programet e reja mësimore kanë sjellë risi dhe janë hartuar me qëllim të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit, gjë që mungonte më herët, vërehet një konfuzion në mes të qëllimeve, objektivave dhe rezultateve. Meqenëse ideja ishte që Planet dhe Programet mësimore të gjuhës shqipe të jenë në funksion të arritjes së rezultateve mësimore, atëherë nuk kishte nevojë të përsëriteshin edhe objektivat. Aq më tepër kur nuk është arritur të bëhet diferencim i qartë në mes të objektivave dhe rezultateve. Ato shpeshherë tingëllojnë pothuajse të njëjta, vetëm në korniza të ndryshme. Rezultatet në disa raste nuk janë të matshme, gjë që e vështirësojnë procesin e vlerësimit të bazuar në to.

Me rastin e rishikimit të Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe, do të ishte e preferuar që objektivat dhe përmbajta e lëndës të mos përfaqësohen fare, në mënyrë që të mos shkaktohet konfuzion, duke u përsëritur dhe ngatërruar ato me rezultatet. Projektimi i mësimimit të gjuhës shqipe, i mbështetur vetëm në rezultate, do t'i sqaronte më tepër kërkesat e lëndës për secilën klasë dhe për secilin nivel. Ajo që do të duhej të ishte e qartë për hartuesit e Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe për çdo rishikim të mundshëm është: Gjuha me të cilën hartohen rezultatet duhet të jetë e matshme, duke pasur parasysh se do ta ndihmonte edhe procesin e vlerësimit të brendshëm, por edhe procesin e vlerësimit në nivel qendror. Po ashtu, rezultatet duhet të harmonizohen edhe me kërkesat e standardeve për Shkollat Mike për Fëmijë, posaçërisht në dimensionin Efikasiteti në

mësimdhënie dhe nxënie, në të gjitha standardet e këtij dimension, konkretisht në fushat Kurrikula dhe procesi mësimor<sup>59</sup>.

Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit nuk është nevoja që të futet nën ombrellën e kategorive dhe nënkategorive dhe nuk është nevoja që të futet brenda disa kornizave apo shablloreve të pakuptimta, por do të duhej që në funksion të shkathtësive të komunikimit të përcaktohen rezultatet mësimore dhe të plotësohen edhe me disa komponentë të tjerë, siç janë kompetencat kryesore të nxënies, për t'u harmonizuar edhe me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës<sup>60</sup>.

Fazat nëpër të cilat duhet të kalojë procesi i rishikimit të planeve dhe programeve mësimore janë: Analiza e nevojave, të shkruarit e kurrikulit apo Planeve e Programeve mësimore, zbatimi i tyre, monitorimi dhe vlerësimi<sup>61</sup> dhe rivlerësimi i serishëm deri në përmirësimin dhe avancimin e tyre.

## **Përfundime**

Mbështetur në analizën e dokumenteve të Planeve dhe Programeve mësimore në arsimin e detyruar dhe në gjetjet nga analiza e bërë, konsiderojmë se krahas ndryshimeve pozitive dhe të suksesshme të gjuhës po ashtu vërehen edhe mangësi të tjera, të cilat duhen evituar në të ardhmen. Ndryshime të theksuara që përfaqësohen në këto programe kanë të bëjnë me qasjen metodologjike, përmes së cilës do të mund të zhvillohen shkathtësitë komunikuese, të cilat ndihmojnë arritjen e rezultateve të nxënësve. Pengesat dhe vështirësitë, të cilat i kanë

---

<sup>59</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Instituti Pedagogjik i Kosovës: Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë, draft-dokument për përdorim të brendshëm, Prishtinë, shkurt, 2012, f. 20-23.

<sup>60</sup> Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Kosovës, Prishtinë, 2011, f. 16-21.

<sup>61</sup> Hajrije Devetaku-Gojani: Procesi i zhvillimit të kurrikulit dhe i Planeve e Programeve mësimore në Kosovë 2001-2011, Kërkime Pedagogjike, Nr. 2, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë 2011, f. 157-160.

përcjellë programet e gjuhës shqipe, kanë të bëjnë me aspektin e zbatimit të tyre në praktikë, për të cilën duhet punuar në të ardhmen. Përfundimet nga kjo analizë janë:

- Programet mësimore të gjuhës shqipe sjellin risi në raport me programet e viteve të 90-ta, si në përmbajtje po ashtu edhe në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit;
- Nuk ka harmonizim të plotë dhe ka përsëritje të panevojshme në mes të objektivave, përmbajtjes dhe rezultateve mësimore;
- Mësimdhënësit e gjuhës shqipe nuk janë aftësuar paraprakisht për të punuar me Programet e reja të gjuhës shqipe;
- Jo të gjithë mësimdhënësit e gjuhës janë informuar për risitë dhe qasjen me të cilën janë hartuar programet;
- Nuk janë zhvilluar udhëzues metodologjikë, të cilët do t'i ndihmonin mësimdhënësit e gjuhës shqipe për të zbatuar me sukses programet e reja;
- Përfaqësimi i shkathtësive të komunikimit brenda kategorive dhe nënkategorive nuk përfaqëson në mënyrë të denjë qasjen e re mësimore për mësimin e gjuhës shqipe.

## **Rekomandime**

- Me rastin e rishikimit të Planeve dhe Programeve mësimore të gjuhës shqipe, shtrirja e Programit të lëndës të lirohet nga kornizat aktuale, të cilat nuk konsiderohet se kanë sjellë ndonjë dobi të veçantë;
- Të organizohen trajnime të veçanta për mësimdhënësit e gjuhës shqipe për zbatimin e Programeve mësimore mbështetur në rezultate të pritura;
- Përcaktimi i rezultateve mësimore për klasë të mbështetet në Kurrikulën e re të Kosovës, duke eliminuar kështu objektivat mësimore dhe përmbajtjen me qëllim të ikjes së paqartësive dhe konfuzioneve të panevojshme;



- Të bëhet mentorimi dhe monitorimi i mësimdhënësve të gjuhës shqipe nga institucionet përgjegjëse për t'i ndihmuar ata në procesin e realizimit të mësimdhënies dhe për të kontrolluar kualitetin e arritjeve.

## **Referencat**

1. Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës: Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, Arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë, Prishtinë, 2001.
2. Hajrije Devetaku-Gojani: Gjuha Shqipe në tekstet shkollore, Libri Shkollor, Prishtinë, 2009
3. Hajrije Devetaku-Gojani: Procesi i zhvillimit të kurrikulit dhe i Planeve e Programeve mësimore në Kosovë 2001-2011, Kërkime Pedagogjike 2, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë 2011.
4. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Kërkime Pedagogjike 1, Prishtinë, 2012.
5. Jack Peffers, Euan Reid, Dr Fani Stylianidou, Dr Paddy Walsh, Professor Michael Young: Institute of Education, University of London: Planprogramet kombëtare në Kosovë-Vlerësimi I hapave të parë, korrik, 2005.
6. Ministria e Arsimit e Kosovës: Programi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, për klasën V të shkollës fillore, Prishtinë 1994.
7. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Instituti Pedagogjik i Kosovës: Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë, draft-dokument për përdorim të brendshëm, Prishtinë, shkurt, 2012.
8. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Kosovës, Prishtinë, 2011.

9. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Pani dhe Programi mësimor 7, Prishtinë, 2004.
10. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Pani dhe Programi mësimor 8, Prishtinë, 2005.
11. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe Programi mësimor 5, Gjuhë shqipe, Prishtinë, 2005.
12. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe Programi mësimor 6, Gjuhë shqipe, Prishtinë, 2003.
13. Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës: Plani dhe Programi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë për klasën VIII, Prishtinë, 1997.
14. Republika e Kosovës: Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Kulturës, Plani e Programi i Gjuhës shqipe e i letërsisë për shkollën fillore, klasat I-IV, Prishtinë, 1996.

M. Sc. Ismet Potera

**RËNDËSIA E TË DHËNAVE STATISTIKE  
PËR VENDIMMARRJE NË ARSIM**  
*(Analizë e gjendjes në Kosovë)*

*“Mënyra e të menduarit statistikor për jetën e përditshme të qytetarëve  
një ditë do të jetë e nevojshme,  
njësoj si lexim-shkrimi”*

H.W.Well

## **Hyrje**

Shkas për këtë analizë ishte pjesëmarrja në Konferencën Rajonale në Zagreb (2011), organizuar nga ETF-ja, me temën bosht “Shfrytëzimi i të dhënave për vendimmarrje në arsim”. Pothuajse të gjitha vendet e rajonit i prezantuan problemet dhe sfidat e ngjashme sa i përket regjistrimit, grumbullimit, analizës, përpunimit dhe vlefshmërisë së të dhënave në sistemin e edukimit. Në të gjitha burimet konstatohet se të dhënat e sakta janë faktorë dhe instrumente me rëndësi për funksionim dhe përmirësim në të gjitha fushat e shoqërisë, në veçanti të sistemit të edukimit në një shtet. Ky konstatim nuk e ndihmon përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së sistemit të edukimit nëse ato të dhëna nuk analizohen, nuk krahasohen dhe nuk publikohen për ekspertët dhe për publikun e gjerë. Funksionalizimi i të dhënave arrihet atëherë kur ato shfrytëzohen për vlerësimin e rezultateve të punës së institucionit dhe shërbejnë si bazë për planifikimin zhvillimor të veprimtarisë së institucionit, shkollës, DKA-së apo Ministrisë.

Nëse i referohemi etimologjisë së fjalës “...statistikë rrjedh prej latinishtes mesjetare “status”, që tregon rendin politik,..., [prandaj] ...statistika është shkenca që përshkruan faktet më të rëndësishme të shtetit... dhe i njëjti term në latinishten klasike do të thotë mënyrë e të

*qenit, rrethanë, gjendje faktike dhe në këtë kuptim mund të përfshijë edhe konceptin modern të statistikës, me një fushë zbatimi më të gjerë se ai i mëparshmi*<sup>62</sup>. Pra, këtu edhe dëshmohet rëndësia e ruajtjes së të dhënave, por edhe e përdorimit të tyre në të mirë të përmirësimit të akëcilës do qoftë fushë.

Politikat dhe vendimmarrja duhet të mbështeten në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara. Të dhënat na tregojnë gjendjen, ku/çfarë jemi, në bazë të të cilave orientohemi se kah duhet të shkojmë dhe ku duam të arrijmë. Kjo është arsyeja pse institucioni/organizata duhet që në vazhdimësi të regjistrojë, të dokumentojë, të ruajë, të përpunojë, të analizojë, të krahasojë dhe t'i publikojë\* të dhënat për institucionin. Kjo nuk duhet të bëhet vetëm sa për të krijuar tabela, numra, dokumente të shumta, por për të përcjellë dhe vlerësuar në vazhdimësi përparimin, ngecjet dhe cilësinë e punës që bëjmë.

Edukimit është fusha më e ndjeshme në shoqëri. Nga cilësia e përgatitjes së brezit të ri varet shumë e ardhmja e shoqërisë, e shtetit, e rajonit dhe e ardhmja e njerëzimit. Sot ekzistojnë qendra, institucione dhe agjenci të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat në fokus kanë zhvillimin e arsimit, kahet e zhvillimit, nevojat për ndryshime në arsim në kohën e zhvillimit të hovshëm të TI-së dhe ndikimet në mësimdhënie dhe nxënie, cilësia e edukimit, inkluzioni dhe e drejta për qasje të barabartë në edukim, integrimi në UE etj.

Funksionimi i sistemit arsimor, qëndrueshmëria e tij, nuk mund të zhvillohet pa ndërtimin e sistemit funksional për regjistrimin, grumbullimin, përpunimin, analizën, krahasimin dhe publikimin e të dhënave/treguesve të funksionimit të sistemit, nga niveli parafillor deri në universitet. Dihet se sa buxhet ndahet për funksionimin e sistemit edukativ, si pjesë e shoqërisë, e cila vetëm konsumon dhe kontributi i

---

<sup>62</sup> Giovanni Gironi, Tommaso Salvemini: Leksione të statistikës, Dudaj, Tiranë 2000, fq.14.

\* Sqarim: publikimi nuk vlen për ato të dhëna të cilat cilësohen si sekret i organizatës/institucionit.

së cilës shihet vetëm atëherë kur ekspertët e dalë nga ky sistem ndihmojnë zhvillimin e ekonomisë. Institucionet publike dhe donatorët e tjerë duan të dinë për paranë publike nëse është shpenzuar me vend ose jo. Këtë mund ta mësojnë nga indikatorët me anën e të cilëve vlerëson efikasitetin e gjithë sistemit edukativ. Këta indikatorë gjenden në shkollë, DKA, SMIA dhe në agjencitë e tjera, të cilat i regjistrojnë dhe i publikojnë të dhënat. Prandaj, ndërtimi i sistemit vertikal-horizontale për sigurimin e të dhënave është i domosdoshëm.

### **Kultura e evidentimit të të dhënave**

Në vendet me traditë të mangët statistikore mungon kultura e evidentimit dhe e mbajtjes me rregull të të dhënave, të cilat për çdo ditë i kanë në duar, ballafaqohen me to, i dëgjojnë nga të tjerët, i lexojnë në medie dhe në shumicën e rasteve ato të dhëna mbesin në formë të numrave, të cilat pas një kohe e humbin kuptimin dhe është vështirë të nxirren përfundime nga ato. Kjo ndodh në të gjitha nivelet institucionale dhe shoqërore. Prandaj, është nevojë e ngutshme ndërgjegjësimi i përgjegjësve të institucioneve, nga entet parashkollore deri në ato qeveritare, për kultivimin e kulturës për evidentimin, përpunimin, krahasimin dhe publikimin e të dhënave të besueshme. Për këtë shih moton në fillim.

### **Rëndësia e të dhënave për përmirësimin e cilësisë së arsimit**

Një prej sfidave shoqërore në fushën e të dhënave në arsim në Kosovë është sigurimi i të dhënave të sigurta dhe të vlefshme për fusha të caktuara arsimore. Në shumë raste, sidomos në shkolla, mungon kultura e evidentimit të saktë të të dhënave. Vetëm ata që janë marrë me këto të dhëna, statistika, e dinë se çfarë është niveli i cilësisë dhe i sigurisë së tyre. Sistemi i instaluar kohët e fundit në MASHT/SMIA siguron përpunim të shpejtë dhe të saktë të të dhënave, por nuk garanton vlefshmërinë e tyre. Të dhënat në sistem vijnë nga shkollat dhe komunat.

Ku qëndron rëndësia e të dhënave të sakta?

Nga besueshmëria e të dhënave varet cilësia e politikave dhe vendimeve për përmirësimin e praktikave edukative.

Po vendimmarrja pa u bazuar në të dhëna të sakta dhe të sigurta?

Një element i një të dhëne nga një departament, i cili përcjell cilësinë e edukimit, mund të ndihmojë në vendimmarrje për përmirësimin e cilësisë së edukimit. Shtrohet pyetja, sa këto të dhëna evidentohen, regjistrohen, dokumentohen dhe analizohen në shkollë, DKA? Praktika e deritashme në Kosovë tregon se këso të dhënash dhe analizash në nivel shkolle janë shumë të rralla apo fare. As në nivelin komunal nuk bëhet ndonjë analizë e të dhënave që vijnë nga shkollat, ose nga niveli qendror SMIA<sup>63</sup> ose ASK<sup>64</sup>. Por, janë të rralla shkollat të cilat i kërkojnë këto të dhëna për të parë se ku janë ngecjet më të mëdha, ku janë sukseset dhe ku duhet intervenuar me ndryshime. Ose, a bëhen analiza të trajnimeve dhe certifikimeve të mësuesve për të verifikuar (vlerësuar) ndikimin e tyre në përmirësimin e cilësisë ose rritjen e shkallës së artitshmërisë së nxënësve në nxënie, qoftë në lëndë të caktuara apo në suksesin në përgjithësi? Gjetja e korrelacionit mes këtyre faktorëve, numrit të trajnimeve dhe cilësisë/suksesit të arritur, është mjet me rëndësi për gjetjen e mekanizmave për përmirësimin e cilësisë së edukimit, qoftë në lëndë, në klasë, në shkollë apo në nivel komune.

Problem më vete në këtë aspekt paraqet evidencimi i të dhënave cilësore, të cilat mund të përdoren për përmirësimin e cilësisë në edukim. P.sh., shkolla mban evidenca për trajnimin e mësuesve (numri i trajnimeve dhe llojet), por nuk bën analiza lidhur me ndikimin e këtyre të dhënave në përmirësimin/ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmirësimin e suksesit të nxënësve. Administratori i shkollës mban shënime për planifikimin e mësimeve (vjetor, mujor, përgatitja për orë etj.), por nuk bën analiza për cilësinë e tyre, ndikimin e tyre në

---

<sup>63</sup> Sqarim: SMIA Sistemi i menaxhimit të Informatave në MASHT.

<sup>64</sup> ASK: Agjencia e Statistikave të Kosovës

përmirësimin e cilësisë së nxënies. Shkolla mban evidenca nga monitorimi (drejtori, pedagogu, psikologu ose inspektori), por nuk bëhen vlerësime dhe krahasime për ndikimin e këtyre monitorimeve në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies ose të nxënies. Këto më shumë mbesin në nivel administrativ sesa veprime, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe shfrytëzimit të tyre për të ndërtuar platforma të qëndrueshme për punë dhe nxënie.

### **Të dhënat në nivel të DKA-së**

DKA-të bëjnë veprime të ngjashme me shkollat. Mbajnë evidenca që kanë të bëjnë kryesisht me çështje të buxhetit, të cilat tërthorazi ndikojnë në përmirësimin e cilësisë, dhe të dhënat të cilat ua dërgojnë shkollat për nxënësit, mësuesit, si shifra numerike. P.sh., mbajnë të dhëna për shpenzimet për ngrohje, pajisje, mirëmbajtje të objektit, për hapësira shkollore, numri i nxënësve, mësuesve, kualifikimi i tyre, sukseset sipas semestrave. Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë pothuajse është çështje dytësore për zyrtarët komunalë. Deklaratat e tyre pas dështimeve në vlerësimet e jashtme janë kryesisht: kjo është gjendja reale. Nuk bëhen analiza dhe krahasime midis të dhënave, të cilat kanë të bëjnë me cilësinë në arsim, me qëllim të konstatimit të trendit pozitiv ose negativ në një aspekt të caktuar të arsimit, si p.sh. suksesi, mungesat, specifikat sipas lëndëve mësimore ose sipas shkollave e niveleve të arsimit.

### **Rëndësia e EMIS në menaxhimin e të dhënave në arsim**

SMIA furnizohet me të dhëna nga DKA-të. Tani, me instalimin e softuerit të ri, DKA-të dhe shkollat kanë mundësi të bartin të dhënat në softuer. Të dhënat kryesisht janë numerike, grafike, por pa ndonjë verifikim për validitetin, saktësinë dhe cilësinë e tyre. Nuk bëhet ndonjë hulumtim për verifikimin e saktësisë së tyre. Po të krahasosh raportet statistikore brenda një viti, shihen dallime të mëdha në shifra, por pa bërë ndonjë sqarim ose verifikim pse është ashtu. Sidomos një dukuri e

tillë ndodh me numrin e nxënësve, suksesin dhe lëvizjet e nxënësve. Në shumë raste, nga këto të dhëna nuk mund të gjykosh nëse një numër i nxënësve e ka ndërruar shkollën, e ka lënë shkollimin, apo ka emigruar. Rëndësia kryesore e të dhënave në arsim është njohja me trendin dhe kahet e zhvillimit të një aspekti në sistemin e arsimit. Gjendjen ku jemi, si jemi, e vlerësojmë me treguesit nga evidencat e marra nga të gjitha institucionet, të cilat i grumbullojnë ato të dhëna: shkolla, DKA-ja, Agjencia e Statistikave, SMIA, ministritë e tjera. P.sh., njohja me të dhënat/evidencat për natalitetin dhe mortalitetin nga fshati, ku ka një shkollë, deri të Qeveria, është me rëndësi për orientimin e politikave dhe të planifikimit në edukim.

Çështja e migrimit nga zona rurale në urbane është me shumë rëndësi për planifikimin e regjistrimit të nxënësve në shkollë, planifikimin e kuadrit mësimor, planifikimin e buxhetit, hartimin e planit zhvillimor, të shkollës, komunës ose qeverisë.

Treguesit për suksesin/mossuksesin e nxënësve, në nivel klase, shkolle, në lëndë të veçantë apo në fusha mësimore, paraqesin tregues me vlerë për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përmirësimin e suksesit të nxënësve. Për ndërmarrjen e veprimeve për përmirësimin e një segmenti të veçantë të sistemit të edukimit duhet të zhvillohet një proces i gjatë dhe një varg aktivitete, si marrje vendimesh, planifikimesh, mjete buxhetore dhe ngritje kapacitetesh. Evidencat e sakta orientojnë vendimmarrësit për përcaktimin e prioritetëve për të bërë ndryshime. Këtu shihet edhe rëndësia e evidencave për t'i bazuar/orientuar politikat arsimore. Kjo shton rëndësinë dhe përgjegjësinë për evidencat të sakta, valide, të besueshme dhe të krahasuara me evidencat paraprake të institucionit (shkollës), krahasimi me institucionet e tjera të komunës, të rajonit apo në nivel shtetëror. Vetëm si të dhëna, numra, nuk paraqesin ndonjë vlerë nëse ato nuk analizohen, nuk krahasohen, pasi që “politikëbërja e bazuar në të dhëna iu referohet proceseve, të cilat ndihmojnë marrjen e vendimeve më të



mira, duke vendosur evidencat në qendër të proceseve politike”<sup>65</sup> dhe në bazë të tyre të merren vendime për ndryshime dhe reforma të sistemit arsimor ose të aspekteve të veçanta të sistemit. Vlerën dhe besueshmërinë e të dhënave e rrit saktësia e tyre. Nga besueshmëria dhe saktësia e tyre varet cilësia dhe efikasiteti i vendimeve që marrim. Vendimet e marra bazuar në të dhëna jo të sakta, jo të besueshme, nuk prodhojnë ndryshime pozitive, cilësore, por të gabuara. Marrja e vendimeve të gabuara shtetit i kushton shumë, si në buxhet ashtu edhe në përmirësimin e cilësisë së sistemit edukativ. Këtë e ilustron skema më poshtë: shigjetari jo i saktë, pa njohuri për rëndësinë e poqëve elektrike gabimisht do të qëllojë poqin e gabuar. Pasojat dihen.



Rezultatet e testit të Maturës Shtetërore janë një tregues me rëndësi për t’u përdorur për të përmirësuar shumëçka në sistem. Shkalla e lartë e braktisjes së shkollimit është tregues me rëndësi për ndërmarrjen e veprime ndërinstitucionale për përmirësimin e kësaj dukurie. Zhvillimi i hovshëm i TI-së ka ndikuar që kjo të futet si kompetencë e veçantë e Kurikulit, trajnimeve të shumta etj.

<sup>65</sup> Effective use of statistical data for policy analysis and advocacy: Building on success”, 24-26 October 2011, përgaditur nga Carla Abou Zahr, fq. 2.

SMIA, për nevoja të Ministrisë etj., harton raporte me të dhënat kryesore. Po si janë këto të dhëna dhe a bëhen analiza profesionale të tyre, shihet në një botim të tij. P.sh., kur bëhet krahasim i suksesit të nxënësve nëpër vite thuhet: “Kjo shkallë kaq e lartë e dallimeve është shumë brengosëse. Prandaj, *preokupim kryesor*, jo vetëm i shkollave, Drejtorive komunale, MASHT-it, *por edhe i ekspertëve mbetet aftësimi dhe ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për mënyrat dhe format e vlerësimit të nxënësve*”<sup>66</sup>. Sipas kësaj del se dallimi prej 12 % në suksesin e nxënësve, brenda dy vjetësh, është çështje e vlerësimit, apo mangësi gjatë vlerësimit të dijeve të nxënësve nga mësuesit, e jo cilësia e mësimdhënies apo nxënies.

Mënyra e këtillë e analizës dhe e interpretimi i të dhënave duhet të ndryshojnë, duke u fokusuar në esencën e problemit. Sidomos në gjykimin dhe përfundimet, sugjerimet që dalin nga interpretimi i të dhënave, duhet shumë kujdes dhe profesionalizëm.

Gabimet e këtilla në raportimin dhe prezantimin e të dhënave mund të paraqesin probleme edhe gjatë vendimmarrjes dhe hartimit të politikave përmirësuese në arsim. Të dhënat e raportuara, në formë të treguesve, të paverifikuar dhe pa interpretim adekuat, mund të udhëzojnë për ndërmarrjen e hapave të gabuar dhe nuk e ndihmojnë përmirësimin e praktikave dhe cilësinë e edukimit. Për të ndihmuar përmirësimin e cilësisë së edukimit në Kosovë SMIA jo vetëm të mbledhë të dhënat, por ato duhet të përcjellë në vazhdimësi trendin: rënie-ngritje, rënie-rënie, apo ngritje-ngritje të dukurisë apo të ndonjërit nga treguesit arsimor. Përveç mbledhjes, përpunimit, raportimit, krahasimit, duhet të bëhet edhe një vlerësim kualitativ i këtyre të dhënave.

### **Gabimet gjatë interpretimit të të dhënave dhe mashtrimi vizual**

Në shumë raste, te ne, të dhënat jepen në formë të mesatares dhe të përqindjes (%). P.sh., kalueshmëria në klasën V është 80 %, por ka

---

<sup>66</sup> Treguesit dhe të dhënat statistikore në arsim, 2004-2007, SMIA/MASHT, 2008, Prishtinë, fq. 19.

rezik që shpesh nga mesatarja nuk i shohim problemet në nivel komunal dhe në nivel shkolle, apo në nivel lënde mësimore. Raportohet se Testin e Maturës e kaluan 48 % e maturantëve të Kosovës, por sipas të dhënave kishte shkollë nxënësit e së cilës as 5 % nuk e kanë kaluar testin. Këtu qëndron problemi i mesatares. Në rastin kur vetëm 3-5 % 3 nxënësve kalojnë në vlerësimin e jashtëm, ndërsa në vlerësimin e brendshëm kjo përqindje është 35 % (shembull), atëherë ky tregues duhet të shërbejë për të hulumtuar shkaqet e mospasurisë. Këto shkaqe ndryshojnë nga shkolla në shkollë, nga lënda mësimore në tjetrën, nga mësuesi në mësues, nga brezi i nxënësve në tjetrin. Ose, nëse shihet mesatarja e nxënësve për klasë, është mesatare tejet e kënaqshme, diku rreth 27 nxënës për klasë. Por, nëse i shikojmë rastet ku në një klasë janë edhe 50 nxënës, ku edhe sasia e ajrit për nxënës është jashtë çdo standardi pedagogjik, kjo e dhënë për mesataren e nxënësve nëpër klasë është tejet mashtruese.

Si të shfrytëzohen këta tregues për përmirësimin e suksesit të nxënësve?

E para, shkolla duhet të marrë rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe t'i krahasojë me rezultatet e vlerësimit të brendshëm.

E dyta, duhet t'i identifikojë specifikat për lëndë të caktuar, p.sh., sa është kalueshmëria në matematikë, fizikë etj.

E treta, këto të dhëna t'i krahasojë me klasat dhe shkollat e tjera, në nivel shkolle, komune, rajoni.

E katërta, gjetjet nga krahasimet t'i vendosë si prioritet për përmirësim në vitin vijues.

Prioritetet dhe aktivitetet, të hartuara në formë të objektivave, duhet të bëhen pjesë e Planit dhe Programit vjetor të punës së shkollës. Objektivat më afatgjatë bëhen pjesë e PZhSh-së. Nëse dështimet më të mëdha në suksesin e nxënësve të shkollës XY, sipas treguesve nga vlerësimi i jashtëm, janë në Fizikë, klasa 12/2. ose 9/3. Atëherë këto të dhëna krahasohen me klasat e tjera të shkollës, me të njëjtat klasa në shkollat e tjera. Nxjerrim të dhënave nga realizimi i Programit të Fizikës

për këto klasë. Bisedojmë me mësuesit e kësaj lënde mësimore lidhur me pengesat dhe vështirësitë gjatë realizimit të Planit dhe të programit mësimor të kësaj lënde. Përfundimi: arsimtari i lëndës ka nevojë për aftësi shtesë, nxënësit kanë nevojë për mësim shtesë, shkolla ka nevojë për mjetet didaktike shtesë etj. Të gjitha këto programohen për vitin vijues.

### **Pasoja nga planifikimi pa mbështetje në të dhëna të vlefshme**

Kohët e fundit në kronikat nga komunat kemi lexuar se në XY fshatin shkolla e ndërtuar para 5-6 vjetësh mbyllet për mungesë të nxënësve. Çka do të thotë kjo e dhënë? Mungesë e planifikimit të mirëfilltë, pa u studiuar, analizuar dhe krahasuar të dhënat (statistikat) demografike, migrimi i popullsisë etj. Sa i ka kushtuar taksapaguesit një ndërtim i tillë i dështuar? Çfarë do të mund të bëhej me atë buxhet për të mirën e cilësisë së edukimit? Kjo është pasojë e mangësisë në analizën dhe shfrytëzimin e të dhënave, p.sh. të Agjencisë së statistikave, për zhvillimet në shoqëri në periudha afatgjate. Rastet e këtilla dëshmojnë domosdonë e koordinimit të veprimeve ndërsektorial, kur bëjmë plane afatgjate, qoftë edhe për ndërtimin e një shkolle në fshat apo në qytet.

### **Përfitimi nga të dhënat e vlefshme dhe të sakta**

Çfarë mund të përfitojë mësuesi/shkolla nga të dhënat cilësore si dhe analiza e tyre?

E para, grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave prezantojnë performancën e punës së shkollës dhe të mësuesve.

E dyta, njohja me të dhënat për arritjet, vlerësimi, paraqet një instrument të mirë për njohjen me gjendjen se ku/si jemi dhe ku duhet bërë intervenime për ndryshime dhe avancime në punën e tyre.

E treta, të dhënat duhet t'u shërbejnë atyre për ndryshimin e strategjive, mjeteve dhe qasjeve gjatë punës me nxënës.

Çfarë mund të përfitojnë institucionet dhe shoqëria në përgjithësi nga grumbullimi, përpunimi, analiza dhe publikimi i të dhënave?

Thuhet se “statistikat janë sytë e politikëbërësve”. Institucionet janë hartues të politikave arsimore të një vendi. Përveç tjerash, ato i hartojnë edhe planet dhe programet edukative, i përcaktojnë/përvijojnë përmbajtjet programore për të gjitha nivelet dhe fushat edukative. Gjithashtu, institucionet ndajnë edhe mjete buxhetore për të gjitha veprimtaritë shkollore. Prandaj, të dhënat u duhen:

E para, për të arsyetuar investimet në fushën e arsimit dhe për t’u dhënë llogari taksapaguesve për mjetet që ata i kanë paguar;

E dyta, për të vlerësuar performancën e politikave të veta, të shprehura nëpërmjet programeve dhe planeve mësimore;

E treta, për të përmirësuar dhe avancuar politikat institucionale dhe shtetërore me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarit;

E katërta, për të marrë vendime të qëndrueshme për avancimin e sistemit të edukimit;

E pesta, për të siguruar një sistem edukimi të qëndrueshëm dhe konkurrent me vendet e tjera.

E gjashta, përfiton Ministria e Financave, sepse treguesit nga të dhënat i shërbejnë për vlerësimin e orientimit të drejtë ose të gabuar të buxhetit publik, nevojat për planifikimin e prioritetëve në periudhat në vazhdim, por edhe llogaridhënia për dështimet ose ngecjet eventuale në fusha të caktuara.

### **Çfarë duhet të bëjë shkolla me të dhënat**

Cilët tregues duhet analizuar në shkollë për të vlerësuar shkaqet e rënies së cilësisë?

E para, në cilat lëndë mësimore treguesit tregojnë ngecje? P.sh., nëse në lëndën e Matematikës në të gjitha klasat nota mesatare është 3.5, ose edhe më e ulët. Në lëndën Gjuhë angleze nota mesatare është 3.6, në lëndën Biologji nota mesatare është 4.5. Kështu vlerësohet dhe krahasohet sukcesi në të gjitha lëndët mësimore, për klasë, lëndë dhe për nxënës. Shikojmë pasqyrën e trajnimeve për të gjithë mësuesit e

shkollës. Analizojmë të gjitha aktivitetet mësimore të zhvilluara në lëndët mësimore Matematikë dhe Gjuhë angleze.

**Vendimi:** Mësuesit e Matematikës dhe të Gjuhës angleze duhet të ndihmohen në zhvillimin pedagogjik dhe profesional. Kërkesa bëhet në DKA ose në MASHT.

Me nxënësit të mbahen orë plotësuese për plotësimin e dijes nga këto lëndë mësimore.

Për të ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë duhet ndjekur strategjia në vijim:

Situata → Synimi	Veprimet
Ku gjendemi?	Treguesit/analiza
Çka duam të ndryshojmë?	Planifikimi
Ku duam të arrijmë?	Synimi/pritjet
Si të arrijmë atje?	Aktivitetet
Çka të bëjmë më tutje?	Analiza/vlerësimi
Kush do ta vlerësojë përparimin?	Përgjegjësit
Cilat veprime do t'i matim /vlerësojmë?	Treguesit
	Informimi

Për të marrë një vendim, për cilindo ndryshim në shkollë/organizatë, duhet ndjekur procedurën si në tabelë. Për të ndryshuar cilësinë e edukimit duhet ndryshuar cilësinë e veprimit. Për ta ndryshuar cilësinë e veprimit duhet analizuar të gjithë faktorët, të cilët e ndihmojnë ose e pengojnë veprimin. Siç e kemi përmendur më lart, cilësinë e edukimit e përbëjnë shumë faktorë, pa të cilët është e kotë të kërkohet ajo cilësi. Në rend të parë është mësuesi dhe kompetenca e tij profesionale dhe pedagogjike për punë me nxënës. Pastaj programi mësimor (kurriculum), klima shkollore për mësimdhënie dhe nxënie, motivimi i nxënësve për të marrë pjesë aktive në nxënie. Të gjitha këto duhet të jenë pjesë përbërëse e evidencave shkollore.

## **Përfundim**

Për të bërë ndryshime në shkollë duhet bërë analiza dhe veprime të bazuara në të dhëna, sidomos kur kemi të bëjmë me cilësinë e edukimit. Prandaj, mjetet dhe veprimet për të bërë ndryshime duhet planifikuar, ndërsa aktivitetet duhet projektuar duke paraparë të gjithë hapat dhe strategjitë për ta arritur ndryshimin. Zakonisht, shkolla harton planin vjetor dhe planin zhvillimor, në të cilët parashihen synimet për arritjen e objektivave të saj. Planifikimi për ndryshim, i bazuar në të dhëna, qëndron midis gjendjes (treguesve) në të cilën jemi dhe synimit ku duam të arrijmë.

Nëse marrim shembullin e mësipërm për rritjen e cilësisë së nxënies në matematikë dhe gjuhë angleze, atëherë në planifikim themi: nota mesatare në fund të vitit do të rritet nga 3.5 në 4.5, sepse e kemi një gjendje të njohur notën mesatare, të cilën duam ta rrisim. Për ta arritur këtë duhet bërë edhe analiza dhe krahasime të faktorëve, nga të cilët mund të ndikohet procesi i ndryshimit të suksesit. Kjo mund të matet pas përfundimit të ciklit të projektuar.

Gjendja e kulturës për menaxhimin e të dhënave në Kosovë ende lë shumë për të dëshiruar. Është i pamohueshëm fakti se dështimet e shumta janë rrjedhojë e mungesës së kulturës profesionale dhe mosrespektimi i të dhënave për marrjen e vendimeve, ose marrja e vendimeve në mungesë të të dhënave të vlefshme.

Statistikat vetëm si numra dhe përqindje apo mesatare në shumë raste mashtrojnë pamjen e vërtetë të një dukurie/gjendje apo të një aspekti shoqëror, siç është arsimi.

Promovimi i një ndërgjegjësimi profesional për procesin e regjistrimit, përpunimit, analizës dhe krahasimit e interpretimit të të dhënave në arsim është domosdoshmëri e kohës.

Thënia e H.W.Well se ‘mënyra e të menduarit statistikor për jetën e përditshme të qytetarëve është bërë e nevojshme, njësoj si lexim-shkrimi’ është shumë aktuale.

## Burimet

1. Udhëzimi Administrativ Nr.9/2011, MEST, datë 30.12.2011.
2. Boris Petz, Osnovne statističke metode za nematematicare, SNL, Zagreb, 1985.
3. Education Indicators Framework, MEST, Prishtina 2010.
4. Gabriel Gamez, Statistical Office of the European Free Trade Association, UNECE, New York and Geneva, 2008.
5. Giovanni Girone, Tommaso Salvemin: Leksione të statistikës, Dudaj, Tiranë 2000.
6. EMIS/MEST Kosovo Education Statistics 2010/11, 2011.
7. EMIS/MEST, Kosovo Education Statistics 2005-6, 2006.
8. Ministry of Education, Science and Technology, Kosovo Education Strategic Plan 2011-2016, 2010.
9. EMIS/MEST, Indicators and statistical data in education, 2004-2007, 2008.
10. Carla Abou Zahr, Effective use of statistical data for policy analysis and advocacy: Building on success”, 24-26 October 2011.
11. EURYDICE, National Testing of Pupils in Europe: Objective, Organization and Use of Results, 2009, EACEA.
12. MEST, Manual on using of the EMIS – version on-line” and “Manual on using of the EMIS – version off-line”, Prishtina, 2011.
13. See the approved SDP form in <http://www.masht.gov.net/advCms/#id=22>
14. MEST, Law on Pre-university Education in the Republic of Kosovo, Law No. 04/L-032, 2011.



M. Sc. Luljeta Bajrami-Shala

## PASQYRIM I SHKURTËR I REFORMËS SË SISTEMIT ARSIMOR NË KOSOVË, 2000-2010

### **Përmbledhje**

Me këtë analizë u përpoqëm që të paraqesim të dhënat kryesore të ndryshimeve të bëra në sistemin arsimor në periudhën 2000-2010. Reformimi i sistemit arsimor në Kosovë filloi me objektiv të caktuar, që të zë hapat me sistemet arsimore të përparuara. Mund të themi se nisja e reformimit të sistemit arsimor në Kosovë u bë në shpejtësi dhe pa përgatitje paraprake të mirëfillta dhe të domosdoshme për t'i hyrë një procesi të këtillë shumë kompleks. Sistemi arsimor, sikurse akëcili sistem qoftë, duhet të mbështetet mbi bazën e sistemit arsimor ekzistues, duke bërë ndërhyrje e ndryshime në segmentet jofunksionale, ose të tejkaluara të tij. Ndryshimet u bënë duke u munduar sadopak t'i përshtaten kushteve dhe mundësive në vendin tonë. Përmirësimi dhe avancimi i vazhdueshëm i sistemit arsimor është i domosdoshëm që të bëhet në vazhdimësi, për faktin se ndryshimet në vazhdimësi ndodhin në vetë shoqërinë njerëzore, pa të cilat as sistemi arsimor nuk do të kishte kuptim. Procese të këtilla në sistemet arsimore ndodhin në të gjitha vendet e botës, sidomos në vendet në tranzicion, siç është Kosova, ku objekt reformimi dhe ndryshimi janë të gjitha segmentet e sistemit.

Arsimi parauniversitar në Kosovë është bazuar sipas ISCED-së, gjë e cila arrihet me aprovimin e Kornizës së Kurrikulit 2011<sup>67</sup>. Në vitin 2002 ka filluar regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë në moshën 6-

---

<sup>67</sup> Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, Prishtinë, 2011.

vjeçare, pa i bërë përgatitjet e duhura, sidomos ndryshimi i planeve dhe programeve mësimore, tekstet shkollore, por as përgatitja e mësuesve për punë me gjashtëvjeçarët. Problem më vete sollën edhe futja e klasës së pestë me vetëm një mësues dhe futja e klasës së nëntë në nivelin e arsimit të detyrueshëm, ngase filluan pa përgatitje të mirëfillta paraprake. Edhe në arsimin e mesëm të lartë u fut provimi i maturës, që nga viti 2006.

Po ashtu, ndodhi edhe reforma në Universitetin e Prishtinës, u ristrukturuan fakultetet dhe u hoqën studimet me korrespondencë. Bazë e reformave në Universitetin e Prishtinës u bë Deklarata e Bolonjës, modeli evropian i studimeve (3+2+3), i parashikuar deri në vitin 2010.

## **Hyrje**

Ndryshimet në sistemin shoqëror kushtëzojnë ndryshimet edhe reformimin e sistemit arsimor në tërësi. Sipas Majkëll Fullanit, “në një botë ku sfidat dhe problemet janë ‘miqtë tanë’, ku vetë jeta është ndryshim dhe ‘udhëtim’ në një destinacion të panjohur, njeriu për të mbijetuar duhet të rinovohet vazhdimisht, gjithnjë e me shumë po aktivizohet vlera e pazëvendësueshme dhe ekzistenciale e arsimit<sup>68</sup>. Sipas kësaj sistemi arsimor është një nga sfidat kryesore të secilit vend, në veçanti në Kosovë.

Çështja e rritjes së cilësisë dhe e efikasitetit të sistemit arsimor është preokupim i vazhdueshëm i shoqërisë. Prandaj, nevoja për ndryshim të sistemit arsimor u shtrua me forcë, sidomos në vitet e 60-ta të shek. XX, për të vazhduar deri në ditët e sotme.

Sipas Koliqit, “Kosova synon të sendërtojë një sistem arsimor sipas parametrave të vendeve të përparuara, të cilat kanë sistem të përsosur të arsimit”<sup>69</sup>. Sistemi i ri arsimor filloi mbi bazën e ndryshimit të sistemit arsimor tradicional. Nisi duke kritikuar dhe mohuar shumë vlera të ndërtuara për shumë vjet dhe të trashëguara nga sistemi i kaluar i

---

<sup>68</sup> Koliqi, Dr. Hajrullah. “Sistemi i Arsimit në Kosovë”, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004, f.19

<sup>69</sup> Po aty.f. 45

arsimit në Kosovë. Me këtë nuk mohoj domosdonë e nisjes së ndryshimeve në atë sistem arsimor, por kjo duhet të bëhej duke studiuar mirë të mirat dhe mangësitë e tij. Kjo duhet të bëhej shkallë-shkallë, siç kanë vepruar të gjitha vendet në tranzicion. Në krye të këtij procesi fillimisht ishin njerëz ndërkombëtarë dhe ky ishte njëri ndër gabimet që u bënë në këtë proces. Arsimi në Kosovë kishte krijuar vlera të padiskutueshme, mbi të cilat do të duhej sendërtuar reformën e sistemit të ri arsimor.

Një proces i këtillë, siç është reforma e sistemit, nisi pa u studiuar mirë dhe pa u bërë përgatitjet e mirëfillta. Pa u bërë një përgatitje e tillë pasojat janë të papërmirësueshme. Këto po i shohim edhe tani, në të gjitha shkallët e shkollimit, sidomos në arsimin e lartë, universitete. Përderisa vërejmë një shpërndarje relativisht të qëndrueshme të nxënësve në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në arsimin e mesëm të lartë shohim një rritje dramatike të numrit të nxënësve gjatë këtyre pesë vjetëve. Kjo ka ndodhur, para së gjithash, për shkak të zgjerimit të arsimit të obliguar, duke përfshirë edhe vitin e nëntë të shkollimit.

### **Një historik i shkurtër i zhvillimit të arsimit në Kosovë**

Duke pasur parasysh se historia e arsimit në Kosovë është mjaft e gjatë, nuk do zgjerohemi në specifikat e saj, në mënyrë që të ruajmë kontekstin e temës nga viti 2000 e tutje. Historia e arsimit në Kosovë ndahet në tri periudha: Periudha e parë fillon me hapjen e shkollave fillore anembanë Kosovës, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Arritjen më të madhe në këtë periudhë e paraqet themelimi i [Universitetit të Prishtinës](#) dhe hapja e [Bibliotekës Universitare të Kosovës](#). Gjatë kësaj periudhe arsimi zhvillohej në tri gjuhë: [shqipe](#), [serbokroate](#) dhe [turke](#)<sup>70</sup>.

Periudha e dytë fillon rreth vitit [1991](#) dhe paraqet reagim ndaj rrënimin të dhunshëm të sistemit arsimor nga ana e politikës represive serbe. Si

---

<sup>70</sup> [http://sq.wikipedia.org/wiki/Arsimi\\_n%C3%AB\\_Kosov%C3%AB](http://sq.wikipedia.org/wiki/Arsimi_n%C3%AB_Kosov%C3%AB), Maj. 2011.

rezultat i kësaj, ngrihet një sistem pavarur arsimor, që realizohej në 452 shkolla të plota fillore, 67 shkolla të mesme, 1 universitet me 14 fakultete dhe 7 shkolla të larta, me afro 400.000 nxënës e studentë dhe me 21.000 punëtorë të arsimit. Financimi i këtij sistemi bëhej nga puna vullnetare dhe ndihmat që i jepnin *diaspora* dhe popullata shqiptare, të cilët këtë sistem e shihnin si hapin e parë të *pavarësisë së Kosovës*<sup>71</sup>.

Më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën Kushtetuese, ndërsa më 7 shtator e shpalli Kushtetutën e Kosovës. Me këto dokumente u vendos që deri me nxjerrjen e ligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore të punohej edhe në arsim sipas ligjeve gjegjëse. Më 30 gusht 1994, Qeveria e Republikës së Kosovës nxori dekret-ligjin për drejtimin e përkohshëm të veprimtarisë edukativo–arsimore në Republikën e Kosovës. Ndërkohë u nxorën edhe disa rregullore të arsimit dhe u sistemuan në revistën ‘Kumtari i Arsimit’, nr. 1/1994. Në këtë periudhë, “mësimi shqip në Kosovë u organizua sipas plan-programeve të reja të nxjerra nga Pleqësia e Arsimit, përkatësisht nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës”<sup>72</sup>.

Periudha e tretë fillon nga viti 1999 e këndej. Kjo e fundit karakterizohet me fillimin e reformës rrënjësore të arsimit në të gjitha nivelet: nga arsimi dhe edukimi parashkollor e deri në universitet, të cilat kishin për synim përshtatjen e arsimit në Kosovë sipas standardeve bashkëkohore evropiane e botërore. Gjatë kësaj periudhe filloi të zhvillohet edhe sistemi privat i arsimit. Si hap i parë i këtij sistemi

<sup>71</sup> Po aty. Maj. 2011.

<sup>72</sup> Dekretligji nr. 7/30.08.1994; Kumtari i arsimit nr. 1/1994, i cili ngërthen këto rregullore; Rregulloren për themelimin dhe veprimtarinë e shkollës; Rregulloren për organet qeverisëse dhe profesionale; Rregulloren për emërtimin e institucioneve edukativo-arsimore; Rregulloren për kriteret e zgjedhjes dhe detyrat e arsimtarëve; të bashkëpunëtorëve në mësim; Rregulloren për regjistrimin, të drejtat, si dhe vlerësimin dhe cilësimin e nxënësve në shkollë; Rregulloren për organizimin e provimeve të nxënësve në shkollë; Rregulloren për organizimin e provimeve përfundimtare dhe të maturës në shkollën e mesme; Rregulloren për evidencën e punës edukativo-arsimore dhe për dokumentacionin pedagogjik të nxënësve.

merret themelimi i Departamentit të Arsimit dhe Shkencës (DASH), që përcillet me krijimin e infrastrukturës ligjore dhe profesionale, e cila duhet të lehtësojë reformimin rrënjësor të arsimit (sistemi 5 + 4 + 3- 4, në arsimin e përgjithshëm dhe në atë profesional dhe Marrëveshja e Bolonjës në arsimin e lartë, si dhe me themelimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në mars të vitit 2002.<sup>73</sup> Marrë në tërësi, viti shkollor 1999/2000 ishte viti i përpjekjeve për ndërtimin e infrastrukturës fizike, si dhe rehabilitimin e pasojave nga periudha paraprake, por edhe përpjekja për trajnimin e mësuesve, arsimit special, arsimit profesional etj.

Në 2001 u bë hapi kryesor i reformës, u nxor Korniza e Kurikulumit të Ri të Kosovës, e cila u paraqit për diskutim publik<sup>74</sup>, por, edhe pse gjithë këto vite u punua me të, asnjëherë nuk u miratua, deri në rishikimin e saj, në vitin 2010. Ky mund të emërohet si proces i ndryshimit të sistemit të arsimit të Kosovës.

Gjatë gjithë këtyre viteve sistemi arsimor në Kosovë pësoi ndryshime të shumta, të cilat do t'i paraqesim në vijim.

### **Sistemi i ri arsimor në Kosovë, vitet 2001-2010**

Arsimi në Kosovë zhvillohet në institucione shoqërore dhe private. Duke filluar nga viti 1999, arsimi në Kosovë iu nënshtrua reformave në të gjitha nivelet: nga arsimi dhe edukimi parashkollor e deri në universitet. Këto reforma kishin për synim përshtatjen e arsimit të Kosovës sipas standardeve evropiane të arsimit. Hapat e parë konkretë në sendërtimin e një sistemi të ri arsimor, me parametra evropianë, u bënë në vitin shkollor 2000/01, kur arsimi fillor nga 4 u bë 5-vjeçar, arsimi i mesëm i ulët 4-vjeçar dhe arsimi i mesëm i lartë 3(4)-vjeçar. Zhvillimi i planeve dhe programeve të përgjithshme të arsimit për të tre

---

<sup>73</sup> ISCED-KSNA, Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit, MASHT, Prishtinë, 2004. f. 5.

<sup>74</sup> Koliqi, Hajrullah, Sistemi i Arsimit në Kosovë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004, f.54.

nivelet: arsim i detyrueshëm 9-vjeçar (nga mosha 6 vjeç); nxjerrja e Statutit të përkohshëm të Universitetit të Prishtinës, fillimi i zbatimit të modelit evropian të studimeve (Deklarata e Bolonjës).

Korniza e Kurrikulit (2001) përcaktonte të gjithë parametrat e nevojshëm që do të duheshin mbajtur parasysh në punë të përkufizimit të qëllimeve dhe të përmbajtjeve kurrikulare, në punë të zgjedhjes së metodave dhe materialeve për nxënie, si dhe përkitazi me çmuarjen e arritjes së standardeve të arsimit<sup>75</sup>.

Vend me rëndësi në procesin e reformimit të sistemit arsimor paraqet formimi i Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, në mars të vitit 2002.

Pas ndërtimit të institucioneve vend me rëndësi zë hartimi i bazës ligjore. Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2002. Me të sanksionohet e drejta për arsim dhe specifikon qëllimet e arsimit, si dhe parimet e mosdiskriminimit dhe përcaktohet organizimi i rrjetit shkollor. Sipas këtij ligji, çdo institucion i financuar nga fondet publike duhet të ketë një bord të shkollës, me përfaqësues të zgjedhur nga mësimdhënësit dhe prindërit. Në nivelin 2 e 3 të arsimit në bord të shkollës duhet të ketë edhe përfaqësues të nxënësve. Me qëllim të krijimit të infrastrukturës ligjore për zhvillimin e veprimtarisë së botimit të teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik<sup>76</sup> u hartua Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, nr. 02/L-67, datë 24.06.2006<sup>77</sup>.

Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, është miratuar në qershor të vitit 2008, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Me këtë ligj disa kompetenca për menaxhimin e sistemit të arsimit barten nga niveli qendror në atë vendor. Ky ligj gjithashtu

---

<sup>75</sup> Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, MASHT, Prishtinë, 2001, f. 15.

<sup>76</sup> Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, nr. 02 /L-67.

<sup>77</sup> [http://www.bic.at/downloads/en/brftipps/0\\_1\\_bildungssystem\\_en.pdf](http://www.bic.at/downloads/en/brftipps/0_1_bildungssystem_en.pdf), prill 2011.

parasheh të drejta speciale për komunitetin serb në përdorimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore nga Republika e Serbisë dhe është mbizotërues në rast të mospërputhjes së dispozitave me ato të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Ligji për inspektimin e arsimit në Kosovë, nr. 2004/37, parasheh inspektimin e arsimit në Kosovë, duke u përqendruar më shumë në aspektet ligjore të arsimit. Pas miratimit të ligjit u themeluan shtatë Zyra Rajonale të Inspektimit, të cilat i zëvendësuan Zyrat e deriatëhershme për zhvillimin e arsimit.

Këshilli i ekspertëve për arsimin parauniversitar hartoi Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017, e cila u miratua në mars të vitit 2007. Strategjia përcakton vizionin dhe misionin, si dhe i ka objektivat strategjike dhe masat.

Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2007/2017 krijon bazat për një qasje të integruar të arsimit në Kosovë në përgjithësi<sup>78</sup>. Objektivat më të rëndësishme strategjike për sektorin e arsimit lidhen me zhvillimin e kurrikulave të përmirësuar, cilësisë dhe qasjen e përmirësuar në arsim pas zhvillimit të një strategjie unike e koherente sektoriale.

Të gjitha këto objektiva janë përfshirë në strategjitë ekzistuese, por kanë nevojë për planifikim më të hollësishëm. Udhërrëfyeni i sektorit të arsimit, i cili u prit shumë mirë nga Qeveria dhe donatorët e ndryshëm, përfshirë edhe Komisionin Evropian, përcaktonte shtatë udhërrëfyes që çonin në funksionim dhe cilësi më të mirë të sektorit të arsimit.

Ligji mbi arsimin e lartë është aprovuar në maj të 2003 dhe është hartuar në pajtim me zhvillimet e fundit në sistemet evropiane të arsimit të lartë. Në mënyrë të veçantë e përcakton detyrimin që sistemi i lartë arsimor i Kosovës të zhvillohet në drejtim të qëllimeve të vendosura nga procesi i Bolonjës. Ndërkohë, dy udhëzime administrative që e rregullojnë Agjencinë për Akreditim të Kosovës

---

<sup>78</sup> Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë. MASHT, Prishtinë 2007-2017. fq. 22.

(AAK) dhe licencimin e institucioneve private sigurojnë bazat fillestare për ngritjen e mekanizmave të garantimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Në këtë rrugë të transformimit nga gjendja e tanishme, në vizionin e së ardhmes për një Kosovë si shoqëri e integruar në proceset e ngjashme në Evropë, sistemi arsimor në Kosovë parasheh të sigurojë përfshirje të gjithmbarshme të fëmijëve dhe të rinjve në sistemin arsimor, parasheh që mësimi të zhvillohet në më së shumti dy ndërrime, synon që do të shtatëfishojë përfshirjen e tanishme të fëmijëve të grupmoshës 0-5 vjeç, ndërkaq premtan se do të përfshijë pothuajse të gjithë (90 %) të fëmijëve të grupmoshës 5 – 6 vjeç në arsimin parafillor, që deri në vitin 2017 të gjithë mësimdhënësit në shërbim të përfshihen në programe të akredituara për zhvillim profesional e të tjera të ngjashme<sup>79</sup>.

Nga viti 2006 fillon të zbatohet provimi i maturës në gjimnaze dhe shkolla profesionale, si vlerësim i jashtëm, po ashtu edhe testi i arritshmërisë në fund të klasës së nëntë dhe në përfundim të klasës së pestë në disa shkolla, në të gjitha rajonet.

Ligji për provimin final dhe për provimin shtetëror të maturës, nr. 03/L-018, parasheh provimin e detyruar shtetëror të maturës për gjimnaze dhe për nxënësit e shkollave profesionale që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në universitet. Dispozitat e këtij ligji dhe të rregulloreve të tjera parashohin edhe përdorimin e rezultateve të maturës për pranim në arsimin e lartë.

Këtu vlen të përmendet procesi i hartimit të Ligjit të ri për arsimin parauniversitar, i cili do të zëvendësojë ligjin e miratuar në vitin 2002. Përveçse është në harmoni me Ligjin arsimin në komuna, ligji i ri parasheh futjen në zbatim të disa risive, si shtrirja e arsimit të obliguar prej moshës 5-vjeçare deri në moshën 18-vjeçare (13 vjet), kërkesa të reja për kualifikimin e mësimdhënësve, statusin e ri të punësimit për mësimdhënësit, bartjen e mëtejme të përgjegjësisve prej komunave në shkolla, e të tjera<sup>80</sup>.

---

<sup>79</sup> Po aty, f. 13

<sup>80</sup> Shih Ligjin për arsimin parauniversitar.



## **Struktura e shkollimit – struktura e re organizative**

Kosova tani ka sistemin 5 + 4 +3 dhe 4-vjeçar të shkollimit, i cili fillon prej moshës 6- vjeçare. Klasa e 13-të me Kurikulin e Ri është hequr dhe është e vlefshme vetëm për nxënësit e regjistruar. Ndërrimet strukturale janë bërë me qëllim që ta bëjnë sistemin arsimor në Kosovë të njëjtë me sistemet arsimore në vendet e BE-së dhe të vendeve të zhvilluara. Struktura arsimore në Kosovë tani përbëhet prej arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë dhe arsimit të lartë-universitar.

## **Ndryshimet në arsimin parashkollor**

Arsimi parashkollor përbëhet prej dy cikleve: kujdesi në foshnjore (kopsht) dhe arsimimi parashkollor në foshnjore. Fëmija mund të ndjekë foshnjoren qysh prej moshës 9 mujore. Megjithatë, kujdesi nuk konsiderohet si edukativ, derisa fëmija të jetë tre vjeç. Për rrjedhojë, kujdesi në foshnjore mbulon fëmijët e moshave prej 9 muajsh deri në tre vjet, derisa arsimimi parashkollor përfshin ata prej tre deri në gjashtë vjeç. Arsimi parafillor nuk ishte i obliguar, ndërsa me Kurrikulin e Ri të Kosovës (ende i paaprovuar, por në proces) parashihet të jetë i obliguar. Krahasuar me sistemin arsimor të Austrisë, edukimi parashkollor nuk është i obligueshëm, por fëmijët dërgohen në baza vullnetare dhe mund të dërgohen vetëm pasi të mbushin 3 vjet<sup>81</sup>. Në bazë të Rregullores së UNMIK-u të vitit 2001 u hartua Ligji për edukim parashkollor dhe Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për arsim parashkollor me nr. 02./L-52, në vitin 2006, me qëllim të vënies së bazës ligjore, për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e edukimit parashkollor<sup>82</sup>. Po ashtu, në arsimin parashkollor është hartuar edhe udhëzimi administrativ, nr. 6/2008, i cili u miratua më datën

<sup>81</sup> [http://www.bic.at/downloads/en/brftipps/0\\_1\\_bildungssystem\\_en.pdf](http://www.bic.at/downloads/en/brftipps/0_1_bildungssystem_en.pdf), prill 2011.

<sup>82</sup> Ligji mbi edukimin parashkollor. nr .02/L-52, MASHT

03.03.2008, që ka për qëllim të sigurojë mundësinë e përfshirjes së fëmijëve të grupmohave të ndryshme në edukim parashkollor<sup>83</sup>.

Sistemi i edukimit parashkollor ndahet në tri nivele:

Çerdhja (për fëmijët e moshës 9 muaj-3 vjeç);

Kopshti (për fëmijët e moshës 3-5 vjeç);

Klasa parafillore (për fëmijët e moshës 5-6 vjeç).

Funksioni kryesor i çerdhës është përkujdesja dhe mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve, formimi i shprehive higjienike, përfitimi i aftësive bazë të të folurit etj. Në kopshte qëllimet kryesore janë zhvillimi i aftësive dhe i operacioneve mendore, zhvillimi i imagjinatës, formimi i shprehive higjienike dhe shprehive të sjelljeve sociale, formimi i koncepteve elementare gjuhësore e matematikore, njohja me mjedisin, zhvillimi i ndjenjës dhe aftësive shprehëse muzikore dhe figurative, zhvillimi i shprehive shëndetësore, si dhe zhvillimi fizik nëpërmjet lojës. Në klasën parafillore fëmijët kryesisht përgatiten për kalimin në shkollë fillore.

Edukimi parashkollor zhvillohet në institucione të specializuara publike dhe private, në të cilat për fëmijët rëndom organizohet qëndrimi tërëditor. Fëmijët janë të ndarë në grupe prej 15-30, ndërkaq klasat parashkollore, si rregull, organizohen në shkollë fillore dhe në institucione parashkollore.

Për edukatorët e arsimit parashkollor janë realizuar edhe trajnime për aftësim dhe janë përfshirë gati të gjitha edukatorët në trajnimin 'Hap pas Hapi', për nivelin bazik dhe të avancuar, për 3-6 vjeç. Po ashtu, është realizuar edhe trajnimi për zbatimin e kurrikulit për moshën 3-6 vjeç dhe në vitet 2009/2010 filloi të realizohet programi i licencuar për metodën e Majeutikës, për aftësim të edukatoreve në kopshte parashkollore.

Sipas të dhënave statistikore të MASHT-it, në Kosovë në vitin shkollor 2004/05 ishin gjithsej 32 institucione parashkollore. Prej tyre 28 janë

---

<sup>83</sup> Udhëzimi Administrativ, nr 6/2008, për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore, MASHT.

institucione kryesore dhe 4 paralele të ndara.<sup>84</sup> Në disa komuna, në mungesë të objekteve, një numër i fëmijëve që u takojnë grupmoshave 5-6 vjeç gjinden në objektet e shkollave fillore, ndërsa në vitin shkollor 2010/11 janë gjithsej 42 institucione parashkollore me 5154 fëmijë, prej tyre 2471 ose 47.9 % janë femra, ndërsa 2683 ose 52.1 % meshkuj, sipas të dhënave statistikore për vitin 2010/11 në MASHT<sup>85</sup>.

### **Ndryshimet në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët**

Sipas Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, edukimi fillor (1-5) dhe i mesëm i ulët (6-9) janë të obliguar për të gjithë. Shkollimi i detyruar fillon në moshën 6 vjeç (mosha minimale e arsimit të obliguar). Sipas këtij ligji, shkollimi në institucionet arsimore me fonde publike është falas. Arsimi i mesëm i ulët është faza e dytë e arsimit bazë të detyruar dhe përfshin klasat 6-9, gjerësisht moshat 12 deri në 15 vjeç. Mësimi në shkollat fillore në Kosovë organizohet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake, turke dhe kroate.

Pra, nga viti shkollor 2000/2001 mosha për fillimin e arsimit fillor të detyruar ka ndërruar prej moshës 7 vjeç, sa ka qenë përpara, në moshën 6-vjeçare, përderisa kohëzgjatja e arsimit të detyrueshëm është zgjatur prej tetë në nëntë vjet<sup>86</sup>. Para kësaj periudhe arsimimi i detyrueshëm ka qenë i bazuar në modelin 4 + 4, të përbërë prej dy cikleve: cikli i klasave të ulëta apo klasave edukative dhe cikli i klasave të larta apo mësimi klasor dhe lëndor. Në ciklin e parë mësimi i të gjithë fëmijëve është bërë nga një mësimdhënës i vetëm, derisa në ciklin e dytë ka pasur mësimdhënës të specializuar për një lëndë.

Ky arsim zhvillohet sipas modelit 5 + 4 vjet dhe është i aplikuar që nga viti shkollor 2004/05. Sipas të dhënave statistikore, në Kosovë në vitin

---

<sup>84</sup> [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Pasqyrë\\_e\\_Statistikave\\_të\\_Arsimit\\_në\\_Kosovë.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Pasqyrë_e_Statistikave_të_Arsimit_në_Kosovë.pdf), qershor .2011 .f. 7.

<sup>85</sup> [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Statistikat\\_e\\_Arsimit\\_në\\_Kosovë\\_2010-11.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Statistikat_e_Arsimit_në_Kosovë_2010-11.pdf), qershor 2011, f. 5.

<sup>86</sup> Vendimi është marrë nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ, me sugjerime të DEST.

shkollor 2004/05 janë gjithsej 944 shkolla fillore dhe 500 prej tyre ishin shkolla qendrore dhe 444 ishin satelite (paralele të ndara)<sup>87</sup>. Ndërsa në vitin 2010 numri i shkollave fillore është rritur në 992 (601 shkolla amë dhe 391 paralele të ndara)<sup>88</sup>.

Me formimin e Këshillit për Licencim, programet e trajnimit duhet të kalojnë disa faza të aplikimit, të plotësojnë kriteret me të cilat vlerësohet sa është i nevojshëm, sa ka qëndrueshmëri dhe sa ka vlera ai program të realizohet në Kosovë.

### **Ndryshimet në arsimin e mesëm të lartë**

Arsimi i mesëm i lartë është organizuar në arsimin e përgjithshëm dhe në arsimin profesional. Arsimi i mesëm i lartë zgjat 3 ose 4 vjet, varësisht nga programet arsimore të përcaktuara nga MASHT-i. Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të ndjekin këtë nivel mbi bazën e shkollimit. Arsimi i mesëm i lartë ndahet në dy kategori, atë të përgjithshëm dhe atë profesional. Arsimi i mesëm profesional, që nënkupton shkollat profesionale, si qëllim parësor ka përgatitjen e kuadrove për treg të punës, por ofron edhe mundësi të aplikimit në studime më të larta, post-sekondare dhe universitare. Ky lloj arsimi është organizuar në tetë tipa të shkollave, ku mësimi zhvillohet në disa profile.

Reforma solli ndryshime të mëdha edhe në arsimin e mesëm. Sipas sistemit të arsimit në Kosovë jetësohet harmonizimi midis mësimin të lëndor dhe atij të integruar.

Arsimi i mesëm i ulët katërvjeçar –shkalla 2, sipas ISCED-së, është niveli i dytë i arsimit të obliguar për të gjithë fëmijët, nga mosha 11 deri në 15 vjeç.

Është shkallë e përforcimit dhe orientimit, sidomos nga klasa IX. Arsimimi në klasat VI,VII,VIII “synon thellimin e njohurive në fusha

---

<sup>87</sup> [http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Pasqyre\\_e\\_Statistikave\\_te\\_Arsimit\\_ne\\_Kosove.pdf](http://www.masht.gov.net/advCms/documents/Pasqyre_e_Statistikave_te_Arsimit_ne_Kosove.pdf), 2004/2005, f. 14

<sup>88</sup> Shënime Statistike 2010-2011.Arsimi Public Parauniversitar.MASHT.

të ndryshme të dijës, si dhe sigurimin e një baze për orientimin profesional dhe për karrierën e ardhshme”<sup>89</sup>.

Në këtë shkallë të shkollimit të detyrueshëm nxënësit ballafaqohen me dituri akademike, shkencore dhe kulturore. Arsimi në klasën IX synon të krijojë mundësi që nxënësit, duke vrojtuar e shqyrtuar mundësi të ndryshme, të orientohen për shkollimin e mëturjes, për karrierën e tyre profesionale.

Arsimi i mesëm i lartë është rregulluar me Ligjin mbi arsimin fillor dhe të mesëm, nr. 2002/2. “Pranimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë bëhet mbi bazën e një sistemi të drejtë përzgjedhës, i administruar nga komunitatet e në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga MASHT-i. Pranimi bëhet mbi bazën e një kërkesë të nënshkruar nga nxënësi, me kusht që ai të ketë përfunduar me rezultate të kënaqshme programin mësimor të nivelit 2, i cili është i përshtatshëm për studimet në nivelin 3”<sup>90</sup>.

Arsimi i mesëm i lartë tre-katërvjeçar “synon studimin e thelluar të profilit të zgjedhur dhe aftësimin për integrim të suksesshëm në tregun e punës apo në orientimin dhe integrimin në arsimin universitar”<sup>91</sup>.

Arsimi i mesëm i lartë në Kosovë përfshin gjimnazet dhe shkollat profesionale që zgjasin tre ose katër vjet. Drejtimet e përgjithshme janë ato shkolla të cilat ofrojnë arsimim të përgjithshëm që kanë për qëllim përgjithësisht të zhvillojë aftësitë akademike të studentëve dhe t’i përgatisin ata për arsimim universitar. Arsimi i mesëm përfshin dy lloje: arsimin e përgjithshëm (gjimnazet) dhe arsimin profesional (shkollat teknike dhe profesionale). Siç janë shkollat e përgjithshme me dy drejtime (shoqërore – gjuhë dhe shkenca natyrore dhe matematiko-natyrore), shkollat e përgjithshme pedagogjike, shkollat e specializuara në gjuhët e huaja. Shkollat profesionale (të zanatit) zgjasin tre deri në katër vjet. Shkollat e mesme katërvjeçare i përgatisin nxënësit për punë ose për studime të mëtejme, derisa ato trevjeçare vetëm për punë.

---

<sup>89</sup> Korniza e Kurrikulit të ri të Kosovës, Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës, Prishtinë, shtator 2001, f. 40.

<sup>90</sup> Po aty, f. 42.

<sup>91</sup> Po aty, f. 41

Kohëzgjatja e shkollimit të mesëm të lartë profesional, pjesë e shkollimit parauniversitar në Kosovë, është e nivelizuar në tre nivele. Niveli i parë përfshin klasat 10+11. Kjo shkallë ofron kualifikimin bazik dhe mundëson punësimin në treg të punës, si punëtor i gjysmë i kualifikuar. Niveli i dytë është vazhdimësi e nivelit të parë, përfshin klasën 12 dhe ofron punësim në treg të punës si punëtor i kualifikuar. Me dy nivelet e para mund të krijohet një kuadër profesionalisht kompetent për një punë të kualifikuar në treg, por nuk garanton përgatitjen akademike për studime të suksesshme universitare. Kjo nuk d.m.th se ata nuk kanë të drejtë të avancimit të mëtejshëm në karrierë. Për të mos ua marrë të drejtën e studimeve nxënësve të shkollave profesionale, qysh në 2002, me Strategjinë e arsimit profesional është paraparë nevoja për hartimin e një ure lidhëse në mes të shkollimit profesional dhe atij universitar. Prandaj, është hartuar koncepti i klasës së 13-të, e cila u ofron nxënësve të shkollave profesionale dy mundësi: a) marrjen e maturës profesionale që hap dyert e fakulteteve të ndryshme, ose b) marrjen e nivelit të tretë të kualifikimit profesional, i cili ofron mundësi më të mira për punësim dhe hap dyert e shkollimit për shkallën e katërt, e cila bën kualifikimin për titullin teknik. Kjo e fundit planifikohet të zhvillohet në dy vitet e ardhme në Kosovë. Me Ligjin e arsimit profesional thuhet se Kosovës i nevojitet zhvillimi i arsimimit post-sekondar, si p.sh. kolegjet e shkencave aplikative, kështu që nxënësit e suksesshëm të arsimit profesional do t'i kenë dyert e hapura për zhvillim shumë të mirë të karrierës së tyre profesionale. Në vitin 2003 në Kosovë ishin 50 shkolla të mesme profesionale (me 107 profile), shumica e të cilave janë të ndara në qendra të mëdha urbane<sup>92</sup>, ndërsa tani, në vitin 2010/11, janë 56 shkolla të mesme profesionale. Në vitet e fundit u krijuan edhe dy qendrat e kompetencës, në Skenderaj dhe në Malishevë. Sipas të dhënave statistikore, në vitin shkollor 2010/2011 në Kosovë janë gjithsej 111

---

<sup>92</sup> Strategjia për zhvillimin e arsimit të mesëm profesional në Kosovë (draft) MASHT, Prishtinë, prill 2003 ,f. 3

shkolla të mesme të larta, prej tyre 92 amë dhe 19 paralele të ndara<sup>93</sup>. Duke u bazuar në Kurrikulin e Ri të Kosovës, është paraparë që arsimi i mesëm i lartë të jetë i obligueshëm nga viti 2019.

### **Ndryshimet në arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta**

Në bazë të Ligjit mbi arsimin fillor dhe atë të mesëm në Kosovë, e drejta për arsimin special është e drejtë e patjetërsuar. Sipas ligjit, ata që nuk përfitojnë ose që nuk kanë mundësi të përfitojnë mësimdhënie të zakonshme, në mënyrë të kënaqshme, kanë të drejtë për arsim special. Arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë filloi hapat e parë drejt integritit në shkollë dhe në shoqëri që nga viti 2000. Arsimi special ishte i veçuar dhe organizohej në shkolla speciale. Para lufte ekzistonin disa qendra të tilla të specializuara për fëmijët me retardime mentale (Prishtinë, Prizren, Pejë), për fëmijët me pengesa në të folur dhe në të dëgjuar (Prishtinë, Prizren, Mitrovicë) për fëmijët me pengesa në të parë (Pejë). Ekzistonin edhe shkollat fillore speciale për fëmijët me dëmtime dhe vështirësi të lehta në kuadër të shkollave fillore “Naim Frashri” dhe “Elena Gjika” në Prishtinë dhe nga një paralele në Pejë e Gjakovë, si dhe shkolla spital në Shtime.

Mirëpo, në shtator të vitit 2000 FSDEK-u përgatiti një dokument mbi nevojat speciale –arsimin inkluziv në Kosovë, me objektiv themelor: zbatimi i arsimit të përshtatshëm për fëmijët me nevoja të veçanta dhe përfshirja e tyre në arsim cilësor në Kosovë<sup>94</sup>. Mbi këtë bazë filloi të jetësohet projekti “Përkrahja Finlandeze në zhvillimin e sektorit të edukimit në Kosovë (2000-2003), i cili filloi më 4 shtator 2000 dhe u emërua edhe agjenci udhëheqëse për fushën e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta/edukim inkluziv. Kështu arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë shënoi një hap cilësor, si në aspektin e filozofisë

---

<sup>93</sup> Shenime Statistike për vitin 2010/2011. Arsimin publik parauniversitar, Kosovë. SMIA. f. 6

<sup>94</sup> Toward effective school for all, Finish Support to the Development of Educational Sector in Kosovo (FSDEK) Department of Education and Science (UNMIK), Ministry for Foreign Affairs of Finland, February, 2001. f. 6.

ashtu edhe në të metodologjisë së mësimdhënies në institucione arsimore për fëmijët me nevoja të veçanta. Kështu filloi zbatimi dhe filozofia e inkluzionit (gjithëpërfshirjes) së të gjithë fëmijëve në shkollim, i sanksionuar edhe me legjislacionin kosovar. Në vitin shkollor 2000/2001 në institucione të tilla u përfshinë 503 nxënës<sup>95</sup>, ndërkaq gjatë vitit 2002/2003 u hapën edhe 30 klasë të reja në 24 komuna, për fëmijët të cilët kanë dëmtime ose vështirësi të rënda në të nxënë. Këto janë klasë të bashkëngjitura në kuadër të shkollave të rregullta. Numri i fëmijëve në klasë të tilla në vitin shkollor 2002/2003 u rrit dukshëm, madje për 150%<sup>96</sup>, por ky numër është shumë i vogël kur dihet se mesatarja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla botërore sillet nga 2-3 %<sup>97</sup>.

U bë edhe aftësimi i mësuesve nga Grupi Këshillëdhënës i Helsinkit, 'Save the Children "etj. Çështja e arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta përpunohet edhe në Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës, 2002<sup>98</sup>. Krahas MASHT-it dhe institucioneve të tjera qeveritare dhe joqeveritare, me qëllim që të zgjerohet arsimi gjithëpërfshirës, u mobilizuan edhe mësuesit, prindërit, drejtorët e shkollave dhe asociacioneve të tjera.

Po ashtu, në vitin 2002/2003 u hap drejtimi ri në Fakultetin Filozofik - Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta. Sipas të dhënave statistikore të viteve 2004/05 nga MASHT-i, gjithsej në Kosovë janë 7 shkolla të arsimit special dhe 64 paralele me klasë të bashkëngjitura, të cilat mësimin e zhvillojnë në shkolla të rregullta, që do të thotë se në secilën komunë ka një ose më tepër klasë të bashkëngjitura në shkollat e rregullta për fëmijë me nevoja të veçanta. Ky numër i këtyre klasave është gjithnjë në rritje.

<sup>95</sup> Statistikat për arsimin në Kosovë, 2001.MASHT, Prishtinë 2001.f.30.

<sup>96</sup> Drejt arsimimit për të gjithë, Përkrahja Finlandeze në Zhvillimin e Sektorit të Edukimit në Kosovë,2003.f. 3.

<sup>97</sup> Naser Zabeli; Nga segregacioni drejt inkluzionit.Edukimi special në Kosovë. Përkrahja finlandeze në zhvillimin e sektorit të edukimit në Kosovë, Prishtinë 2003, f.10.

<sup>98</sup> Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, 2002, nenet; 35,36,37,38,39,40.



Në vitin 2007 u hartua Udhëzimi Administrativ nr. 9/2007, që ka për qëllim që të përcaktojë procedurën me të cilën bëhet vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta, në mënyrë që atyre t'u ofrohet arsimim i përshtatshëm për t'i përmbushur nevojat e tyre të përcaktuara nga MASHT-i. Që nga ky vit, shkollat speciale janë shndërruar në qendra burimore. Qendra Burimore është një institucion, i cili duhet të sigurojë shërbimet për shkolla të rregullta me nxënës të integruar apo me klasë të bashkëngjitura. Qendrat burimore duhet të bëjnë vlerësimet lidhur me nevojat e veçanta e nxënësve. Bazuar në këtë vlerësim, duhet të përpilohet PIE në bashkëpunim me prindërit, mësuesit dhe me ekspertët e tjerë përkatës.

U hartua Plani strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë 2010-2015<sup>99</sup>. Ky plan strategjik përcakton në mënyrë të strukturuar dhe të integruar se si i duhet qasur dhe si duhet të trajtohet çështja e procesit gjithëpërfshirës në aspektin e saj praktik dhe funksional.

### **Ndryshimet në arsimin universitar**

Realiteti i ri politik, ekonomik, shoqëror, kulturor, kërkesat dhe sfidat e integritit evropian dikojnë nevojën për transformim, reformim dhe zhvillim edhe të arsimit të lartë. Universiteti i Prishtinës përbëhej prej 22 fakulteteve dhe shkollave të larta. Deri në vitin 2003/2004 kishte këto fakultete: 1 universitet publik, 15 fakultete, 7 shkolla të larta dhe 10 institucione private të arsimit të lartë, ndërsa sot është rritur numri i universiteteve. Në vitin 2006 u themelua Universiteti i Prizrenit, i cili përbëhet prej 7 fakulteteve, me drejtime të ndryshme, si: Juridik, Arkitekturë, Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Psikologjisë, Fakulteti i Gjuhës angleze dhe Fakulteti i Shkencave Politike, ndërsa shkollat e larta pedagogjike, si dhe Fakulteti i

---

<sup>99</sup> Plani strategjike per organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja te veqanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë, 2010-2015, MASHT. Prishtinë, mars 2010, f. 8

Mësuesisë janë bartur në Fakultetin e Edukimit. Universiteti i Prishtinës është anëtar i plotë i Asociacionit të Universiteteve Evropiane.

Sipas të dhënave nga ueb-faqja zyrtare e Universitetit të Prishtinës, “në vitin akademik 2009/2010 Universiteti i Prishtinës i ka të regjistruar 41.833 studentë, prej tyre 37.839 në studime themelore dhe 3.544 në studime master”<sup>100</sup>. Në kuadër të Universitetit të Prishtinës është themeluar edhe Fakulteti i Edukimit. Fakultetit të Edukimit është një transformim nga ish-Shkollat e Larta Pedagogjike. “Me vendim administrativ të ministrit të Ministrisë për Arsim, Shkencë e Teknologji, të datës 9.9.2002, u themelua Fakulteti i Edukimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Mësimin akademik si fakultet i ri e filloi më 18.11.2002, ndërkaq hapja solemne e këtij institucioni u bë më 14 mars 2003”<sup>101</sup>.

Programet mësimore në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë realizohen për katër vjet të studimeve të rregullta. Me vendimin nr. 33/01, të datës 7. 5. 2003, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë vendosi që Fakulteti i Edukimit me qendrat rajonale në Prishtinë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan, nga viti akademik 2003/2004, të fillojë zhvillimin dhe zbatimin e programit mësimor për përgatitjen e mësimdhënësve për ciklin e mesëm të ulët - mësimdhënës lëndorë të klasave VI-IX. Programet që ofron Fakulteti i Edukimit mundësojnë përgatitjen e edukatorëve të institucioneve parashkollore, mësimdhënësve të shkollës fillore dhe mësimdhënësve dy-lëndorë në përputhje me standardet e aftësisë të mësimdhënësve. Pas mbarimit të studimeve, të diplomuarit marrin gradën bachelor i programit përkatës.

Në degën e Prizrenit, në Programin Fillor dhe Programin Teknologji-Informatikë mësimi organizohet edhe në gjuhën turke dhe atë boshnjake.

---

<sup>100</sup> <http://www.uni-pr.edu/Universiteti/Historiku.aspx>, qershor, 2011.

<sup>101</sup> Po aty, qershor 2011

“Universiteti i Prishtinës përbëhet prej: 1. Njësive akademike dhe 2. Njësive organizative.

Në Njësitë akademike të Universitetit bëjnë pjesë fakultetet që veprojnë në kuadër të kornizës institucionale të Universitetit, duke ofruar programe të arsimit të lartë, kërkime shkencore ose krijimtari artistike. Fakultetet e Universitetit ofrojnë këto lloje të studimeve të rregullta dhe pasuniversitare, në përputhje me dispozitat e Statutit të Universitetit: 1. Studime themelore - bachelor, 2. Studime master dhe 3. Studime të doktoratës”<sup>102</sup>.

Njësitë organizative të UP-së janë Zyra për Marrëdhënie me Jashtë, Biblioteka Universitare dhe Qendra e Rrjetit Kompjuterik të Universitetit. Në vitin 2001, pranë Universitetit të Prishtinës filloi punën Universiteti Veror Ndërkombëtar, me program të hapur për studentë, profesorë dhe specialistë vendës dhe të huaj. Kjo praktikë vazhdon të realizohet edhe sot, duke shkëmbyer përvoja të ndryshme ndërkombëtare dhe lokale. Universiteti mëton që kjo të bëhet një traditë dhe praktikë e mirë e Universitetit të Prishtinës.

## **Arsimi privat**

Në Kosovë përveç arsimit publik, funksionon edhe arsimi privat, i cili zhvillohet në të gjitha nivelet e arsimit. Arsimi privat është një alternativë dhe plotësim i arsim publik. Institucionet arsimore private janë pjesë e sistemit kombëtarë të arsimit, por kanë një autonomi organizative dhe operative. Shikuar nga aspekti humanist ,arsimi privat e intensifikon zhvillimin e personalitetit ,ndërsa arsimi publik ndërton një shoqëri demokratike, kurse shikuar nga aspekti ekonomik, arsimi privat maksimalizon bashkërenditjen e suksesit financiar, ndërsa ai publik rritë profitet e përbashkëta<sup>103</sup>.

---

<sup>102</sup> <http://www.masht-gov.net/advCms/#id=1> ,maj 2011.

<sup>103</sup> Alfie Kohn; “The schools and Our Children Deserve (Moving Beyond Traditional Classrooms and “Tougher Standards “),Houghton Mifflin Company.Boston,New York. 1999, f. 119.

Arsimi privat në Kosovë nis pas vitit 1999. Institucionet private duhet të licencohen nga MASHT-i, në bazë të mendimit paraprak të inspektoratit shkollor. Kjo është e rregulluar edhe me Ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm (të Kosovës), por institucionet arsimore private duhet të plotësojnë disa standarde që të kërkojnë lejen nga MASHT-i.

Në Kosovë, sipas të dhënave statistikore nga MASHT-i, në vitin shkollor 2004/05 ishin gjithsej 12 institucione arsimore private. Në arsimin privat në vitin shkollor 2009/10 janë regjistruar 2811 nxënës, në nivelin parashkollor 58 (2.0 %), në atë fillor 1180 (42.0 %) dhe 1573 (56 %) në nivelin e mesëm të lartë<sup>104</sup>.

Vlen të theksohet se në disa shkolla private gjuha angleze mësohet që nga klasa e parë e shkollës fillore. Po ashtu, edhe themelimi dhe veprimtaria e institucioneve të arsimit të lartë privat është e rregulluar me Ligjin për arsimin e lartë. Tani pothuajse rreth 30 institucione private të arsimit të lartë funksionojnë në Kosovë.

## **Përfundimi**

Sistemi arsimor në Kosovë, që nga viti 2000 deri në vitin 2010, kaloi nëpër disa faza të ndryshimit. Një reformë gjithëpërfshirëse e arsimit ishte domosdoshmëri e kohës. Reforma arsimore u zhvillua paralelisht me bartjen e përgjegjësive nga niveli qendror në atë vendor, një trend që pritet të vazhdojë në të ardhmen. Për këtë arsye, çdo veprim që synon sjelljen e ndryshimeve në klasë duhet të forcojë kapacitetet e autoriteteve vendore dhe të shkollave, ta cilat do të jenë përgjegjëse për të zbatuar dhe mbështetur reformën. Qeveria duhet të zhvillojë politika dhe të krijojë infrastrukturë ligjore për ta mbështetur përmirësimin e shërbimeve arsimore, shtimin e përgjegjshmërisë së shkollave për të përmirësuar rezultatet e nxënësve.

---

<sup>104</sup> Statistikat e arsimit në Kosovë. MASHT, 2009/2010. f. 7.

Duke pasur parasysh se çdo reformë duhet të sjellë risi dhe ndryshime të thella, të shoqëruara me sfida, të papritura dhe vështirësi për bartësit e saj, sidomos për mësëmdhënësit, mund të themi se këtë e vështirëson edhe më shumë mosdija, inercioni i traditës, pasiguria dhe dyshimet ndaj këtyre ndryshimeve.

Ndër problemet që u paraqiten gjatë procesit të reformimit të sistemit arsimor në Kosovë ishte regjistrimi i fëmijëve në shkollën fillore në moshën 6-vjeçare, pa u bërë ndryshimet në planet dhe në programet mësimore për këtë nivel, pastaj tekstet mësimore, përgatitja e mësuesve etj. Pra, ‘barra’ që konsiderohej shumë e rëndë për fëmijët 7-vjeçar tani u kaloi atyre 6-vjeçar.

Problem dhe sfida paraqiti klasa e nëntë e arsimit të detyrueshëm. Nuk mund të themi se u bënë përgatitje të duhura shtruese paraprake. U bë ndryshimi/reforma pa programet mësimore të domosdoshme. Për këtë mungonin edhe tekstet shkollore dhe mjete të tjera të domosdoshme didaktike.

Me nguti filluan edhe reformat në Universitetin e Prishtinës. Zbatimi i sistemit të Bolonjës, si dhe regjistrimi pa kriter i studentëve, hapja e degëve dhe e universiteteve private, janë disa nga sfidat dhe problemet e reformimit të sistemit arsimor edhe në nivelin e studimeve akademike.

Reforma e sistemit arsimor ishte një domosdoshmëri e kohës, por domosdoshmëri nuk ishte ngutja në hapa, për të cilët edhe vendet me traditë në arsim këtë e kanë bërë hap pas hapi, duke ndërtuar sistem arsimor të qëndrueshëm.

Nga analiza e bërë mund të përfundojmë se:

Reformimi dhe ndryshimi i sistemit arsimor në Kosovë ishte i domosdoshëm, sepse ishte tradicional dhe nuk mund t’u përshtatej kushteve dhe rrethanave të reja, si shoqërore, shkencore dhe trendëve të arsimit në rajon dhe më gjerë.

Fillimi i procesit të reformimit të sistemit arsimor në Kosovë është bërë ngutshëm dhe pa studiuar mirë specifikat dhe vlerat e qëndrueshme vendëse.

Dihet se në Kosovë erdhën shumë organizata e shoqata nën ombrellën e UNMIK-ut, të cilat mëtonin të shpenzonin donacionet në fushën e arsimit, por pa studiuar mirë rrethanat nëpër të cilat kishte kaluar arsimit kosovar, si dhe nevojat momentale shoqërore.

Në kontekst të kësaj edhe u ndërmorën disa hapa të pamatur për ndryshime dhe reforma në segmente të ndryshme të sistemit në të gjitha shkallët e arsimit.

Krahas kësaj, institucionet arsimore ende ishin të reja, por edhe me kufizime në veprim nga UNMIK-u, për të ndërmarrë hapa konkretë në ndërtimin e infrastrukturës ligjore e strategjike. Kështu u nxorën e u hartuan ligje e udhëzime të cilat shpesh binin ndesh me realitetin arsimor.

Mund të themi se procesi i reformimit të sistemit arsimor në Kosovë është në vazhdimësi. Rezultatet do të mund të shihen vetëm kur të përfundojë e gjithë reforma, vertikale dhe horizontale dhe të bëhet vlerësimi i saj.

## **Rekomandime**

Të vazhdohet me reforma në arsim, por të planifikohen më parë si duhet dhe t'iu përshtaten kushteve dhe mundësive në Kosovë;

Qeveria të zhvillojë politika dhe të krijojë një infrastrukturë ligjore për të mbështetur përmirësimin e shërbimeve arsimore, shtimin e përgjegjshmërisë së shkollave, për të përmirësuar rezultatet e nxënësve; Heqja e pedagogëve nga shkolla ishte njëri prej gabimeve të bëra në emër të reformës. Sado i pamjaftueshëm të ketë qenë ky shërbim, ishte mjaft i nevojshëm në kohën kur mësuesit dhe nxënësit ballafaqohen me ndryshimet si në strukturë ashtu edhe në sistem. Duke pasur parasysh kohën kur filloi reforma dhe duke e ditur se çfarë roli duhet të ketë

shërbimi profesional në shkollë, si njëri ndër agjentët e ndryshimit në arsim;

Të zbatohet kriteri për pranim të studentëve në Universitetin e Prishtinës;

Institucionet vartëse të nxjerrin mësim nga hapat e gabuar të bërë gjatë realizimit të reformës dhe të ndryshimeve në cilindo segment arsimor.

## **Literatura**

1. Koliqi, Hajrullah "Sistemi i Arsimit në Kosovë", Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
2. ISCED-KSNA, Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit.
3. Korniza e Kurrikulit të ri të Kosovës, Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës, Prishtinë, Shtator 2001.
4. Ligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik, nr. 02 /L-67.
5. Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë, 2007-2017.
6. Ligji mbi edukimin parashkollor, nr. 02/L-52.
7. Udhëzimi Administrativ, nr. 6/2008, për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore.
8. Vendimi është marrë nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ, me sugjerime të DEST-së.
9. Të dhënat statistikore për arsimin në Kosovë, 2002/2003, shtator 2003, MASHT/BB/EMIS
10. Shënime statistikore 2010-2011, Arsimi Publik Parauniversitar.
11. The Living Standard Measurement Survey; World Bank (2001): Kosovo Poverty Assessment. Volume I
12. Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, nr. 2002/2, 2002, nenet 35,36,37,38,39,40.
13. Toward effective school for all, Finish Support to the Development of Educational Sector in Kosovo (FSDEK)

Departament of Education and Science (UNMIK), Ministry for Foreign Affairs of Finland, February, 2001.

14. Statistikat për arsimin në Kosovë, 2001, Prishtinë, 2001.
15. Drejt arsimimit për të gjithë, Përkrahja Finlandeze në Zhvillimin e Sektorit të Edukimit në Kosovë, 2003.
16. Zabeli, Naser, Nga segregacioni drejt inkluzionit. Edukimi special në Kosovë, Prishtinë 2003.
17. Plani strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë, 2010-2015, Prishtinë, mars 2010.
18. Strategjia për zhvillimin e arsimit të mesëm profesional në Kosovë (draft) MASHT, Prishtinë, prill 2003.
19. Kohn, Alfie; ‘ The schools and Our Children Deserve (Moving Beyond Traditional Classrooms and “Tougher Standards “), Houghton Mifflin Company. Boston, New York. 1999.
20. Popovci, Dukagjin, Raport për gjendjen e arsimit parauniversitar në Kosovë, 2010.

Shkarkuar më 18.05.2011, <http://www.masht.gov.net/advCms/#id=1>,

Shkarkuar më 05.04.2011, [see-educoop.net](http://see-educoop.net) në rrjetin [.net](http://see-educoop.net)

Shkarkuar më 04.06.2011, <http://www.uni-pr.edu/Universiteti/Historiku.aspx>,

Shkarkuar më 08.11.2011

[http://www.bic.at/downloads/en/brftipps/0\\_1\\_bildungssystem\\_en.pdf](http://www.bic.at/downloads/en/brftipps/0_1_bildungssystem_en.pdf) ,



M. Sc. Lirije Bytyqi-Beqiri

## PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PIKNIKËVE, VIZITAVE, SHËTITJEVE DHE EKSKURSIONEVE MËSIMORE NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME NË KOSOVË

### **Hyrje**

Shkolla, si institucion edukativo-arsimor, veprimtarinë e saj e zhvillon në bazë të aktiviteteve të shumta. Veprimtari kryesore e shkollës është mësimi, në kuadër të të cilit organizohen aktivitete të ndryshme, me karakter edukativ dhe arsimor.

Shkolla, krahas mësimit, duhet t'i përgatisë nxënësit për jetë dhe punë në mjedisin që ata jetojnë. Kjo punë bëhet përmes planifikimit të aktiviteteve mësimore, me anën e së cilave realizohen përmbajtje mjedisore, të cilat lidhen me lëndë të ndryshme, duke siguruar një përshtatshmëri të mirë ndërmjet përmbajtjes dhe metodave mësimore.

Fokus yni në këtë punim është trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin dhe organizimin e piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve mësimore. Qëllimi ynë është që përmes këtij punimi të japim përgjigje në këto pyetje:

- Cili është qëllimi dhe rëndësia e planifikimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve mësimore?
- Si parashihet me ligj organizimi i piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë?

Punimi do të mbështetet mbi bazën ligjore dhe literaturën pedagogjike që e rregullon planifikimin dhe organizimin e piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë.

## I. Konceptet kryesore

Gjatë trajtimit të kësaj tematike kemi veçuar disa koncepte kryesore, të cilat e kanë këtë kuptim:

**Nxënës** - “çdo person i regjistruar në çfarëdo programi të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore dhe aftësuese”<sup>105</sup>.

**Mësimdhënës** - “personi i kualifikuar sipas dispozitave të këtij ligji me përgatitje akademike dhe profesionale, i punësuar për ofrimin e shërbimeve arsimore për nxënësit”<sup>106</sup>.

**Shkollë** - “çdo institucion arsimor që ofron shërbime arsimore në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të ISCED-it, përfshirë çdo institucion aftësimi që ofron shërbime arsimore në nivelin 3 të ISCED-së”<sup>107</sup>.

**Ditë mësimi** - dita kur mbahet mësimi.

**Vit shkollor**- “periudha kohore që fillon më 1 shtator të një viti dhe që përfundon më 31 gusht të vitit pasues, e caktuar nga ministria, siç është përcaktuar në Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës, ndaras për shkollat dhe institucionet e aftësimit”<sup>108</sup>.

**Planifikim**- “Organizimi i punës sipas një plani”<sup>109</sup>. Bërja me kohë e planit të masave që duhet marrë, duke përcaktuar edhe afatet për një punë.

**Organizim**- përgatitjet e nevojshme që bëjmë, në mënyrë që një aktivitet të kryhet sa më mirë, të ketë përfundime sa më të frytshme dhe të arrihet qëllimi i dëshiruar.

**Realizim**- “...Arritje në një fushë...”<sup>110</sup>.

---

<sup>105</sup> Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, faqe 3

<sup>106</sup> Po aty, faqe 4

<sup>107</sup> Po aty, faqe 2

<sup>108</sup> Po aty, faqe 4

<sup>109</sup> Shih më gjerësisht: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës së Sotme, Botim i dytë i ripërpunuar (me rreth 35.000 fjalë), botimet ‘Toena’, Tiranë 2002, faqe 1013

<sup>110</sup> <http://fjalorshqip.com/>, data e shkarkimit, 03.09.2012

**Pikniku mësimor** - Mësimi ditor i organizuar në grup (grupin e caktuar të nxënësve dhe mësimdhënësit përkatës), i zhvilluar në natyrë, me qëllim të realizimit të objektivave mësimore të përcaktuara më parë.

**Vizitë mësimore** - Shkuarja diku dhe qëndrimi atje për pak kohë, për të plotësuar nevojat për realizimin e përmbajtjeve mësimore.

**Shëtitjet e nxënësve** - dalja dhe ecja e nxënësve në natyrë, këmbë apo me mjete të tjera udhëtimi, duke e planifikuar paraprakisht dhe përcaktuar qëllimin, objektivat, të cilat lidhen me procesin mësimor dhe itinerarin e shëtitjes.

**Ekskursioni mësimor** - “formë pune mësimore-edukative, nëpërmjet së cilës krijohen mundësi për të organizuar vëzhgime dhe për të fituar njohuri mbi objektet dhe dukuritë në kushtet natyrore dhe të zakonshme”<sup>111</sup>.

## **II. Qëllimi dhe rëndësia e planifikimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve**

Planifikimi mësimor, si pjesë e procesit të organizimit të punës mësimore sipas një plani, kërkon përkushtim, kohë, mund dhe atraktivitet. Për realizimin e planit dhe programit mësimor planifikohen aktivitete mësimore të ndryshme, të cilat hyjnë si pjesë përbërëse e punës mësimore dhe ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatet mësimore.

Në listën e aktiviteteve mësimore hyjnë edhe piknikët, vizitat, shëtitjet dhe ekskursionet me karakter edukativo-arsimor, të cilat po ashtu janë pjesë e procesit mësimor.

### *Qëllimi i planifikimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve*

Piknikët, vizitat, shëtitjet dhe ekskursionet që planifikohen në shkolla kanë karakter edukativo-arsimor. Ato bëhen me qëllim të shtjellimit, sqarimit dhe konkretizimit të përmbajtjeve mësimore, të cilat mësohen në kuadër të lëndëve të caktuara. Qëllimi i organizimit të tyre lidhet

---

<sup>111</sup> Osmani, Shefik, Fjalor i Pedagogjisë, 8 Nëntori, Tiranë 1983, faqe 182

drejtpërdrejt me qëllimin e përmbajtjeve mësimore që mësohen në klasë.

*Rëndësia e planifikimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve* qëndron në faktin se:

- piknikët, vizitat, shëtitjet dhe ekskursionet janë pjesë e procesit mësimor;
- kontribuojnë në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të reja të nxënësve;
- freskojnë dhe zgjerojnë njohuritë e mëparshme të nxënësve;
- informacionet e marra nga piknikët, vizitat, shëtitjet apo ekskursionet përshtaten me njohuritë e nxënësve, me mjedisin (ambientin) dhe materialin mësimor që mësohet;
- informacionet që marrin nxënësit nga këto aktivitete janë në korrelacion me njohuritë paraprake të nxënësve, si dhe me përmbajtjet që do të mësohen gjatë vitit shkollor në vazhdimësi;
- janë shumë atraktive për nxënësit e të gjitha moshave;
- zgjojnë kureshtje dhe interesim të madh të nxënësit.

Planifikimi, organizimi dhe realizimi i aktiviteteve mësimore duhet të jetë i përshtatur me përmbajtjet në plane dhe programe, duke pasur parasysh vendin dhe kohën e duhur. Kjo mundëson arritjen e objektivave të caktuara.

### **III. Baza legjislative për organizimin e piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve me karakter mësimor**

Mënyra e organizimit dhe e realizimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë rregullohet me Udhëzimin Administrativ, numër 35/2008, data 22.09.2008, i nxjerrë nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në mbështetje të nenit 93. (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores për punën e Qeverisë, nr. 01/ 2007.

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është që të rregullohet mënyra e organizimit dhe e realizimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve, ekskursioneve dhe festimeve - ceremonialeve në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë.

Në nenet prej 2 deri 11 ky udhëzim administrativ e përcakton mënyrën e organizimit të piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve, si dhe të gjitha obligimet që duhet të kryhen para realizimit të tyre, si: obligimet e shkollës, obligimet e nxënësit, leja për realizimin e ekskursionit, dokumentacioni i nevojshëm për sigurimin e lejes nga DKA-ja, zgjedhja e agjencisë, si dhe përgjegjësinë e palëve në kontratë. Duke u mbështetur në këtë udhëzim administrativ, shkolla mund të nxjerrë rregullore të brendshme për të specifikuar rregullat për organizime të tilla në bazë të specifikave të shkollës, e sidomos është e nevojshme që shkolla të ketë rregullore të brendshme për organizimin e piknikëve dhe vizitave.

Me këtë rregullore shkolla cakton rregullat e organizimit të piknikëve dhe vizitave në bazë të konfiguracionit gjeografik dhe ekonomik që ka vendi në të cilin vepron dhe në bazë të objektivave, të cilat planifikohen të mbërrihen me organizime të tilla.

Shkolla mund të përgatisë një listë për vendet ku mund të bëhen pikniku, shëtitjet dhe vizitat. Është e rrugës që shkolla të sigurojë marrëveshje paraprake me institucione, fabrika apo vende të tjera, të cilat janë në interes për shkollën për t'u vizituar, ngase nuk mund të bëhen vizita në ato vende ku paraprakisht nuk kemi siguruar marrëveshje bashkëpunimi me stafin udhëheqës.

Kjo do t'i ndihmojë mësimdhënësit në planifikimin me kohë të tyre dhe do t'u japë mundësi që për vizitat apo shëtitjet të përgatiten paraprakisht dhe përmbajtja e tyre të jetë në korrelacion me përmbajtjet mësimore të lëndëve të caktuara.

### **3.1. Pikniku me karakter mësimor**

Pikniku organizohet dy herë gjatë vitit shkollor. Në bazë të Udhëzimit Administrativ, numër 35/2008, pikniku mund të planifikohet të

organizohet në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor. Realizohet për nivelin 1, respektivisht për arsimin fillor, dhe organizohet brenda territorit të komunës përkatëse.

Duke e pasur parasysh moshën e nxënësve të arsimit fillor, 6-11 vjeç, konstruktin fizik të tyre dhe karakteristikat psikologjike të kësaj moshe, është shumë e arsyeshme që pikniku të realizohet brenda territorit të komunës, e nëse është e mundshme, pse jo, edhe brenda qytetit apo fshatit, në ato vende ku është e përshtatshme dhe ambienti e plotëson qëllimin e piknikut.

Rëndësia e organizimit të piknikut qëndron në faktin se lloji i informacionit që riprodhohet më lehtë në këto mosha është informacioni që lidhet me kujtesën figurative ose shqisore. Fëmija i kësaj moshe është shumë më tepër shqisor sesa verbal. Mëson më shpejt dhe më lehtë nga ajo që sheh, mban mend më gjatë objektin, pamjen që e sheh dhe e përjeton.

Pikniku e ka efektin e vet shumë pozitiv në ato përmbajtje me tematika nga mjedisi, të cilat mund të zhvillohen në natyrë. Mjedisi apo vendi ku organizohet pikniku mund të shërbejë si burim informacioni. Mësimi i organizuar përmes piknikut në natyrë nxënësve u tërheq vëmendjen për problemet mjedisore, duke i nxitur ata të mendojnë dhe të veprojnë për problemet mjedisore të zonës.

Përmes veprimtarive mësimore zhvillohen veprimtari që drejtojnë nxënësit në sjellje pozitive ndaj mjedisit, e po ashtu edhe në aksione për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Pra, mësimi që lidhet me mjedisin bëhet më konkret dhe më praktik në situata të vërteta jetësore.

Meqë pikniku është pjesë e mësimimit, patjetër se duhet të planifikohet dhe të organizohet në korrelacion me përmbajtjen mësimore, e cila është paraparë të realizohet atë ditë.

Si për çdo orë mësimore, edhe për piknikun duhet përgatitje e veçantë. Struktura e përgatitjes ditore për piknikun nuk ndryshon shumë nga ajo e përgatitjes së një ore mësimore. Elementet bazë të planifikimit

mbeten të pandryshuara, duke përfshirë tri fazat e planifikimit: evokim, realizim dhe reflektim. Gjithashtu, secila fazë përmban elementet e veta.

Derisa në ditët kur mësimi realizohet në klasë, sipas orëve mësimore, planifikimi bëhet si i veçantë për secilën orë mësimore, në planifikimin e piknikut me karakter mësimor bëhet planifikim i përbashkët për të gjitha lëndët, duke i integruar përmbajtjet e tyre në aktivitete të ndryshme sipas karakterit të përmbajtjeve. Të vetmet ndryshime ndërmjet planifikimit të aktiviteteve që zhvillohen brenda një ore mësimore dhe aktiviteteve që zhvillohen gjatë piknikut mësimor mund të jenë lloji dhe kohëzgjatja e realizimit të tyre.

### **Model i planifikimit të piknikut me karakter mësimor**

Klasa: IV

<b>Tema</b>	Kujdesi për natyrën
<b>Kohëzgjatja</b>	4 orë mësimi
<b>Vendi</b>	Në natyrë
<b>Materialet</b>	Lapsa, fleta të bardha, ngjyra, qese bërlloku, dorëza për një përdorim
<b>Lëndët</b>	Gjuhë shqipe, Njeriu dhe natyra, Edukatë qytetare, Edukatë figurative, Punë dore
<b>Qëllimi</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Të bëhen të ndërgjegjshëm për ambientin, mbrojtjen e tij;</li><li>- Të mësojnë për problemet që rrjedhin nga ndotja e ambientit dhe jetesa në një ambient të tillë;</li><li>- Të diskutohen përgjegjësitë tona për kujdesin ndaj natyrës.</li></ul>
<b>Metodat</b>	Diskutim, punë në grupe, punë individuale, punë në dyshe

<b>Rezultatet e të nxënit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi tregon rolin e mjedisit natyror për botën e gjallë dhe aktivitete njerëzore;</li> <li>- Shpjegon dhe argumenton rregulla të sjelljes në natyrë;</li> <li>- Praktikon kujdesin dhe mirësjelljen në lidhje me atë mjedis;</li> <li>- Pasuron fjalorin me fjalë e shprehje të reja;</li> <li>- Materialet, të cilat zakonisht i hedhim si të panevojshme, nxënësi i përdor për të krijuar mjete e vegla pune, të cilat do t'i shërbejnë në punën mësimore për konkretizimin e mësimi;</li> <li>- Kupton se faktori njeri është shkaktari kryesor i ndotjes, por edhe i pastrimit dhe mirëmbajtjes së mjedisit;</li> <li>- Përmes vizatimit bën dallimin mes ambientit të pastër dhe atij të papastër (me mbeturina).</li> </ul>
-------------------------------	---

Fazat e realizimit	Aktivitetet	Përshkrimi i aktivitetit	Koha e realizimit
E V O K I M	<b>Ambienti që na rrethon</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësit përshkruajnë vendin, natyrën që i rrethon, bukuritë e saj, format e relievit;</li> <li>- Japin secili mendimin e tyre;</li> </ul> <p>Pastaj ju japim kohë nxënësve që pasi ta shprehin mendimin e tyre për atë mjedis natyror të bëjnë pyetje për gjithçka që u intereson rreth atij mjedisi.</p>	15 minuta



	<b>Natyrë dhe faktori njeri</b>	<p>U themi nxënësve të shpër - ndahen në drejtime të ndryshme, mundësisht të largohen larg njëri-tjetrit për të gjetur shembuj të ndotjes së mjedisit.</p> <p>Pasi të gjejnë shembuj të tillë nxënësit formojnë rrethin e diskutimit dhe debati zhvillohet sipas pyetjeve orientuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cila është mbeturina më e përhapur që kanë ndeshur?</li> <li>- Kush mund ta ketë hedhur atë?</li> <li>- Kush është përgjegjës për këto lloje ndotjesh?</li> <li>- Çfarë duhet bërë për t'i ndaluar ato?</li> </ul> <p>Cilat janë rregullat e sjelljes në natyrë?</p>	<p>10 minuta</p> <p>15 minuta</p>
R E A L I Z I M	<b>Prezantim grafik i tipareve të natyrës</b>	<p>Nxënësit organizohen në grupe, sipas dëshirës së tyre. U japin fleta të bardha të formatit A3, të cilave do t'ju bëjnë një vijë (ndarje) në mes. Në anën e majtë të fletës nxënësit bëjnë vizatim të peizazhit mbi bazën e vëzhgimit, kryesisht vizatim të vendeve ku ka mbeturina. Sipas mundësive bëjnë dhe fotografi.</p> <p>U tregojmë nxënësve për kohën që kanë në dispozicion për ta përfunduar vizatimin. Secili nxënës duhet të shënojë emrin në pjesën pas vizatimit, në mënyrë që saktësisht të dihet autori i punimit.</p>	30 minuta

	<b>Dreka</b>	Për nxënësit porositet ushqim dhe pije	20 minuta
	<b>Krijojmë për nevojat tona</b>	<p>Pyesim nxënësit se çfarë do të bëjnë me gjësendet që nuk do t'u nevojiten më si: foliet (mbështjellësit e bukës), shishet e plastikës, qeset e najlonit në të cilat ishte vendosur ushqimi. (Paraprakisht para organizimit të piknikut sigurohemi që ushqimi të mbështjellët me folie dhe të vendoset në qese najloni).</p> <p>Nxënësit i grupojmë në tri grupe dhe u ndajmë detyra.</p> <p>Grupi i parë me shishet e pijeve do të punojnë, sipas dëshirës, mjete mësimore, të cilat do iu nevojiten për konkretizimin e mësimit.</p> <p>Grupi i dytë do të punojnë sipas dëshirës mjete mësimore nga foliet (mbështjellësit e ushqimit).</p> <p>Grupi i tretë do të punojnë sipas dëshirës mjete mësimore nga qeset e najlonit, në të cilat ka qenë i vendosur ushqimi.</p> <p>Ideator dhe kreator të punës së nxënësve janë vetë nxënësit. Sipas nevojës edhe mësime-dhënësit mund të japin sugjerime në mënyrë që të lehtësojnë punën e nxënësve.</p>	30 minuta

<b>Vendi im është i pastër</b>	Ndajmë nxënësit në dyshe, u shpërndajmë qese bërlloku me ngjyra dhe u sqarojmë nxënësve se në qeset e bërllokut me ngjyrë të kaltër duhet të vendosin letrat, në qesen e bërllokut me ngjyrë të verdhë të vendosin plastikën, në qeset e bërllokut me ngjyrë të gjelbër të vendosin qelqin, ndërsa në qesen e bërllokut me ngjyrë hiri të vendosin kanaçet. Kjo bëhet me qëllim që nxënësit t'i kenë të qarta çka paraqesin ngjyrat e ndryshme të kontejnerëve të vendosur në vendet e caktuara për mbeturina. Gjithashtu, shpërndajmë edhe doreza për një përdorim dhe fillon aksioni për pastrimin e ambientit. Pas pastrimit të ambientit, nxënësit grumbullojnë qeset me mbeturina në një vend të caktuar, duke i vendosur në qesen përkatëse edhe dorezat e tyre.	15 minuta
<b>Prezantim grafik i tipareve të natyrës</b>	Pasi që nxënësit të ulen, u japim fleta të bardha (secili fletën që kishte më herët, i gjejmë në bazë të emrit) dhe në anën e djathtë bëjnë vizatim të peizazhit të së njëjtës pjesë që vizatuan më parë, por tashmë ajo hapësirë është e pastër. Sipas mundësive, bëjmë dhe fotografi. Kjo u ndihmon nxënësve që të vërejnë dallimet mes ambientit të pastër dhe atij të papastër.	30 minuta

R E F L E K T I M	<b>Albumi i përshtypjeve</b>	Nxënësve u japim fletëza që të shkruajnë përshtypjet e tyre nga dita e piknikut.	5 minuta
		Diskutim me nxënësit për mundësinë e hapjes së një ekspozite në shkollë me vizatimet e nxënësve, punët e punuara nga nxënësit, si dhe fotografitë e bëra nga pikniku, me qëllim që për rezultatet e arritura nga ajo ditë mësimi përmes piknikut të informohen edhe nxënësit e tjerë dhe përmes tyre të barten edhe mesazhe për ruajtjen e mjedisit. Po ashtu, mund të ekspozohen edhe fletëzat me përshtypjet e nxënësve nga pikniku, si dhe të vendoset një fletore ku do t'i shkruajnë përshtypjet dhe komentet e tyre nxënësit, mësimdhënësit, prindërit, të cilët do kenë rastin ta shohin këtë ekspozitë.	10 minuta

Dita e piknikut është ditë mësimi. Kohën dhe vendin e mbajtjes së piknikut e cakton mësimdhënësi. Mund të organizohet për qëllime të ndryshme dhe të lidhet në të njëjtën kohë me shumë lëndë mësimore. Mësimdhënësi mund të përzgjedhë ato metoda apo teknika, të cilat nxisin diskutimin, debatin, refleksionin apo vlerësimin e situatave, në përshtatje me moshën e nxënësve. Në tërësinë e metodave dhe teknikave përmendim disa prej tyre, të tilla si situatat e rastit, loja në role, tregimet, historitë, etj., për të vetmen arsye se përdorimi i tyre përmbush më së miri pritshmërinë e mësuesve për trajtimin e problematikave të ndryshme që lidhen me vendin ku organizohet pikniku. Kjo nuk e privon aspak mësimdhënësin nga liria për të

përdorur metodën, teknikën apo për të hartuar strategjinë që ai/ajo e konsideron si më efektiven në kushtet konkrete të klasës me të cilën ai/ajo punon.

Realizimi i piknikut shënohet në ditar, në rubrikat e orëve dhe duhet shënuar edhe emrat e nxënësve, të cilët nuk kanë marrë pjesë në piknik.

### **3.2. Vizitat mësimore**

Vizitat mësimore organizohen për nivelin 1 (klasat I-V) dhe nivelin 2 (klasat VI-IX), brenda territorit të komunës përkatëse. Janë pjesë e procesit edukativo-arsimor dhe mund të organizohen gjatë tërë vitit mësimor. Duhet të planifikohen me kohë, me qëllim që vizitat të jenë në korrelacion me përmbajtjet mësimore.

Mësuesi, respektivisht arsimtari i lëndës, e cakton institucionin (shoqëror, ekonomik, kulturor etj), të cilin do ta vizitojë, dhe e përshkruan qëllimin e vizitës. Vizitat mund të bëhen për qëllime të ndryshme dhe në vende të ndryshme.

Qëllimet për t`u zhvilluar vizita mund të përcaktohen në përputhje me nevojat që lindin sipas tematikave të planifikuara. Të tilla mund të jenë: vizitat në fabrika, në ndërmarrje të ndryshme, vizitat monumenteve e vendeve me histori në të kaluarën, si vendet ku janë zhvilluar beteja gjatë luftës së fundit, vendet me vlera kulturore, shkolla të vjetra, muze, teatro, shtëpitë e kulturës, kullat e vjetra, nga të cilat nxënësit mund të mësojnë shumë për të kaluarën e popullit tonë, mënyrën e jetesës dhe të arsimimit në të kaluarën.

Në orët mësimore ku flitet për relievin, bukuritë e natyrës, kushtet klimatike, vendet atraktive, turizmin etj. mund të vizitohen vende të ndryshme turistike, përmes së cilave nxënësit do të njihen me bukuritë e natyrës, me atraktivitetin e vendit tonë etj.

Mund të organizohen edhe vizita në shkolla të tjera, me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet nxënësve dhe mësimeve të atyre shkollave. Me organizimin e këtyre vizitave nxënësit dhe mësimeve vendosin në këtë mënyrë ura të reja komunikimi, njihen

me moshatarë dhe njohin mënyrën e punës dhe aktivitete të shkollave të ndryshme, të cilat mund t'i shfrytëzojnë si modele në punën dhe aktivitetet e tyre.

Vizita me karakter mësimor mund të bëhen edhe në institucione të ndryshme, si në stacionin policor, gjykatë, komunë, etj. Përmes tyre nxënësit mund të mësojnë për veprimtarinë e këtyre institucioneve, rolin që kanë në jetën tonë dhe lidhjen e tyre me komunitetin.

Vizitat e tilla planifikohen më parë. Mësimdhënësit në bashkëpunim me punëtorët e atij institucioni caktojnë kohën e vizitës. “Mësuesi ose arsimtari i lëndës mund ta zhvillojë njësinë mësimore, sipas planit dhe programit, në lokalet e institucionit. Temën mund ta shtjellojë mësuesi ose i autorizuari i institucionit”<sup>112</sup>.

Nxënësit duhet të parapërgatiten për vizitën, si dhe duhet bërë përpjekje për të marrë garancitë e duhura që personeli i institucionit që zhvillohet vizita të jetë në dispozicion të nxënësve për aq kohë sa është paraparë të zhvillohet vizita dhe të angazhohen plotësisht në aktivitet.

Vizitat, të cilat zhvillohen në objekte prodhuese dhe u ndihmojnë nxënësve të lidhin teorinë me praktikën, të kuptojnë lidhjen që kanë shkencat e natyrës me teknikën dhe teknologjinë e prodhimit. Bashkëpunimet e tilla ndërmjet shkollës dhe institucioneve industriale, ekonomike apo bujqësore, kontribuojnë në lidhjen e shkollës me jetën dhe prodhimin.

Këto vizita mund të zgjojnë kureshtjen dhe interesimin e nxënësve që të hulumtojnë më tutje në lidhje me një punë të tillë dhe në të ardhmen të zgjedhin po atë profesion. Pra, mund të shërbejnë edhe si orientim profesional për nxënësit.

Vizitat e tilla, me karakter mësimor, shënohen në ditar të klasës, ashtu sikur orët e rregullta mësimore. Kjo vizitë konsiderohet ditë pune dhe ditë mësimi.

---

<sup>112</sup> UA Piknikët, vizitat, shëtijtjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë numër: 35/2008, data 22.09.2008, faqe 2.

Vizita mësimore mund të bëhen edhe brenda orarit të mësimit. Në rast se objekti apo institucioni që vizitohet është afër shkollës, vizita mund të kryhet brenda një apo dy orëve mësimore. Mundësitë e tilla duhet shfrytëzuar në maksimum, ngase një gjë e tillë jep mundësinë që brenda ditës së njëjtë të kryhet veprimtari edhe në institucionin e planifikuar, por të vazhdohet edhe me aktivitete të tjera në klasë. Krahas njohurive që fitojnë nxënësit, shohin edhe zbatimin e njohurive në praktikë, grumbullojnë materiale dhe të dhëna për mësimet e ardhshme.

Në raste të tilla vizitat mund të kenë këto tri lloje të ecurive:

- Në fillim të procesit mësimor bëhet vizita, pastaj mësimdhënësi me nxënësit kthehet në klasë, diskuton rreth asaj vizite, duke vazhduar me pjesën e aktiviteteve të planifikuara në klasë, normalisht duke e ndërlidhur me qëllimin dhe objektivat e vizitës mësimore;
- Fillohet me aktivitet në klasë, duke i përgatitur paraprakisht nxënësit për vizitën dhe përfundon me vizitën në institucionin ose objektin e caktuar;
- Fillohet me aktivitet në klasë, duke i parapërgatitur nxënësit për vizitën, vazhdohet me vizitën dhe prapë nxënësit kthehen në klasë dhe vazhdojnë veprimtarinë mësimore, duke e integruar me njohuritë e marra gjatë vizitës.

Varet nga mësimdhënësi se cilën nga këto ecuri do ta zgjedhë. Është në kompetencat e tij që të organizojë vizitën sipas mënyrës më të përshtatshme për nxënësit dhe institucionin në të cilin zhvillohet vizita.

### **3.3. Shëtitjet me karakter mësimor**

Në Udhëzimin Administrativ piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër 35/2008, data 22.09.2008, neni 4, përcakton kriteret e organizimit të shëtitjeve. Në bazë të këtij udhëzimi administrativ, “shëtitja njëditore organizohet për nxënësit e klasave të fundit të arsimit të mesëm të ulët respektivisht për nxënësit e klasave të IX-ta. Shëtitja organizohet nëpër Kosovë, në fund të muajit

maj, ose në fillim të muajit qershor”<sup>113</sup>. Varet nga organizatorët e shëtitjeve se ku do të caktojnë lokacionin e shëtitjes. Zakonisht, vendet më të frekuentuara nga nxënësit me rastin e shëtitjeve mund të jenë vendet apo monumentet historike, peizazhet atraktive, vendet me vlera kulturore, të cilat me kronologjinë e ngjarjeve që paraqesin e plotësojnë përmbajtjen e lëndëve të ndryshme që janë mësuar gjatë vitit shkollor. Si vende më të frekuentuara gjatë shëtitjeve janë: Prekazi Legjendar, më pas, Burimi – kultivimi i peshkut, Banja e Pejës – burimi termik, burimi i Drinit të Bardhë, Peja, Deçani, Gjakova, Ura e Shenjtë, Ujëvarat e Mirushës, Prizreni me monumentin e Lidhjes së Prizrenit dhe vendet e tjera atraktive.

“Shëtitjen e udhëheq zëvendës drejtori, i autorizuar i drejtorit, ose vetë drejtori. Kohën e nisjes, marshutën dhe kohën e kthimit e cakton drejtori i shkollës”<sup>114</sup>.

Paraprakisht duhet të përcaktohet qëllimi i shëtitjes, objektivat të cilat duhet t’i përmbushë shëtitja, itinerari i shëtitjes dhe mësimdhënësit, të cilët do t’i përcjellin dhe udhëheqin nxënësit gjatë gjithë kohës.

“Ecuria e shëtisë shënohet në fletën e fundit të ditarit “Evidencimi i momenteve më karakteristike të punës së paraleles”<sup>115</sup>.

Pas përfundimit të shëtitjes duhet të përgatitet raporti në të cilin do të përshkruhet koha e nisjes, marshuta, koha e kthimit, si dhe ecuria e shëtisë. Në bazë të Udhëzimit Administrativ raporti i dorëzohet Këshillit të shkollës, në formë të shkruar.

### **3.4. Ekskursionet mësimore**

Ekskursionet mësimore organizohen vetëm për vitet e fundit të nivelit të 3-të, respektivisht për maturantë. Janë pjesë përbërëse e procesit mësimor, të cilat realizohen gjatë vitit shkollor dhe mund të zgjasin deri

---

<sup>113</sup> UA Piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër: 35/2008, data: 22.09.2008, faqe 2

<sup>114</sup> Po aty, faqe 2

<sup>115</sup> UA Piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër: 35/2008, data: 22.09.2008, faqe 2



në 5 ditë mësimi. “Me rastin e planifikimit të punës mësimore, në fillim të vitit shkollor duhet parashikuar edhe organizimi i ekskursioneve në kuadër të lëndëve përkatëse ose si ekskursione me karakter të përgjithshëm shkollor”<sup>116</sup>. Rëndësia e ekskursioneve qëndron në faktin se zhvillon te nxënësi aftësinë e përvetësimit, vëzhgimit, analizës, sintezës, kujtesës logjike, intuitës, të menduarit të pavarur dhe kureshtjen.

“Ekskursioni mësimor është një nga metodat më të frytshme për përvetësimin aktiv të njohurive teorike. Ai jep mundësi të mëdha për rritjen e shkallës së pjesëmarrjes së nxënësve në mësim, në gjallërimin e veprimtarisë së tyre, si dhe në rritjen e aftësisë mendore aktive e krijuese”<sup>117</sup>.

Ekskursioni organizohet sipas planit vjetor të punës së shkollës/drejtorit.

“Për organizimin e ekskursionit merr vendim Këshilli i shkollës së paku një muaj përpara. Me vendimin e Këshillit të shkollës përcaktohet:

1. Data e nisjes dhe e kthimit;
2. Itinerari, vizita e monumenteve historike, kulturore etj;
3. Pagesa për nxënësit dhe personi i cili do të menaxhojë të hollat”<sup>118</sup>.

Paraprakisht përcaktohet përmbajtja, qëllimi dhe detyrat e në bazë të tyre përcaktohet vendi dhe kohëzgjatja e ekskursionit.

“Për arsye të racionalizimit dhe ekonomizimit të kohës së punës, si dhe mjeteve materiale, në planifikimin e ekskursioneve duhet të marrë pjesë një numër i madh i arsimtarëve, me qëllim të koordinimit dhe korrelacionit të punës mësimore”<sup>119</sup>.

---

<sup>116</sup> Zylfiu, Dr. Sci. Nijazi, Didaktika (Teori e mësimit dhe e mësimdhënies), UP, Prishtinë, 2005, faqe 245

<sup>117</sup> <http://www.izha.edu.al/programet/klasa7/Biologjia.pdf>, Tiranë 2005, faqe 10, shkarkuar më 22.09.2012

<sup>118</sup> UA Piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër 35/2008, data: 22.09.2008, faqe 2

<sup>119</sup> Zylfiu, Dr. Sci. Nijazi, ‘Didaktika’ (Teori e mësimit dhe e mësimdhënies), UP, Prishtinë, 2005, faqe 245

Ekskursionin e udhëheq drejtori i shkollës, ose i autorizuari nga Këshilli i shkollës.

Për organizimin e ekskursioneve, përveç drejtorit, obligime të shumta e presin këshillin e ekskursionit, MASHT-in, kujdestarët e klasave, nxënësit, obligime të cilat janë përcaktuar me Udhëzim Administrativ<sup>120</sup>.

Drejtori i shkollës ka obligim t'i njoftojë nxënësit dhe prindërit me vendimin e Këshillit të shkollës, rregullat e ekskursionit, obligimet dhe përgjegjësitë e nxënësit në ekskursion. Njoftimi duhet të bëhet jo më pak se 5 ditë pas marrjes së vendimit. Në mungesë të kujdestarit të klasës, drejtori e cakton një mësimdhënës, i cili mban mësim në atë klasë, me kusht që shkuarja e tij në ekskursion të mos e çrregullojë procesin mësimor. Së bashku me kujdestarin e klasës janë të obliguar ta ruajnë rendin, qetësinë dhe sigurinë e nxënësve gjatë realizimit të ekskursionit. Është i obliguar t'i ruajë të gjitha procesverbalet dhe pasi të kthehen nga ekskursionin bëhet raporti me shkrim.

Shkolla është e obliguar ta zgjedhë Këshillin e ekskursionit prej 3 ose 5 anëtarësh.

Nëse shkolla nuk i ka më tepër se 10 paralele, respektivisht 10 kujdestarë të klasave, në ekskursion, anëtarë të Këshillit mund të jenë të gjithë kujdestarët e klasave me drejtorin, respektivisht udhëheqësin e ekskursionit në krye të këshillit.

Këshilli i ekskursionit e ka për detyrë t'i njoftojë nxënësit për sjelljet dhe pasojat e mundshme.

Në rast se nxënësit nuk u binden vendimeve të eprorëve të tyre, Këshilli i ekskursionit mund t'ia ndërpresë ekskursionin në çdo kohë.

Për pjesëmarrësit e ekskursionit vlejné ligjet dhe aktet e tjera nënligjore për shqiptimin e masave ndëshkuese.

Këshilli është i obliguar për çdo mbrëmje të mbajë mbledhje dhe ta shqyrtojë situatën gjatë ditës. E cakton arsimtarin, i cili e mban

---

<sup>120</sup> Për këtë shih: UA Piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë numër 35/2008, data: 22. 09. 2008, faqe 3-4

procesverbalin për çdo mbledhje, si dhe e përgatit raportin nga ekskursioni. Raporti nga ekskursioni i dërgohet DKA-së më së largu 5 ditë pas kthimit nga ekskursioni. Në rast të mosdorëzimit të raportit të ekskursionit në DKA, ndaj Këshillit të ekskursionit dhe shkollës do të merren masa ndëshkuese administrative sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kujdestari i klasës është përgjegjës për nxënësit e klasës së vet, respektivisht të grupit të cilin i ka në mbikëqyrje. Në ekskursion nuk mund të marrë pjesë askush përpos kujdestarëve të klasave dhe udhëheqësit të ekskursionit.

Nxënësi është i obliguar të jetë i sjellshëm dhe korrekt ndaj shokëve, ndaj arsimtarëve, ndaj personelit të agjencive turistike dhe hoteliere; ta respektojë rendin shtëpiak në hotele apo në vende të cilat vizitohen, t'u bindet vendimeve të kujdestarit dhe drejtorit apo udhëheqësit të ekskursionit.

“Meqë shumica e ekskursioneve zhvillohen me ndihmën e personave profesionalë<sup>121</sup> dhe shkencorë të vendit ku realizohen ato... kërkohet edhe përgatitja e tyre lidhur me përmbajtjet dhe veprimet që do të ndërmerren me rastin e vizitës së nxënësve. Varësisht nga përmbajtja, pozita, struktura dhe format e objektit apo veprimi që përbën objektin e njohjes në ekskursion, përcaktohet mënyra e zhvillimit të ekskursionit në një vend të caktuar.”<sup>122</sup>

Vitet e fundit është bërë traditë që ekskursionet të realizohen jashtë Kosovës, sidomos në Shqipëri. Për organizimin e ekskursioneve jashtë shtetit të Republikës së Kosovës duhet të sigurohet leja paraprake nga DKA-ja. “Drejtori i shkollës është i obliguar ta sigurojë vendimin me shkrim nga DKA-ja, së paku 5 ditë më parë”<sup>123</sup>.

---

<sup>121</sup> Kemi fjalën për mësime të lëndëve të caktuara

<sup>122</sup> Zylfiu, Dr. Sci. Nijazi, ‘Didaktika’ (Teori e mësimit dhe e mësimitdhënies), UP, Prishtinë, 2005, faqe 246

<sup>123</sup>UA Piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë numër 35/2008, data: 22.09.2008, faqe 4

Për sigurimin e vendimit me shkrim nga DKA-ja, shkolla duhet të paraqesë kërkesë me shkrim, e cila duhet nënshkruar nga drejtori ose ushtruesi i detyrës. Kërkesa duhet të plotësohet nga drejtori i shkollës/udhëheqësi i ekskursionit dhe duhet të përmbajë të dhënat të cilat janë paraqitur në formularin A, i cili është bashkëngjitur në shtojcën e Udhëzimit Administrativ piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër 35/2008, data: 22.09.2008.

Në kërkesë duhet të paraqiten të dhëna si: emri i shkollës dhe vendi, emri i drejtorit të shkollës, emri i udhëheqësit të ekskursionit dhe Këshilli i ekskursionit (emrat e anëtarëve). Gjithashtu, në kërkesë duhet të paraqitet edhe qëllimi i ekskursionit, koha e fillimit dhe e mbarimit të ekskursionit, si dhe itinerari. Pastaj, duhet të ceket qartë edhe numri i paraleleve që do të marrin pjesë në ekskursion, si dhe numri i kujdestarëve të klasave.

Para realizimit të ekskursionit duhet të merret edhe pëlqimi i secilit prind për pjesëmarrjen e fëmijës së tij në ekskursion dhe lista me pëlqimin me shkrim të secilit prind/përgjegjës për fëmijën e tij duhet t'i bashkëngjitet këtij dokumentacioni.

Që dokumentacioni për paraqitjen e kërkesës të jetë më i plotë dhe më argumentues, në të duhet të përfshihet edhe kopja e planit vjetor të punës së shkollës, në bazë të të cilit argumentohet se ekskursioni është planifikuar me kohë nga organet e shkollës.

Pjesë tjetër e punës së organizimit të ekskursioneve është edhe zgjedhja e transportit, e cila bëhet sipas formularit B dhe vendimit të komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e agjencisë turistike që bëhet sipas formularit C, formularë këta të cilët janë bashkëngjitur në shtojcën e Udhëzimit Administrativ piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër 35/2008, data: 22.09.2008.

“Meqë ekskursioni zakonisht ka të bëjë me angazhime të shumta fizike dhe shqisore, të shoqëruara nga një shkallë e lartë e aktivitetit mendor, atëherë, pos kujdesit për nxitjen e interesit dhe të vëmendjes, duhet bërë

edhe regjistrimi dhe incizimi i shumë informatave, që mund të jenë me interes nga aspekti edukativ dhe arsimor...”<sup>124</sup>.

Informatat e tilla mund t’i përdorim gjatë punës me nxënës edhe pas kthimit nga ekskursioni, të cilat mund të shërbejnë për qëllime konkretizimi.

## **Përfundimi**

Konkludimet e arritura përputhen me qëllimin e parashtruar, si dhe me rolin dhe funksionin e shkollës në planifikimin, organizimin dhe realizimin e piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve mësimore. Përmbajtjet, format dhe metodat e punës mësimore në shkollën e sotme u përshtaten nevojave, afiniteteve e interesave të nxënësit. Veç klasës, mësimi organizohet në kabinet, në punëtori, në bibliotekë, në natyrë, në institucione dhe objekte industriale, ekonomike, bujqësore etj.

Përmes konsultimit dhe analizës së dokumenteve zyrtare mund të nxjerrim këto përfundime:

- Organizimi i piknikëve, vizitave, shëtitjeve dhe ekskursioneve në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë ka bazë ligjore dhe rregullohet me Udhëzimin Administrativ piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër 35/2008, data: 22.09.2008;
- Qëllimi i organizimit të tyre lidhet drejtpërdrejt me qëllimin e përmbajtjeve mësimore që mësohen në klasë, pra shtjellimin, sqarimin dhe konkretizimin e përmbajtjeve mësimore, të cilat mësohen në kuadër të lëndëve të caktuara;
- Janë mjaft me rëndësi për shkollën dhe sidomos për nxënësit, ngase kontribuojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e aftësive të nxënësve,

---

<sup>124</sup> Zylfiu, Dr. Sci. Nijazi, ‘Didaktika’ (Teori e mësimit dhe e mësimdhënies), UP, Prishtinë, 2005, faqe 247

lidhin teorinë me praktikën, zgjojnë kureshtje dhe interesim te nxënësit dhe janë shumë atraktive;

- Për realizimin e tyre shkolla mund të ofrojë mundësi të shumta, fillimisht duke planifikuar me kohë, duke siguruar marrëveshje paraprake me institucione, fabrika apo vende të tjera, të cilat janë në interes për shkollën për t'u vizituar dhe duke bërë përgatitjet adekuate për realizimin e tyre;
- Udhëzimi Administrativ piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë, numër 35/2008, data: 22.09.2008, jep sqarimet e nevojshme për organizimin e shëtitjeve dhe ekskursioneve mësimore;
- Duke u mbështetur në këtë udhëzim administrativ, shkolla mund të nxjerrë rregullore të brendshme për të specifikuar rregullat për organizimin e piknikut dhe vizitave mësimore, duke u bazuar në konfiguracionin gjeografik dhe ekonomik që ka vendi ku vepron dhe në bazë të objektivave, të cilat planifikohen të mbërrihen me organizime të tilla.

## **Literatura**

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fjalor i Gjuhës së Sotme, botim i dytë, i ripërpunuar (me rreth 35.000 fjalë), botimet 'Toena', Tiranë 2002.
2. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe Programi mësimor, për klasën e parë fillore, Prishtinë, gusht 2003.
3. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe programi mësimor, për klasën e dytë fillore, Prishtinë, qershor 2004.
4. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe programi mësimor, për klasën e tretë fillore, Prishtinë, shkurt 2005.

5. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe programi mësimor, për klasën e katërt fillore, Prishtinë, dhjetor 2005.
6. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, Plani dhe programi mësimor, për klasën e pestë fillore, Prishtinë, dhjetor 2005.
7. Osmani, Shefik, Fjalor i Pedagogjisë, ‘8 Nëntori’, Tiranë 1983,
8. Zylfiu, Dr. Sci. Nijazi, ‘Didaktika’ (Teori e mësimimit dhe e mësimdhënies), UP, Prishtinë, 2005.

**Burime të tjera:**

UA Piknikët, vizitat, shëtitjet, ekskursionet dhe festimet-ceremonialet në shkollë numër 35/2008, data: 22.09.2008.

<http://fjalorshqip.com/>,

<http://www.izha.edu.al/programet/klasa7/Biologjia.pdf>, Tiranë 2005, shkarkuar më 22.09.2012.





Sahare Reçica

## SISTEMI I MBËSHTETJES SË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE NË KOSOVË

### **Përmbledhje**

Konventat dhe dokumentet e tjera, të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, të nënshkruara si marrëveshje ndërkombëtare për zbatim nga shumë shtete të botës, krijuan bazën për ndryshim të pozitës së grupeve të marginalizuara në shoqëri, ndër to edhe të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara. Nga këto dokumente rrjedh edhe filozofia e arsimit gjithëpërfshirës, si e drejtë për përfshirje në arsim për të gjithë fëmijët pa dallim, duke ofruar mundësitë për qasje të barabartë, duke respektuar nevojat dhe interesimet individuale. Politikat e shumë shteteve sistemin e arsimit e zhvillojnë mbi parimin e gjithëpërfshirjes, mirëpo zbatimi në praktikë është sfidë për të gjithë. Vendet e ndryshme për realizimin e gjithëpërfshirjes zbatojnë sisteme të ndryshme të mbështetjes, varësisht nga politikat e brendshme dhe zhvillimet ekonomike. Shumë vende e zbatojnë modelin e transformimit të shkollave speciale në qendra burimore, model ky i cili ka filluar të zbatohet edhe në Kosovë.

Synimi i Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe organizatave të rëndësishme ndërkombëtare ka nxitur edhe harmonizimin e politikave me këto shtete. Janë hartuar ligje dhe strategji shumë të avancuara. Edhe Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë në Kosovë ka miratuar një varg dokumentesh, të cilat e përkrahin gjithëpërfshirjen dhe sigurojnë se çdo fëmijë, pa dallim, ka të drejta të barabarta për arsimim cilësor. Përveç hartimit të politikave, MASHT-i vazhdon ta menaxhojë dhe ta financojë arsimin special.

Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore zhvillohet në shkolla speciale – qendra burimore, klasa të bashkangjitura – dhoma të burimeve dhe në shkolla të rregullta „gjithëpërfshirëse”. Aktualisht, një numër shumë i vogël i fëmijëve është i përfshirë në sistemin arsimor (krahasuar me numrin e përgjithshëm që supozohet se ekziston, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë). Një numër i nxënësve në shkolla të rregullta mbështetet nga mësimitdhënës udhëtues dhe mësimitdhënës gjithëpërfshirës.

Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është kryesisht kompetencë e MASHT-it, pasi që ende nuk janë bartur kompetencat në komuna dhe shkolla. Sipas akteve ligjore, komunat duhet t’i formojnë ekipet për vlerësimin profesional të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilat do t’i vlerësonin nevojat e fëmijëve dhe do të përcaktonin llojin e mbështetjes. Po ashtu, parashihet edhe punësimi i koordinatorëve për arsim gjithëpërfshirës nëpër komuna. Aktualisht, komunat e kryejnë vetëm transportin e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat përkatëse.

Shkollat duhet të përfshijnë të gjithë fëmijët e zonave që i mbulojnë, pa dallim, dhe të krijojnë klimë miqësore. Udhëheqja e shkollës duhet të formojë ekipin për vlerësimin e nevojave të nxënësve, të sigurojë mësimitdhënës të përgatitur për gjithëpërfshirje dhe shërbime profesionale të nevojshme, të mbikëqyrë hartimin dhe zbatimin e planit individual, të sigurojë qasje, mjete mësimore dhe mjete ndihmëse bazuar në nevoja, të planifikojë aktivitete të lira ku mund të përfshihen të gjithë, të bashkëpunojë me prindër, komunitet, ekspert nga jashtë dhe OJQ për të siguruar mbështetje të duhur për nevojat e të gjithë nxënësve.

Mësimitdhënësit duhet të jenë të përgatitur për gjithëpërfshirje, të pranojnë se në klasë ka nxënës me nevoja të ndryshme arsimore, të jenë të afërt me nxënës dhe të durueshëm. Ata duhet t’i njohin specifikat e aftësive të kufizuara, mënyrat e qasjes dhe të udhëheqin ekipin për planin individual të arsimit. Mësimitdhënësit duhet t’i akomodojnë të

gjithë nxënësit në klasë bazuar në nevojat e tyre, të përshtatin metodologjitë e mësimdhënies, materialet mësimore dhe të bashkëpunojnë me prindër dhe qendra burimore.

Roli i prindërve në shkollë është i pazëvendësueshëm. Në politikat arsimore prindërit janë pjesë e shkollës si në këshillat udhëheqëse, ekipet për planifikim të shkollës dhe monitorues të proceseve. Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta duhet të jenë pjesë e ekipit për hartimin dhe vlerësimin e PIA-s. Duhet pasur kujdes në krijimin e raporteve korrekte dhe reciproke me prindër.

Edhe roli i organizatave joqeveritare të ndryshme ka qenë dhe mbetet i pamohueshëm në lëvizjen e proceseve të arsimit në të gjitha fushat, e në veçanti mbështetëse të sistemit për gjithëpërfshirjen në arsim.

Sipas analizës së bërë, organizimi i sistemit të mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore është i planifikuar mirë dhe i përgjigjet së drejtës dhe kritereve për gjithëpërfshirje, por ngec zbatimi në praktikë. MASHT-i duhet të sigurojë shërbimet mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta para se ata të përfshihen në klasa të rregullta. Po ashtu, duhet të barten përgjegjësit sipas planifikimit, për organizimin e sistemit të mbështetjes, dhe të bëhet monitorimi i zbatimit të ligjit.

## **1. Hyrje**

“Arsim për të gjithë” është një lëvizje shpresëdhënëse ndërkombëtare për të krijuar mundësitë e arsimit për të gjithë personat, pa dallim. Parimi kryesor i arsimit për të gjithë është që të gjithë personat të kenë të drejtën në arsim, e cila e drejtë është potencuar që në nenin 26 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948.

Synimi i Republikës së Kosovës për t’u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ka nxitur ndryshime dhe reforma në sistemin e arsimit.

E drejta për arsimim është e garantuar për të gjithë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga ligjet e tjera në fuqi, sipas të cilave

institucionet publike duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për secilin, në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre.

Në shumë dokumente është potencuar se qasja e Arsimit për Nevoja të Veçanta është një qasje në të cilën nevojat e veçanta të secilit nxënës janë baza për planifikimin dhe realizimin e përkrahjes së nevojshme dhe gjithashtu përfshin një kategorizim bazë mes nxënësve të rregullt dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin gjithëpërfshirës të arsimit.

Gjithëpërfshirja në arsim është parim i politikave arsimore në shumicën e vendeve ndërkombëtare, por zbatimi në praktikë ende është një sfidë për të gjithë. Shumë njohës të kësaj çështje pranojnë se koncepti i filozofisë së sistemit arsimor ka ndryshuar, por jo edhe qasja. Sidomos, mbetet sfidë sistemi i mbështetjes së personave me nevoja të veçanta arsimore. Kjo e ka shtyrë Agjencinë Evropiane<sup>125</sup> për arsimin e personave me nevoja të veçanta të fillojë një hulumtim, për të kuptuar se si po e zbatojnë vendet e ndryshme me sistem arsimor gjithëpërfshirës sistemin e mbështetjes në arsim për personat me nevoja të veçanta arsimore, i cili pritet të përfundojë në vitin 2014.

Arsyeja e trajtimit të kësaj teme është aktualiteti i sistemit të mbështetjes, si sfidë në shumë shtete, analiza e organizimit të këtij sistemi në Kosovë dhe propozimi i rekomandimeve për funksionim të këtij sistemi.

## **2. Koncepti gjithëpërfshirje - parim në politikat ndërkombëtare dhe vendore të arsimit**

Ky parim mbështetet mbi të drejtën e të gjithë fëmijëve pa dallim nga gjendja e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, shqisore, gjuhësore apo ndonjë gjendje tjetër, të kenë qasje në shkollë.

Në shekullin e kaluar kanë ekzistuar mendime të ndryshme për gjithëpërfshirje, e që disa vazhdojnë t'i mbrojnë edhe sot. Duke e

---

<sup>125</sup><http://www.european-agency.org/news/organisation-of-provision-to-support-inclusive-education>, shkarkuar në shtator, 2012

mbrojtur qëndrimin për shkollat speciale, shprehen se “fëmijët mund të vendosen në arsim të përgjithshëm vetëm nëse kanë nevojë për mbështetje minimale”<sup>126</sup>, se praktika e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta mund t’i dëmtojë të arriturat për nxënësit e tjerë, pasi që, sipas tyre, “aplikimi i dy e më shumë metodave nuk është i mundshëm në klasë” Nga ana tjetër, “studimet e bëra në vende të ndryshme të botës kanë treguar se shumë fëmijë të izoluar në shkolla speciale nuk kanë arritur rezultate të mjaftueshme, kanë ngecur apo edhe kanë rënë nën nivelin hyrës”<sup>127</sup>, si pasojë e ndikimit të rrethit. Kjo i ka shtyrë përkrahësit e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara të mendojnë për një sistem tjetër të arsimit, që të gjithë të kenë mundësinë të arsimohen së bashku - konceptin e arsimit gjithëpërfshirës.

Sipas këtij koncepti, sistemi gjithëpërfshirës duhet të fokusojë *”fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata të talentuar, fëmijët e rrugës dhe ata të cilët punojnë, fëmijët nga popullatat e viseve të largëta apo ato nomade, fëmijët nga minoritetet gjuhësore, etnike apo kulturore dhe fëmijët nga fushat apo grupet e tjera të pa favorizuara apo të marginalizuara”*<sup>128</sup>.

Ekziston një konsensus i gjerë ndërkombëtar se fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta arsimore dhe të të gjitha grupeve të tjera të marginalizuara duhet të përfshihen në mjediset arsimore të organizuara për shumicën e fëmijëve. Tashmë shumica e vendeve ndërkombëtare e zhvillojnë sistemin e arsimit gjithëpërfshirës, por ballafaqohen me sfidat e zbatimit në praktikë të këtij procesi. Mbi këtë parim mbështeten politikat arsimore edhe në Kosovë.

---

<sup>126</sup> <http://www.european-agency.org/publications/ereports/key-principles-for-promoting-quality-in-inclusive-education-1/Key-Principles-2011-EN.pdf/view>, raport hulumtimi, shkarkuar në shtator 2012.

<sup>127</sup> Po aty

<sup>128</sup> Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, (pjesa e kornizës për veprim në arsimin me nevoja të veçanta), 2007, f. 5.

Derisa “gjithëpërfshirja” është një koncept që përcakton filozofinë e organizimit të sistemit arsimor “për të gjithë”, “përfshirja” i referohet krijimit të mundësisë së çdo individi për qasje të barabartë dhe iu mundëson të gjithëve arritje më të mëdha akademike dhe sociale. “Përfshirja mundëson që çdo nxënës në shkollë të ndjehet i mirëpritur dhe nevojat e tij dhe stilet e të nxënës të vlerësohen”<sup>129</sup>. Sot përfshirja është pranuar gjerësisht, i respekton të drejtat e të gjithëve dhe është qasja e preferuar e shekullit XXI.

Këto koncepte janë zhvilluar më tepër gjatë kësaj dekade, së bashku me ndryshimin e bindjeve të tjera sociale dhe politike, ku ndarja apo izolimi i personave me aftësi të kufizuara konsiderohet mohim i drejtësisë. Klasa gjithëpërfshirëse duhet të konsiderohet si vlerë për nxënësit, sepse ata mësojnë nga njëri-tjetri.

Sipas disa hulumtimeve, të bëra me prindër dhe mësimdhënës, sondazhet tregojnë se fëmijët e tjerë (fëmijët pa dëmtime) në klasa gjithëpërfshirëse nuk pësojnë, përkundrazi fitojnë duke zhvilluar:

- miqësi që i bën fëmijët të bëhen më të dashur, më të kujdesshëm dhe të sigurt;
- parime personale, që i bën ata të rrisin moralin dhe etikën për mbështetjen e shokëve të tyre;
- aftësi sociale që u mundëson fëmijëve në klasa gjithëpërfshirëse të bëhen të vetëdijshëm për veten dhe të tjerët. Ata bëhen të aftë për të kuptuar dhe reaguar ndaj shokëve të tyre në klasë dhe vlerësojnë veçantitë (specifikat) e çdo fëmije.

“Hulumtimet e bëra me studentët pa nevoja të veçanta në shkollat e mesme dhe të larta tregojnë se ata ndihen më pak të frikësuar nga njerëzit që duken ndryshe apo kanë sjellje ndryshe, sepse ata kanë ndërvepruar dhe tanimë *kanë përvoja*. Të njëjtën gjë e kanë pohuar edhe prindërit e tyre. Në klasa përfshirëse nuk ka nxënës të lënduar.”<sup>130</sup>  
Koncepti i përfshirjes në kontestin evropian, sipas udhëzimeve të

<sup>129</sup> <http://nvpie.org/inclusive.html>, raport hulumtimi, shkarkuar në shtator 2012.

<sup>130</sup> <http://nvpie.org/inclusive.html>, shkarkuar në gusht 2012.

UNESCO-s dhe UNICEF-it, më së miri pasqyrohet në modelin e “shkollave mike për fëmijë”. (Drafti për këto standarde është hartuar edhe për shkollat e Kosovës nga Instituti Pedagogjik dhe MASHT-i, me mbështetjen e UNICEF-it, dhe pritet të pilotohet).

Edhe pse sistemi i arsimit gjithëpërfshirës është përkrahur në politikat e shumicës së vendeve ndërkombëtare, shkollat speciale dhe klasat e bashkangjitura vazhdojnë të funksionojnë në shumicën e shteteve të botës, por kryesisht për fëmijët me shkallë më të rëndë të ngecjes në zhvillim. Shumë shtete e praktikojnë modelin e “transformimit të shkollave speciale në qendra burimore - sistem i ngjashëm, i cili është pranuar dhe ka filluar të zbatohet edhe në Kosovë. Sipas këtij modeli, shkollat speciale janë transformuar në qendra të burimore dhe klasat e bashkangjitura speciale brenda shkollave të rregullta janë transformuar në dhoma të burimeve, të cilat konsiderohen si resurse në sistemin e mbështetjes së arsimit gjithëpërfshirës.

Arsimi gjithëpërfshirës - e drejtë për të gjithë, nuk mund të realizohet pa ofrimin e mundësisë, gjegjësisht mbështetjes së nevojshme institucionale. Kur flitet për mbështetjen në arsimin gjithëpërfshirës, kryesisht mendimet fokusohen te fëmijët me aftësi të kufizuara, si kategoria më e ndjeshme e shoqërisë.

### **3. Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë**

Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nënkupton tërësinë e përkrahjes dhe ndihmës së organizuar ndër-institucionale, në shërbim të fëmijëve me nevoja të veçanta për zhvillimin e potencialeve të tyre arsimore. Koncepti i përfshirjes ndërlidhet me ofrimin e mundësive për qasje të barabartë, bazuar në nevojat individuale. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevoja të veçanta arsimore, mund të themi se në Kosovë përkrahja ekziston, por jo edhe ndihma e mjaftueshme për të cilën nevojiten

investime financiare. Në vitet e para të pasluftës qasja për personat me aftësi të kufizuara në jetën publike ka qenë ndër prioritetet qeveritare dhe janë bërë më shumë lëvizje pozitive krahasuar me gjendjen e tanishme.

### **3. 1. Organizimi i sistemit të mbështetjes në politikat vendore**

Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është sfidë për të gjitha vendet. Shtetet e ndryshme sistemin e mbështetjes e organizojnë në harmoni me politikat e tyre vendore, e që varet edhe nga zhvillimi ekonomik dhe mundësitë për investime. Në Kosovë, politikat vendore kanë planifikuar organizimin e mbështetjes dhe kanë krijuar një sistem, i cili do t'i plotësonte nevojat individuale. Shpërndarja e përgjegjësive sipas dokumenteve (ligjit dhe akteve nënligjore) është bazuar në hierarkinë institucionale, por ka ngecur bartja e përgjegjësive tek institucionet gjegjëse.

#### **3.1.1. Roli i MASHT-it në sistemin e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore**

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë është hartuese e politikave arsimore në Kosovë. MASHT-i ka miratuar tashmë një varg dokumentesh në harmoni me politikat shtetërore për fushën e arsimit. Synimi i MASHT-it në këto dokumente është “Arsim për të gjithë”, duke u mbështetur në parimin “gjithëpërfshirës”. Në Ligjin e ri për arsimin parauniversitar (Ligji Nr. 04/L-032, neni 40.1) shkruan: “Qëllimi i qartë i këtij ligji është që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Republikën e Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare, siç parashihen në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (UNESCO,1989), në Deklaratën e Salamankës (1994), Konventën e OKB-së për të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuara (2007) dhe në konventat apo rekomandimet e tjera përkatëse ndërkombëtare”. Po ashtu, edhe në *Kornizën e Kurrikulës*, e miratuar në gusht 2011, parimi i parë mbi të cilën synohet të zhvillohet sistemi i



arsimit është gjithëpërfshirja. “E udhëhequr nga ky parim, Korniza e Kurrikulës mundëson zgjidhje të modifikueshme për t’i trajtuar dallimet në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar kështu në zhvillimin e plotë të potencialeve mësimore të secilit”<sup>131</sup>. Duke u bazuar në këtë, MASHT-i ka hartuar Planin Strategjik për Arsimin Gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë (2010 – 2015). Qëllimi i këtij plani strategjik është përcaktimi i strukturuar i qasjes dhe trajtimit të çështjes së procesit të gjithëpërfshirjes në aspektin e saj më praktik dhe më funksional. Motoja e planit strategjik është “Për një sistem arsimor cilësor për të gjithë nxënësit, duke marrë parasysh dhe respektuar nevojat individuale, interesat dhe mundësitë”<sup>132</sup>. Objektivat e këtij dokumenti janë inkorporuar brenda Planit Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011 – 2016 (PSAK). Në tërë PSAK-un përvijohet vetëdija se një sistem arsimor gjithëpërfshirës është parakusht për të ulur barrierat për përfshirje në arsimimin e rregullt shkollor, strategjitë e arsimit gjithëpërfshirës dhe prioritetet e vendosura. Aktivitetet e planifikuara janë vendimtare për arritjen e Synimeve Zhvillimore të Mileniumit (SZHM) dhe politikën e gjithmbarshme të qasjes së barabartë.

Nëse i analizojmë këto dokumente, përcaktohet qartë orientimi i politikave vendore për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare për arsim.

Përveç hartimit të politikave, MASHT-i është udhëheqës i arsimit special. Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore menaxhohet nga MASHT-i, duke financuar shkollat speciale-qendrat burimore, klasat e bashkangjitura dhe mësimdhënësit gjithëpërfshirës.

Sipas statistikave të MASHT-it, në vitin shkollor 2011/2012 në sistemin arsimor kanë qenë të përfshirë 1179 nxënës me nevoja të

---

<sup>131</sup>MASHT: Korniza e Kurrikules, gusht, 2011. f. 23.

<sup>132</sup>MASHT: Planin Strategjik për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2010 – 2015), mars 2010, f. 8.

veçanta arsimore. Nëse analizojmë numrin e përgjithshëm të nxënësve në arsimin e obliguar, që ishte 295 218, dhe bazohemi në raportin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) se rreth 10 % të popullatës në botë janë me aftësi të kufizuara, del se përqindje shumë e vogël janë të përfshirë në arsimim. Po ashtu, edhe rritja e numrit në vite është shumë e vogël (në vitin shkollor 2007/2008 ishin rreth 909 nxënës). Kjo do të thotë se me të gjitha përpjekjet e bëra përfshirja e kësaj kategorie në arsim është larg nga synimet strategjike.

Për realizimin e parimit të gjithëpërfshirjes, në sistemin e mbështetjes MASHT-i ka zbatuar modelin e transformimit të shkollave speciale në qendra burimore dhe klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve, model ky i zbatuar në shumë vende të botës me sistem arsimor gjithëpërfshirës, si: të gjitha vendet e BE-së, SHBA, Kanada, Japoni, etj.

Roli i qendrave burimore dhe dhomave të burimeve edhe në Kosovë është që të mbështesë shkollat përfshirëse. Kjo mbështetje duhet të ofrohet përmes realizimit të trajnimeve, identifikimit dhe vlerësimit të fëmijëve, hartimin e planeve individuale, përshtatje të materialit mësimor, strategji të mësimdhënies dhe njëkohësisht të bashkëpunojnë edhe me prindërit dhe nxënësit.

Po ashtu, në kohët e fundit (prej 2010), sipas të dhënave nga MASHT-i, 17 shkolla kanë pranuar një numër të konsiderueshëm të fëmijëve me vështirësi në të nxënë (që nga MASHT-i quhen shkolla gjithëpërfshirëse), në të cilat janë punësuar mësimdhënës gjithëpërfshirës, të cilët kanë për detyrë t'i mbështesin të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe mësimdhënësit e klasave përfshirëse brenda shkollës. Numri i shkollave gjithëpërfshirëse pretendohet të rritet në të ardhmen, edhe pse besohet se një numër i konsiderueshëm i nxënësve me vështirësi në të nxënë, të pidentifikuar dhe pa një vlerësim apo mbështetje të veçantë vazhdojnë ta ndjekin mësimin në shumë shkolla të tjera.

Edhe pse vizioni i arsimit gjithëpërfshirës ka filluar të zbatohet, megjithatë nuk i plotëson përcaktimet e parapara në ligj dhe strategji. Sipas ligjit në fuqi, i cili është bazuar në parimin e arsimit gjithëpërfshirës, *institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve*. Nëse analizojmë të arriturat në këtë kontest, shumë institucione shkollore nuk janë të gatshme për pranimin dhe akomodimin e të gjithë fëmijëve.

Në këtë ligj, po ashtu, thuhet se *“mbështetja përkatëse duhet të ofrohet bazuar në nevojat intelektuale të nxënësve”*. Nuk mund të flitet për ndonjë mbështetje përkatëse cilësore, përderisa ende nuk bëhet vlerësimi profesional i nxënësve në mënyrë institucionale. Mbështetja mund të ofrohet vetëm nga mësimitdhënësit – për aq sa ata janë të përgatitur dhe të gatshëm. Një numër i vogël i nxënësve të përfshirë mbështeten nga mësuesit udhëtues të qendrave burimore (sipas statistikave të MASHT-it, rreth 180 nxënës mbështeten nga 8 mësimitdhënësit udhëtues) dhe atë, në masë shumë simbolike, duke ndihmuar mësimitdhënësit për përgatitjen e planeve individuale dhe përshtatjen e materialeve mësimore, por pa bërë ndonjë vlerësim të mirëfilltë apo monitorim të procesit.

Po ashtu, një numër i nxënësve të përfshirë në dy „shkolla gjithëpërfshirëse” mbështeten nga mësimitdhënësit gjithëpërfshirës të punësuar në këto shkolla. Konsiderohet se ata janë më afër nxënësve dhe mund të ofrojnë mbështetje më të madhe për mësimitdhënësit dhe nxënësit e klassave përfshirëse si: në vlerësimin e nxënësve, hartimin e planit individual, përshtatje të materialeve mësimore dhe teknika të qasjes dhe mësimitdhënies.

Në pikën 2.3. të nenit 40 të ligjit shkruan se *“ambientet e posaçme arsimore apo shkollat speciale arsyetohen vetëm pasi që nga vlerësimi i ekspertit del se nuk është praktike të regjistrohet ndonjë fëmijë në shkollën e rregullt publike apo në institucionin e aftësimin”*. Edhe ky

nen nuk zbatohet në praktikë pasi që nuk bëhet vlerësimi nga ekspertët - me përjashtim të mjekut, dhe nxënësit regjistrohen në shkolla speciale apo klasa të bashkangjitura nga pamundësia për qasje në shkolla të rregullta apo mungesa e vetëdijesimit të prindërve për të drejtat e tyre dhe të fëmijëve të tyre.

Në bazë të ligjit, duhet marrë masa për të gjithë fëmijët të cilët përdorin arsye të veçantë nuk përfshihen në arsimin e obligueshëm. Deri më tani, nuk ka informata të zbatimit të këtij neni, që sigurisht se do të ndikonte në mobilizimin e institucioneve arsimore dhe prindërve në rritjen e numrit të nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor.

### **3. 1. 2. Roli i komunave në sistemin e mbështetjes**

Komunat nuk kanë shumë kompetenca për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, edhe pse një gjë e tillë është paraparë me ligj. Sipas ligjit në fuqi, *“komunat marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkolla të rregullta të komunës, përfshirë edhe themelimin e dhomave burimore dhe klasave të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike, përfshirë ato ndijore”*. Aktualisht, DKA-të mbajnë përgjegjësitë vetëm për sigurimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që i ndjekin mësimet në shkollat komunale.

Sipas ligjit në fuqi (neni 41), çdo komunë duhet që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore, të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.

Në ligj shkruan se qëllimet e vlerësimit janë:

- të vlerësojë aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës;

- të japë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxënie dhe mirëqenien e fëmijës;
- të përkufizojë nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhënie;
- të japë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.

MASHT-i e ka nxjerrë edhe Udhëzimin administrativ për themelimin e ekipeve profesionale për vlerësim, në maj të këtij viti. (U. A. nr 07, 2012). Por, deri më tani nuk ka të dhëna se këto ekipe janë themeluar në ndonjë komunë. Formimi dhe funksionimi i tyre sipas detyrave të parapara do të ishte një mbështetje bazë për zhvillimin e potencialeve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe njëkohësisht edhe për shkollën dhe prindërit, bazë për vazhdim më të sigurt të procesit të përfshirjes individuale. Ky model i vlerësimit funksionon edhe në shumë vende të tjera, në të cilat zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes, por dallon shpërndarja institucionale e përgjegjësive për vlerësim, varësisht nga politikat vendore për organizim të brendshëm.

Në kuadër të komunave, MASHT-i parasheh edhe punësimin e koordinatorëve për arsim gjithëpërfshirës, si dhe themelimin e shërbimit këshillimor dhe shëndetësor për nevojat speciale.

### **3. 1. 3. Roli i shkollës në sistemin e mbështetjes**

Bartja e kompetencave që parashihet nga niveli qendror dhe rritja e autonomisë së shkollës nënkuptojnë edhe rritjen e përgjegjësive për organet udhëheqëse të shkollës -këshillat e shkollës dhe drejtorin.

Drejtori i shkollës duhet të ketë listën e fëmijëve të zonës që mbulon shkolla dhe të krijojë mundësitë për qasje të të gjithëve, duke përfshirë infrastrukturën, sigurimin e mësimdhënësve të përgatitur, shërbimeve profesionale dhe atyre ndihmëse, sigurimin e mjeteve mësimore dhe mjeteve ndihmëse të nevojshme.

Shkolla është vendi kyç në të cilën zhvillohet arsimimi. Që të tregojë rezultate, shkolla duhet të bëhet gjithëpërfshirëse, të ristrukturojë

kulturat, politikat, praktikat, në mënyrë që ato t'i përgjigjen diversitetit. Shkollat e së ardhmes duhet të sigurojnë se çdo nxënës do të jetë i mirëpritur, do të ketë akomodim dhe mbështetje të nevojshme. Shkolla duhet të jetë e gatshme që<sup>133</sup>:

- Të përfshijë të gjithë fëmijët e zonës që ajo mbulon, pa dallim, të regjistrojë të gjithë fëmijët, të vlerësojë dhe identifikojë mundësitë dhe nevojat për mbështetje, të bashkëpunojë me prindërit dhe komunitetin, të bashkëpunojë me institucione të tjera bazuar në nevojat e shkollës.
- Të gjithë fëmijët pa dallim të kenë qasje dhe të përfshihen në mënyrë aktive në programe kurrikulare dhe aktivitete të lira në shkollë: shkolla formon ekipin për hartimin e planeve individuale, monitoron dhe vlerëson zbatimin e tij, pajis nxënësit me tekste dhe materiale, mjete mësimore, mjete ndihmëse, shërbime teknologjike që iu përshtaten nevojave të nxënësve, planifikon aktivitete të lira që mundësojnë përfshirjen e të gjithë nxënësve etj.
- Të gjithë fëmijët, pa dallim, mbështeten nga shkolla për zhvillimin e potencialeve të tyre: shkolla siguron mësimdhënës të përgatitur për gjithëpërfshirje, shërbime profesionale në shkollë dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm varësisht nga nevojat e nxënësve si dhe siguron trajnime të nevojshme për mësimdhënës.
- Të gjithë fëmijët respektohen dhe trajtohen në mënyrë të barabartë, dallimet që ekzistojnë në mes tyre pranohen dhe respektohen nga të gjithë në shkollë: shkolla stimulon klimë miqësore dhe ka rregulla të sjelljes të cilat sigurojnë se të gjithë fëmijët ndihen mirë, bashkëpunojnë, reagojnë ndaj diskriminimit, dallimet vlerësohen dhe respektohen.

---

<sup>133</sup> Sqarim: disa nga kriteret që duhet t'i plotësojnë shkollat janë marrë nga drafti "Standardet për Shkollat Mike për Fëmijë", të hartuara nga Instituti Pedagogjik dhe MASHT-i me mbështetje të UNICEF-it, mars 2011. Këto standarde pritet të pilotohen në disa shkolla.

Aktualisht, shkollat në Kosovë nuk mund të themi se i plotësojnë këto kritere, madje, as ato që nga MASHT-i quhen “shkolla gjithëpërfshirëse”. Edhe pse kanë përfshirë një numër të konsiderueshëm të fëmijëve me nevoja të veçanta të zonave që ato i mbulojnë dhe që kanë të punësuar nga një mësimdhënës gjithëpërfshirës, bazuar në kriteret e lartcekura, këto shkolla kanë mangësi për mbështetje të nevojshme. I gjithë procesi i përfshirjes mbetet kompetencë e mësimdhënësit “gjithëpërfshirës”, i cili më tepër luan rol këshillues për mësimdhënësit e klasave përfshirëse. Shkollat nuk posedojnë shërbime të tjera mbështetëse profesionale për asnjë lloj tjetër të mbështetjes specifike (p.sh. terapi e të folurit, fizioterapeut, interpretues të gjuhës së shenjave, etj). Po ashtu, nuk janë marrë asnjë lloj masash për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasa përfshirëse krahasuar me paralelet e tjera homogjene.

### **3.1.4. Roli i mësimdhënësve në sistemin e mbështetjes**

Reformat në sistemin arsimor reflektojnë drejtpërdrejt edhe në ndryshimin e rolit të mësuesit në klasë. Në sistemin tradicional të arsimit, mësuesi ishte vetëm një transmetues i njohurive dhe nxënësit duhej të përshtateshin brenda klasës. Standard për planifikim mësimor ishte mesatarja e nxënësve të klasës dhe sigurisht që nxënësit mbi apo nën këtë nivel nuk arrinin t’i zhvillonin maksimumin e potencialeve të tyre.

Tani, reformimi i sistemit arsimor dhe synimi për arsim gjithëpërfshirës kushtëzojnë edhe ndryshimet në procesin e mësimdhënies, gjegjësisht kompetencat e mësimdhënësit në mënyrë që t’iu përgjigjet kërkesave të kohës. Mësimdhënia me nxënësin në qendër është metodologji e kohës dhe një ndër kriteret për përfshirje brenda klasës.

Para së gjithash, mësimdhënësit duhet ta pranojnë faktin se klasa është e përbërë nga një grup i larmishëm i nxënësve, të cilët vijnë nga grupe të ndryshme sociale dhe kanë njohuri, aftësi, shkathtësi, prirje të ndryshme. Është detyrë e mësimdhënësit t’i njohë, t’i vlerësojë dhe t’i

identifikojë nevojat, mundësitë dhe interesimet e tyre, në mënyrë që të jetë i saktë në mbështetje - në përcaktimin e qasjes dhe planifikimin e mësimdhënies. “Mësuesit nuk duhet të nënvlerësojnë ose të mbivlerësojnë aftësitë aktuale të të menduarit të nxënësve të tyre. Nxënësit as nuk duhet të jenë të mërzitur nga puna që është shumë e thjeshtë dhe as nuk duhen të lihen mbas duke i mësuar gjëra që ata nuk i kuptojnë”<sup>134</sup>. Përveç kompetencave të përgjithshme, një mësimdhënës përfshirës i nxënësve me aftësi të kufizuara duhet të ketë edhe aftësi shtesë për mbështetje, për t’iu ofruar shërbime bazuar në nevojat e veçanta, si:

- Për të kuptuar diversitetin dhe të drejtën e çdo fëmije për t’u përfshirë në shkollën më të afërt të vendbanimit të tij (ta njohë ligjin);
- Të ketë njohuri për specifikat e llojeve të ndryshme të aftësive të kufizuara dhe mënyrat e qasjes ndaj tyre;
- Të zhvillojë ndjeshmërinë, ngrohtësinë dhe durimin;
- T’i motivojë nxënësit;
- Të përshtatë metodologjitë e mësimdhënies;
- Të zbatojë lojën si teknikë të mësimdhënies;
- Të njohë stilet e të nxënësve;
- Të përshtatë planin mësimor, të hartojë PIA, të zbatojë dhe vlerësojë atë;
- Të përshtatë dhe të prodhojë materiale mësimore;
- Të përdorë mjete mësimore të përshtatshme për nevojat e nxënësve;
- Të përdorë mjete ndihmëse të nevojshme;
- Të hartojë teste për vlerësime individuale;
- Të planifikojë fleksibilitet në orët mësimore;
- Të planifikojë forma të ndryshme të punës, e posaçërisht formën individuale;

---

<sup>134</sup>Bardhyl Musai : “Psikologji edukimi”, Pegi, Tiranë, 1999, f. 51.



- Të njohë teknologjinë informative dhe ta përdorë atë për qasje individuale;
- Të krijojë klimë miqësore në klasë, t'i mobilizojë nxënësit e tjerë për ndihmë dhe përkrahje të nxënësve me nevoja të veçanta;
- Ta përfshijë nxënësin me nevoja të veçanta në të gjitha aktivitetet në klasë dhe aktivitete të lira;
- Të vendosë (akomodojë) nxënësin në klasë në vend të përshtatshëm;
- Të bashkëpunojë me prindër;
- Të bashkëpunojë me shërbimin profesional të shkollës, shërbimin për rehabilitim, udhëheqjen e shkollës dhe kolegët;
- Të bashkëpunojë me ekipin për vlerësim profesional, qendrat burimore-dhomat e burimeve, OJQ-të dhe ekspertë të tjerë adekuatë etj.

Mësimdhënësit duhet të përgatiten dhe të aftësohen mbi bazën e këtyre kriterëve në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të kohës dhe të jenë kompetentë për arsim gjithëpërfshirës.

“Ne mund të diskutojmë për përfshirjen në shumë nivele, si: nivelin konceptual, nivelin e politikave, nivelin normativ apo kërkimor, por në fund është mësuesi i klasës ai që ka për t'u përballur me një shumëllojshmëri të nxënësve në klasë. Mësuesi është ai që i zbaton parimet e arsimit përfshirës”<sup>135</sup>.

### **3.1.5. Roli i prindërve në sistemin e mbështetjes**

Të drejtat dhe obligimet e prindërve janë të rregulluara me ligj dhe kërkohet nga prindërit që të kujdesen për fëmijën e tyre. Në Kosovë, prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara janë mbështetësit kryesorë të tyre, gjatë tërë jetës dhe shpeshherë në popull thuhet se “fëmija me aftësi të kufizuara është barrë vetëm për familjen”, pasi që nuk funksionon ndonjë përkujdesje e organizuar institucionale.

---

<sup>135</sup> <http://www.european-agency.org/publications/ereports/key-principles-for-promoting-quality-in-inclusive-education>, shkarkuar në shtator, 2012.

Prindërit ose kujdestarët e fëmijës janë njohësit më të mire të fëmijës, andaj bashkëpunimi me prindër është çelës për punë të suksesshme të institucioneve arsimore. Prindërit duhet nxitur për bashkëpunim me profesionistët në shkollë për të krijuar mundësinë që nxënësi të marrë mbështetjen e duhur dhe të arrijë në nxënie. Por, duhet pasur kujdes për një bashkëpunim efikas, pasi që prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta janë të “lënduar”, shpeshherë ndihen “fajtorë” apo të “turpëruar” për gjendjen e fëmijëve të tyre. Nevojat e prindërve janë të ndryshme dhe duhet marrë parasysh dallimet socio-kulturore, të rrethit, të njohurive, të arsimimit, të aftësive për komunikim dhe interesave të ndryshme.

Partneriteti mes prindërve dhe shkollës kërkon respektim, mikpritje dhe gatishmëri për të marrë informata nga njëri-tjetri.

Komunikimi me prindër kërkon përgatitje dhe strategji, të cilave duhet përmbajtur:

- Gjatë bashkëbisedimit me prindër, për njohjen e gjendjes së fëmijës sugjerohet që mësimdhënësi fillimisht duhet të kërkojë informata pozitive, sepse në të kundërtën prindi mund të revoltohet;
- Prindi ka nevojë të dëgjojë edhe lëvdata për fëmijën e tij, andaj mësimdhënësi nuk duhet të hezitojë të përshkruajë ndonjë sjellje të mirë të fëmijës - në të kundërtën, nëse prindi dëgjon vetëm vërejtje dhe pakënaqësi, do të hezitojë të bashkëpunojë me shkollën;
- Nxitni prindin të flasë, që të merrni informata se çka thotë fëmija për shkollën, në mënyrë që të kuptoni vlerësimin e tij dhe ju të vazhdoni apo korrigjoheni;
- Prindin duhet dëgjuar me kujdes dhe duhet marrë ndonjë shënim, që ai të ndihet i rëndësishëm;
- Brengat për fëmijën shprehni në mënyrë graduale dhe kërkon mendimin e tij për të gjetur zgjidhjen së bashku;

- Ndani përgjegjësitë dhe obligimet e mësimdhënësit dhe prindit, tregoni se prindi është shumë i rëndësishëm për ju;

Prindërit dhe mësimdhënësit duhet të punojnë si një ekip, të hartojnë së bashku planin individual arsimor dhe ta mbështesin mësuesin për ta zbatuar atë duke e përkrahur fëmijën në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Format e bashkëpunimit të shkollës me prindër janë të shumta dhe të llojllojshme, si:

- Vizitat në shkolla;
- Takimet formale dhe joformale;
- Vizitat në shtëpi;
- Këmbimi i informatave gjatë sjelljes dhe marrjes së fëmijës në shkollë;
- Bisedat telefonike;
- Mbledhjet e prindërve;
- Këmbimi i shënimeve;
- Tabelat e shpalljeve;
- Kutitë për vërejtje dhe sugjerime;
- Angazhimi i prindërve në shkollë.

Format e bashkëpunimit me prindër duhet të jenë të rregullta, të ketë respekt reciprok, informatat të jenë të besueshme dhe konfidenciale.

Se roli i prindit është i pazëvendësueshëm në mbështetjen e fëmijëve tregojnë edhe politikat vendore, të cilat e fuqizojnë prindin duke e kyçur në strukturat vendimmarrëse të institucioneve arsimore. Nga bashkëpunimi i prindit me shkollën “pritet të realizohet qëllimi fundamental i edukatës – zhvillimi i tërësishëm i personalitetit, zhvillimi dhe edukimi i potencialit gjenetik dhe shfaqja maksimale e tij”<sup>136</sup>. Prindi është ai që e ndien në shpirt se çka i mungon fëmijës së tij.

Disa prindër të nxënësve të përfshirë në shkolla të rregullta i kanë vlerësuar nevojat e fëmijëve të tyre për mbështetje dhe kanë angazhuar

---

<sup>136</sup> Prof.dr.Afërdita Deva –Zuna&bashkautorët:Partneriteti shkollë-familje-komunitet, Prishtinë:Shtëpia Botuese ‘Libri Shkollor’, 2009, f. 56.

me vetëfinancim asistentë në klasa (në pamundësi të mbështetjes institucionale), të cilët gjatë tërë procesit të mësimit përkrahin dhe ndihmojnë nxënësit dhe mësimdhënësit në realizimin e PIA-s.

### **3.2. Roli i OJQ-ve në sistemin e mbështetjes**

Roli i organizatave joqeveritare është i rëndësishëm në shtytjen e proceseve reformuese. Edhe në vendin tonë, funksionimi i tyre ka ndikuar në mbështetjen e zhvillimit të shumë proceseve të rëndësishme shoqërore, ndër to edhe në fushën e arsimit. Është i pamohueshëm roli i UNICEF-it, UNHCR-së, FSDEK-ut, ‘SAVE the Children’, ‘Educ-Aid’, ‘Down Syndrom Kosova’ etj. në mbështetjen e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. MASHT-i, DKA-të, institucionet arsimore, kanë qenë përfituese nga projektet e shumta të realizuara në bashkëpunim me këto organizata. OJQ-të kanë qenë mbështetëse të fëmijëve me nevoja të veçanta në shumë fusha: që nga organizimi i kampanjave vetëdijesuese, zhvillimi i politikave, mobilizimi i institucioneve relevante, e deri te trajnimet e personelit të institucioneve arsimore dhe mbështetja direkte e fëmijëve me mjete mësimore dhe mjete ndihmëse. Andaj, mbështetja e mëtejme e OJQ-ve është një mundësi për realizimin e politikave të parapara për mbështetje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

### **4. Përfundime dhe rekomandime**

Politikat e MASHT-it janë të orientuara nga parimi i gjithëpërfshirjes, i cili siguron se të gjithë fëmijët, pa dallim nga gjinia, rasa, aftësia, gjendja emocionale, sociale apo ndonjë rrethanë tjetër, kanë të drejtë për qasje të barabartë në arsim cilësor.

Shumë shtete në botë e zbatojnë këtë parim, por sistemi i mbështetjes, nga i cili kushtëzohet gjithëpërfshirja, mbetet sfidë për të gjithë. Ofrimi i shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta varet nga politikat e brendshme dhe zhvillimi ekonomik i tyre.

- Shumë vende në sistemin e mbështetjes e kanë praktikuar transformimin e shkollave dhe klasave speciale në qendra burimore, të cilat konsiderohen si resurse për shkollat gjithëpërfshirëse.

- Përveç hartimit të politikave, MASHT-i (Sektori për Arsim Special) menaxhon arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Modeli i transformimit të shkollave speciale në qendra burimore, ka filluar të zbatohet edhe në Kosovë. Janë punësuar mësimdhënës udhëtues, të cilët i mbështesin nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta. Në dy shkolla janë punësuar mësimdhënës gjithëpërfshirës, të cilët i mbështesin nxënësit me nevoja të veçanta brenda shkollave.

- MASHT-i nuk i ka bartur kompetencat te komunat për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, përveç transportit në shkolla. Edhe pse është miratuar Udhëzimi administrativ, komunat nuk i kanë themeluar ekipet për vlerësime profesionale, që është mangësi shumë e madhe për përcaktimin e shërbimeve të mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

- Shumica e shkollave në Kosovë nuk janë të gatshme për gjithëpërfshirje. Ato nuk i pranojnë të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta të zonës që mbulojnë, në të kundërtën numri i fëmijëve të përfshirë në sistemin arsimor do të rritej. Edhe udhëheqësit e shkollave kanë nevojë për vetëdijesim, zbatim të ligjit dhe trajnime profesionale. Shkollave iu mungojnë ekipet për shërbime profesionale dhe shërbime ndihmëse, por edhe bashkëpunimi me ekspertë të fushave specifike nga jashtë.

- Shumë mësimdhënës në Kosovë vazhdojnë mësimdhënien tradicionale dhe nuk janë të përgatitur për gjithëpërfshirje, e sidomos për grupin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mësimdhënia me fëmijët në qendër është metodologji e kohës dhe mundësi për gjithëpërfshirje. Për të arritur gjithëpërfshirjen, mësimdhënësit duhet reformuar.

- Prindërit duhet të vetëdijesohen dhe të kuptojnë të drejtat për fëmijën me aftësi të kufizuara se duhet të jenë të barabartë, sikurse edhe fëmijët e tjerë, dhe kanë të drejtë ta regjistrojnë fëmijën në shkollën më të afër

nga vendbanimi. Prindërit duhet të jenë bashkëpunëtorë të shkollës. Ata kanë të drejtë të jenë pjesë e menaxhimit të saj. Duhet pasur kujdes kontakteve me prindër për krijimin raporteve pozitive, të cilat ndikojnë në arritjen e cilësisë. Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore duhet të jenë pjesë e ekipit për hartimin dhe vlerësimin e PIA-s për fëmijët e tyre.

- Roli i OJQ-së është i pamohueshëm në zhvillimin e proceseve arsimore. Kontributi i tyre është i rëndësishëm për zhvillime të mëtejme, sidomos në sistemin e mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, kur dihet se ofrimi i shërbimeve të nevojshme varet kryesisht nga mundësitë për investime financiare.

Sistemi i mbështetjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është i paraparë në politikat e vendit me shumë saktësi, por zbatimi në praktikë është shumë i mangët dhe mund të themi se nuk zbatohet një sistem funksional i mbështetjes. Prandaj, rekomandoj që:

- Para vendimit për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim të rregullt, të vlerësohen nevojat për mbështetje dhe të sigurohen shërbimet e nevojshme;

- MASHT-i të krijojë mekanizma për monitorimin e zbatimit të ligjit për procesin e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore; Sigurimi i shërbimeve për mbështetje të nevojshme të nxënësve është standard që duhet plotësuar – për të realizuar të drejtat e barabarta në sistemin arsimor gjithëpërfshirës.

## **Referencat:**

1. Adukovic, Dean: Forcimi i fëmijëve, Timegate-Prishtinë, 2001
2. Dokumentet dhe politikat mbi aftësinë e kufizuar dhe gjithëpërfshirjen në arsim: MASHT, FSDEK, UNICEF, HANDIKOS, Prishtinë, 2008.

3. Grup autorësh: Zhvillimi i Arsimit Gjithëpërfshirës në Kosovë, Përkrahja finlandeze për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë, Prishtinë, 2008.
4. Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Prishtinë, (përkthim), 2008.
5. Kërkime Pedagogjike, Përmbledhje punimesh, nr. 2, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë, 2011.
6. Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, MASHT, Prishtinë, gusht 2011.
7. Ligji për Arsimin Parauniversitar, MASHT, Prishtinë, 2011.
8. Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë: Zyra e Kryeministrit dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, Prishtinë, 2008.
9. Musai, Dr. Bardhyl: Psikologji edukimi, Pegi-Tiranë, 1999.
10. Musai, Dr. Bardhyl: Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies, “Eurolindja”, Tiranë, 1996.
11. Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2001-2016 (PSAK): MASHT, Prishtinë, 2010.
12. Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010-2015: MASHT, Prishtinë, 2010.
13. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017. MASHT, Prishtinë, 2007.
14. Shënime dhe materiale të ndryshme nga vizitat studimore, trajnimet, seminarët, konferencat dhe interneti.
15. Zuna - Deva, Prof. dr. Afërdita & bashkautorët: Partneriteti shkollë – familje - komunitet, Prishtinë: Shtëpia Botuese ‘Libri Shkollor’, 2009.

### **Faqe të internetit**

1. <http://www.masht-gov.net>
2. <http://www.european-agency.org>
3. <http://pedagogjia.wordpress.com>

4. <http-www.izha.edu.al-materiale> - Revista\_Pedagogjike\_2011.pdf.url
5. <http://pedagogjia.wordpress.com/>
6. [http://www.iccog.co.me-ispitni-images-Nacionalni\\_ispiti-2010-2011](http://www.iccog.co.me-ispitni-images-Nacionalni_ispiti-2010-2011)
7. <http://www.downsyndromekosova>
8. <http://www.inclusive-education-in-action.org>
9. [http://en.wikipedia.org/wiki/Special\\_educatio](http://en.wikipedia.org/wiki/Special_educatio)
10. <http://www.benchmarkeducation.com/old/supporting>



## ORGANET E SHKOLLËS DHE FUNKSIONIMI I TYRE

### 1. Hyrje

S'ka dyshim se një rol të madh dhe shumë të rëndësishmin në funksionimin normal të shkollave e kanë edhe organet e brendshme të shkollave, organet qeverisëse dhe ato profesionale, siç janë drejtori, zëvendësdrejtori, Këshilli drejtues i shkollës, Këshilli i prindërve, Këshilli i nxënësve, Këshilli i arsimtarëve, si dhe Këshilli i klasave dhe aktivet profesionale. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm për rolin e padiskutueshëm të tyre, institucionet përkatëse të arsimit të Republikës së Kosovës e kanë rregulluar edhe me ligj funksionimin dhe fushëveprimtarinë e tyre nëpër shkolla. Funksionimi i tyre rregullohet me Ligjin për arsimin parauniversitar të Kosovës, nr. 04/L-032.

Nëse i referohemi Ligjit për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës, ekzistimi i këtyre organeve udhëheqëse dhe themelimi i tyre ka për qëllim lehtësimin e funksionimit sa më efikas të punëve në shkolla, në mënyrë që qeverisja e institucioneve shkollore të realizohet sa më profesionalisht dhe në përputhje me kërkesat bashkëkohore të arsimit kombëtar. Edhe pse drejtori i çdo institucioni është bartës dhe udhëheqës i të gjitha aktiviteteve në shkollë, duhet t'i koordinojë aktivitetet e shkollës së bashku me organet e tjera, në mënyrë që të dëgjohen dhe të plotësohen edhe kërkesat e niveleve të tjera, siç janë mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit, si subjekte aktive dhe të domosdoshme në aktivitetin e shkollës.

Të trajtosh funksionimin e organeve të një institucioni nuk është e lehtë, ngase qasja ndaj punës së tyre duhet të jetë shumëdimensionale dhe, pa dyshim, me takt profesional. Dhe, jo vetëm kaq, sepse fryma profesionale është aq e papërkufizuar, sa gjithherë mund të gjesh arsye për të kontestuar apo për të konfirmuar një performancë menaxhuese të

këtyre organeve. Kështu që, edhe në këtë shkrim nuk mëtoj se kam arritur t'i paraqes të gjitha anët e funksionimit, me të arriturat dhe të metat e tyre, por kam bërë përpjekje t'i trajtoj së paku teorikisht obligimet ligjore të funksionimit normal dhe me ndjeshmëri profesionale, shoqërore dhe me atraktivitetin e nevojshëm, si garanci për një udhëheqje efektive të çdo institucioni, e në rastin tonë të atyre shkollore.

Prandaj, shihet e nevojshme që disa detyra të delegohen te organet e tjera në shkollë, të cilat në asnjë mënyrë nuk e zhveshin drejtorin nga përgjegjësitë, por vetëm ia lehtësojnë komunikimin dhe mundësojnë efikasitet më të mirë të punëve në shkollë. Edhe puna e zëvendësdrejtorit e ka rëndësinë dhe peshën e madhe në mbarëvajtjen e punëve në shkollë, sidomos kur për arsye objektive mungesa e drejtorit është e theksuar.

Nga ana tjetër, nuk duhet lejuar që i tërë angazhimi i udhëheqjes së një shkolle të koncentrohet vetëm në realizimin e orëve mësimore, duke i improvizuar aktivitetet e tjera të organeve në shkollë, ngase pa një qasje të përbashkët të të gjithëve, pa një angazhim të njerëzve autoritativë dhe profesionalisht të përgatitur nga komuniteti më i gjerë, nuk mund të garantohen rezultate të kënaqshme në cilësinë e mësimin si dhe performancë menaxhuese të suksesshme dhe efektive.

Organet e tjera të shkollës vetëm sa e fuqizojnë dhe e bëjnë udhëheqjen e shkollës më efikase dhe më funksionale. Edhe nga kontaktet me udhëheqës të shumë shkollave del në pah pajtimi se pjesëmarrja aktive e të gjitha palëve në vendimmarrje në nivel të shkollës çon te një kualitet i ri në funksionimin e shkollës. Në këtë kontekst, funksionimi i këshillave të shkollave vetëm sa e ndihmon operacionalizimin e kapaciteteve udhëheqëse, duke mundësuar që detyrat të kryhen në mënyrë sa më efikase, duke i motivuar ata për angazhim rreth punëve në shkollë, duke i inkurajuar për iniciativa të ndryshme rreth avancimit të performancës së përgjithshme të shkollës, si dhe duke e krijuar një traditë të punës ekipore dhe të përbashkët në funksion të një menaxhimi sa më efektiv dhe bashkëkohor të një institucioni arsimor. Normalisht

se këto angazhime të organeve të shkollës janë të përcaktuara me ligj dhe nuk duhet të ketë ngatërrim apo përvetësim kompetencash, duke i dhënë drejtorit rolin mbikëqyrës në të gjitha hallkat e udhëheqjes në shkollë.

Që këtej, edhe pse mund të konkludojmë se përgjithësisht gjendja në udhëheqjen e shkollave tona është e kënaqshme, sado që vërehet qartë se me një udhëheqje më atraktive, më të angazhuar dhe më efikase mund të kishte rezultate më të mira, sidomos në disa shkolla, duke u vërejtur se është lënë anash roli i komunitetit të prindërve në përmirësimin e ambientit të jashtëm të shkollave, si një pasqyrë shumë domethënëse për kulturën tonë të përgjithshme mjedisore. Në këtë kontekst, edhe aktivizimi më gjithëpërfshirës i këtyre organeve udhëheqëse dhe profesionale nëpër shkolla do të kishte efekte të dukshme në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të punëve në shkolla, si një kërkesë e domosdoshme për një avancim të cilësisë së arsimit tonë në të gjitha nivelet.

## **2. Qëllimet**

- Qëllimet e kësaj analize janë:
- Të analizojë funksionimin e organeve të shkollës;
- Të shohë rolin fuqizues të kapaciteteve menaxhuese të anëtarëve të këtyre organeve;
- Të përcaktojë saktë rolin udhëheqës dhe përgjegjësitet e përcaktuara me ligj të këtyre organeve;
- Të promovojë rëndësinë e organeve të shkollave në sistemin arsimor në vend, si dhe
- Të nxjerrë në pah rolin praktik të tyre në mbarëvajtjen e punëve të përgjithshme në shkolla.

## **3. Organet e shkollës**

Sipas Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, çdo institucion shkollor është i obliguar t'i ketë organet e parapara, të cilat ndihmojnë në planifikimin e veprimtarisë shkollore dhe mbështesin

arritjet e pikësnyimeve të përgjithshme të institucionit përkatës. Me këtë është paraparë t'u jepet mundësia të gjitha strukturave, si mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe kategorive të tjera që të kenë një rol më aktiv në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe mbarëvajtjes së përgjithshme të punëve në shkolla. Duke e parë anën funksionale të ekzistimit të këtyre organeve në ofrimin e mbështetjes së gjithanshme për edukimin dhe arsimimin sa më të mirë të nxënësve, çka nënkuptohet se interesi i nxënësve duhet të jetë gjithmonë në plan të parë, roli i tyre, ndër të tjera, mund të fokusohet në këto veprimtari:

- Të realizohet një udhëheqje profesionale, efikase, korrekte dhe e koordinuar, si garanci për performancë të mirë të punëve në institucion;
- Të ofrohet konsulencë e gjithanshme në mes të drejtorit dhe organeve të tjera të shkollës, si në aspektin organizativ, ashtu edhe në atë profesional;
- Të mobilizohen dhe të inkurajohen të gjitha strukturat e mundshme të rrethit në përfshirjen e dhënies së kontributit të tyre për mbarëvajtjen e punëve në shkollë;
- Të ndërtohen marrëdhënie efektive në mes të shkollës, prindërve dhe nxënësve;
- T'u mundësojnë prindërve dhe të gjitha strukturave që t'i shprehin pikëpamjet e tyre për edukimin publik.

Pra, organet e shkollës kanë rol shumë domethënës në mbarëvajtjen e përgjithshme të punëve në shkolla, të cilët gjithmonë në koordinim dhe me bashkërendim të ndërsjellë ndihmojnë në planifikimin e aktiviteteve të gjithanshme në shkolla dhe të aktiviteteve jashtëshkollore, në përpilimin e kalendarit të aktiviteteve shkollore, mënyrat e pranueshme të sjelljes në ambientet shkollore, gjithmonë në përputhje me standardet bashkëkohore, ashtu si edhe politikat konfliktzgjidhëse, vendosjen e prioriteteve në programin e shkollës, mënyrat për vendosjen e një komunikimi sa më efektiv shkollë-prind-nxënës, kriterin kryesor

përzgjedhës, deri te përdorimi i ambienteve të shkollës nga komunitetet apo edhe në ndikimin e tyre në profilin e shkollës.

#### **4. Këshilli Drejtues i shkollës**

Këshilli drejtues i shkollës përbëhet nga:

- Tre përfaqësues të prindërve, duke përfshirë së paku një përfaqësues të komunitetit pakicë në komunë, nëse ka ndonjë nxënës nga komunitet në atë shkollë;
- Dy përfaqësues nga shoqëria , të cilët i cakton Komuna dhe mund të jenë me interes për shkollën;
- Tre përfaqësues të mësimdhënësve.

Sipas ligjit të ri të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës – Ligji nr. 04/L-032, roli i Këshillit drejtues të shkollës është si vijon:  
Neni 17

11. Këshilli drejtues i shkollës në nivelet 1, 2 dhe 3 të ISCED-së ka detyrat dhe kompetencat si vijon:

11.1. Të hartojë rregullat e shkollës të specifikuara në nenin 22 të këtij ligji, për t’u miratuar nga Komuna;

11.2. Të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve nga anëtarët e Këshillit drejtues, që të marrin pjesë në cilësinë e vëzhguesve në emërimin e drejtorit, zëvendës drejtorit dhe mësimdhënësve të shkollës;

11.3. Të ushtrojë funksionet e ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës, siç është përcaktuar në këtë ligj;

11.4. Të vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë;

11.5. Të miratojë aktivitetet jashtë kurrikulare të shkollës, sipas propozimit të drejtorit të Shkollës<sup>137</sup>.

---

<sup>137</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, f 1

#### **4.1. Struktura dhe funksionimi i Këshillit drejtues të shkollës**

“Ligji për arsim fillor dhe të mesëm parasheh konstituimin e obligueshëm të Këshillit të shkollës, përbërja e të cilit do të përfshinte tre përfaqësues të zgjedhur të prindërve, pesë përfaqësues të mësimdhënësve, në shkollat e mesme edhe një përfaqësues i nxënësve, kurse drejtori i shkollës është anëtar i këshillit, por pa të drejtë vote”<sup>138</sup>. Këshilli mund të emërojë edhe anëtarë të tjerë pa të drejtë vote, me qëllim të përfaqësimit sa më të mirë të të gjitha komuniteteve dhe palëve me interes që përfshihen në punën e shkollës. Gjithmonë struktura e këtij këshilli duhet të reflektojë edhe madhësinë e institucionit, që nënkupton numrin e nxënësve dhe të mësimdhënësve. Përveç të tjerash, Këshilli Drejtues i shkollës ka të drejtë të shqyrtojë raportet e menaxhmentit dhe të diskutojë të gjitha çështjet që i vlerëson me interes për shkollën, por gjithmonë duke e pasur parasysh rolin udhëheqës të drejtorit dhe në bashkëpunim me të, pa ngatërruar në asnjë rast kompetencat.

##### **4.1.1. Misioni dhe detyrat e Këshillit drejtues të shkollës**

Duke e parë të nevojshme specifikimin e mëtejme dhe deri në detaje të punës së organeve të një institucioni shkollor, atëherë edhe Këshillit drejtues të shkollës i janë përcaktuar detyra të caktuara, që gjithsesi janë në funksion të realizimit të qëllimeve të politikave organizuese në një institucion të caktuar, në këtë rast shkollor. Kështu që detyrat e Këshillit drejtues të shkollës, gjithsesi i koordinuar me drejtorin e shkollës, janë:

- të miratojë planin afatmesëm të shkollës;
- të miratojë planin vjetor të shkollës;
- të shqyrtojë dhe ta aprovojë buxhetin e shkollës (kontributet e komunitetit ose të donatorëve, të ardhurat nga veprimtaritë e shkollës etj.);

---

<sup>138</sup>. Pupovci D., Tafarshiku N.: “Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë”, Prishtinë, 2008, f. 9

- të miratojë raportin vjetor të shkollës dhe raportin e saj financiar;
- të hartojë rregulloren e brendshme të shkollës;
- të përpiqet të sigurojë kontribute nga komunitetet, si nga bizneset dhe burime të tjera në të mirë të mbarëvajtjes së punëve në shkollë;
- të miratojë projekte bashkëpunimi me institucione të tjera, si dhe
- të miratojë veprimtaritë e shkollës për komunitetin, pas procesit mësimor.

Krejt këto obligime të Këshillit drejtues të shkollës kanë për qëllim sigurimin e pjesëmarrjes të sa më shumë subjekteve, sidomos përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës dhe në mbikëqyrjen e punës së saj.

Përveç kësaj, kur e sheh të nevojshme Këshilli mund të konsultohet edhe për çështjet e mëposhtme:

- për zhvillimin fizik të shkollës;
- për çështjen e programit shtesë mësimor;
- ndaj reagimeve të organeve komunale për çfarëdo dokumenti politik;
- të konsultohet rreth planifikimeve që lidhet me arsimin brenda territorit të komunës;
- për shënimin e ditës së shkollës, siç është data dhe mënyra e manifestimit;
- për shprehjen e pikëpamjeve të veta për çdo çështje lidhur me shkollën ose me arsimin e përgjithshëm në komunë.

Natyrisht se të merresh me të gjitha këtë angazhime nuk është e lehtë dhe kërkon mobilizim të të gjitha subjekteve, gjithsesi me drejtorin në krye, në mënyrë që për çdo çështje të diskutohet në hollësi dhe me vizion të qartë, pasi paraprakisht të jenë analizuar të gjitha rrethanat objektive që kushtëzojnë ose favorizojnë një parakusht, me qëllimin që në punën e këtyre organeve të mos ketë improvizime dhe vetëm planifikime të porealizuara.

“Nga anëtarët e Këshillit të shkollës pritet që të respektojnë të gjitha

normat juridike dhe ligjet. Shkolla është e obliguar të njoftojë dhe t'u mundësojë qasje ndaj të gjitha normave juridike me të cilat rregullohen obligimet”<sup>139</sup>.

## **4.2. Drejtori i shkollës**

Çdo institucion arsimor, ashtu si edhe i çdo karakteri tjetër, është i obliguar me ligj që të ketë organet udhëheqëse, në krye të të cilave qëndron drejtori. Ai është person që përfaqëson institucionin në raport me organet e tjera më të larta shtetërore kompetente, ndaj të cilave mban përgjegjësi dhe jep llogaridhënie. Pra, drejtori merr instruksionet nga organet kompetente dhe i përcjell në institucionin që e udhëheq, duke qenë koordinator i dyanshëm: në mes të institucioneve kompetente shtetërore dhe kolektivit të institucionit përkatës, në krye të të cilit qëndron. Pra, në mënyrë përmbledhëse mund të konstatojmë se drejtori organizon, planifikon dhe udhëheq në tërësi punën e shkollës, në të gjitha segmentet e saj. Roli i tij në këtë kontekst është i pazëvendësueshëm, por kjo nënkupton se edhe zgjedhja e tij duhet t'i nënshtrohet një filtri të rreptë profesional, shoqëror dhe etik.

Nga sa u tha dhe ashtu siç mund të dalë nga obligimet e përcaktuara me ligj, drejtori kryen këto detyra dhe obligime ndaj institucionit:

- përfaqëson shkollën dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së saj;
- i udhëheq dhe i koordinon të gjitha aktivitetet në shkollë;
- përgatit propozimin e planit vjetor të punës dhe është përgjegjës për jetësimin e tij;
- udhëheq punën e Këshillit pedagogjik;
- përgatit mbledhjet e Këshillit drejtues;
- i raporton Këshillit drejtues për punën e shkollës;
- mbikëqyr dhe këshillon personelin e shkollës;

---

<sup>139</sup>. Divna Shipoviq , Gule Gulev, George Mikollov etj, “Doracak për këshillat e shkollave fillore dhe të mesme”, raport nga interneti , Shkup, 2008, f.14



- kujdeset për bashkëpunimin e institucionit me prindërit (mbledhjet e prindërve, orët për biseda dhe format e tjera të bashkëpunimit);
- njofton prindërit për punën e shkollës, si dhe për ndryshimin e të drejtave dhe të obligimeve të nxënësve;
- vendos për masat edukative;
- është përgjegjës për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave dhe detyrimeve të nxënësve;
- përcakton sistematizimin e vendeve të punës;
- vendos për krijimin e marrëdhënies së punës dhe për përgjegjësinë
- disiplinore të punëtorëve;
- kujdeset për bashkëpunimin e shkollës me shërbimin shëndetësor të saj;
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin dhe në bazë të autorizimeve të Këshillit drejtues.

### **4.3. Zëvendësdrejtori (ndihmësdrejtori)**

Personi numër dy në një institucion shkollor është zëvendësdrejtori (ndihmësdrejtori), detyrat dhe kompetencat e të cilit lidhen me punët e brendshme në shkollë. Varësisht prej numrit të nxënësve, e rrjedhimisht edhe të mësimdhënësve, një institucion arsimor mund t'i ketë edhe dy ndihmësdrejtorë, por në praktikën tonë, në shkollat që i kemi vizituar, zakonisht postin e zëvendësdrejtorit e mban një person.

Edhe zëvendësdrejtori duhet të jetë person me aftësi të dallueshme organizative, si dhe të posedojë vlera të përgjithshme profesionale e morale, të pakontestueshme nga stafi i shkollës apo edhe nga komuniteti përkatës.

Të gjitha detyrat që i referohen drejtorit, me përjashtim të kompetencave të veçanta, i përkasin edhe zëvendësdrejtorit, puna e të cilit është të ndihmojë atë në menaxhimin e punëve në shkollë, sidomos

ato që kanë të bëjnë me procesin mësimor, me çështje organizative të brendshme dhe me kontrollin e realizimit të objektivave shkollorë.

#### **4.4. Organet profesionale të shkollës**

Përveç organeve qeverisëse, në shkolla funksionojnë edhe organet profesionale, të organizuara nëpërmjet këshillave, të quajtur Këshilli i arsimtarëve, Këshilli i klasave dhe aktivet profesionale.

##### **4.4.1. Këshilli i arsimtarëve**

Këshillin e arsimtarëve e përbëjnë arsimtarët, bashkëpunëtorët profesionalë dhe bashkëpunëtorët në mësim. Mirëpo, në praktikën tonë shkollore, për aq sa kemi vërejtur në këtë analizë, zakonisht janë vetëm mësimdhënësit ata që e funksionalizojnë këtë këshill, të cilët janë mjaft aktivë gjatë tërë vitit shkollor.

Këshilli i arsimtarëve kryen këto detyra:

- aprovon programin vjetor të punës së shkollës;
- miraton objektivat e përgjithshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies në nivel të shkollës;
- shqyrton realizimin e planit dhe programit mësimor;
- verifikon suksesin e përgjithshëm të nxënësve;
- vendos për kundërshtimet e nxënësve lidhur me cilësitë nga lëndët e caktuara mësimore;
- miraton programet e punës të aktiveve profesionale;
- propozon masa disiplinore ndaj nxënësve;
- propozon avancimin e nxënësve të dalluar;
- propozon lëvdata dhe shpërblime për arsimtarë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe në mësim;
- propozon komisionet për provime të nxënësve dhe cakton afatin, formën dhe mënyrën e dhënies së provimeve;
- organizon bashkëpunimin me shkolla të tjera dhe institucionet përkatëse për çështje mësimore;
- ndihmon në aktivitete të lira të nxënësve dhe arsimtarëve;

- propozon masa për aftësimin e arsimtarëve, bashkëpunëtorëve në mësim dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë;
- inicion apo ndihmon në kryerjen edhe të punëve të tjera me interes të shkollës.

Këshillin e arsimtarëve udhëheq drejtori i shkollës, ose, në mungesë të tij, zëvendësdrejtori.

Pa dyshim se funksionimi korrekt, efikas dhe me objektivitet i këtij këshilli krijon klimë të favorshme për punë cilësore në procesin mësimor dhe për ambient të përshtatshëm dhe kushte të favorshme për aktivitetet e tjera përcjellëse në objektin shkollor, që janë në funksion të rritjes së aktiviteteve të nxënësve në shkollë e, në fund të fundit, që e shtojnë performancën e përgjithshme të shkollës si institucion me rëndësi të veçantë shoqërore.

#### **4.4.2 Këshillat e klasave**

Këshillin e klasave e përbëjnë mësimezhënësit, të cilët zhvillojnë mësimin në klasat përkatëse të çdo niveli. Në këto periudha kohore ky këshill debaton sukseset dhe cilësinë e realizimit të planprogramit shkollor të paraparë me ligj.

Këshilli i klasave kryen këto punë:

kujdeset për realizimin cilësor dhe sasior të planit dhe programit mësimor për çdo paralele;

kujdeset për vlerësimin e rregullt dhe objektiv të nxënësve për çdo lëndë mësimore;

vërteton suksesin individual të nxënësve për çdo lëndë dhe suksesin e përgjithshëm në paralele, por nuk ka të drejtë të përmirësojë suksesin individual dhe të paraleles;

shqyrton vijimin e rregullt të nxënësve në mësim;

propozon lëvdata, shpërblime, por edhe masa disiplinore për nxënësit;

organizon bashkëpunimin me prindër;

ndihmon punën e komunitetit të nxënësve dhe të aktiviteteve të lira të nxënësve;

kryen edhe punë të tjera me interes të paraleles dhe të shkollës. Këshillin e klasave e udhëheq kryetari i këshillit, i cili emërohet nga Këshilli i klasave me shumicë votash.

#### **4.4.3. Aktivitetet profesionale**

Aktiviteti profesional kryen këto punë dhe detyra:

- zhvillon objektivat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies për lëndët në përputhje me objektivat e shkollës
- kujdeset për realizimin cilësor dhe sasior të objektivave të planit dhe programit mësimor për lëndët përkatëse mësimore
- kujdeset për zbatimin e metodologjive të reja në procesin mësimor për fushat e caktuara lëndore
- propozon pajisjen e shkollës me mjete mësimore
- organizon aktivitetet e nxënësve nga lënda apo fusha e caktuar edukativo-arsimore
- harton programin e punës së aktivitetit profesional
- kryen edhe punë të tjera me interes të aktivitetit profesional.

Kryetari i aktivitetit të çdo klase apo të çdo lënde mësimore emërohet për çdo vit shkollor nga numri i mësimdhënësve përkatës, por zakonisht emërohet mësimdhënësi më me përvojë.

#### **4.5. Këshilli i prindërve**

Në bazë të kësaj analize është dëshmuar se angazhimi i prindërve nga organet drejtuese të shkollës në përcjelljen dhe mirëvajtjen e punëve në shkollë i kontribuojnë cilësisë dhe efikasitetit të punëve në shkollë për një ambient pune efikas dhe komod.

##### **4.5.1. Misioni i dhe detyrat e Këshillit të prindërve**

Të gjitha dokumentet relevante: Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Strategjia e Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 2007-2017, Korniza e Kurrikulit të Kosovës, doracakët për Këshillin Drejtues të Shkollës, etj., saktësojnë qartë obligimet e këtij këshilli,

duke konkluduar se ky këshill ka një misionin të përcaktuar qartë, e që mund të përmblihet në këto pika:

- Të iniciojë diskutimin për të gjitha çështjet me interes për punën në shkollë;
- Të debatojë dhe të kërkojë ngritjen e cilësisë së procesit mësimor në shkollë;
- Të inkurajojë ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese dhe proceseve demokratike si dhe
- Të kontribuojë në zgjidhjen proaktive të problemeve të ndryshme në shkollë.

Detyrat e Këshillit të prindërve janë:

Neni 19

1. Çdo institucion arsimor apo aftësues duhet të ketë Këshill të prindërve.
2. Kompetencat dhe fushëveprimtaria e Këshillit të prindërve përcaktohen nëpërmes aktit të veçantë nënligjor;
3. Këshilli i prindërve zgjidhet me vota të fshehta të të gjithë prindërve të nxënësve që vijnë në mësimin në atë institucion;
4. Prindërit, përveç përfaqësimit në Këshillin e prindërve, kanë të drejtë t'i paraqesin ankesat e tyre drejtorit të institucionit arsimor dhe aftësues, Komunës dhe Ministrisë lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe mjedisin shkollor<sup>140</sup>.

S'do mend se këto formulime duhet të specifikohen në mënyrë që këshilli të marrë iniciativë për çështje konkrete dhe pastaj ta ndjekë atë deri në zgjidhjen përfundimtare të saj, për aq sa lejojnë kompetencat dhe mundësitë objektive. Natyrisht se detyrë e këtij këshilli është edhe që “të bashkëpunohet ngushtë me prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta, me mësimdhënësit e klasës së tyre, me institucionet komunale të arsimit dhe ato qendrore lidhur me realizimin e së drejtës së shkollimit të barabartë për të gjithë fëmijët e atij lokaliteti”.

---

<sup>140</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, f. 16

Nga këto përcaktime si dhe nga detyrat konkrete të këtij këshilli mund të gjykojmë se krijimi i një partneriteti të mirëfilltë prind-shkollë, i konceptuar në atë mënyrë që të arrijë qëllime të përbashkëta në përfshirjen e shoqërisë civile në identifikimin e prioriteteve dhe avancimin e performancës së funksionalitetit të shkollës në përgjithësi, është një prej qëllimeve strategjike të organeve udhëheqëse kompetente arsimore në të gjitha nivelet. Mobilizimi i sa më shumë njerëzve, e dëshirueshme sa më kompetentë, mundëson identifikimin sa më të qëlluar të nevojave prioritare dhe mësimi i sa më shumë përvojave që janë në funksion të aktivitetit konkret të shkollës. Identifikimi i prioriteteve mbetet çështje përherë e papërfunduar, sepse çdo rrethanë kohore apo tjetër lind nevoja të reja dhe shtron kërkesa për përmbushjen e tyre, që pastaj kërkon angazhimin e komunitetit të prindërve për t'u arritur këta objektiva. Këtu duhet parë rolin vendimtar të Këshillit të prindërve si organ kontrubutdhënës në çdo aspekt.

Realizimi sa më i suksesshëm i objektivave programorë të shkollës është nga detyrat e parapara të këtij këshilli. Duke i specifikuar në detaje punët që janë në funksion të avancimit të aktiviteteve të përgjithshme të shkollës, prindërit kanë të drejtë të paraqesin ankesa të ndryshme qoftë rreth cilësisë së mësimdhënies, qoftë rreth çështjeve të tjera që lidhen me shkollën e drejtori i shkollës, apo edhe të organet më të larta arsimore komunale a në Ministrinë e Arsimit.

#### **4.5.2. Funksionimi i Këshillit të prindërve**

Duke qenë strukturë e organizuar sipas ligjit, ky këshill formohet në fillim të çdo viti shkollor, i cili pastaj aprovon një rregullore të punës, në bazë të së cilës zhvillon aktivitetin e tij gjatë atij viti shkollor. Këshilli i prindërve zgjidhet me vota të fshehta nga një numër më i madh i prindërve pjesëmarrës në tubim. Si parim, çdo institucion shkollor zgjedh prej çdo klase nga një prind që përfaqëson tërë klasën, kështu që struktura përbërëse e Këshillit nuk është e limituar, por duhet të reflektojë përbërjen e përgjithshme të numrit të klasave në shkollë.

Anëtarët e këshillit zgjidhen për një vit shkollor, ata edhe mund të rizgjidhen nëse kanë fëmijë në shkollë, e pastaj këta zgjedhin kryetarin e këshillit. Këshilli i prindërve u jep rekomandime organeve të shkollës, drejtorit dhe Këshillit drejtues të shkollës, në lidhje me çështje që vlerëson se meritojnë ndërhyrjen e tyre. Ky këshill duhet të mblidhet së paku 4 herë brenda vitit shkollor, por, sipas nevojave, mund të mblidhet edhe më shpesh.

Si vlerësim i përgjithshëm mund të përfundohet se funksionimi i këtij këshilli është me shumë rëndësi, bile i rëndësisë së veçantë po të kihet parasysh roli i tij si një mbikëqyrës dhe rekomandues i punëve në shkollë, me kusht që ky këshill të jetë aktiv dhe i pandikuar në punën e tij.

Në bazë të Ligjit për Arsimin Fillor dhe të Mesëm është formuar Këshilli i Prindërve i Arsimit të Kosovës (KPAK), si organ qendror që duhet ta përfaqësojë interesin e prindërve në nivel qendror dhe të shërbejë si kanal komunikimi në mes të MASHT-it dhe prindërve, mirëpo praktika aktuale nuk dëshmon se ka një komunikim të tillë, aq më pak se roli i këtij këshilli është funksional.

“Prindërit janë të mendimit se shkolla duhet t’i ftojë ata në mbledhje të prindërve... duke u deklaruar se ata ftohen rrallë nga shkolla dhe duke pohuar se të paktën dikush në familjen e tyre është i aftë dhe kompetent për të shfrytëzuar për të mirë mbledhjet me prindër, por edhe ka për detyrim ta bëjë një gjë të tillë. Edhe më e madhe është përqindja e prindërve që pohojnë se pjesëmarrja e tyre në këto takime ndihmon fëmijën e tyre”<sup>141</sup>.

#### **4.6. Këshilli i nxënësve**

Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës, në çdo shkollë duhet të funksionojë edhe Këshilli i nxënësve. Ekzistimi i këtyre këshillave është menduar të jetë në funksion të

---

<sup>141</sup> . Gashi Shkelzen, Popovci Dukagjin: “Këndvështrimi i prindërve për pjesëmarrje në jetën e shkollës në Kosovë”, KEC, Prishtinë 2010, f. 15

përmirësimin të mjedisit mësimor në shkollë, të kushteve të punës, sidomos të atyre që janë drejtpërdrejt në interes të mirëqenies së nxënësve. Krejt kjo me qëllim që zëri i nxënësve të dëgjohet dhe të jetë i respektueshëm në procesin e përgjithshëm të punës në shkolla, ngase në fund të fundit, vetë ekzistimi i shkollës ka kuptim vetëm me nxënësin në qendër të saj, prandaj çdo angazhim për përmirësimin e kushteve të nxënësve në shkollë është jo vetëm i ligjshëm, por edhe i domosdoshëm.

Nga detyrat më parësore të këtij këshilli janë:

- Angazhimi në ngritjen e kushteve objektive në klasë dhe përgjithësisht në objektin shkollor;
- T'i identifikojë nevojat prioritare dhe t'ia raportojë drejtorit dhe Këshillit drejtues të shkollës;
- Përfaqësues të këtij këshilli të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit drejtues të shkollës, në mënyrë që edhe me këtë pjesëmarrje të japin kontributin e tyre në përmirësimin e kushteve të punës në shkolla.

#### **4.6.1. Struktura dhe funksionimi i Këshillit të nxënësve**

Këshilli i nxënësve duhet të themelohet me fillimin e çdo viti shkollor. Në disa shkolla, sidomos në ato që kanë paralele të ndara ose më shumë klasë, është praktikë që fillimisht të themelohet një kuvend i nxënësve, me përfaqësues nga të gjitha paralelet, e pastaj kuvendi të themelojë këshillin, respektivisht të delegojë nxënësit për këtë këshill.

Këshilli i nxënësve duhet të mblidhet sa herë që vlerëson se ka ndonjë iniciativë konkrete, por së paku një herë në 3 muaj. Në çdo tubim nxënësit duhet të organizojnë debate në interes për nxënësit, shkollën a rrethin, të japin iniciativa të ndryshme, të përkushtohen për nxjerrjen e revistës së shkollës, bile një herë brenda vitit shkollor, në mos në secilin gjysmëvjetor nga një.

Në këtë kontekst, drejtori i shkollës, Këshilli drejtues dhe ai i prindërve e kanë për obligim t'u ofrojnë përkrahje profesionale nxënësve në



angazhimet e tyre, t'u bëjnë të mundur sigurimin e hapësirave të nevojshme për angazhim si dhe të merren seriozisht me kërkesat e nxënësve, me propozimet e tyre, të çfarëdo natyre qofshin ato, por gjithsesi që kanë të bëjnë me aktivitetet shkollë.

## **Përfundime**

Roli dhe detyrat e organeve të shkollave duhet të konsolidohen, të funksionalizohen dhe të kërkohet nga to, që organet kompetente të tregojnë performancë profesionale në udhëheqjen e shkollës, si dhe rezultate konkrete, gjithsesi të dukshme, në mbarëvajtjen e punëve në shkolla.

Të gjitha këto hallka të menaxhimit të një institucioni shkollor duhet t'i koordinojnë aktivitetet e tyre, në mënyrë që shkolla të funksionojë si një tërësi efikase, ku cilësia e mësimi të jetë në krye të prioriteteve, duke e pasur si misionin qendror të të gjitha angazhimeve. Natyrisht se edhe aktivitetet jashtëmësimore duhet kushtuar rëndësinë e nevojshme, sidomos me angazhimin e prindërve dhe të komunitetit që është i lidhur me shkollën, që kjo të mundësojë që ambienti brenda objektit shkollor të jetë i përshtatshëm dhe joshës për nxënësin dhe ta motivojë atë për nxënie, por po aq i rëndësishëm duhet të jetë edhe mjedisi rreth shkollës, duke reflektuar një kulturë ambienti të standardeve të kohës.

Pra, duke e parë se organet e shkollës kanë rol shumë domethënës në mbarëvajtjen e përgjithshme të punëve në shkolla, gjithsesi realizimi i një udhëheqje profesionale, efikase dhe bashkërenduese është kërkesë e domosdoshme dhe obliguese nga ligjet përkatëse, e cila duhet të mbikëqyret nga organet kompetente arsimore. Pa dyshim, roli i drejtorit mbetet kyç dhe përcaktues, ngase prej tij kërkohet koordinim i të gjitha aktivitetet në shkollë. Ai i mobilizon dhe i inkurajon të gjitha strukturat udhëheqëse të shkollës, kështu që përzgjedhjes së tij

gjithmonë duhet kushtuar rëndësi të veçantë, duke u përcaktuar për kandidatin që i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara.

Ndërsa, po aq e rëndësishme për një performancë të suksesshme në mësimdhënie dhe në mësimnxënie është përgatitja profesionale e mësimdhënësve. Prandaj edhe përzgjedhja e tyre duhet t'i nënshtrohet një kriteri sa më profesional, duke pasur parasysh edhe mundësinë e trajnimeve të herëpashershme, për t'i përcjellë arritjet bashkëkohore që kanë të bëjnë me procesin mësimor.

Nga ana tjetër, komuniteti i prindërve duhet të jetë gjithëherë i angazhuar dhe aktiv, në mënyrë që të ketë mundësinë t'i shprehë pikëpamjet e tyre për cilësinë e procesit mësimor dhe kualitetin e përgjithshëm të menaxhimit të shkollës.

## **Rekomandime**

Duke u mbështetur në të gjitha këto konkludime, rekomandojmë:

- Të hartohen një strategji për organet e shkollave dhe doracakë përkatës;
- Gjithmonë t'i kushtohet kujdes i veçantë zgjedhjes së drejtorit të një institucioni, duke pasur parasysh relevancën e tij përcaktuese në performancën e atij institucioni;
- Të mbretërojë mirëkuptimi maksimal dhe besimi i plotë i ndërsjellë në mes të drejtorit, zëvendësdrejtorit dhe organeve të tjera udhëheqëse të shkollës;
- Të bëhet një komunikim i rregullt i organeve drejtuese të shkollave me rrethin dhe bashkësitë e tjera të lidhura në çfarëdo mënyre me shkollën;
- Drejtorët e shkollave të jenë më të hapur dhe bashkëpunues me organet e shkollës;
- Të ketë qasje profesionale dhe angazhim të përbashkët në zgjidhjen e çdo problemi eventual që paraqitet në shkollë;

- Të ndërtohet një vizion i përbashkët në mes të këtyre partnerëve si parakusht për një performancë të mirë në shkollë;
- Të mos ketë dilema e dyshime për angazhimin dhe aktivizimin e prindërve, edhe jashtë Këshillit të prindërve, për një cilësi më të mirë të punës në shkolla;
- Të funksionalizohet dhe të fuqizohet një bashkërendim i të gjitha aktiviteteve në shkollë nëpërmes informimit të mirëfilltë rreth politikave dhe procedurave të organeve të shkollave;
- Të bëhet mbikëqyrja, kontrolli dhe stimulimi për angazhime të shtuara të të gjitha organeve kompetente arsimore në nivel vendi, si dhe
- Monitorimi të jetë parakusht për rezultate të gjithanshme në çdo institucion shkollor dhe për një kualitet të ri të udhëheqjes së shkollës.

### **Referencat:**

1. Deva A-Zuna, “Partneriteti shkollë-familje-komunitet”, Prishtinë 2009
2. Divna Shipoviq , Gule Gulev, George Mikollov, etj., “Doracak për këshillat e shkollave fillore dhe të mesme”, raport nga interneti, Shkup, 2008,
3. Fullan Majkëll, “Forca e ndryshimit”, Tiranë 2002
4. Grup autorësh: “Kërkime pedagogjike”, Instituti Pedagogjik i Kosovës, nr. 2, Prishtinë 2012.
5. Gashi Sh. Pupovci D., “Këndvështrimi i prindërve për pjesëmarrje në jetën e shkollës në Kosovë”, KEC, Prishtinë 2010
6. Gega Fatbardha: “Për ju mësues dhe prindër”, Tiranë 2002
7. Grup autorësh: “Qeverisja në arsim”, Prishtinë 2003
8. GIZ: “Udhëheqja dhe menaxhimi i personelit”, Prishtinë 2012
9. GIZ: “Plani zhvillimor i shkollës”, Prishtinë 2012
10. GIZ: “Shkolla e mirë”, Prishtinë, 2012

11. GIZ: “Komunikimi dhe bashkëpunimi”, Prishtinë, 2012
12. GIZ: “Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007- 2017”, Prishtinë 2012
13. Koliqi Hajrullah, “Sistemi i arsimit në Kosovë”, Prishtinë 2004
14. Kuvendi i Kosovës, 2008. Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.
15. “Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës”, Prishtinë, 2011
16. Pupovci, D. Tafarshiku N., “Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë”, Prishtinë, 2008
17. [http://www.gazetazyrtare.com/egov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=155&Itemid=56](http://www.gazetazyrtare.com/egov/index.php?option=com_content&task=view&id=155&Itemid=56).


[http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Strategjia\\_per\\_zhvillimin\\_e\\_arsimit\\_parauniversitar\\_ne\\_Kosove](http://www.mashtgov.net/advCms/documents/Strategjia_per_zhvillimin_e_arsimit_parauniversitar_ne_Kosove)

MA. Osman Buleshkaj  
M. Sc. Selim Mehmeti

STANDARDET E PRAKTIKËS PROFESIONALE TË  
DREJTORËVE TË SHKOLLAVE NË KOSOVË – INSTRUMENTE  
PËR VETËVLERËSIM TË PËRFORMANCËS DHE  
VETËZHVILLIM PROFESIONAL

*Objektivi i këtij shkrimi është nxitja dhe motivimi i drejtorëve të shkollave në përvetësimin dhe praktikimin, në mënyrë të vazhdueshme, të standardeve të praktikës profesionale gjatë planifikimit, udhëheqjes, administrimit, organizimit dhe menaxhimit të punës së shkollës, me qëllim të arritjes së vlerave të edukimit cilësor.*

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të drejtorëve të shkollave në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka nxjerrë udhëzimin administrativ për standardet e praktikës profesionale për drejtorët e shkollave. Këto standarde janë hartuar rreth gjashtë fushave kryesore të udhëheqjes së shkollave. Ato përbëjnë atë se çfarë pritet të dinë drejtorët e shkollave, si dhe çfarë aktiviteteve duhet të kryejnë, me qëllim të arritjes së secilit standard.




Secila nga këto fusha kryesore (standarde) të praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave përfshin një numër të pritjeve në lidhje me njohuritë dhe të kuptuarit e drejtorëve të shkollave në fushën përkatëse të udhëheqjes. Ato i theksojnë treguesit e performancës përmes së cilëve mund të vlerësohet përmbushja e secilit standard<sup>142</sup>. Këto standarde, si dhe treguesit e njohurive dhe të performancës, janë të ndërvarura ndërmjet vete dhe plotësojnë reciprokisht njëri-tjetrin. Drejtorët e suksesshëm të shkollave, varësisht prej kontekstit ku punojnë, do të vazhdojnë të integrojnë aktivitete të reja me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre të përgjithshme.

<sup>142</sup> Më gjerësisht për njohuritë, të kuptuarit dhe treguesit e performancës për secilin standard të praktikës profesionale për drejtorët e shkollave në Kosovë shih Udhëzimin Administrativ 04/2012 datë 02.05.2012 ([www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net))

## Për çfarë shërbejnë standardet e praktikës profesionale për drejtorë të shkollave në Kosovë?

Standardet për drejtorët e shkollave kanë një varg përdorimesh. Ato do të shërbejnë si pika referimi kur caktohen politika dhe praktika për punësimin dhe zhvillimin profesional të menaxherëve të shkollave. Këto standarde do të ofrojnë udhëzime për të gjitha palët e interesit të shkollës që ofrojnë programe të zhvillimit profesional për drejtorë të shkollave, udhëzime/kritere për akreditimin dhe vlerësimin e këtyre programeve.

Standardet e përcaktojnë një pikë të përgjithshme të referencës për sistemin dhe për instrumentet e vlerësimit të performancës së drejtorëve të shkollave, të theksuara si aktivitetet për arritjen e secilit standard. **Së fundmi**, *standardet paraqesin një varg instrumentesh për menaxherët që të bëjnë vetëvlerësim; vetëzhvillim dhe reflektim të praktikës së tyre profesionale.* Qëllimet e aplikimit të standardeve përshkruhen më së miri përmes diagramit më poshtë.



Si mund ta vetëvlerësojë performancën e tij një drejtor shkolle në bazë të treguesve të performancës së standardeve për drejtorë të shkollave? Njëri prej qëllimeve të përdorimit të standardeve të praktikës profesionale për drejtorët e shkollave është shfrytëzimi i tyre si instrumente për vetëvlerësim të praktikës profesionale. Kjo nënkupton se secili drejtor shkolle duhet të bëjë një analizë të detajuar, në bazë të këtyre standardeve, në një periudhë të caktuar kohore, me qëllim që ta kuptojë me kohë se cilat janë përparësitë e tij/saj, të cilat duhet të mbahen edhe më tutje dhe të përforcohen, si dhe cilat janë aspektet të cilat duhet t’i përmirësojë.

Vetëvlerësimi mund të bëhet në pesë nivele. Për secilin nivel mund të përdoren pikët e vlerësimit, në bazë të sistemit të notave në arsimin parauniversitar. Nivelet e vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe pikët e vlerësimit mund të jenë si në vijim:

Nivelet	Pikët
Shumë i lartë	5
I lartë	4
Mesatar	3
Nënmesatar	2
I dobët	1

Drejtori mund ta bëjë vetëvlerësimin vetëm për një standard, d.m.th. në bazë të treguesve të performancës për standardin përkatës, për shembull në standardin për udhëheqje dhe motivim – në bazë të treguesve të performancës për këtë standard. Ose mund ta bëjë një vetëvlerësim të gjithmbarshëm për të gjitha standardet e praktikës profesionale për drejtorët e shkollave.

Duke e pasur parasysh se standardet e praktikës profesionale për drejtorë të shkollave po aplikohen për herë të parë në Kosovë, preferohet që vetëvlerësimi i parë të jetë një vlerësim i gjithmbarshëm, i cili i përfshin të gjitha standardet, për shkak se kjo krijon një mundësi që përmirësimi i praktikës profesionale të drejtorëve të fillojë me standarde dhe me fusha specifike të atyre standardeve, e pastaj mund të punojnë me to sipas prioritetit. Më pastaj, ai/ajo bën vlerësimin e



herëpashershem të përmirësimit të standardit, në të cilin ka punuar në bazë të aktiviteteve që i ka ndërmarrë në lidhje me aspekte të caktuara.

**Si mundet që një drejtor shkolle të bëjë vetëvlerësim të drejtë dhe të paanshëm për përmbushjen e standardeve të praktikës profesionale?**

Për të bërë një vetëvlerësim të paanshëm dhe të drejtë, drejtori i shkollës duhet t'i respektojë këto mundësi:

Mundësia I	Secili drejtor shkolle duhet ta shohë vetëvlerësimin si një mundësi për përmirësim dhe vetëvlerësim. Kjo nënkupton se ai drejtor që e vlerëson vetveten duhet të jetë i motivuar që ta bëjë vetëvlerësimin në mënyrë objektive.
Mundësia II	Instrumenti i vlerësimit duhet t'i jepet një kolegu, i cili e njih mirë performancën e drejtorit të shkollës, i cili i bashkë-ndan kriteret për vlerësim dhe i cili i aplikon ato kriteret me objektivitet.
Mundësia III	Vetëvlerësimi është pjesë e vlerësimit të performancës së shkollës, instrumenteve, pyetësorëve anonimë me nxënës, mësimsdhënës dhe prindër, për aspekte të caktuara të aktiviteteve shkollore/institucionale, por të cilët nuk kanë pyetje të drejtpërdrejta për drejtorin e shkollës/institucionit. Zbatimi i pyetësorëve me palët kryesore të interesit krijon një mundësi të mirë për secilin drejtor të shkollës që ta plotësojë me më saktësi vetëvlerësimin sa i përket caktimit të pikëve për performancën e tij/saj në lidhje me standardet e praktikës profesionale.

## Një shembull i simuluar për vetëvlerësimin e përfundimit në përbushjen e një standardi<sup>143</sup>

Nr.	Standardi – Udhëheqja dhe motivimi / Treguesit e përfundimit	Pikët
1	Ai/ajo komunikon dhe udhëhiqet prej një filozofie të edukimit, e cila bazohet në hulumtime të mirëfillta, në përvojën dhe reflektimin personal;	3
2	Ai/ajo e përfshin bashkësinë shkollore (duke përfshirë aspekte të barazisë gjinore, pakicave etnike, të mësimdhënësve, të prindërve, të nxënësve, dhe të bashkësisë) në zhvillimin e planeve strategjike dhe planeve vjetore të punës;	2
3	Ai/ajo e dizajnon dhe i menaxhon procedurat operative që kanë të bëjnë me planet e shkollave për t'i shfrytëzuar në maksimum mundësitë për të nxënë të suksesshëm;	2
4	Ai/ajo i përdor të dhëna relevante demografike që kanë të bëjnë me nxënësit dhe familjet e tyre gjatë hartimit të një misioni dhe të qëllimeve të shkollës;	3
5	Ai/ajo e komunikon vizionin dhe misionin e shkollës me efikasitet tek personeli, prindërit, nxënësit dhe pjesëtarët e bashkësisë;	3
6	Ai/ajo siguron që vizioni, misioni dhe planet e zbatimit të monitorohen dhe vlerësohen rregullisht, si dhe të rishikohen sipas nevojës;	2

<sup>143</sup> Nëse një drejtor i shkollës dëshiron të shfrytëzojë këtë metodologji të vetëvlerësimit, atëherë, përgatit nga një tabelë të e ngjashme për secilin standard të praktikës profesionale për drejtorë të shkollave. Në secilën tabelë vendos të gjithë treguesit e përfundimit për standardin përkatës dhe hapësirën e zbrazët për pikët e vlerësimit. Bën një vlerësim të paanshëm dhe korrekt, pastaj ndjek hapat për vetëzhvillim profesional me qëllim të arritjes së standardeve të praktikës profesionale.

7	Ai/ajo i identifikon, i qartëson, dhe merret me pengesat, duke përfshirë edhe ato shoqërore, për arritjen e vizionit;	2
8	Ai/ajo sigurohet që planifikimi, vendimmarrja dhe zbatimi i strategjive bazohet në një vizion të përbashkët dhe në të kuptuarit e kulturës së shkollës;	2
9	Ai/ajo e ndihmon ndryshimin si dhe e promovon inovacionin në pajtim me nevojat aktuale dhe të ardhme të bashkësisë shkollë;	3
10	Ai/ajo i analizon një numër të dhënash (sipas nevojës, të dhëna të ndara për gjininë) për ta përcaktuar progresin drejt arritjes së qëllimeve të shkollës, duke përfshirë të dhëna për vlerësimin e të nxëniet;	2
11	Ai/ajo i komunikon dhe i feston të arriturat e shkollës për nxitje të zhvillimit të vazhdueshëm;	3
12	Ai/ajo i raporton personelit, këshillit udhëheqës të shkollës; bashkësisë dhe komunës sa i përket nivelit të arritjeve në lidhje me planet strategjike dhe vjetore	2
<b>Gjithsej pikë</b>		29
Mesatarja e pikëve 29 (pikë) : 12 (tregues) = 2.42 pikë		2.42

Vlerësimi i gjithmbarshëm i përmbushjes së **Standardit 1 – Udhëheqja dhe motivimi** është i nivelit nënmesatar. Duke pasur parasysh nivelin e arritjes së këtij standardi, kërkohen aktivitete për vetëzhvillim profesional me qëllim të përmbushjes së këtij standardi të praktikës profesionale për drejtor të shkollës.

Pra, në këtë mënyrë mund të bëhet vetëvlerësimi i performancës për secilin standard të praktikës profesionale për drejtorë të shkollave, ku bazë e vetëvlerësimit janë treguesit e performancës së secilit standard, përkatësisht aktivitetet për arritjen e standardeve.

## Si mundet që një drejtor i shkollës ta njohë dhe ta kuptojë më mirë një standard të praktikës profesionale të drejtorit të shkollës dhe të fillojë vetëzhvillimin profesional?

Vetëvlerësimi i drejtë dhe i paanshëm për përmbushjen e standardeve të praktikës profesionale është i lidhur ngushtë me shkallën e njohurive dhe të kuptuarit të standardeve të praktikës profesionale. Për këtë kontekst është ngritur pyetja: *Si mundet që një drejtor i shkollës ta njohë dhe ta kuptojë më mirë një standard të praktikës profesionale të drejtorit të shkollës dhe të fillojë vetëzhvillimin profesional?*

Në përgjigje të pyetjes së ngritur janë dhënë disa hapa me përshkrim të aktiviteteve që çojnë një drejtor shkolle drejt njohjes dhe të kuptuarit të drejtë të standardeve të praktikës profesionale dhe rrjedhimisht drejt vetëzhvillimit profesional të drejtorëve të shkollave në arritjen e standardeve të praktikës profesionale.

Hapat	Përshkrimi i aktiviteteve
<b>Hapi i parë</b>	Vendosni se në cilin standard do të përqendroheni gjatë një periudhe të caktuar kohore. <b>Për shembull: Standardi 1: Udhëheqja dhe motivimi.</b>
<b>Hapi i dytë</b>	Analizoni në esencë përshkrimin e standardit <b>Udhëheqja dhe motivimi: Drejtori i shkollës e promovon suksesin e shkollës dhe të nxënësve të tij duke dhënë ndihmën në zhvillimin, artikulimin dhe zbatimin e një vizioni për mësim, i cili reflektohet në vlera të përbashkëta të shkollës, në mision, qëllim dhe mësimdhënie në klasë.</b> <b>Pyetjet kryesore:</b> Çka nënkupton kjo për praktikën/punën e drejtorit? Si e kuptoj unë përshkrimin e këtij standardi? Çfarë duhet të ndërmerret që të mësoj më shumë rreth këtij standardi?
<b>Hapi i tretë</b>	Veçojeni ndonjë aspekt të këtij standardi që duhet ta mësoni më shumë dhe ta kuptoni më mirë. <b>Për shembull, aspektin e këtij standardi:</b>

	<b>Komunikimi efektiv.</b>
<b>Hapi i katërt</b>	<p><b>Parashtroni pyetje në lidhje me komunikimin efektiv, bie fjala si:</b></p> <p>Cilat janë objektivat për komunikim të brendshëm të shkollës?</p> <p>Cili është roli i drejtorit në procesin e komunikimit në shkollë?</p> <p>Si mund ta zhvillojmë kulturën e komunikimit në shkollë?</p> <p>Cilat janë disa parime të komunikimit që duhet të respektohen?</p> <p>Si të krijohet besimi gjatë komunikimit?</p> <p>Cilat janë nevojat e domosdoshme për komunikim?</p> <p>Si ta shpërndaj informacionin në shkollën time?</p> <p>Cilat janë disa mënyra praktike dhe të dobishme të komunikimit me prindër?</p>
<b>Hapi i pestë</b>	<p>Reflektoni dhe përgjigjuni në këto pyetje. Identifikoni pyetjet që nuk mund t’ju përgjigjeni qartë dhe në detaje. Gjeni literaturë dhe burime profesionale, si dhe kolegë që mund t’ju ndihmojnë t’ju përgjigjeni si duhet këtyre pyetjeve.</p>
<b>Hapi i gjashtë</b>	<p>Hartojeni një strategji dhe zbatojeni atë me synimin që t’i zgjeroni njohuritë tuaja për aspektet e veçanta të komunikimit, të cilat i keni identifikuar, si: <i>diskutoni dhe reflektoni me kolegë më me përvojë, lexoni materiale dhe module të trajnimit që e trajtojnë këtë temë, merrni pjesë në programe të udhëheqjes dhe programe të tjera të trajnimit, simuloni role ku e praktikoni komunikimin efektiv etj.</i></p>
<b>Hapi i shtatë</b>	<p>Ndërmerrni aktivitete në shkollën tuaj, si fjala vjen: <i>komunikojani vizionin e shkollës suaj personelit mësimor i shkollës, prindërve dhe pjesëtarëve të komunitetit; komunikojini arritjet e nxënësve dhe</i></p>

	<p><i>rezultatet e përformancës së personelit para personelit të shkollës suaj;</i></p> <p>Pasi i keni ndërmarrë aktivitetet e lartë shënuara, reflektoni se si keni komunikuar, çfarë shkoi në rregull dhe çfarë duhet të përmirësohet ende në stilin tuaj të komunikimit.</p>
<b>Hapi i tetë</b>	<p>Reflektoni për njohuritë e fituara dhe të kuptuarit e komunikimit efektiv gjatë kësaj faze dhe se cilat ishin rezultatet e këtyre aktiviteteve të komunikimit, të cilat i keni zhvilluar. Merrni vendime të informuara mirë dhe bëni ndryshimet e nevojshme për aktivitetet tuaja në të ardhmen.</p>

Në këtë mënyrë mund të veprohet për secilin standard të praktikës profesionale, ku bazë për vetëzhvillim profesional mund të jenë rezultatet e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të përformancës së drejtorit të shkollës.

## **Përfundimi**

Nga ajo që u prezantua në këtë shkrim, vijmë në përfundim se standardet për drejtorët e shkollave janë të obligueshme për të gjithë drejtorët e shkollave, pa marrë parasysh lokacionin e shkollës, gjuhën apo specifikat e tjera. Ato në mënyrë të veçantë kanë për synim të ofrojnë një kornizë për vetëvlerësimin e përformancës së drejtorëve dhe për vetëzhvillim profesional, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit që duhet të ofrojnë shkolla dhe sistemi i arsimit në Kosovë.

Vetëzhvillimi profesional i bazuar në njohuritë, të kuptuarit dhe treguesit e përformancës së standardeve të praktikës profesionale, krahas me zhvillimin profesional përmes trajnimeve për drejtorë të shkollave dhe formave të tjera të zhvillimit profesional, i ndihmon drejtorët e shkollave për të planifikuar, udhëhequr, administruar, organizuar dhe menaxhuar shkollën, procesin mësimor, me efikasitet dhe efektivitet të lartë.

***Ne ju inkurajojmë që ta bëni këtë. Suksese!***

Zehrie Plakolli

## PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I PUNËS SË SHKOLLËS

### **Hyrje**

Duke e ditur se vlera më e madhe e njerëzimit është dija dhe mënyra e organizimit të përfitimit të dijes është institucioni arsimor-shkolla, duhet të synohet që ky institucion të jetë sa më i avancuar në aspektin e cilësisë, në mënyrë që shoqëria të shkojë rrugës së duhur të zhvillimit. Parakusht i domosdoshëm i një sistemi arsimor, i cili do ta kryejë funksionin e vet dhe do ta arrijë synimin e tij është planifikimi dhe menaxhimi cilësor i institucionit arsimor (shkollës). Që shkolla të jetë një transmetues cilësor i dijes, duhet t'i ketë të avancuara dy pikat kryesore të saj: planifikimin dhe menaxhimin e punës. Planifikimi i punës së shkollës është pjesë e politikës arsimore të shtetit, komunës, shkollës, por edhe familjes e komunitetit. Plani shkollor është dokument në të cilin parashihen aktivitetet e të gjitha subjekteve të shkollës dhe bashkëpunëtorëve jashtë saj, për një afat të caktuar- 1, 3, 5-vjeçar, por nuk është trajtuar shumë (sidomos vitet e fundit) në ligje dhe në udhëzime çështja e planifikimit. Pra, nuk ka ndonjë dokument, udhëzim konkret a model, në të cilin përcaktohet struktura, forma dhe koha se kur duhet bërë një plan vjetor apo edhe zhvillimor i shkollës. Për këtë arsye, qëllimi i këtij punimi është studimi i aspektit planifikues dhe menxhues të shkollës dhe evidentimi i gjendjes reale të kapaciteteve njerëzore të këtyre aspekteve në shkolla. Po ashtu, në këtë punim këto dy problematika të punës së shkollës do të jenë të vështruara dhe të ballafaquara në dy aspekte (fakte):

1. Planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës, sipas dokumentacionit të fundit legjislativ të MASH-it;
2. Planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës sipas hulumtimit (fakteve) në terren.

Duke u bazuar në këto dy lloj faktesh: infrastrukturën ligjore dhe bazën reale në shkolla, vërehen ndryshime të shumta, të cilat ky studim ka synim të ndikojë që në të ardhmen të jenë sa më minimale.

### **1. Planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative të MASHT-it**

Në sistemin tonë arsimor janë bërë shumë ndryshime dhe secili prej tyre ka pasur si qëllim avancimin, zhvillimin dhe perfeksionimin e këtij sistemi, i cili patjetër që si objektiv e ka shkollën si institucion arsimor dhe si synim ngritjen e shoqërisë në aspektin edukativo-arsimor. Të gjitha këto ndryshime kanë bazë ligjore, formë udhëzimi apo formë rregullash, të cilat synojnë ta “drejtojnë” dhe ta ndihmojnë funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (në të cilat, aq sa mundet, do të bazohet puna e shkollës përgjithësisht).

Pa dashur që të rishkruajmë këto ligje, udhëzime, dhe parimet e tyre, ne do t'i paraqesim këtu vetëm aspektet planifikuese e menaxhuese të shkollës, sipas këtyre dokumenteve të përpiluara nga politikëbërësit arsimorë.

Sipas Ligjit për arsimin parauniversitar të Kosovës (gusht-2012), të gjitha aktivitetet e shkollës duhet të jenë të decentralizuara, të shpërndara në sistem. Po ashtu, të shpërndara duhet të jenë edhe përgjegjësitë dhe llogaridhënia, sepse kuptohet që mënyra e centralizuar e planifikimit dhe menaxhimit të punës së shkollës është joefikase. Një drejtor i vetëm nuk mund të kryejë punë efektive dhe të mbajë përgjegjësi si i vetëm. Kështu që, me decentralizim kuptojmë shpërndarjen e punëve dhe përgjegjësisive tek një sistem i tërë faktorësh shkollorë (mësuesit, personeli administrativ, nxënësit, prindërit dhe bashkëpunëtorët e shkollës) në mënyrë të planifikuar.

Në funksionimin e një shkolle cilësore faktorë të suksesit duhet të jenë organet (këshillat) brenda shkollës, fushëveprimi i të cilave është i rregulluar me bazë ligjore për arsimin parauniversitar. Po ashtu, sipas Ligjit të fundit për arsimin parauniversitar organi më i lartë qeverisës i shkollës është Këshilli Drejtues. Ky këshill i harton planet e punës së



shkollës dhe rregullat specifike të saj. Pastaj ky i angazhon dhe i bënë përgjegjës personelin brenda shkollës dhe përfaqësuesit e prindërve dhe DKA-së. Të gjithë këta, së bashku, duhet të hartojnë planin e punës së shkollës dhe të marrin vendimet e nevojshme lidhur me këtë. Këshilli Drejtues i shkollës i përpilon edhe rregulloret specifike (sipas nevojave) të shkollës për: nxënësit, prindërit, për rendin shtëpiak të shkollës dhe për aktivitetet jashtëkurrikulare. Anëtarët e Këshillit Drejtues janë përgjegjës ndaj nxënësve, personelit të shkollës, prindërve dhe DKA-së. Ata veprojnë vetëm si ekip. Prandaj, sipas Ligjit për arsimin parauniversitar të Kosovës- neni 17, pika 1, çdo shkollë është e obliguar ta ketë Këshillin Drejtues, i cili përbëhet nga 3 prindër, 2 përfaqësues të komunitetit të emëruar nga DKA-të, 3 mësimitdhënës dhe 1 përfaqësues i nxënësve i niveleve 2 ose 3<sup>144</sup>.

(Po sipas ligjeve dhe udhëzimeve bashkëkohore të zhvillimit arsimor dhe kudo nëpër infrastrukturën ligjore të viteve të fundit, faktori prind është i theksuar dhe i angazhuar në mënyrë të veçantë, sepse, në fakt, objektivi i shkollës është nxënësi, i cili vjen nga familja. Ligji për APU, neni 3, pika 2, thotë: “Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore, komunave dhe qeverisë<sup>145</sup>. Do të thotë se jorastësisht si përgjegjësit e parë janë potencuar prindërit. Shkolla dhe familja janë dy sisteme edukative të ndërlidhura që plotësojnë njëra-tjetrën dhe si anëtar të përbashkët të tyre e kanë nxënësin. Marrëdhëniet në mes të këtyre dyjave (shkollës dhe familjes) ndikojnë në ndjenja, veprime, sukses të fëmijës, si dhe në ecuri e mbarëvajtjeve të përgjithshme të shkollës).

### **Planifikimi i punës së shkollës, si obligim dhe nevojë**

Sipas të gjitha ligjeve të sistemit arsimor dhe udhëzimeve administrative, parashihet që secila shkollë të bëjë planin vjetor dhe zhvillimor, kurse si udhërrëfyes i ecurisë së shkollës është Plani

<sup>144</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës –nr. 04/L-32

<sup>145</sup> Po aty.

zhvillimor i shkollës. Ky është mjet për zhvillim dhe instrument matës që reflekton gjendjen në shkollë. Plani zhvillimor i shkollës është një proces i tërë i menaxhimit, një sistem i tërë punësh të shpërndara në të gjitha segmentet dhe faktorët e shkollës (personeli i shkollës, familja, komuna, komuniteti etj.). Qëllimi i çdo aktiviteti të çdo lloj plani është përparimi i procesit të mësimdhënies-nxënies. Pikat orientuese të planit duhet të jenë: orientimi në pasqyra statistikore, të cilat reflektojnë gjendjen ku jemi, e në bazë të tyre të parashohim se çka duhet të arrijmë, çka duhet të ndryshojmë dhe çka të synojmë. Do të thotë, formula prej nga nisët një plan është bërja e një analize SWOT për shkollën, ku paraqiten të gjitha përparësitë, mundësitë, ngecjet dhe dobësitë e shkollës.

Çdo dëshirë, objektivë apo synim, arrihet vetëm përmes planifikimit dhe realizimit të tij. Shkolla, e cila ka kapacitete profesionale planifikuese, del nga lëvizja e planifikimit tradicional e të izoluar. Ajo bën plan bashkëkohor. që do të thotë bën plan bashkëveprues, të hapur me DKA-të dhe me shkollat e tjera, me prindër, me komunitetin etj. (Përmes mobilizimit të këtyre faktorëve në planifikim, është e nevojshme që të përfshihen edhe projektet me prioritet, të cilat mund të realizohen vetëm me angazhim të të gjithë këtyre). Planifikimi i avancuar, përveç kriterëve të tjera, duhet të ketë patjetër pjesën e monitorimit dhe të vlerësimit, pika këto të cilat janë si garantuese për realizim të këtij plani. Kjo pjesë realizohet përmes monitorimit dhe vlerësimit, qoftë të brendshëm apo të jashtëm (nga DKA-të dhe inspektorët e MASHT-it). Sa i përket kësaj pike, deri më tash, nuk kemi pasur dhe as nuk kemi ndonjë instrument vlerësimi dhe as monitorimi të planifikimit apo realizimit të punës së shkollës (ndonjë udhërrëfyes metodologjik apo përmbajtjesor), edhe pse si parim i tretë, pika 3.1.3, i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2007-2017 është parimi i monitorimit-matjes dhe vlerësimit. Ky parim thotë: “Sistemi i arsimit nuk mund të avancohet dhe as të integrohet në sistem bashkëkohor të arsimit pa një sistem shumë të sofistikuar dhe funksional të monitorimit

dhe vlerësimit të procesit edukativo-arsimor<sup>146</sup>. Po ashtu, edhe sipas Ligjit i Arsimit Parauniversitar 2012 thotë se DKA-të duhet të formojnë një ekip profesional për vlerësim dhe përkrahje të nevojshme në institucionet arsimore<sup>147</sup>.

## **Planifikimi dhe menaxhimi, dy aspekte të ndryshme, por që e kushtëzojnë njëri-tjetrin**

Menaxhimi i mirë mbështetet në planifikim të mirë dhe, njëkohësisht, planifikimi i mirë mbështetet në menaxhim të mirë. Menjëherë pas ligjit, është i rëndësishëm udhëheqësi i shkollës, i cili e zbaton ligjin dhe duke e zbatuar atë e përcakton suksesin e shkollës. Gjithnjë në funksion të realizimit të planit të shkollës, drejtori, si kryesues i institucionit arsimor, duhet t'i ketë parasysh, në mënyrë të posaçme, këto fusha të punë së tij: udhëheqje me motivim, mësimdhënie-nxënie cilësore, planifikim e menaxhim në bashkëpunim, si dhe etikë profesionale. Drejtori i shkollës duhet të ketë njohuri dhe të kuptojë Kornizën e Kurrukulumit të Arsimit Parauniversitar, zbatimin e Planit Strategjik të Shkollës, komunikimin efektiv, transparencën dhe llogaridhënie<sup>148</sup>. Vetëm një drejtor me njohuri të tilla garanton suksese në shkollë, sepse ai, duke pasur njohuri për pikat e lartcekura, i zbaton edhe parimet e udhëzimet që dalin nga to, e si rezultat i kësaj është shkolla e avancuar dhe cilësore.

## **2. Gjendja reale e planifikimit dhe menaxhimit të punës së shkollës, sipas rezultateve të dala nga hulumtimi në terren**

Hulumtimi me temën “**Planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës**” është realizuar mbi këtë hipotezë: Planifikimi dhe menaxhimi

---

<sup>146</sup> Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 207-2017( faqe 36).

<sup>147</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar 2011(neni 41, faqe 26).

<sup>148</sup> Udhëzim Administrativ për standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave (2012).

i punës së shkollës është një pikë e brishtë (me shumë dobësi) e sistemit tonë arsimor parauniversitar.

**Qëllimi i hulumtimit:**

Studimi dhe evidentimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese të shkollës.

**Objektivat e hulumtimit:**

1. Të ofrohen më shumë njohuri për gjendjen ekzistuese në planifikim dhe menaxhim të punës së shkollës;
2. Të jepen rekomandime të dala nga terreni (hulumtimi në shkollë dhe punëtorja e realizuar me drejtorë shkollash dhe zyrtarë të DKA-ve) për MASHT-in, DKA-të dhe shkollat, lidhur me këtë aspekt të punës së shkollës.

**Mostra:**

Hulumtimi është bërë në 21 shkolla të rajoneve të ndryshme të Kosovës. Janë anketuar 19 drejtorë, 5 zëvendësdrejtorë dhe 4 zyrtarë të DKA-ve.

**Metodat e hulumtimit:**

Hulumtimi është realizuar përmes metodës së analizës teorike (analizës së ligjeve, udhëzimeve për fushën në fjalë, si dhe materialeve të tjera administrative dhe planeve konkrete shkollore), metodës deskriptive dhe metodës statistikore (përpunimit të rezultateve të të dhënave të dala nga terreni).

**Teknikat e hulumtimit:**

Hulumtimi është bërë përmes anketimit dhe intervistave.

**Instrumentet:**

Pyetëtori për intervistat e strukturuar me kompetentët e kësaj fushe.

## **Të dhënat nga pjesa hulumtuese e studimit, për fushën e planifikimit:**

Sipas të dhënave të dala nga hulumtimi, ekzistojnë zbrazësi dhe mangësi e informacioneve për çështjet kryesore të planifikimit të punës së shkollës, si: nga kush bëhet planifikimi i punës së shkollës, kur bëhet, a ka instrumente të vlerësimit të planit dhe realizimit të tij etj. Lidhur me këto pyetje, kemi marrë përgjigje nga më të ndryshmet, por pothuajse të gjitha ishin joadekuate.

Nga numri i të intervistuarve, drejtorë, zëvendësdrejtorë, mësimdhënës - anëtarë të K. Drejtues, (22 %) mendojnë se planet e shkollës duhet të bëhen në shtator, një pjesë (9%) në mars, një pjesë (43 %) mendojnë që planifikimi i punës së shkollës duhet të bëhet në qershor, kurse pjesa tjetër (26 %) e të intervistuarve nuk kanë ide se kur duhet përpiluar planet e shkollës. Pastaj, 23 % e mësimdhënësve të anketuar, që janë anëtarë të Këshillit Drejtues të Shkollës, mendojnë se këto duhet t'i bëjë vetëm drejtori dhe sipas tyre me rëndësi është plani individual i mësimdhënësve dhe realizimi i tij, kurse plani i shkollës, i cili është i përgjithshëm, nuk ka ndonjë rëndësi të theksuar.

## **Të dhënat nga hulumtimi në terren:**

- Të gjitha shkollat, në të cilat është realizuar hulumtimi (në 21 shkolla), i posedojnë planet vjetore dhe zhvillimore;
- Planet e tyre përgjithësisht janë më shumë formale sesa funksionale (përmbajnë shumë narracion, histori shkollash, përbërjen e personelit, e shumë të dhëna të tjera të panevojshme);
- Planet e shkollave të ndryshme dhe të komunave të ndryshme janë pothuajse të ngjashme (kryesisht të bazuara në ligjet e vjetra);
- Shumicës së planeve u mungojnë specifikat e shkollës;
- Këto plane më shumë u ngjajnë rregulloreve të punës apo ndonjë udhëzimi administrativ sesa një plani operativ të shkollës;
- Shumë (mbi 50 %) nga planet e analizuara i përshkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e tërë personelit të shkollës, që nga drejtori e deri

te shërbyesit teknikë të shkollës, detaje këto që nuk janë aktivitete vjetore, por të përhershme dhe të pandryshueshme, dhe që nuk e kanë vendin në planifikim të punës.

- Asnjë plan nuk e parasheh vlerësimin dhe monitorimin e realizimit të tij, as raportin për përgjegjësitë.
- Mbi 90 % e planeve të studiuara (Planeve Zhvillimore dhe Vjetore të shkollës) i kanë të evidentuara objektivat e tyre, por vetëm si dëshira, pa qenë të paraqitura aktivitetet operative dhe mundësitë për realizimin e tyre.

Plani është pjesa teorike e punës praktike të shkollës, prandaj përpilimi vetëm formal dhe shumë administrativ i tij patjetër që do të rezultojë me ngecje të shumanshme në shkollë.

### **Rezultate të dala nga terreni, në fushën e menaxhimit**

- Shumica e shkollave i kanë të themeluar këshillat e shkollës, por nuk e kryejnë funksionin e tyre.
- Në të gjitha shkollat e kontaktuara, kompetencat e vendimmarrjes dhe të planifikimit i ka vetëm drejtori.
- Në shumë raste, Këshilli Drejtues i shkollës nuk i di kompetencat e veta dhe shumë mësimdhënës mendojnë që për çdo gjë duhet të vendosë drejtori.
- Pothuajse të gjitha shkollat menaxhohen në mënyrë ‘autoritare’ nga drejtori dhe personeli i shkollës nuk di çka përmbajnë ligjet dhe udhëzimet e reja për arsimin parauniversitar.

### **Përfundim**

Janë bërë shumë ndryshime në sistemin e arsimit parauniversitar, por në fushën e planifikimit dhe të menaxhimit të shkollës, pak ka ndryshuar. Dhe, kjo është si rezultat i mosinspektimit dhe monitorimit adekuat, i mungesës së vlerësimit të ecurisë së zhvillimit dhe funksionimit të punës së shkollës, si dhe mungesës së përgjegjësisë dhe

llogaridhënies. (Ne nuk dimë asnjë rast të dhënies së llogarisë apo suspendimit të ndonjë anëtari të personelit të shkollës për dobësi ose papërgjegjësi në punë. Nuk dihet nëse ndonjë shkollë është rrezikuar që të mbyllet, pavarësisht cilësisë së saj infrastrukture apo profesionale. Lidhur me këtë fushëveprim të shkollës, në emër të cilësisë së saj, janë bërë disa angazhime të OJQ-ve të ndryshme, si nga KEC-i, cili shpërndan një model të Planit Zhvillimor të shkollës, apo GIZ-i, cili trajnon drejtor shkollash (në marrëveshje me MASHT-in). Por, në fakt, planifikimi dhe menaxhimi i punës së shkollës janë problematika që funksionojnë akoma me të vjetrën. Kështu që u mbetet kompetentëve, politikëbërësve që të ndërmarrin diçka më serioze lidhur me këto dy çështje kyçe të funksionimit të institucioneve arsimore.

## **Rekomandime:**

### **Për MASHT-in**

- Të hartohet një model apo udhëzim për formën, përmbajtjen, kohën (kur bëhet) dhe mënyrën e planifikimit të punës së shkollës, si dhe një instrument për vlerësimin e tij.

### **Për Drejtoritë Komunale të Arsimit**

- Të aftësojë (përmes trajnimesh) drejtorët dhe anëtarët e Këshillave Drejtues të shkollave, për planifikim dhe menaxhim cilësor të punës së shkollës;
- Të emërojë (zgjedh) drejtorë jopolitikë dhe me performanca profesionale për fushën;
- Të formojë ekipe monitoruese dhe vlerësuese të funksionimit të shkollave brenda komunës së vet.

### **Për shkollat**

- Të sigurojnë informacionet e duhura (ligjet, udhëzimet e reja), në të cilat definoohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit në shkollë;

- Të funksionalizojnë të gjitha organet e shkollës, përfshirë këtu edhe Këshillin e Prindërve (sepse edhe në Ligjin e ri të arsimit parauniversitar thuhet se arsimit parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore, komunave dhe qeverisë”<sup>149</sup>.

## Burimet

1. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë - 2007-2017.
2. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës - 2011.
3. Udhëzimi Administrativ për Standardet e Praktikës Profesionale të Drejtorëve të Shkollave (2012).

---

<sup>149</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-32 (neni 3, pika 2).



**Botues**

Instituti Pedagogjik i Kosovës

**Shtypi**

Shtypshkronja “Teknika”, Prishtinë

Tirazhi: 1000 copë

Katalogimi në botim – CIP

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37(082.1)

Kërkime pedagogjike: përmbledhje punimesh /  
kryeredaktor Nezir Çoçaj. - Prishtinë : Instituti  
Pedagogjik i Kosovës, 2012. - 223 f. : ilustr. me  
ngjyra ; 21 cm.

Parathënie : f. 4-5

1. Çoçaj, Nezir

**ISBN 978-9951-591-05-8**